

# Fatos Kongoli

BIBLIOTEKA  
SHTETIT

SH-32

K 89



# TREGIME

8SH-32

k 89.

1540



~~89947~~

# Fatos Kongoli

TREGIME

SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

## KUR HYJA NË JETË

Atëherë lufta sapo kishte mbaruar dhe ne ishim fare të vegjël. Aq të vegjël, sa luanim me bombat e kuqe italiane, të mbetura andej-këndej nëpër qoshe rrugësh, në gërmadha shtëpish, në këmbët e urave të shkatërruara. Sigurisht, ne nuk e dinim se ato ishin bomba, përndryshe nuk do të na tërhiqte aq tepër ajo lodër e llahtarshme, ku gjetën vdekjen dy djem të lagjes.

Që prej asaj dite, nëna një javë me radhë më mbylli në shtëpi. Për këtë u bënë shkaktare dy fqinje tiranase, të cilat se nga e kishin marrë vesh dhe e trembën për vdekje nënën time, kur i thanë se i biri (domethënë unë) i kishte shpëtuar për mrekulli nga mynxyra, vetëm se rastësisht qenkësh larguar në çastin kur kishte plasur bomba.

Ishte vërtet një torturë e madhe të rrije nga mëngjesi gjer kur ngrysej në dritare dhe të

vështroje shokët që luanin në rrugicë. Ajo ishte një rrugicë e qetë, pranë qendrës së qytetit, me një varg dyqanesh, që radhiteshin njëri pas tjetrit, nga kasapi gjer te samarxhiu. Zakonisht paradite kalonin tri-katër karroca. Pasdite të merrte malli të shihje njerëz dhe, po të mos luanin djemtë e lagjes, ajo me të vërtetë do të katandisej në një rrugicë të mjerë. Nga mbrëmja kalonin burrat, ca burra të vjetër me qeleshe, që shkonnin e faleshin te xhamia aty pranë. Ky ishte çasti kulminant i dëfrimit tonë. Në hynim fshëhurazi në oborrin e xhamisë dhe përgjonim besimtarët tek shtriheshin përmbys mbi hasra. Këpuçët, opingat dhe nallanet i linin jashtë. Atëherë ne ua mbushnim me ujë...

Një ditë Liçi, djali i një fshatari nga Peza, që e kishim komshi, më tregoi zbulimin e fundit të djemve. Pranë urës së madhe të Lanës, përballë hotel «Dajtit», na paskëshin gjetur një tunel. Ai ishte i gjatë, krejt i errët dhe, po të ecje nëpër vijën e ujit që e përshkonte, dilje tutje, në një mëngë lumi, pranë stadiumit të futbollit. Ata ishin futur pesë vetë dhe nga mesi i rrugës Gimi, djali i pijeshitësit, kishte filluar të qante nga frika. Pastaj Liçi më tregoi se Fejzullahu, i biri i hoxhës, u paskej thënë të mos futeshin në atë tunel, sepse brenda ishte shtëpia e xhindëve.

Unë u shtriva në divan. Më erdhi për të qarë kur mendova se mbase kurrë nuk do të kisha mundësi të futesha në atë tunel. Mallkova fatin tim të poshtër e mbi të gjitha ata qelbanikë fashistë, që, kur ia mbathën prej këtej, s'ishin kujtuar më as për armët, as për bombat që i kishin

lënë andej-këndeje. Gjendja ime mbetej pashpresë kur më dilte para sysh nëna, të cilën nuk ishte e mundur ta mallëngjeja. Gjatë kësaj kohe ajo ma kishte prerë shkurt çdo kërkesë, bile një herë më kërcënoi e më hoqi veshin, kur i thashë se do të ikja fshehurazi, nga dritarja. E vetmja mbështetje që kisha, babai, kthehej në shtëpi shumë vonë, atëherë kur unë nuk kisha nevojë as të dilja, as të luaja.

Babi ishte oficer. Ai erdhi te ne një vit pas çlirimit të Tiranës dhe më kujtohet që mbante një palë mustaqe të trasha. Mua më dukej e habitshme që lufta kishte mbaruar, ndërsa babai akoma luftonte diku. Një ditë nëna i tha hallës se ai ishte hedhur në Jugosllavi. Unë u përpoqa të përfytyroja se si mund të hidhej babai me një të kërcyer në atë vend që quhej Jugosllavi. Dhe përse atje akoma luftonin? Nuk ia mbaja mend fytyrën babait, bile më dukej se nuk e kisha parë kurrë atë njeri, që ishte im atë. Vetëm si nëpër mjegull ndonjëherë më faniteshin konturet e një vizioni të turbullt, si diçka e largët, mjaft e largët, që më nanuriste lehtë, si në ëndërr. Dhe sa herë që flitej për babanë unë ndieja këtë nanurisje të këndshme, gati magjepsëse. Kështu më ndodhi edhe atë natë kur ai më shtrëngoi fort në kraharor dhe për herë të parë njoha tim atë, një burrë të lartë gjer në tavanin e shtëpisë.

Pas disa kohësh babai ndërroi edhe uniformën. Në vend të qillotave partizane dhe kapës me yll, ai veshi një palë rroba të bukura oficeri, me spaleta tërë yje, një kapelë me strehë të gjerë e të shkëlqyer. Por përsëri, bashkë rrinim shumë pak. Megjithëse më dha fjalën se do të shëtiste

me mua, bile në rrugë do të më lejonte të mbaja kapelën e oficerit, kjo ndodhte shumë rrallë, sepse ai ikte herët në mëngjes, kur unë ende flija, dhe kthehej natën, kur përsëri më gjente në gjumë. Shpesh, për ditë me radhë ai nuk kthehej fare në shtëpi dhe nëna thoshte se babai kishte shumë punë. Kjo, pa dyshim, rëndonte në gjendjen time, që isha i detyruar të qëndroja i kyçur brenda, në mëshirën e nënës. Dhe kushedi se sa do të zgjashte dënimi im, sikur në lagje të mos kishte ndodhur një ngjarje e jashtëzakonshme. Në krye të rrugicës, aty ku ngrihej një hotel i madh me emrin «Internacional», u inaugurua një kinema verore. Perdja ku projektohej filmi binte në rrugë, kështu që çdo kalimtar, kur t'ia kishte qejfi, mund të rrinte e të vështronte rehat-rehat atë që të tjerët e shihnin nga brenda të ulur nëpër karrige. Sido që periudha e perdes zgjati fare pak, sepse më vonë në vend të saj u ngrit një mur i madh, ngjarja pati jehonë në të gjithë banorët e rrugicës. Qysh një orë përpara se të fillonte filmi, në këtë anë të murit ndarës, krahas fëmijëve, zinin vend ca plaka të nderuara e të shëndosha, ndonjë burrë, bile një natë për pak iu mbush mendja të qëndronte edhe babait të Fejzullait, hoxhë efen-disë.

Ky ishte rasti më i volitshëm për mua që të shpëtoja përgjithmonë nga robëria. Kësaj here, me ndërhyrjen e babait, puna u rregullua mirë e bukur vetëm me një premtim, të cilin e dhashë me lehtësi dhe plotësisht i kënaqur, për të mos u larguar asnjëherë nga rrugica.

Tashmë historia e tunelit të Lanës u harrua.

Tërë ditën ne qëndronim pas perdes së bardhë, që u bë objekti i të gjitha bisedave tona. Liçi mburrej se një herë kishte mundur të hynte në anën tjetër të perdes, domethënë brenda në kinema dhe, për habinë tonë, na shpjegoi se ne i shihnim figurat të kthyer së prapi. Kjo profeci e Liçit u bë shkak i lindjes së diskutimeve, por, meqë asnjëri prej nesh akoma nuk kishte pasur rast të shikonte një film për së mbari, mbeti në fuqi mendimi i Liçit. Ne i shihnim figurat për së prapi. Për pak rëndësia e kësaj ane të perdes do të ishte lëkundur, sikur Gimit të mos i shikonte nëpër mend se fundja ne shikonim film pa para, ndërsa ata brenda me para. Në qoftë se edhe ato do ta shikonin njësoj, ç'kuptim do të kishte bileta? Kështu që Liçi u detyrua të tërhiqej.

Një ditë, si zakonisht, ishim grumbulluar rrëzë murit të lartë. Dielli sapo perëndonte. Ne po prisnim me padurim të errej. Aty pranë kaluan disa burra me qeleshe, që na panë, me sa dukej, të kënaqur, që së fundi do t'u linim rehat këpucët gjatë kohës së faljes. Pas pak rrotull minares u ndez një rreth dritash të vogla. Tek vështronim dritat, dikush thirri:

— Djema, shikoni një aeroplan!

— Ku, more, pse gënjen? — tha Liçi.

— Për kokën e nënës, ja ku është, — tha tjetri, — në drejtim të minares së xhamisë.

Atëherë të gjithë në fillim vumë re një pikë të zezë, të lëvizshme. Dalngadalë pika nisi të zmadhohej dhe në qiellin e hapur u shqua trupi krejt i zi i një aeroplani, krahët e tij metalikë dhe një uturimë e mbytur, që sa vinte rritej. Ne u ngritëm si me sustë nga vendi ku qemë ulur, u der-

dhëm me vrap nëpër rrugicë e filluam të thërrisnim sa na hante fyti:

— Aeroplani, aeroplani!...

Britmat tona tërhoqën vëmendjen e më të mëdhenjve. Ata ndaluan në mes të rrugës dhe ngri-tën kokat drejt qiellit. Aeroplani, si një shpend i llahtarshëm, afrohej vazhdimisht me një zhurmë tronditëse. Befas diku larg u dëgjuan ca krisma të fuqishme dhe ne shtangëm kur vumë re të çanin qiellin ca predha të zjarra. Ato ngriheshin nga drejtime të ndryshme, por rrihnin të goditnin një pikë, aeroplanin e zi, që shkiste rëndë-rëndë dhe afrohej gjithnjë e më tepër.

— Ah, qenat, breshkaxhinjtë e djallit, — thirri një burrë, që se nga mbiu aty pranë me një automatik në krah.

— Bjerini, mor, qenit! — thirri një tjetër.

Në rrugicë u grumbulluan shumë njerëz. Ne e kuptuam se ai ishte një aeroplan armik që me siguri po vinte të lëshonte bomba. Këtë mendim i pari e shprehu Liçi, dhe Fejzullai menjëherë ua mbathi këmbëve për në shtëpi. Asnjë tjetër nuk u largua. Ne ia qepëm sytë qiellit blu, ku tani vërvitëshin me tërbim dhjetëra copra zjarri, që kërkonin të shfarosnin atë qenie të zezë.

— T'ëmën, — tha njëri, — s'po e qëllojnë dot kërmën.

Vërtet, në mënyrën më të habitshme, aeroplani lëvizte midis predhave që i kalonin pranë. Kjo shkaktoi te njerëzit një zemërim të papërmbajtur. Shumë vetë filluan të shanin me zë të lartë e me ç't'u vinte për gojë, ata që hanin breshka dhe që fare pak kohë më parë ua kishim thyer dhëmbët në malet tona. Ky zemërim i përgjithshëm



na përfshiu edhe ne, fëmijët. Por, me gjithë zemërimin tonë, si për inat, aeroplani fluturoi midis predhave pikërisht mbi minaren e xhamisë, pastaj bëri një kthesë të shpejtë mbi kokat tona. Atë çast burri me automatik në krah nuk u përmbajt. Ai u ngjit në mënyrë të rrufeshme mbi çatinë e një shtëpie përdhese, drejtoi armën nga qielli dhe e shkrepiti.

— Ah, qen, bir qeni, na shpëtove, — thirri ai me zë të mbytur, ndërsa aeroplani i zi, duke rënkuar, filloi të largohej nga jugu. Edhe goditjet u rralluan. Tek-tuk ndonjë shirit i zjarrit çante qiellin, gjersa aeroplani u shndërrua në një pikë të vogël, që ca nga ca u zhduk. Për disa çaste të gjithë mbetëm më këmbë, si të hutuar. Asnjërit nuk i besohej se si ai korb i zi kishte mundur të fluturonte mbi kokat tona dhe të largohej.

Rrugica u zbraz. Dalngadalë po errej. Ne ende qëndronim në qoshen rrëzë murit, si të kishte ndodhur një fatkeqësi e madhe. Gimi tha se po bëheshim vonë për të parë filmin. Edhe pak vendet më të mira do të ziheshin, por asnjëri prej nesh nuk lëvizti.

— Duhet të ketë qenë nga ata që s'i zë plumbi, — tha Liçi, — kam dëgjuar se ka edhe njerëz që s'i zë plumbi.

— Profka, — iu përgjigja unë, — plumbi, po të zuri, të vret.

— Jo! — protestoi Liçi, — thonë se ka ca njerëz që lindin me këmishë. Ata nuk i zë plumbi për kiamet.

— Epo mirë, — u hodh një djalë nga mëhalla fqinjë, — ç'lidhje ka kjo me aeroplanin? Ai s'është njeri, që të ketë lindur me këmishë.

Ky argument i bindi të gjithë. Veçse një gjë mbeti e pasqaruar: arsyeja përse dhjetëra predha s'mundën të rrezonin një aeroplan. Zgjidhja e këtij problemi të ngatërruar m'u la mua, meqë im atë ishte oficer dhe oficerët i dinë më mirë se kushdo këto gjëra. Prandaj atë mbrëmje, me gjithë urdhrat e prera të nënës, unë nuk fjeta. Kjo për pak desh më kushtoi shtrenjtë. Babai erdhi shumë vonë, me fytyrë të ngrysur e tërë nerva. Këtë e kuptova menjëherë, sepse, sapo më pa mbi krevet, më tha me zemërim:

— Po ti, ç'bën akoma zgjuar?

Toni i tij i ashpër më trembi. Nuk guxova t'i shpjegoja arsyen përse kisha ndenjtur zgjuar gjer në atë orë. Por, kur u kujtova se të nesërmen duhej t'u jepja një përgjigje shokëve, mora zemër.

— Të prisja ty, — i thashë me një fije zëri.

Ndërkaq babai ishte ulur në tryezë për të ngrënë. Në fillim ai nuk m'u përgjigj dhe kështu kaluan disa minuta.

— Ç'punë ke me mua, — tha pa e kthyer kokën.

— A mund të vij aty pranë? — e pyeta.

Ai psherëtiu thellë.

— Mirë pra, eja!

Unë kërceva nga krevati. Me një frymë i tregova tërë historinë e aeroplanit, se si ai kaloi mbi minaren e xhamisë dhe neve na erdhi shumë keq që asnjë predhë nuk e rroku, por flitej se ishte nga ata që s'i kapte plumbi. Ndërsa flisja, babai po më vështronte me vëmendje. Ai hoqi

pjatën mënjanë. U përkul lehtë dhe unë ndjeva prekjen e butë të dorës së tij.

— Pse, — e pyeta, — s'është kështu?

— Sigurisht që jo, — tha babai, — s'besoj të jesh aq pa mend, sa të gënjejesh nga këto përralla.

— Po mirë atëherë, pse s'u rrëzua!

Babai vuri buzën në gaz.

— E di çfarë? Po të guxojë të vijë përsëri, me siguri do ta rrëzojmë. Tani fli se është vonë.

Sikur të mos ishte zgjuar nëna, ka mundësi të kisha biseduar me të gjatë e gjerë. Por ajo hyri në dhomë me vrull e më kërcënoi hapur se do të më dënonte po të mos flija, sepse babai ishte mjaft i lodhur dhe duhej të pushonte.

Unë u binda. I fyer në sedër, për më tepër ngaqë babai nuk bëri asnjë ndërhyrje, u thashë «natën e mirë». Edhe ata u ngritën. Mbeta vetëm në errësirën e dhomës, midis mureve, ku drita e zbehtë e hënës projektonte ca figura të turbullta. Ku ndodhej tani aeroplani? Mbulova kokën me jorgan. Ishte e pamundur të flija. Ah, sikur ta kishin qëlluar! Atëherë ai do të rrëzohej midis flakëve, do të ulërinte nga tmerri... Do të ulërinte uuu, si ujk. Ku e kisha dëgjuar këtë fjalë? Ku? Ah, po. Kështu tha njëherë babai: «reaksioni ulërin». Atëherë unë u përpoqa të përfytyroja se ç'mund të ishte ky reaksion, që shqyente gojën dhe ulërinte si bishë. Ai me siguri mund të shqyente edhe fëmijët. Si arixhofkat... Ha,ha, ha... Sa u tremba atë ditë. Të nesërmen ishte Një Maji, festa e Një Majit. Fejzullai na tha se për Një Maj dalin arixhofkat me thasë në krahë dhe rrëmbejnë fëmijë. Pastaj i therin, i bëjnë copa-

-copa dhe i pjekin në furrë. Pastaj i hanë. Lele... Unë ia tregova babait. Ai shau reaksionin. Më tha se s'duhej të trembesha. Pikërisht në atë rast babai përdori shprehjen e çuditshme «reaksioni ulërin»... Ha, ha. Reaksioni ulërin uuuu... Si ai aeroplani i zi. Duhej të kishte një lidhje midis tyre. Ata të dy ulërinin...

U ktheva në krahun tjetër duke ndjerë një zbrazësi në krahator. Kjo zgjati tërë natën dhe, kur u gdhi, më dhimbte koka. Në gojë kisha një shije të hidhur, tamam si atë ditë kur me Liçin pimë fshehurazi nga një bisht cigareje. Ptui!...

— Ç'ke kështu, — më tha babai, — që kur ka filluar të të dalë gjumi kaq herët?

— Hiç, — iu përgjigja, — s'kam gjë.

— Dale, — foli ai, — ti je zverdhur.

—Kush, unë?

Këtë e thashë kot, sa për të treguar se, edhe po të isha zverdhur, kjo nuk kishte ndonjë rëndësi. E rëndësishme ishte se si do t'i sqaroja shokët rreth historisë së aeroplanit, por, meqë edhe vetë akoma nuk dija ndonjë gjë, rrugëdalja mbetej në tym.

Kopsita rripat e pantallonave dhe, si pa të keq, pyeta:

— A thua të vijë më ai?

— Cili, — tha babai, që po rregullonte çantën e madhe prej lëkure.

— Po ja pra... ai.

— Cili, bre, — qeshi babai.

— Ai pra, aeroplani.

Babai seç mërmëriti nëpër dhëmbë dhe më zuri nga supet.

— Dëgjo këtu! Me sa shoh të paska hyrë frika,

por, po të vijë, ke për të parë se do t'ia rregullojmë qejfin.

Unë nuk e zgjata. Përgjigjja e babait më kënaqi dhe në një farë mënyre u shpjegova shokëve se ai qelbanik aeroplan nuk do të guxonte të vinte më. Edhe sikur ta gënjente mendja, me siguri do të gjente belanë.

Disa ditë me radhë përgjuam qiellin. Atëherë ishte verë dhe bënte shumë vapë. Por ne digjeshim në diell më kot, sepse aeroplani nuk po dukej. Kur u mërzitëm së përgjuari, papritur e pakujtuar babai u largua urgjentisht nga shtëpia. Nëna më tha se ai kishte vajtur të luftonte diku në kufi. Më puthi në ballë dhe shtoi se porosia e fundit e babait ishte për mua. Duhej të bëhesha djalë i mbarë.

Një javë më vonë prej tij morëm një letër, të cillën, me sa kuptova, nëna e kishte lexuar në fillim fshehurazi. Në një pusullkë të vogël, posaçërisht për mua (të paktën nëna kështu më tha kur ma lexoi), babai më njoftonte të mos bëhesha fort merak për punën e atij aeroplani, se kishin rrëzuar disa andej nga kufiri. Pastaj më puthte në të dyja faqet.

—Oh sa mirë, — thashë unë, — ç'kanë për t'u gëzuar djemtë.

Nëna më shtrëngoi fort, por nuk foli. Ndjeva rrahjet e shpejta të zemrës së saj, dihatjet e trupit të ngrohtë. Që nga ajo ditë lodrat në rrugicën e ngushtë m'u dukën vërtet punë kalamajsh. Kuptova se po hyja në jetë.

## DHURATA E DITËLINDJES

— Unë them se duhet t'i blemë një dhuratë simbolike, — tha Miti duke mbështetur lehtë bërrylat në vitrinën prej xhami të kinkalerisë.

Gruaja heshti. Ajo nuk e kapi menjëherë domethënien e fjalës «simbolike», që i shoqi e kishte përdorur papritur e pakujtuar. Megjithatë nuk u hutua. E mori me mend se ai me siguri bënte fjalë për diçka me vlerë, meqë edhe rasti ishte i tillë. Miku i afërt i Mitit, domethënë shoku i dashur i fëmijërisë së tij, mbushte plot dyzet e pesë vjeç. Prandaj ajo u përpoq të arsyetonte e të përcaktonte se cila mund të ishte në këtë rast dhurata më me vlerë, që i shoqi e quante «simbolike». Pas një ngurrimi të shkurtër, gjatë të cilit e vështroi burrin drejt e në sy, tek rrinte i mbështetur në vitrinën prej xhami, gruaja tha me vendosmëri:

— Sigurisht, s'ka ku të vejë më mirë se

një këmishë e bardhë najloni dhe një kollare e kuqe...

— Hëm! — mërmëriti Miti si për të pastruar fytin, — ashtu thua ti?

E shoqja, një grua e shëndoshë, nënë e katër fëmijëve, me një fytyrë të butë e të pastër, tundi kokën. Ai shtrembëroi buzët, e zuri nga krahu dhe dolën jashtë.

— Ç'pate, — pyeti gruaja e habitur.

— Dëgjo këtu, — tha Miti. — Rustemi ka ditë-lindjen, nuk është bërë dhëndër. Unë them që t'i blejmë një dhuratë simbolike...

— E pra, — tha gruaja, — simbolike...

— Kështu, — vazhdoi burri, — këmisha vi-shet e priset, me një fjalë harrohet.

Pastaj e zuri gruan nga krahu dhe e afroi pranë xhamit të trashë të vitrinës që shkëlqente nga dritat.

— E shikon atë shqiponjën prej shqope? — tha duke treguar me gisht. — Ajo po, është një dhuratë e vërtetë. Tjetri e vendos në dhomë e sa të jetë gjallë kujtohet për ty, për shokun e fëmijërisë, bashkë me të cilin ka gjakosur këmbët me topa lecke.

Mitin, me sa dukej, e përfshinë kujtime të largëta dhe e pushtoi një farë mallëngjimi. Ai ishte punëtor, mekanik i kategorisë së shtatë. Gjithë jetën ishte marrë me hekura. Ndërsa Rustemi ndoqi shkollën, derisa mori diplomën e inxhinierit. Tani ai punonte në uzinën e vogël të qytetit. «Si është jeta», mendoi kur kujtoi se sa herët ishte martuar. Atëherë Rita ishte një çupë

me fytyrë të mitur, nga ato çupat e mira të fabrikës së trikotazhit. Ndryshe puna e Rustemit. Ai kishte studiuar rregullisht. Por miqësia është miqësi...

Miti mbështolli me kujdes shqiponjën, i futi krahun gruas dhe kaloi nëpër bulevardin kryesor të qytetit, ku prej kohësh ishin ndezur llambat neon.

— Po sikur të ketë njerëz, — tha gruaja, kur shtypën sustën e ziles elektrike te dera e Rustemit.

Pritën më këmbë disa çaste, gjatë të cilave ai vështroi shtëpinë. Ndërkaq dera u hap befas. Prapa saj nuk kishte asnjëri.

— Oj, — tha Miti, që e kuptoi si qëndronte puna, — edhe portën e komanduaka nga brenda.

Ata të dy mbetën një copë herë të hutuar. Rita mendoi se urimi më i përshtatshëm në këtë rast do të ishte «edhe njëqind», gjë që ia shprehu të shoqit, e bindur se këtë radhë kishte thënë një gjë me vlerë. Ajo nguli këmbë për këtë edhe kur u futën në një paradhomë të mobiluar me kolltukë, ku pritën jo më shumë se pesëmbëdhjetë minuta, në shoqërinë e plakës shurdhe të Rustemit, që i detyronte të gjithë njerëzit të thërrisnin sa u hante fyti. Ndërsa Rita bërtiste, për t'i mbushur mendjen plakës se e ëma binte kushërirë e largët e saj, Miti vuri re se në dhomën përballë kishte njerëz. Atëherë ai u përpoq të arsyetonte se përse ishte e nevojshme që këta të rrinin këtu në paradhomë e të molloisnin me plakën. Kjo s'ka asnjë kuptim, mendoi ai.



Dyshimeve të Mitit i dha fund bashkëshortja e Rustemit që, e stolitur si për ditë feste, doli nga dhoma përkundrejt. Pritja gati ceremoniale e saj, së cilës e shoqja iu përgjigj me urimin «edhe njëqind», që e kishte në majë të gjuhës, Mitit nuk i bëri asnjë përshtypje. Ai do të dëshironte që në vend të saj t'i priste Rustemi, sepse ai kishte ditëlindjen e për të e bleu dhe dhuratën simbolike. Ai mbeti i zhgënjyer kur bashkëshortja e Rustemit i tha, pa iu dridhur zëri, se i shoqi nuk mund t'i priste tani, për arsye se s'mund të linte vetëm një grup shokësh që i kishte ftuar për darkë.

— Aha! — tha Miti, — domosdo...

Deshi të shtonte se, sigurisht, kur njeriu është i zënë, nuk ka mundësi të presë. Po kjo iu duk pa kuptim, prandaj e la mendimin përgjysmë.

— Oh, po ju s'dini gjë, — gati sa s'thirri gruaja e Rustemit, — s'besoj ta keni marrë vesh.


Miti vështroi Ritën. Ajo ngriti supet dhe të dy bashkë mbetën të hutuar.

— Pse? — pyeti ai, — ç'ka bërë vaki?

— Çudi si s'e keni marrë vesh, — tha ajo. — Rustemi u bë drejtor i fabrikës së miellit. Ka nja tri ditë që ia komunikuan.

Ndërsa Rita nxitoi të uronte me shprehjen e zakonshme «la e më la», Miti mendoi se s'kishte asnjë lidhje midis vizitës së tij dhe drejtorllëkut të Rustemit. Fundja, ai erdhi për ditëlindjen, e ca më mirë që miku i tij ishte bërë drejtor. Një rrugë e dy punë...

Ndërsa e shoqja e Rustemit po lavdërohej, duke i ligjëruar fjalët me një zë që atij iu duk si



kakarisja e një pule, dera e dhomës përballë u hap dhe prej andej doli Rustemi. Ai u afrua drejt tyre, u shtrëngoi duart formalisht, por nuk i ftoi brenda.

— Më falni, — tha pastaj, — më kanë ardhur disa shokë...

Ndërkaq e shoqja erdhi me një tabaka të madhe në dorë, ku kishte vendosur dy gota liker.

Në paradhomë ra një heshtje e mërzitshme. Miti mërmëriti nëpër dhëmbë, ndjeu t'i hipte gjaku në kokë, por nuk arriti të thoshte ndonjë gjë të zgjuar. I zgjati Rustemit shqiponjën prej shqope dhe hyri në një bisedë të ngatërruar. Më në fund, ndonëse ishte nga ata tipa njerëzish që nuk ligësh-tohen nga vogëlsirat, ai u ngrit, puthi faqet e fishkura të plakës dhe bashkë me gruan, që kushedi se çfarë po i dërdëlliste, dolën në rrugë.

Kur e kujtonte më vonë këtë skenë, i fyer në sedër, i hipnin nervat. Sigurisht, për këtë nuk mund të quante shkaktare Ritën, e cila, ç'është e vërteta, e mërziti me romuzet e pamëshirshme për mikun e tij. Duke e shoshitur punën me gjakftohësi, erdhi në përfundimin se ai bashkë me gruan ishin të përshtatshëm për çdo lloj tryeze. Tek e fundit, Rustemi s'kishte kapur qiellin me dorë. Nga tërë shoqëria e tyre e fëmijërisë, së paku nja gjashtë vetë kishin poste më të larta se Rustemi, bile dhe në Tiranë. Por asnjëri prej tyre s'ia kishte bërë këtë.

Pas dy vjetësh kjo ngjarje mbeti e harruar diku thellë në kujtesën e tij. Madje ai jetonte i lumtur me katër fëmijët dhe Ritën, që vazhdonte të punonte në trikotazh. Në raste të rralla, kur e

shoqja ishte veçanërisht në qejf, e pyeste: «More, si është historia e asaj dhuratës simbolike?» ose «A thua të jetë gjallë akoma ajo shqiponja prej shqope?». Atëherë shpirti i tij lëndohej, fyhej nga kujtimi i një miqësie që kishte përfunduar për faqe të zezë.

Një ditë ata ishin ulur në një lokal për të pirë birrë. Miti, të cilit mezetë nuk i kishin pëlqyer ndonjëherë, kthente me etje birrën e ftohtë. Duke vështruar Ritën që përtypej, ai mendoi se ajo duhej të ishte të paktën nja dhjetë kile më e rëndë. Atë çast në hyrje të lokalit u duk Rustemi. Rita e pa e para dhe i bëri me shenjë Mitit, që u çudit. Ky ishte një rast i jashtëzakonshëm, për arsye se Rustemi prej kohësh nuk dukej në lokale. Asgjë s'do ta kishte habitur më tepër sesa ecja e shkujdesur e Rustemit që, si u sorollat nëpër lokal, vendosi të ulej në tryezën e tyre. Rita, po të kishte pasur mundësi, do ta quante këtë veprim të paturpshëm. Miti e ndjeu veten si në gjemba. Ai vështroi i hutuar fytyrën e hequr të Rustemit. Iu duk se në të kishte humbur çuditërisht ajo shprehja e njohur, e vendosur. Ai porositi kamerierin të sillte një birrë, duke i hedhur së shoqes, që po lëvizte në karrige, një vështrim ngulmues, të cilin e kuptonin vetëm ata të dy. Pastaj, me vështirësi, mezi mundi të belbëzonte në mënyrë të ftohtë diçka të tillë si: «Ç'kemi, shoku Rustem». Tjetri ngriti supet. Tha se në këtë lokal birrën e servirin në freskët dhe shtoi se asgjë nuk mund të jetë më e këndshme se birra e ftohtë në një ditë të nxehtë... Po, birra e ftohtë është e këndshme, tha Miti me vete, ai ka të drejtë. Pastaj,

befas iu kujtua shqiponja prej shqope. Gjurmët e vjetra të sedrës së fyer dhanë një alarm të përgjithshëm në tërë qenien e tij. Kushedi se ç'do të kishte thënë po të binte viktimë e ngacmimeve të brendshme. Por ai kishte një mendje shumë të kthjellët dhe gjykimin e shëndoshë të një njeriu të përmbajtur. Kështu që mundi të shmangte çdo ngasje kryeneçe e të thoshte:

— Besoj se jeni shumë i zënë me punë, s'është shaka të jesh drejtor.

Rustemi shtrembëroi fytyrën i pakënaqur dhe ktheu gotën e birrës. Pastaj nisi një bisedë intime. E pyeti për fëmijët, për plakën, e pyeti nëse bënte kokrra portokalli i oborrit dhe për kumuritë e mëngjesit. I tha se e kishte marrë malli të lahej në lumë, e solli nëpër mend turli lloj ngjarjesh të kaluara. Dalngadalë Mitit filloi t'i zbutej gjaku. Atij iu zgjidh gjuha.

Kur u kthye në shtëpi. Rita iu shkreh:

— Nuk e dija se qenkëshe kaq servill!

— Moj, mbaj gojën, — tha ai, — e kam mik. Fundja, njerëz jemi, edhe gabojmë.

Me kaq i vunë kapak bisedës. Të nesërmen në drekë, kur u kthye në shtëpi, ai vuri re se Rita ishte e mërzitur. Ajo nuk bëri asnjë nga ato shakatë e zakonshme, të cilat atij i pëlqenin aq tepër. Kishte marrë një pamje gati të trishtuar, në kundërshtim me karakterin e vrullshëm, që ia njihje prej kohësh.

— Aha, — i tha ai, — s'të paska ecur sot.

Ajo heshti dhe e vështroi drejt në fytyrë. Burrin u habit.

— Ç'ke kështu, të ka sharë njeri?

— Uh, — psherëtiu gruaja, — s'di si të të

them. Unë e di që Rustemin e ke pasur mik të vjetër. Por... sesi më duket. Sot mora vesh se atë e paskan shkarkuar nga drejtorllëku për disa proçka që paska bërë.

Ky njoftim burrit i ra si bombë. Gruaja heshiti për disa çaste dhe mori frymë thellë. Pastaj, si u mbush me frymë, tha:

— Prandaj erdhi e u ul në tryezën tonë ai?

Burrit i doli para syve shqiponja prej shqoqe dhe mendoi se e shoqja kishte të drejtë.

## DY LETRA

### I

Fshati Gur i Zi ndodhet në skajin më të largët të rrethit — kështu e filloi tregimin e tij miku im Xhezair Dani, instruktor i vjetër partie. Ai ngrihet i tëri mbi shkrepë, me disa lagje të shpërndara pa kurrfarë rregulli. Gjatë Luftës, në kohën e operacionit të Dimrit, batalioni ynë kaloi andej dhe qëndroi, me sa më kujtohet, nja dhjetë ditë. Këto ishin të mjaftueshme që ne të njiheshim me njerëzit, të lidhnim edhe miqësira. Prandaj m'u duk e natyrshme kur sekretari i parë më thirri në zyrën e tij e më njoftoi se isha caktuar kryetar i një ekipi që do të nisej për në Gur të Zi, ku formimi i kooperativës parashikohej të përfundonte brënda muajit. Kisha plot dy vjet pa vajtur në Gur të Zi. Bile herën e fundit vajta në mënyrë personale, i ftuar në një dasmë. Miku im i vjetër, Shefit Zguni, një plak tetëdhjetepesëvjeçar, denbabaden bari, martonte të nipin. Merr me mend një familje të ma-

dhe prej afro dyzet vetësh. Plaku, një burrë i gjatë, i thinjur por me mendje të kthjellët, gjer në çastin kur vdiq i mbajti vetë në dorë frenat e shtëpisë. Dy djemtë e mëdhenj dhe një nip iu vranë në luftë. Por i mbeti një djalë dhe shumë nipër që u martuan dhe e mbushën me nipër e stërnipër, të cilët ai nuk i ndau. Pranë shtëpisë së vjetër me mure të trasha guri ata ngritën tri shtëpi të reja, që radhiteshin në një brinjë të butë.

Ajo dasmë ishte e çuditshme veçanërisht për plakun, i cili vdiq pas gjashtë muajsh. Çifti qëndroi aty një natë dhe të nesërmen u largua. Arsy-eja kishte qenë e thjeshtë. Të tërë ata ishin barinj e më pak bujq. Kishin disa ara të shpërndara në faqe të malit dhe tufa bagëtish që i kullosnin lart, në lëndinën e Valit. Por njërin nga nipërit plakut iu mbush mendja ta dërgonte në shkollë. Atëherë, pa u formuar kooperativa, fshati nuk kishte nevojë për llogaritar, por nipçja u bë llogaritar i mesëm dhe u emërua me punë në një kooperativë të fushës nja pesë orë larg Gurit të Zi. Një ditë papritur e pakujtuar i tha gjyshit se donte të martohej në fushë me një agronome. Kjo ishte diçka e jashtëzakonshme, e, si u mendua disa ditë me radhë, plaku e miratoi formalisht vendimin e të nipit me një kusht: Dasma të bëhej në konaqet e tij. Dhe vërtet, ashtu u bë. Dhëndri njëzetegjashtëvjeçar, që dallohej menjëherë prej të tjerëve nga mënyra e veshjes e nga disa sjellje të shpenguara, ishte një djalë me shtat mesatar, me ca sy të zinj. Nusen pata mundësi, si mik i afërt i familjes, ta shihja vetëm për një çast. E quanin Ruhije...

Më tutje, për afro dy vjet, nuk pata ndonjë rast të takohesha me këtë çift. Vetëm atë mbrëmje, pas takimit me sekretarin, tek rrija në dhomë dhe vrisja mendjen, më doli parasysh si një kujtim i largët. Dy vjet më parë nuk mund të parashikoja se ajo njohje e shpejtë me dhëndrin tani do të merrte për mua një rëndësi të veçantë. Ai ishte llogaritar, ndërsa e shoqja agronome. Po sikur t'u propozoja të ngjiteshin lart? I përfshirë nga emocioni, futaj duart në xhepa dhe u afrova pranë dritares. Në sfond dukeshin malet si një bllok i rëndë.

Shqetësimet e mia nuk ishin pa baza. Këtë e pashë që të nesërmen, kur në mbledhjen e ekipit, me propozimin tim, morën pjesë edhe ata, burrë e grua. Atëherë ishte dimër. Në qytet kishte rënë dëborë, gjë që s'mbahej mend prej disa vjetësh. Edhe të ftohtët e atij viti s'mbahej mend. Kur u futën tek unë atyre u ishin skuqur fytyrat dhe supet e palltove u ishin lagur nga dëborë.

— Besoj më mbani mend, — u thashë, kur zunë vend në karrige.

Gruaja vuri buzën në gaz, ndërsa Kadriu (kështu e quanin nipçen e/plakut) tha:

— Llaf është ai, shoku Xhezo? Ju jeni mik i shtëpisë sonë.

Gjatë kësaj kohe ai ishte shëndoshur. Të parët i ishin burrëruar.

U shpjegova përse i kisha thirrur. Pastaj heshta. Edhe ata heshtën. Propozimi që u bëhej i zuri në befasi.



— Kjo gjë është vendosur, apo... — foli Kadriu pas pak.

— Jo, — ndërhyra unë, — asgjë s'është vendosur. Ju thirra vetëm të bisedojmë.

Mënyra se si ma bëri atë pyetje nuk më pëlqeu. Ndjeva diçka jo të sigurtë dhe më erdhi keq.

— Një çikë e vështirë kjo punë, — tha Kadriu. — Kanë kaluar kaq vjet. — Tani jemi rregulluar, kemi shtëpinë tonë. Kemi edhe një fëmijë të vogël.

— Prandaj edhe unë ju thirra të bisedojmë, — iu përgjigja.

Ai heshti. Balli iu mbush me ca sumbulla të mëdha djerse. Nxori me nxitim një cigare dhe unë dallova një dridhje të lehtë të gishtërinjve.

— Ju e dini se prej kohësh jam larguar nga fshati. Njerëzve të mi kjo nuk u ka pëlqyer kurrë, veçanërisht martesë ime.

Këtu ai u skuq dhe Ruhija uli kokën.

— Duan të thonë se gjyshi vdiq nga marazi im.

— Profka, — thashë padashur, — këto janë profka. Xha Shefiti as që e ka çarë ndonjëherë kokën për vogëlsira të tilla.

— Mirë pra, edhe unë ashtu them. Veçse për një pjesë të farefisit unë jam një i ikur, i fshirë nga defteri, një biçim kollovari që ia mbathi pas fustanit të gruas...

— Unë them të na lini pak kohë të mendohemi, — ndërhyri e shoqja, — s'ka mundësi të vendosim kaq shpejt.

Kadriu e priti me një farë apatie propozimin e gruas së tij. Atëherë unë nuk mund të gjykoja për bazën mbi të cilën i kishin ndërtuar ata të

dy marrëdhëniet me njëri-tjetrin. Prandaj apatinë e Kadriut e mora për mosaprovim të plotë.

— S'kam ndonjë kundërshtim, — u thashë, — por nuk mund të pres gjatë, sepse pas pesë ditësh nisemi.

— Na mjaftojnë dy ditë për t'u menduar. Apo jo, Kadri?

Tjetri tundi kokën, por nuk foli.

Dy ditë më vonë, me një Gaz të komitetit, kapërceva rrugën e asfaltuar dhe u gjenda në zyrat e kooperativës. Ruhijen e takova në një rrugë qerresh midis arave. Mbi flokët e zinj i kishin ngrirë ca bulëza uji që dukeshin si rubinë të vegjël. Fshiu me mëngë baltën e ngjitur pas fustanit dhe unë vura re se duart i qenë plasaritur nga të ftohtët.

— Ne e vendosëm atë punë, — tha Ruhija, — mos u shqetësoni më.

— Oh, po ju keni marrë një vendim shumë të drejtë, — thashë unë dhe ndjeva respekt për atë grua të re, të cilën e njihja fare pak.

Më pas, në përgjithësi ngjarjet u zhvilluan ashtu siç kisha parashikuar. Katër ditë pas mbërritjes sonë në Gur të Zi, të parët e dhanë fjalën për t'u futur në kooperativë Zgunajt. Si e rrahën mbarë e prapë këtë çështje, Arif Zguni, vëllai i plakut Shefit, mori pushkën, doli në dritare dhe e shkrepiti disa herë në errësirë. Ky veprim u shoqërua me gjëmimet e një lodre në brinjën me dëborë. Dikush i binte asaj me tërë forcën.

Në dhomë ndodheshin të gjithë burrat e Zgunajve. Përjashtim bënin vetëm dy gra: plaka

e Arifit dhe Ruhija. Ato qëndronin pas shpinës së burrave. Atëherë unë bëra një ndërhyrje që mund të kishte përfunduar me zarrar.

— E, bre shokë, — u thashë, — a ka lezet që këto dy gra të rrinë veç?

Arifi shkundi llullën, por vështrimi i tij mbeti i fiksuar midis gotave. Kjo gjëndje vazhdoi gjersa ndjeva një zë burri, të cilin s'e mora vesh se i kujt ishte.

— Le të shkojnë matanë, — tha ai, — nuk i ndalon njeri.

Ruhija buzëqeshi e hutuar. Kurrë s'do të më shqitet nga mendja shkimi i saj i mekur. Atëherë vura re se si mund të zhvleftësohej njeriu, se si shfaqet me kryeneçësi kapadaillëku i mashkullit. M'u duk sikur dikush më shqiti diçka në kraharor.

Ruhija e zverdhur u ngrit.

— Dale, — ndrëhyri Arifi. — Sot kemi gëzim. Ajo qëndroi midis dhomës e heshtur.

— Eja këtu, — vazhdoi plaku, — kush të ketë qejf të pijë, kujt i dhemb koka të dalë. Hajt, gëzuar!

Të gjithë ngritën gotat. Ndërsa plaku hapi pak vend pranë meje, Ruhija u ul në brinjë dhe unë ndjeva dihatjet e shpejta të saj.

Zyrat e kooperativës u vendosën në një dhomë të shkollës, që më parë kishte shërbyer si depo rrangullinash. Drejtori, vendali, pranoi me gjithë qejf ta lironte atë dhomë gjër në verën e ardhshme.

Unë po rrija në një tryezë të vogël e me

gishtërinjtë e ngrirë mezi mbaja lapsin për të formuluar kërkesat për disa materiale të domosdoshme. Bashkë me mua ndodhej kryetari i kooperativës, një burrë i shkurtër i thinjur, me ca mustaqe të holla, njeri i drejtë, por fatkeqësisht, siç doli më vonë, i paaftë. Në krah të tij, mbi një fron druri, ngrohte duart me frymë kryetari i këshillit Veip Skuqi. Hunda e madhe, e hollë i ishte skuqur nga të ftohtët. Kisha thirrur gjithashtu Kadriun dhe Ruhijen.

— S'do të bëje keq të qëndroje edhe ndonjë javë, — më tha kryetari i këshillit, — le më që s'ke nga të ikësh. Rrugët janë të zëna.

— Jo, — u përgjigja, — s'ka mundësi. Megjithatë do të shihemi shpejt.

Unë mbylla çantën prej lëkure, e, pasi u dhashë disa porosi të fundit, dola jashtë.

Përreth gjithçka ishte e bardhë. Një bardhësi e ftohtë, që s'di përse më ngjalli diçka të trishtuar, ndoshta nga lodhja e atyre ditëve, që po e ndieja në të gjitha gjymtyrët. U përqafova me ta dhe bëra disa hapa.

— Po të duash më përcillni pak, — i thashë Kadriut.

Ata erdhën pranë meje burrë e grua. U nisëm tatëpjetë brinjës. Ndihej vetëm frymëmarrja jonë e rëndë dhe kërcitja e dëborës.

— Si jeni rregulluar, — i pyeta.

— Ç'ka, — tha Kadriu, — xhaxhai na liroi një dhomë.

Si ecëm disa hapa, nxora nga xhepi një stilograf dhe ia lashë në dorë.

— Ç'eshtë kjo, — pyeti Kadriu i habitur.

— Merre, — i thashë, — për kujtim. Ka për të të hyrë në punë.

Gjatë këtyre ditëve unë po filloja të ndieja diçka vërtet prekëse për këtë çift. Në një farë mënyre më dukej se kisha disa detyrime ndaj tyre, gjë që më shkaktonte një dashuri prindërore.

— Do të lodheni, — më tha Ruhija, — ka rënë shumë dëborë.

Ajo ngriti jakën prej gëzofi sipër veshëve. Mbi mollëzat e skuqura të faqeve puliteshin dy sy të butë, që ishin bërë të menduar.

— Si e keni djalin, — e pyeta.

— Tërë kohën fle, — u përgjigj ajo, — klima e malit do t'i prijë.

— Oh, pa tjetër, — thashë unë dhe në fytyrë më ranë fluturzat e dëborës që mbushnin hapësirën.

## II

Mbase nuk do t'ia vlente ta zgjasja këtë rrëfim, sikur ngjarjet të mos rrokulliseshin në mënyrë të tillë, që më vunë para disa situatash të ndërlikuara. Kjo nisi gjashtë muaj pas kthimit nga Guri i Zi.

Atë ditë isha mbyllur në zyrë që në mëngjes. Më kërkohet me urgjencë një relacion mbi kooperativat malore, pothuajse gjysmë viti pas ngritjes së tyre.

U shtriu në karrige. Atëherë u kujtova se që nga mëngjesi kisha pirë vetëm një kafe. Kjo më

shkaktonte një dhimbje të lehtë në stomak dhe mendova se do të bëja mirë të zbrisja poshtë, në bufenë e komitetit. Tek bëhesha gati të dilja, dikush trokiti në derë.

— Hyr, — thirra me zë të lartë.

Dera u hap ngadalë dhe para syve të mi qëndroi një person, të cilin as që ma merрте mendja ta shihja atë çast: Kryetari i këshillit të Gurit të Zi.

— Ju shqetësoj? — pyeti ai me një buzëqeshje të hutuar.

— Aspak! — thashë unë.

Ai më zgjati dorën. Hoqi kasketën prej kadi-feje dhe duke kruajtur kokën u ul në karrige.

— Hë, bre Veip, — e pyeta, — kur paske zbritur?

Ai i hodhi një vështrim dhomës, nxori një kuti duhani dhe ndezi një cigare të trashë që e mbushi dhomën me një erë të rëndë.

Veipin e njihja prej kohësh. Me kalimin e viteve trupi i drejtë i ishte kërrusur pak. Vetullat i ishin thinjur, por në fytyrë i kishte mbetur ajo shprehje e gjallë energjike, që e dallonte nga të tjerët.

Si thithi një copë herë duhanin pa folur, ai kushedi përse psherëtiu.

— Kam ardhur për disa çështje me shumë rëndësi, shoku Xhezo.

Unë u përpoqa të merrja me mend se cilat mund të ishin këto çështje kaq me rëndësi që Veipi përgatitej të m'i parashtronte papritur e pakujtuar.

— Urdhëro! — i thashë, — të dëgjoj.

— S'e di në bëj mirë apo keq, po te ne po ngjajnë padrejtësira.

— Bah! — kërceva unë, — si kështu?

Veipi u kërrus dhe mbështeti duart mbi tryezë, Vetullat iu ngritën përpjetë.

— Megjithatë më parë dua të të pyes nëse janë të vërteta ato fjalë që qarkullojnë, — tha ai.

Unë e vështrova i habitur. Më bëri përshtypje një lloj këmbënguljeje që ndihej në kërkesën e tij.

— Çfarë fjalësh? — thashë unë, si të doja ta merrja me të mirë. — Përse mendon se unë duhet t'i di ato fjalë që qenkan përhapur andej?

Kjo përgjigje e hutoi Veipin. Me sa dukej ai kishte formuar një bindje të plotë dhe u ndodh në befasi. Por, meqë unë i rashë në të se ku donte të dilte, vendosa ta sqaroja çështjen gjer në fund.

— Mirë, o Veip. Më thuaj, ç'ke dëgjuar? Po qe se bëhen padrejtësi duhet t'i ndreqim.

Ai tundi kokën. Pastaj, si e mori veten, më shpjegoi gjithçka bluante në vete. Brenda njëzet minutash, gjatë të cilave nuk i ndërhyra asnjëherë, ai shfaqti pakënaqësinë e tij ndaj pëshpëritjeve që qarkullonin poshtë e përpjetë. Sipas këtyre pëshpëritjeve, do të hiqej kryetari ekzistues i kooperativës e në vend të tij do të caktohej një tjetër. Veipi nuk e sqaroi cili do ta zëvendësonte, por tha se kjo do të krijonte në fshat një situatë të rëndë. Së fundi ai shtoi se, si njeri që i dhimbej fati i kooperativës, nuk mund të qëndronte duke soditur një gjendje aspak të shëndoshë.

— Jam i bindur se këtu bëhen hatërlleqe, —  
përfundoi Veipi dhe mori frymë thellë.

Unë u trondita. Që në këtë mes kishte diçka të vërtetë, kjo s'më habiste aq, sa fakti se si kishte mundësi që gjëra të tilla, pa u vendosur e pa u diskutuar, të merreshin vesh e të qarkullonin poshtë e përjetë. Të them të drejtën m'u ngri-  
tën nervat. Qëndrime të tilla, joserioze, shpesh na kanë nxjerrë telashe me njerëzit. Prandaj e pye-  
ta:

— Kush i ka thënë këto gjëra?

Veipi më vështroi me dinakëri.

— Ja, — tha ai, — në përgjithësi flitet.

Këtij lëmshi vështirë t'ia gjeje fillin. Por  
thelbi i çështjes paraqiste interes. Aq më tepër që  
Veipi shkëputej nga fshati e në mënyrë të hapur  
vinte e më kërkonte llogari.

— Nuk më the, për cilin flitet të jetë kryetari  
i ardhshëm, — e pyeta.

— Lëre mos e nga, — tha Veipi, — ju duhet  
ta njihni atë agronomen, që s'ka disa muaj që ka  
ardhur te ne.

— Po, e njoh.

— Mendoni, si mund të këmbehet Qamili me  
të?!

Mendimi i parë që më lindi në kokë ishte t'i  
derdhesha Veipit e ta bëja për një lek. Sepse në  
vend që të punonte, e brente merakun për gjëra të  
cilat nuk mund t'i vendoste një njeri i vetëm. Por  
në vend të kësaj i fola me butësi:

— Mirë, o Veip, ç'të të them, kur s'di gjë.

— Vërtet, — u përgjigj ai, — ndërsa unë men-  
doja se edhe ju duhet ta dinit.

— Megjithatë, le ta zëmë se unë di diçka.



Ç'kuptim ka që ti të shkëputesh nga Guri i Zi e të vish gjer këtu?

Veipit i shkëlqyen sytë. Ai kruajti kokën dhe mërmëriti:

— Atëherë puna do të ndryshonte.

— Si kështu?

— Po ja, ju s'duhet ta lëjoni një gjë të tillë. Kjo është e padrejtë.

Unë mezi u përmbajta. U ngrita në këmbë dhe, duke futur në sirtar fletët e relacionit, i thashë:

— Dëgjo Veip! Ti shqetësohesh më kot. Këto nuk i vendosim unë e ti nga kjo zyrë, por i gjithë fshati. Po që se ke vërejtje, të këshilloj t'i bësh në vendin dhe në kohën e duhur. Tani kthehu në shtëpi dhe mos u merr me këtë gjë.

— Më vjen keq, — tha Veipi, të cilin e përfshiu një lloj paniku, — unë erdha vetëm për t'u këshilluar me ju.

— Bukur, — iu përgjigja pa qejf, — unë ta dhashë këshillën time.

Veipi mbylli derën pa u ndier. Në dhomë mbetën pezull fjollat e kaltra të tymit të duhanit dhe një erë e rëndë që më zuri grykën. U ula në karrige. Mbështeta kokën mbi tryezë dhe para syve më dolën shpatet e rrëpira të Gurit të Zi. Ç'të papritura fshihnin akoma? U përpoqa të rendisja disa fakte: në fillim u therën kafshë pune, pastaj u shitën të tjera, mbjelljet ecën për faqe të zezë, stallat s'dihej se kur do të nisnin. Gjer kur do të vazhdonte kështu? Ne e kishim dhënë gjatë këtyre muajve të gjithë ndihmën materiale paraprake. Por punët s'po ecnin. Niveli i organizimit ishte

fare përtokë dhe mendova se këtu duhej të kape-  
shim. Mund të çoje materiale sa të doje në Gur  
të Zi por s'merrej vesh se nga shkonin. Ngjarja  
më skandaloze ndodhi në fund të pranverës, kur  
fara që dërguam për mbjellje u shpërdorua keqas.  
Atëherë u poq mendimi se në krye të punëve  
duhej vënë një njeri që të merrte vesh. Më të  
përshtatshëm se Ruhija në Gur të Zi nuk mund  
të gjeje. Por hëpërhë ky ishte vetëm një mendim.  
Për më tepër kur nuk ishim të bindur në se  
Ruhija do t'ia dilte kësaj detyre. Po të gjykoje  
nga përgatitja e saj dhe puna e këtyre muajve,  
ajo kishte mjaft të dhëna. Si agronome, ajo u  
ndesh me një pjesë të opinionit, që ishte kundër  
mbjelljes së grurit në malësi. Fërkimi rreth këtij  
problemi qe aq i madh, sa që u zgjidh vetëm me  
ndërhyrjen e Komitetit të Partisë. Po kështu për  
mbjelljen e jonxhës dhe krijimin e një plantacioni  
mollësh. Por rrethana të tjera e vinin në pikëpyet-  
je këtë mendim. A do t'ia dilte Ruhija të kryente  
punën e drejtuesit?... Dhe ja tani kjo vizitë e pa-  
pritur e Veipit. Këtu diçka lëvizte. Përse ky inte-  
resim kaq i madh? Një varg pikëpyetjesh më lin-  
dën në kokë. Net të tëra e rraha me vete këtë prob-  
lem për të krijuar një bindje të qartë për hapin  
që mund të bëhej...

### III

... Rasti e solli që më pas, në mënyrë të pa-  
pritur, më njoftuan se isha caktuar të ndiqja një  
kurs dyvjeçar në shkollën e Partisë.

Mua as që më shkonte ndër mend se më vonë do të vazhdoja pikërisht atë punë, që e ndërpreva përkohësisht. Kjo ndodhi ditët e para, kur sapo kisha filluar rishmë detyrën. Dy vjet nuk janë pak. Pas një periudhe të tillë, nuk mund të mos e ndiesh veten të shkëputur nga mjaft gjëra, të cilat deri dje kanë qenë aq të afërta. Disa ditë me radhë m'u desh të njihesha me situatën. Lexova materialet e vitit të kaluar, bisedova me shokët dhe një mëngjes, tek shihja postën që sapo kishte ardhur, sytë më zunë një zarf të hapur me këtë shënim: *Shokut Xhezo për verifikim*. Kjo ishte nënvizuar me dy vija të kuqe. Lashë mënjanë gazetat dhe mora zarfin në dorë. Dikush, me laps kopjativ, me një shkrim të pastër, kishte formuluar adresën e Komitetit të Partisë. Nxora letrën dhe vura re se edhe ajo shoqërohej me një pusullë përcjellëse, ku thuhej: *Shoku Xhezair, lexoje me kujdes, verifiko gjendjen dhe më raportoj mbi situatën sa më shpejt. Sido që pa nënshkrim, problemi mund të krijojë pështjellime. Vepra me maturi. Të fala, Araniti.*

Sapo lexova emrin e sekretarit të parë e kuptova se kisha të bëja me një çështje serioze. Rrotullova letrën nëpër duar dhe numërova faqet e mbushura me të njëjtin shkrim që lexohej mbi zarf. Plot gjashtë faqe të shkëputura nga një fletore e zakonshme nxënësi. Shumë shpejt u mësova me atë kaligrafi dhe, duke harruar gjithçka, u zhyta në rreshtat që i përpiva me një frymë gjer në fund. Pas kësaj, pothuajse i skandalizuar e lexova për së dyti. Pastaj për së treti... Filloi të më ziente koka. E rrëmbeva letrën i inatosur dhe, si ai njeriu që s'di ç'bën, e mblodha shuk. Futa

duart në xhepa e, duke marrë frymë me vështirësi, u afrova pranë dritares. Nuk e di se sa ndenja ashtu, me vështrimin të humbur tej, në ato male të ashpra, që ishin pjesë e pandarë e gjithë jetës sime. Më erdhi të vija kujën kur mendova se pikërisht andej, nga ata shkrepë, nga ato vise, pa të cilat nuk mund të kuptoja qenien time, vinte tani një copë letër që m'u mblodh në grykë si lësh. U përpoqa të mbushesha me frymë. Mora nga tryeza shukun e letrës, e shpalosa dhe e lexova për të katërtën herë. I njëjti shkrim, e njëjta përmbajtje, të njëjtat mendime të radhitura keq, por gjithësesi të qarta e tronditëse. Tani nuk jam në gjendje që ta formuloj fjalë për fjalë. Ajo ishte një letër e gjatë, për më tepër e mërzitshme. Autori i saj, me mllef të hapur pyeste Komitetin e Partisë së gjer kur do të lihej në krye të punëve në Gur të Zi një femër e korruptuar dhe imorale si Ruhija. Për këtë renditëshin një sërë faktesh pa rëndësi, por ajo që ia vlente dhe që përbënte akuzën kryesore ishte denoncimi i marrëdhënieve të saj të kundërligjshme me drejtorin e shkollës 8-vjeçare, një vendali me emrin Lirim. Nuk më shqitet nga mendja kjo frazë: «Marrëdhëniet e tyre të turpshme kanë rënë në sy të tërë fshatit dhe dëmtojnë çdo ditë vijën e Partisë. Nuk është çudi që nesër këto marrëdhënie të çojnë, pa asnjë faj, ndonjë njeri në rrugën e krimit. Prandaj kërkojmë të merren masa urgjente». Akuza e dytë, që bënte autori anonim, ishte paaftësia e plotë e Ruhijes për të drejtuar kooperativën. Por kjo ishte formuluar në mënyrë të përgjithshme, pa ndonjë fakt konkret. Në fund më tërhoqi vemendjen një mendim i hedhur kalimthi, por mjaft i çu-

ditshëm: Komiteti i Partisë mund të mos nxitohej dy vjet më parë për zgjedhjen e saj si kryetare, por këtu, sipas autorit, kanë pasë ndikuar edhe simpatitë personale të ndonjë punonjësi të aparatit, që në atë kohë ishte në komitet. Pra aludohej qartë për mua, veçse autori anonim ende nuk e kishte marrë vesh se tashmë isha kthyer në detyrë.

Kjo pra, në vija të përgjithshme, ishte përmbajtja e asaj letre. U mbështeta në shpinën e karriges dhe mbylla sytë. Kishin kaluar dy vjet. Shumë ujë kishte rrjedhur gjatë kësaj kohe. Nga do t'ia nisja tani? Brofa në këmbë dhe gati sa s'thirra: «Në djall të vejë, le ta shpiem deri në fund»...

Si piva një kafe në bufenë e komitetit e mora veten dhe mendja m'u qartësua. Unë nuk kisha ndonjë arsye të nevikosesha. Asgjë s'mund të më siguronte që gjatë largimit tim të mos ndodhte dreqi e di se çfarë. Pastaj, a mund të pretendoja se Ruhijen e njihja në rrënjë? Vërtet, a e njihja si duhet Ruhijen? Këtë pyetje ia bëra për herë të parë vetes pas aq kohësh dhe diçka më lëvizi në kraharor. Përshtypjet e mia për të bazoheshin në disa çaste, ndonëse kuptimplote, por përpëseprapë të pamjaftueshme. Po sikur ai autor anonim të shprehte një realitet? Një zë i brendshëm më thoshte se një gjë e tillë ishte e pamundur. Por mbase kjo ishte thjesht një bindje e formuar në rrethana të caktuara, që lidheshin me njohjet e mia në Gur të Zi. Atëherë vura në dyshim veten time dhe mora një vendim të prerë. Këtë çështje do ta studioja me gjakftohtësi të plotë gjersa të dilte në shesh e vërteta.

Që të nesërmen mblodha të gjitha materialet,

raportet, relacionet e dy viteve të fundit për Gurin e Zi. Krahas këtyre tërhoqja në seksionin e bujqësisë një numër evidencash mbi realizimet vjetore. Po kështu kërkova të dhëna në seksionin e shëndetësisë dhe në atë të arsimit e të kulturës. Erdha në përfundimin se gjatë kësaj kohe atje ishte bërë një punë e madhe. Rendimentet e grurit dhe të misrit ishin të larta qysh vitin e parë: ishin arritur një tog suksesesh në frutikulturë, në shtimin e numrit të bagëtive e sa e sa të tjera që s'ka kuptim t'i rendis. Fshati tashmë kishte konsultore, një mami, shkollën, 8-vjeçare, ndërsa së fundi po ndërtonin një rrugë që do të lidhte Gurin e Zi me rrugën kryesore. Të gjitha vetëm brenda dy vjetësh. Megjithatë këto nuk dëshmonin në mënyrë bindëse për thelbin e çështjes. Ato shumë-shumë për Ruhijen përbënin një anë pozitive, por jo gjithçka.

Atëherë rruga e vetme që mbetej ishte ajo e fshatit. Çështja duhej zgjidhur në vend. Ndosh-ta të nesërmen do të gjendesha në Gur të Zi, sikur që në mëngjes të mos ndodhte diçka që m'i përmbysi të gjitha planet. Me çantën e vogël të udhëtimeve në dorë kalova rastësisht para komitetit. Shpesh gjeje ndonjë makinë për andej. Së largu, në shkallët e hyrjes dallova një grua. Dielli i fortë nuk më lejonte të vështroja mirë, por, kur u afrova, për habinë time, vura re se ajo ishte Ruhija. Merre me mend se sa u shqetësova. Ende i kisha përpara syve shkronjat e letrës dhe ja tani Ruhija, papritur e pakujtuar, s'dihej përse kishte zënë derën e komitetit në pikë të sabahut. Sido që të ishte unë kisha dy vjet pa e parë. Diçka më sëmboi. Nuk do të doja ta takoja kështu, në rrethana

kaq të vështira për të. Prandaj iu afrova ngadalë. Ajo s'më vuri re dhe mbase nuk e priste të më shihte, sepse, kur unë i zgjata dorën, ajo më tha e turbulluar:

— Shoku Xhezo... ju këtu?

— Po, — iu përgjigja duke u përpjekur të largoja çdo ndjenjë pasigurie. — S'ka veç disa ditë që fillova.

— Kurse unë ju dija akoma në Tiranë, — tha ajo.

Pastaj heshti. Sytë e mëdhenj i ishin futur thellë në gropëza. Me fytyrën e tërhequr m'u duk tepër e dobësuar. Më dha përshtypjen e një njeriu të lodhur dhe më erdhi keq.

— Ç'ne këtu që pa gdhirë, — e pyeta.

Ajo psherëtiu.

— Kam ardhur që mbrëmë. Dua të takoj ndonjë shok.

Atëherë vura re se si u mundua të fshihte një pikë lot, që i rrëshqiti në cep të syve, gjer poshtë në gushë.

— Vemi në zyrë, — i fola me butësi, — ti nuk je mirë.

Shtyva derën e rëndë të komitetit dhe ajo më ndoqi nga pas. Ndërsa unë u ula në karrige, ajo nxori një shami dhe e lëshoi veten plotësisht, duke qarë me dënësë. Unë e ndjeva veten keq. Skena të tilla nuk më pëlqenin, prandaj me një ton qortues i thashë:

— Ç'bën kështu, Ruhije, mbaje veten!

— Më falni, shoku Xhezo! Më falni! Kjo s'është e hijshme!

Ky shpërthim nervoz i saj më bëri t'i bie çështjes drejtpërdrejt.

— Përse ke ardhur, — e pyeta, — ç'po ndodh kështu me ty?

— Më falni, — përsëriti ajo, — më vjen shumë keq që u takuam në këtë mënyrë.

— Mirë, tani qetësohu! Ne jemi shokë të vjetër, apo jo? Mblidhe veten!

Ruhija zuri vend mirë në karrige dhe me një zë të akullt tha:

— Nuk mundem më.

Pastaj picërroi sytë dhe nuk i mbeti asnjë shenjë dobësie. Unë u ngrita në këmbë.

— S'po të kuptoj, — i thashë, — ti je kuadër dhe duhet të shpjegohesh më qartë.

— Vërtet, — u përgjigj ajo, — jam kuadër por më duket se po flas qartë. Kërkoj të shkarkohem nga detyra.

Ftohtësia ime e preku. Prandaj iu afrova dhe e vështrova drejt në sy.

— Dëgjo Ruhije. Partia gjithmonë ka pasur mendimin më të mirë për ty, prandaj të bëri edhe kryetare. Tani papritur ti vjen me një kërkesë të çuditshme. Kështu nuk bën mirë. Kështu nuk ndihmon as veten tënde, as Partinë. Prandaj përpiqu të arsyetosh me gjakftohtësi.

Ajo buzëqeshi e hidhëruar.

— Keni të drejtë, — do t'jua shpjegoj të gjitha.

Rrëfimi i Ruhijes që i gjatë. E dëgjova tek foli me zë të shuar për gati një orë. Tërë ligjëratën e saj e përshkoi një ndjenjë turpi, që shprehte sedrën e një gruaje të marrë nëpër këmbë. Në përgjithësi ajo nuk ishte në gjendje t'i lidhte mendimet në mënyrë të qartë. Por dukej se problemi më shqetësues për të, zanafillën e kishte në



planin familjar. Ndodhej në prag të ndarjes me të shoqin.

— Oh, — thashë unë, — si është e mundur?

— Nuk e di.

— Ne jemi shokë, — i thashë.

— Jo, s'kam ndonjë gjë të madhe. Unë kurrë s'kam menduar keq për Kadriun. Nuk u kam dhënë rëndësi vogëlsirave. Por, si duket, puna ka nisur që në këto vogëlsira. Atij nuk i pëlqente që unë kisha të bëja aq shumë me meshkuj.

— Po ty ta kërkonte puna...

Marrëdhëniet tona u acaruan keq tani, kohët e fundit. Në fshat mezi ngritëm shkollën e natës. Bëmë një mijë përpjekje për të tërhequr edhe gratë. Shumë burrave kjo nuk u pëlqeu. Një ditë, Kadriu, i inatosur, më tha se isha kryetare kooperative dhe jo kryetare e grave. Më kërcënoi hapur që të hiqja dorë e të mos trazoja gratë e të tjerëve. Ai s'mund t'i duronte fjalët e njerëzve.

— Po mirë, — e pyeta unë, — mos i fryn dikush në vesh Kadriut dhe cili mund të jetë ai dikush?

— Për këtë s'di ç'të them. Në përgjithësi kohët e fundit ai ndryshoi. Vetëm shfrynte. Prandaj tërbimi i tij këtu e një javë më parë për mua nuk qe i papritur. Sapo isha kthyer nga mbledhja e kryesisë ndaj të ngrysur. Gjer në shtëpi më shoqëroi drejtori i shkollës, të cilin e kishim thirrur në mbledhje, sepse diskutuam problemin e nxënësve. Kur u futa në shtëpi, gati duke ulëritur, Kadriu më foli: «Dil jashtë, qërohu nga shtëpia! Jam martuar që gruan ta kem në shtëpi e jo të brendhë me kodoshë!»

Ruhija nxori shaminë dhe fshiu sytë. U ngri-

ta në këmbë. Futa duart në xhepa e për disa çaste u enda poshtë e lart.

— Kjo është arsyeja që ti kërkon të hiqesh nga detyra?

— Nuk mundem më, — u përgjigj ajo.

— A ke ankesë për ndonjë person që të ka penguar haptas?

— Prej kohësh e ndiej se diçka nuk vete. Kjo është arsyeja që jam lodhur. Ndoshta bëj gabim. Por, më thoni, ç'më mbetet mua? Tani, me siguri, i tërë fshati zien. Disa janë edhe të kënaqur që më së fundi Kadriu u bë burrë e ma uli hundën.

— Këtë dua unë, — e ndërpreva, — ti po flet në përgjithësi. A nuk mund të më thuash se kush do të kënaqet nga kjo që ndodhi?

Ruhija më vështroi si e zhgënjyer.

— Si nuk e kuptoni, — tha ajo, — si nuk e kuptoni që në Gur të Zi fatkeqësisht ka njerëz të tillë?

Ajo kishte të drejtë. Ky shpërthim nervoz shprehte dufin që i qe mbledhur nga dita në ditë, nga muaji në muaj, një duf i hidhur, që nuk përmbahej më. Unë iu afrova, i vura dorën në sup dhe i thashë:

— E kuptoj gjëndjen tënde. Por të këshilloj të mbahesh. Tani menjëherë nisunë në fshat dhe vazhdo të kryesh detyrën. Atje do t'i zgjidhim të gjitha.

#### IV

Menjëherë vajta te sekretari i parë, të cilit ia raportova çështjen në vija të përgjithshme. I fola edhe për takimin e papritur me Ruhijen dhe

shpreha mendimin se i gjithë ky lëmsh duhej zgjidhur në fshat. Ai e aprovoi mendimin tim. Më porositi të tregohesha i kujdesshëm gjatë tërë verifikimit të çështjes, për të arritur në përfundime sa më të sakta. Së fundi, më vuri në dispozicion një makinë të komitetit.

Të nesërmen u nisa, sido që disi me vonesë, nga ca punë të ngutshme që më dolën aty për aty. Shoferi, i mërzhitur nga pritja e gjatë, ia shkeli gjer në fund. Kaluam me shpejtësi rrugën e asfaltuar prej disa kilometrash, gjersa morëm një kthesë malore, pas së cilës e humbëm nga sytë pamjen e fushës. Makina jonë e vogël ngjitej në rrëpirë, duke rënkuar, thujse grindej me rrugën sa herë kërcente e tronditej mbi gurët e gropat e saj. Një orë më vonë, befas ajo kërceu nja dy herë përpjetë, gulçoi, bëri të hidhej përsëri përpara, por qëndroi në anë të rrugës. Shoferi kërceu nga sedilia, kurse unë mbeta në ndenjësë i troshitur, me kokën që më gjëmonte.

— Nuk mund të vazhdojmë më tutje, — tha shoferi.

Ai u përpoq të më shpjegonte arsyen. Unë dola jashtë e ndeza një cigare. Një copë herë ai u mor përsëri me motorin. Me mendjen time bëra një llogari të thjeshtë; po të nisesha në këmbë që aty, për nja dy orë arrija në stanet e fshatit.

— A kalojnë makina shpesh këndeje? — pyeta shoferin.

— Edhe aq shpesh jo, po për të kaluar kalojnë. Janë ato të sharrave.

— Mirë atëherë, — i thashë, — ti prit ndonjë makinë, rimorkiohu me të dhe kthehu.

I çuditur nga ky vendim, shoferi më shtrëngoi

dorën, ndërsa unë iu ngjita një monopati, kalova një qafë dhe u futa në pyll. Dushqet fëshfërinin. E gjithë hapësira të joshte me ajrin e pastër kundërmues. Kisha kohë pa u futur kështu në pyll dhe, sikur të kisha nge, me siguri do të endesha gjer në mbrëmje, apo t'ia këputja gjumit pranë ndonjë zgërbonje të vjetër. Bari i njomë kishte mbirë në çdo qoshe ku kishte qenë e mundur, mjaftonte që të gjendej pak dhe i butë, ku të mbinte fara, bile edhe në të çarat e shkëmbinjve. Diku u dëgjuan disa këmborë të largëta, diku pas një brinje, gjë që më kujtoi se në të dalë të këtij pylli ndodhej një baxho. Mesdita ishte thyer, prandaj nxitova hapat. Si kalova një burim me muçile, ku pinin ujë kafshët, para syve më doli baxhoja e kredhur në heshtje, midis një gjelbërimi të dendur drurësh. Përbrenda mureve të saj dëgjohej vetëm një zhurmë e mbytur, pastaj një lehje qeni dhe në derë u duk një burrë i gjatë. Me sa dukej nuk më njohu menjëherë. Qeni vazhdonte të lehte aty, pranë këmbëve të tij.

— Të paska lënë kujtesa, o Rrapi, — thashë unë. Ai lëshoi një pasthirmë habie, i bërtiti qenit që u fsheh pas mureve të baxhos dhe erdhi e më përqafoi.

— Oh, po si kështu, shoku Xhezo... për nder... dhe vetëm fare. Po si je, o burrë i dheut?

Rrapi ishte djali i vogël, i vetmi që kishte mbetur nga djemtë e plakut Shefit Zguni. Dy djemtë e tjerë, siç thamë në krye të këtij tregimi, ranë dëshmorë gjatë Luftës. Rrapi, që në atë kohë ishte fare i vogël, nja trembëdhjetë-katërmëdhjetë vjeç, me sa më kujtohet, qe korrier i një batalioni partizan. Pas Çlirimit e luta xha Shefitin që ta dërgonte në ndonjë shkollë, por ai s'pranoi.

Të vetmin djalë dëshironte ta kishte për gjithë jetën aty pranë, kështu që Rrapi u mor me punët e familjes, iu bë krah të atit. Shumë shpejt ai u bë blegtor i mirë dhe një nga baxhoxhinjtë më të dëgjuar në tërë krahinën...

— Rrapi, si je, — i thashë, — sa kohë kemi pa u parë. — Ai më mbante në krahë, vazhdonte të më shtrëngonte fort, duke më gërvishtur me qimet e dendura të mjekrës.

— Për nder.. po, nja tre vjet po, besoj... Lëre, lëre mos e pyet. Dhe ti vjen kaq papritur, fare vetëm. Hajde, more shoku Xhezo, hajde...

Rrapi më la në dorë kutinë e duhanit dhe heshti. Unë u ula në shesh, mbi bar. Mora një fije letër e zura të dridhja një cigare. Edhe Rrapi u ul pranë meje. Herë-herë ai vështronte nga dera e baxhos, prej nga vinin mbytyr ca pëshpëritje.

— Ka njerëz brenda? — e pyeta.

— Po, — tha Rrapi, — është ai drejtori i shkollës, Lirimi. Seç ka një punë me Brahimin.

— Cilin Brahim?

— Duhet ta njohësh ti, është vëllai i Veip Skuqit, baxhoxhi me mua.

Unë pështyva copërat e letrës që më kishin mbetur në gojë. Shtëpitë e fshatit dukeshin si në pëllëmbë të dorës, edhe ato më të afërtat mbi një kodër rrumbullake, edhe të largëtat, tutje, në faqe të malit, midis blatrave të gjelbra, mbuluar me rrasa të hirta. Një brez i dëndur dushqesh vithisej gjer poshtë, ku kalonte përroi me ca ujëra të rrëmbyera, të ftohta akull, që nuk reshtnin as dimër, as verë.

— Po si kështu, shoku Xhezo, si kështu, vetëm, — tha Rrapi. Unë nuk fola. Pastaj e vështrova drejt në sy:

— Vërtet nuk e merr dot me mend përse kam ardhur? — e pyeta.

Rrapi rrudhi vetullat, por nuk u ndje.

— Unë kam shtëpi, — tha pas pak, — po të duash eja sonte të rrimë.

— Do të vij me gjithë qejf, por jo sonte, — i thashë.

— Si të të vijë për mbarë.

— Jo, s'e kam fjalën aty. Sonte dua të vete nga xhaxhai yt.

Ai vërtiti nëpër duar kutinë e duhanit, pastaj e la në tokë, por nuk shprehu asnjë mendim.

— Edhe Kadriu më duket se një dhomë në konaqet e Arifit ka.

— Ti do të vesh te Kadriu?! — u habit Rrapi.

— Nuk thashë te Kadriu, thashë te Arifi.

Ai ishte zverdhur. Me gishtërinjtë e trashë zuri të rrëmonte dheun pranë këmbëve, të qëronte fijet e barit, gjersa sajoi një si shesh të vogël rrumbullak. Unë ndiqja lëvizjet e gishtërinjve të tij që rrëmonin e rrëmonin me nervozizëm atë copë dhe, sikur të donte të shkulte e të nxirrite jashtë vetes së tij diçka që po e gërryente përbrenda. Pastaj ai e mori tufën e barit në dorë dhe e ngjeshi duke e përzier me dheun e butë.

— Në atë shtëpi mua s'më ka pyetur njeri. Unë s'di asgjë ç'ka ndodhur aty, — tha mbyturazi. — Megjithatë çdo berr varet nga këmbët e tij. Po s'erdhe sonte tek unë, më mbetet qejfi.

Unë vura buzën në gaz.

— Rrapi, i lëmë mënjanë këto, dreqi e mori!  
Ti e kupton se s'kam ardhur të prishem me ty,  
por të ndreq punë. Dhe ti duhet të më ndihmosh.

— Të të ndihmoj?

— Tamam, të më ndihmosh. Ç'janë këto që po  
ndodhin këtu? Ç'bëhet në shtëpinë tuaj?

— Unë e kam shtëpinë time.

— Prapë me këto?

Rrapi u zbut. Uli kokën nga turpi dhe fër-  
koi mjekrën e parruar.

— Eh, mor shoku Xhezo, — tha, — të keqen e  
kemi brenda ne, po ec e gjeje.

— Kaq e vështirë qenka? — thashë unë.

— Merre si ta marrësh. Ja, aty në baxho është  
ai mësuesi, Lirimi. Shyqyr që erdhe ti, se unë do  
të kisha ikur. Nuk më rrihet dot pranë tij. Ti do  
të pyesësh përse? Po ja, bre shoku Xhezo, fjalë  
ka sa të duash. Unë e di mirë e hidhem në zjarr  
se atë djalë s'e ke për ato punë. E njoh me rrënjë  
unë atë. Po ç't'i bëj? Se njerëzit pëshpërisin, sho-  
ku Xhezo, e llafet kanë marrë dhenë. U bëmë për  
turp në fshat...

Para nesh kaluan dy kafsharë me mushka të  
ngarkuara. Ata na përshëndetën dhe humbën midis  
dushqeve. Një copë herë dëgjua tringëllimën e  
patkonjve të mushkave dhe zilkat e tyre, që kum-  
buan gjatë, gjersa nuk u ndien më.

— Po mirë, o Rrapi, — thashë unë, — i beson  
ato që fliten? A mos luan ndonjë gjë tjetër në këtë  
mes? Ë? Se ti je komunist dhe ma ha mendja se  
duhet të shohësh diçka më përtej se xha Arifi,  
fjala vjen...

Rrapi psherëtiu thellë.

— More që diçka luan, unë këtë e kuptoj mirë. Po ç'të bëj? Unë e ndiej, bre shoku Xhezo, e ndiej se diçka nuk vete. Pikërisht atëherë kur kujtojmë se i vëmë punët në udhë, do të dalë ndonjë gjë që të na i përmbysë. Ja tani dhe gjithë kjo rrëmujë...

Atë çast në derën e baxhos u dukën dy burra. Njëri më i ri, me flokë të verdhë, me një xhakëtë kadifeje. Tjetri, i gjatë, i thatë, me ca sy të zinj.

Ne u ngritëm më këmbë. Djaloshi, duke u skuqur lehtë, më zgjati dorën e, megjithëse njëheshim, u tërhoq prapa i druajtur, si të donte të fshihej pas trupit të thatë si kosore të baxhoxhiut. Brahimi, i ngrysur u përshëndosh me mua, duke i shqiptuar fjalët e rastit nëpër dhëmbë. Tashmë dita po thyhej ngadalë. Nga pylli vinte një fëshmërimë e butë gjethesh, ajri po e humbiste ngrohësinë dhe transparencën, një ngjyrë e lehtë portokalli në të gjelbër mbështille tërë shpatin e malit përkundruall nesh, ku tani mezi dalloheshin rrasat e hirta të çative.

— Unë po iki, — tha Rrapi, — a ke ndonjë porosi?

I hutuar ngaqë na u ndërpre aq papritur biseda me të, unë harrova t'i thosha që të lajmëronte Ademini, sekretarin e partisë të fshatit, për një mbledhje që duhej të bënim të nesërmen në mëngjes me organizatën-bazë. Në një farë mënyre i përsërita se atë natë do të veja tek Arifi dhe i lashë të kuptonte se edhe ai duhej të ndodhej partjetër. Pastaj Rrapi u largua nëpër korije dhe ne mbetëm në këmbë përpara baxhos. Menjëherë u pendova që nuk ika me Rrapin. Midis ne të treve



plakosi një heshtje e rëndë, thujse po e mbanim njëri-tjetrin mbi shpinë.

— Ç'kemi, Brahim, — arrita të thosha, — si është Veipi?

— Po mirë, o shoku Xhezo, mirë.

Pastaj ai u fut brenda, prej nga doli me një tas plot me dhallë. Atëherë unë ndjeva se më kishte pushtuar një etje e madhe. Dhallin e ktheva me një frymë.

— A do më? — tha Brahimi, që më shihte sikur do të më vinte në kandar me ata sytë e tij zhbirues.

— Jo, — u përgjigja, — falemnderit.

Djaloshi rrinte mënjanë me po atë druajtjen e fillimit. Ai kishte një vështrim të kthjellët dhe unë s'e pata të vështirë të dalloja një hije trishtimi që endej në fytyrën e tij.

— Po ju, drejtor, — i thashë, — a keni më punë këtu, apo do të vini me mua në fshat?

Ai më vështroi me habi. Me sa dukej nuk e priste një ftesë të tillë nga ana ime, prandaj u tregua menjëherë i gatshëm të më shoqëronte. Pas pak u ndamë me Brahimin. U futëm në pyll, ku rruga priste më shkurt. Unë ecja përpara me çantën e vogël në dorë. Brenda në çantë ndodhej pikërisht letra që akuzonte për imoralitet këtë njeri, që vinte pas meje i heshtur, me një barrë turpi në shpirt. Në këtë mes kishte diçka komike e tragjike njëkohësisht. Se si më erdhi ky mendim edhe ndjeva një dridhërimë në trup.

— A jeni i martuar? — e pyeta papritur.

Ai u zbeh, pështyma iu tha në buzë e mezi bëlbëzoi:

— Jo, shoku Xhezo, po ç'rëndësi ka kjo?

— Asnjë rëndësi, mor djalë, — i thashë, — pse, ka ndonjë të keqe që të pyeta?

— Jo, shoku Xhezo, të keqe nuk ka, por unë budalla nuk jam.

E vështrova i habitur.

— Ç'do të thuash me këtë, — e pyeta.

— Atë që desha të thosha...

Unë ndalova. Në pyll po binte muzgu i mbrëmjes. Ca zogj fluturuan sipër dushqeve me rrëmbim, tutje u dëgjua vajtimi i një qoku.

— Qëndrimi juaj s'më duket serioz, — i thashë, — pse flisni në këtë mënyrë?

Djaloshi u mundua të zotëronte veten:

— Më falni, — tha, — por jam mjaft i tronditur. Unë e marr me mend për se keni ardhur këtu dhe e marr me mend gjithashtu që ju kanë folur për mua. Prandaj po jua them hapur se të gjitha ato janë gënjeshtër e shpifje. Më falni, ju keni punën tuaj dhe çojeni gjer në fund. Por edhe unë do të di ta mbroj veten. Këtu po ndodhin disa gjëra të çuditshme, po të flasim me një gjuhë tepër të zbutur, ndërsa dikush ka qejf t'u fryjë thashethemeve nga më të ndyrat. E dini që më është bërë e padurueshme jeta, pikërisht në fshatin tim? Dhe pse?... Ndërsa ju më hidhni thumba, nëse jam apo s'jam i martuar. E ç'ka të bëjë kjo? Në qoftë se Kadri Zgunit apo Rrap Zgunit nuk u pëlqen fytyra ime, ky nuk është faji im. Dhe përse i përket kryerjes së detyrave të mia shtetërore, nuk marr leje as nga Kadri Zguni, dhe as nga zoti i tij.

Atij zuri t'i dridhej zëri nga emocioni. Ishte e çuditshme se si ai njeri, aq i qetë dhe aq i butë në pamje, të shpërthente në këtë mënyrë.

— Po flet gabim përsëri, — i thashë unë.

— Sigurisht, ju s'keni se si të më mbronni mua.

Unë u trondita. Vetëtimthi më dolën para syve shkronjat e letrës dhe ajo frazë e hedhur si kalimthi lidhur me njohjet e mia personale me familjen e Zgunajve. Pra, punët kishin shkuar thellë. Autori i letrës anonime qenkej mjaft i rafinuar, mjaft dinak. Ai po luante karta tepër të rrezikshme. Duke e mbajtur veten me vështirësi, i thashë i qetë:

— Përse mendoni kështu? Unë ju siguroj se nuk keni të drejtë.

— Ashtu qoftë! — tha ai.

— Tani do të më falni ju mua t'ju pyes për diçka, — thashë unë i mbështetur pas trungut të trashë të një lisi. Meqë vetë e hapët këtë bisedë, më duket se kam të drejtë së pari t'ju them se për ju, mua s'më ka folur keq asnjëri dhe çdo gjë do ta gjykojmë me imtësi, me gjakftohtësi, siç na mëson Partia. Unë jam plotësisht i bindur se, në mos sot, nesër, do ta shpleksim këtë lëmsh. Po ju jeni arsimitar, drejtor shkollë, si të thuash, nga njerëzit më me kulturë në fshat. Atëherë si është e mundur ta humbisni toruan në këtë mënyrë e të bini viktimë pikërisht e këtyre thashethemeve? Si ka mundësi që ta humbni gjykimin gjer në këtë masë? Jo, prisni... më falni edhe ju tani! Së dyti, në mos gabohem, thatë se këtu te ju bëhen disa gjëra që i quajtet të çuditshme, ndërsa dikush ka qejf t'u fryjë thashethemeve nga më të ndyrat. A ju lejohet të shpreheni në këtë mënyrë? Në qoftë se po, ç'janë këto gjëra, kush i fryn dhe përse?

Djaloshi u bë si meit. Diku poshtë nesh gurgu-

llonin ujërat e përroit, një sorrë bishtgjatë me pulla të bardha krakariti aty pranë e pastaj çdo gjë u krodh në një heshtje të shurdhër.

— Nuk m'u përgjigjet, — thashë unë.

— Jo, unë mund të përgjigjem dhe do të përgjigjem. Por kjo ka lidhje me një mik të ngushtë të Zgunajve dhe tuajin njëkohësisht, mendoj unë.

— Me cilin?

— Me Veip Skuqin.

— E çfarë, — thashë unë.

— Po ja, — tha djaloshi, — këtë po bisedoja pak më parë dhe me vëllanë e tij, Brahimin. Ai ka një mbesë te ne, nxënëse në klasën e shtatë. Prej dy javësh ajo s'është paraqitur në shkollë. Vetëm dje mora vesh se do ta martojnë në fshatin këtu pranë. Bisedova me Brahimin dhe ai më thotë se kjo është e vërtetë. Gjoja vajza na qenka shtatzënë. Profka që të gjitha. Në qoftë se Veip Skuqi me vëllezërit nuk i ka prishur fejesat që në djep, siç bënë të gjithë, aq më keq për të kur lejon shkelje të tilla të ligjit, sepse është edhe kryetar i këshillit të fshatit. Me këtë punë të merret ai dhe jo me...

— Me çfarë? — i thashë unë.

— Po ja... gjoja me çështjen time. Thotë gjithandej se fshati ynë nuk e përtyp imoralitetin, se punën time s'do ta lërë me kaq, por do ta bëjë problem lart. Ai le të shohë më mirë punën e së mbesës, dhe të mos hiqet si zot i fshatit.

— Kush, Veipi?

Ai heshti. E kuptova se s'donte të fliste më gjatë.

— Po flet shumë rëndë për të, — i thashë. —

Pastaj, ç'lidhje kanë këto me faktin se Veipi është mik i Zgunajve? Ta themi hapur, unë s'di të ketë qenë ndonjëherë kaq i afërt në atë shtëpi.

— Koha ecën, shoku Xhezo, edhe gjërat ndryshojnë, — tha ai.

Ndërkaq zumë të ngjiteshim kodrës, ku ndodheshin të shpërndara disa ara të përforcuara me mure guri. Drurët e mollëve mbushnin tërë atë faqe kodre grumbuj-grumbuj, së bashku me arrat trupmëdha, në degët e të cilave, gjer sipër në majë, kacavireshin hardhitë që dredhonin me kërcellin e tyre të kuqërremtë. Vinte një aromë e këndshme tërfili e jonxhe të kositur e të tharë në diell.

— Do t'ju them edhe një gjë, shoku Xhezo, — foli befaz djaloshi. — Sado e çuditshme që të duket, edhe këtu te ne, në fshat, ka njerëz që duan të bëjnë karrierë. Pastaj...

— Dëgjo, mor djalë, — ndërhyra unë, — të gjitha këto bëre mirë që m'i the mua, por do të bëje më mirë t'i thoshe edhe kur të organizojmë mbledhjen e asamblesë. Këto janë me rëndësi të madhe, por duhet edhe t'i argumentosh.

Nuk e di se si e kuptoi ai këtë ndërhyrje. Nuk e di gjithashtu përse dëshiroja me gjithë shpirt që dialoshi të kishte të drejtë që gjërat të qëndronin ashtu siç i shtronte ai. Do të përpiqesha me çdo kusht të nxirrja në shesh të vërtetën e fajtorët të merrnin dënimin e merituar, por një zë i brendshëm, thellë në ndërgjegjen time më thoshte se duhej të tregohesha i matur, të mos nxitoja, të mos givkoja nga veprime të jashtme, të futesha e të gërmoja gjersa t'i nxirrja rrënjët kësaj ferre të keqe që kishte mbirë në Gur të Zi.

## V.

Kur u ndava me të qe ngrysur fare.

Sheshi ku ngriheshin zyrat e reja të kooperativës ishte i shkretë. Pas nja dhjetë minutash pranë meje kaloi një djalë i vogël, që kishte vënë përpara një tufë dhënsh. Shkruajta një pusullë dhe e nisa te Ademi. Djali u kthye shpejt. Duke iu marrë fryma më tha se Ademi s'ndodhej në shtëpi. Ishte nisur në fshatin fqinj i ftuar në dasmë. «Bukur, thashë me vetë, edhe dasma është mangut». Shkruajta një pusullë tjetër, këtë radhë për Veipin. E njoftoja të lajmëronte komunistët, kudo që të ishin, që nesër, në orën tetë të mëngjesit të zhvillohej mbledhja e organizatës.

Kur mbeta vetëm qe bërë natë. Murrizave ndihej kënga e bulkthit. Tani fshatarët lëshonin qentë, të cilët merrnin arratinë të çliruar nga zinxhirët. U armatosa me një shkop dhe zbrita tatëpjetë kodrës, anës mureve prej guri të arave. Ndërkaq para syve më doli shtëpia e vjetër e Shefit Zgunit, që hijerëndë zotëronte tërë brinjën e lagjes së Zgunajve. Një qen i madh tundi zinxhirët. Në çardhak u duk silueta e një njeriu.

— Hajt mirë se erdhe, Xhezair Dani, — dëgjo-va një zë burri dhe u habita se si pati mundësi të më njihje në errësi. Tjetri, me një llambë në dorë, zbriti shkallët. Përmes reflekseve të dobëta të llambës në fillim u shqua hunda e madhe, pas-taj mjekra e parruar dhe sytë kureshtarë të Veipit.

— Ku je, bre burrë? — Thirri ai. — U harruam fare.

Ndërsa më përqafonte, më mbyti me erën e rën-

dë të duhanit, që sikur kundërmonte nga tërë trupi i tij.

— E more pusullën? — e pyeta sapa më çliroi.

— Ç'pusullë?

— Tani ta dërgova në shtëpinë tënde, me një djalë.

Veipi ngriti duart përpjetë.

— Kam nja dy orë që ndodhem këtu. Arifi është pa qejf.

Ndërkaq në çardhak dolën dy nipër të Arifit dhe ne e ndërpremë bisedën...

Ngjita në heshtje shkallët e gurta me parmakë druri. Dy djemtë e rinj ecnin përpara meje me fenerë në dorë, ndërsa nga prapa, me hapa të lehtë, vinte Veipi. Një hije e rëndë, e trishtuar kishte rënë në gjithë atë shtëpi. Ajo mbështillte muret e trasha, skutat e fjetura gjysmë të errëta, fytyrat e njerëzve që s'guxonin të më shihnin drejt por e fshihnin pasigurinë e tyre pas një qëndrimi të jashtëm, të akullt, tepër të sjellshëm e të respektuar, përzier me një burrëri të ashpër, që më kujtonte shkrepat e thepisur të Gurit të Zi. Në një farë mënyre këtë shtëpi e kisha si timen, edhe gurët e saj, edhe trarët e tymosur nga vitet, edhe dritaret e ngushta si frëngji, edhe katuan aty poshtë, ku ndihej dihatja e rëndë e kafshëve shtëpiake, gjithçka që e përbënte atë nga themeli, gjer në kulmin e çatisë. Gjithçka më lidhte e asgjë s'më ndante me këtë shtëpi patriotësh të vjetër, ku për herë të parë po hyja me druajtje. Për herë të parë unë nuk u takova si zakonisht me gratë e të rinjtë, të cilët sapa merrnin vesh ardhjen time derdheshin në çardhak. Me sa dukej ata qenë porositur, prandaj unë vajta drejt

e në dhomë të madhe, ku, pranë oxhakut, i mbuluar gjer në brez me një velenxë të hollë, duke tymosur rëndë-rëndë, rrinte Arif Zguni.

Sapo hyra në derë ai bëri të ngrihej, flaku menjëherë velenxën, por kjo që një përpjekje e kotë, sepse ai s'mundi të lëvizte nga vendi prej sëmundjes. Unë i vajta pranë dhe e rroka në qafë.

Pastaj gjithçka u zhvillua në mënyrë disi ceremoniale, gjë që për mua ishte e shpjegueshme dhe jo e papritur. Plaku më zgjati kutinë e duhanit, u përshëndosh sipas zakonisht, ndërsa Rrapi, që ndodhej aty pranë, zuri të bënte kafet. Një copë herë biseda sikur ngeci. Unë vështroja fytyrën e rrudhur të plakut, atë fytyrë të ëmbël që tani kishte ngrirë, si e murosur. Pastaj ai zuri ta hidhte fjalën andej-këndej krejt artificialisht, në kujtime të hershme, që ishin fare larg nga ai shqetësim, që unë e lexoja haptas në rrudhat e ballit të tij të rreshkur.

Tek flisja me plakun, që thithte duhanin i mbështetur në gurin e vatrës, jashtë, pas derës së drunjtë u dëgjuan pëshpëritje. Dikush e ngriti zërin. Për disa çaste pati një lloj rrëmuje e përmes saj erdhi gjer në veshët tanë zëri i një gruaje që thoshte:

— Do të vete, ç'të duhet ty!

Zhurma shqetësoi Arifin.

— Ej, ç'bëhet atje?

Zërat u shuan. Pas pak dera u hap ngadalë. Në dhomë u fut plaka e tij, pak e kërrusur, me një napë të bardhë në kokë. E ndiqnin dy vajza apo gra të reja që i shihja për herë të parë.

— Hë, moj plakë, — tha Arifi, — ç'dreqin bëhet atje?



Ajo u ul në brinjë. Pranë saj, duke përsëritur veprimet e plakës, u ulën të rejat. Arifi pështyu në vatër.

— Ti je i Partisë, mor bir? — më tha plaka.

Unë vura buzën në gaz.

— Po, nëno, — iu përgjigja. — Të gjithë ne të Partisë jemi.

— Ashtu, të keqen, po qe se je i Partisë, na bëj derman e sillna nusen në shtëpi. Ai qafiri na nxu faqen.

Plaka ngri dorën në fytyrën e rrudhur dhe rregulloi napën që i mbështillte flokët. Kur unë ende s'kisha formuluar përgjigjen, dera u hap me vrull. Në dhomë u fut një burrë i gjatë me nofulla të shtrënguara. Ishte djali i Arifit, me të cilin njihesha pak. Si u përshëndet me mua, iu drejtua njëres nga të rejat:

— Po ti, ç'bën këtu?

— Lëre, bre Sadik, vajzën, ç'ke me të? — ndërhyri plaka.

— Vërtet, — thashë unë, — muhabet po bëjmë.

Sadiku gëlltiti pështymën, kaloi dorën e madhe mbi flokët e verdhë dhe u bind.

— E, bre shoku Xhezo. S'e kanë mendjen në vend këto.

Vajza, gjithashtu një leshverdhë e imtë, u struk pas së gjyshes.

— Rri, o Sadik, — tha plaka, — se shpirtin e kam helm. Mos m'i nga vajzat po ec e mblidhi rripat tët nipi.

Sadiku i hodhi së bijës një vështrim kërcënues dhe mërmëriti:

— Burri e merr gruan për shtëpi, jo për t'i nxirë faqen.

Unë nuk u ndjeva. Arifi thithte duhanin me një shprehje të dukshme pakënaqësie.

— Ç'bëhet në këtë shtëpi, o Arif Zguni, — tha shë me zë të rreptë. — Ç'është ky turp?

Të gjithë shtangën. Ai flaku duhanin i mër-zitur. Rrëmbeu mashën dhe duke trazuar zjarrin goditi truallin e ngjeshur të vatrës.

— Kjo shtëpi s'është turpëruar, — foli me zë të mbytur, — kurrë! Por edhe turpin s'e mban.

Kisha prekur në pikën më delikate të sedrës së tyre. Plaku diçka duhej të dinte. Përgjigjja e dëshpëruar tregonte se ai e përkrahte veprimin e të nipit. Po jo pa një shkak të fortë. Ndërkaq në dhomë ishin mbledhur nja pesëmbëdhjetë vetë.

— Ruhija s'ka bërë turpe, — ndërhyri një grua që rrinte në këmbë, pranë derës, — turpi është për ne, që tërë fshati na mban në gojë.

— Rri, moj, aty, mos na çaj kokën, — tha Sadiku.

— Posi, vetëm të bërtisni dini ju.

— Pse, çfarë? T'u lëmë të bridhni, të harboheni?

— Mos e prish gojën, Sadik, — ndërhyri Rrapi, që rrinte në një qoshe, — të gjithë kemi gra e vajza dhe po na prek keq. Nuk po harbohet njeri.

— Posi, mor jahu! Sot duan të venë në shkollë natën, nesër të bëjnë theatër, pasnesër dreqi e merr vesh se çfarë.

— Ti, Sadik, e ke urryer gjithmonë Ruhijen.

— Rrap, mba veten se, për nder...

— Mjaft, — thirri Arifi me nervozizëm, ç'm'u mblodhët të tërë këtu, si lugetër? Ç'drejin keni?

Në dhomë pllakosi heshtja. Fytyrat e njerëzve ndriçoheshin zbehtë nga drita e verdhë e llambës,

ku tiparet me konture të theksuara viheshin më në dukje nga dritëhijet.

— Ç'bëni kështu, — ndjeva zërin e Veipit. — Le më, po kemi edhe shokun Xhezo. Pa ikni ju, vajza, tani! Hajt, se mjaft na mërzitët. Edhe ju, djem!

Asnjëri nuk lëvizi nga vendi. Unë ia qepa sytë Veipit, duke u përpjekjur të përmbaja inatin që po më hipte.

— S'ka gjë, Veip! Le të rrinë. Unë jam në shtëpinë time.

— Ty të lumtë goja, — tha plaku, por nuk e kam parë veten më keq.

Ai u mbështet në vatër dhe atë çast dikush thirri:

— **S'ke përse ta ndiesh veten kaq.**

Ishte zëri i Kadriut, që s'dihet se si mbiu aty pa u vënë re. Unë ktheva kokën. Ai qëndronte te dera në këmbë, me pamje të egërsuar, i tretur e plot kapadaillëk. Sytë i ishin futur thellë në gropëzë dhe ishte aq i hutuar, sa harroi edhe të më përshëndeste. Pas kaq kohësh pa u parë, m'u duk tepër i vogël, me diçka të neveritshme në tërë pamjen e tij.

— I dëgjova të gjitha, — shtoi duke ngrënë fjalët nga emocioni. — Ju s'keni të drejtë të futni hundët në punët e mia. I di vetë ato.

— Ec, or, mbushu, — thirri Rrapi, — s'po flet njeri për ty. Kujt i shet mend? S'ke turp! Mati fjalët se, për nder, për shpirt të plakut, ta zbus kurrizin!

Kadriu nuk e deshi veten. Sytë iu zgurdulluan dhe me një tërbim të heshtur belbëzoi:

— Mos, xhaxha, mos më prek kështu!

— Rri, or, aty. Takohu një herë me miqtë e mos na çaj veshët! Apo je qorrUAR nga sytë?

— Xhaxha!

— Çfarë xhaxha, more. Ku je këtu? Ke respekt ti, apo jo?

— E teprove, Rrap, — ndërhyri Sadiku, — ç'ke me Kadriun?

— Posi, fërkoja krahët ti.

— Ai s'është kalama!

— E, mor, është burrë zakoni.

Diçka ishte krisur në familjen e madhe të Zgunajve, në mënyrë të pandreqshme. Kadriu vështrroi përreth si i humbur. Me një gjest të dëshpëruar klithi:

— Mirë pra, tani do t'jua mbush mendjen top.

Doli me vrull nga dera që e përplasi me forcë dhe u kthye pas pak me një copë letër në dorë. Ai e mbante letrën përpjetë, e tundi në ajër dhe thirri:

— Po kjo si ju duket, na, merreni!

Kadriu e flaku në drejtimin tim. Befas nga qoshja kërceu Veipi, që e kapi dhe deshi ta hidhte në zjarr.

— Budallallëqe, — tha ai, — po bën marrëzira, Kadri.

Më habiti ky nxitim i shqetësuar i Veipit. Përse donte ta zhdukte atë letër? Kjo më bëri të zgjasja dorën e ta rrëmbeja nga flokët.

— Pse e hedh, — i thashë. — Po qe se Kadriu ka të drejtë, pse ta shajmë kot?

— Jo, — tha Veipi, — ai ma ka treguar. Nuk ia vlen.

— Mos e këmbe fjalën, Veip Skuqi, — turfu-lloi Kadriu, — ndryshe më ke folur.

Unë bëra sikur nuk e dëgjova këtë ndërhyrje

të dëshpëruar të Kadriut. Shpalosa letrën, që u dogj pak në qoshe dhe, sapo e hapa, më ra në sy po ai shkrim, po ajo kaligrafi, që më kujtoi rreshtat e drejtë të letrës, që para disa ditësh e kisha marrë në komitet. Pra e njëjta dorë, në të njëjtën kohë, godiste në dy drejtime.

— A ta lexoj me zë të lartë? — pyeta njerëzit që ndodheshin në dhomë.

— Jo, — tha Kadriu, — s'është nevoja.

— Kush e ka shkruar, Ruhija? — pyeti një vajzë.

— Jo, — thashë, — s'dihet kush e ka shkruar.

— Ç'e zgjat, — tha Rrapi, — na e lexo, të paktën të marrim vesh ç'bëhet. — Sadiku heshti. Edhe Veipi. Vetëm plaku lëvizi në qoshen e vatrës.

— Mirë pra, lexoje. Ta dinë të gjithë.

Me sa dukej një pjesë e tyre njiheshin me përmbajtjen e letrës. Gjatë kohës që e lexova, zgunajt, burra e gra, thujse nuk merrnin frymë. Ishte vërtet një letër e ndyrë. Autori anonim, pasi i shprehte Kadriut ndjenjën e respektit, pasi e siguronte se ishte mik i afërt i tij, e vinte në dijeni se e shoqja prej kohësh e tradhtonte. Këtu gratë ndukën faqet. Më poshtë në letër jepeshin disa fakte. Një ditë Ruhija ishte mbyllur vetëm me drejtorin e shkollës për disa orë. Ata takoheshin shpesh dhe një natë ishin parë nga luadhet e Valit. Duke përfituar nga detyra e saj se gjoja bënte kontrolle, Ruhija takohej rregullisht me këtë njeri, ku të mundej.

— Jazëk! — thirri plaka, — lëre, se s'mund ta dëgjoj më!

Megjithatë unë e lexova gjer në fund.

— Mirë e ka Veipi, nuk ia vلente, — thashë dhe e futa letrën në xhep.

— Kjo është poshtërsi, këto janë shpifje, — kllithi vajza e Sadikut.

Pas kësaj krizi një sherr i madh. Unë dëgjoja si i trullosur. Tashmë për mua gjithçka ishte e qartë.

Në kulmin e acarimit Rrapi u ngrit. Vështroi Kadriun si i tërbuar dhe i tha plakut:

— S'kam dëgjuar ndonjëherë gjë më të turpshme, xhaxha. Habitem se si kemi fytyrë të presim sonte këtë mik. Unë për vete po iki. I them Kadri Zgunit të mos shkelë më në shtëpinë time po s'vuri mend.

Ai doli dhe nja dhjetë vetë e ndoqën nga pas. Plaka vuri kujën. Arifi, hijerëndë, thithi duhanin. Urdhëroi t'i sillnin raki. Atë natë s'pranoi njeri në sofër. Kërkoj të pinte vetëm me mua, prandaj dalngadalë dhoma u boshatis. Edhe Sadiku, edhe Kadriu, edhe Veipi dolën jashtë. Kur mbetëm vetëm, ai mori gotën e rakisë.

— Kjo shtëpi s'e ka zakon të turpërohet, — foli i hidhëruar. — Por sonte e lëmë me kaq. Kemi kohë pa u parë dhe kam qejf të çmallemi...

Të nesërmen më dhimbte koka. Tërë natën s'vura gjumë në sy. U ngjita në sheshin e zyrave, por atje s'pripëtinte njeri. Dielli ishte i ftohtë dhe në trup më shkuan dridhërima. Tani duhej të veproja pa humbur kohë. Në çantën time ndodheshin dy letra. Pikësëpari duhej gjetur me çdo kusht autori i tyre. Kjo, në një farë mënyre do të hidhte dritë e do të sqaronte mjaft gjëra. Po si do t'ia bënim? Së dyti duhej përcaktuar qëllimi i këtyre letrave. Ku rrihte autori i tyre? A ishte ai një njeri i shkëputur, një kokëkrisur që s'dinte ç'bënte, apo përfaqësonte një opinion? Po të qe kështu, atëherë puna ndryshonte. Kjo do të thoshte se Ru-

hija, me veprimet e saj, u ishte bërë disave halë në sy. Që ta hiqnin qafe, ata po kalonin në veprime të tilla, por që mund të sillnin pasoja tragjike.

Tek rrija e prisja, nëpër monopatin e ngushtë po ngjitej një njeri. Së largu dallova se ishte Kadriu. Ai ishte zverdhur. Sytë e skuqur tregonin se edhe atë s'e kishte zënë gjumi.

— Më falni, — tha, — mbrëmë nuk u solla mirë me ju.

Kishte diçka të neveritshme në këtë ndryshim të menjëhershëm të tij.

— S'e prisja prej teje, Kadri!

— Më thoni, ç'të bëj? Kam kohë që s'gjej qetësi.

— Fajin e ke vetë.

— Oh, — psherëtiu ai, — ju flisni kështu sepse s'e keni në kurrizin tuaj. Por, po të merrnit edhe ju një letër si ajo, atëherë ta shihnit.

— Çfarë të shihja, — i fola me ashpërsi, — ato marrëzira? Jam i sigurtë se edhe ti vetë nuk i beson. Ja, ma thuaj sinqerisht.

Ai ndezi një cigare dhe e thithi me duf.

— Jo, s'i kam besuar kurrë. Kjo është e vërtetë.

— Atëherë përse sillesh kështu me gruan?

Ai uli kokën. Unë nxora nga çanta letrën tjetër dhe ia lashë në dorë.

— Ç'është kjo?

— Merre, lexoje! S'ke marrë vetëm ti letër.

Kadriu e mori i hutuar. Kur e mbaroi, më vështroi me një pamje fajtori.

— E shikon pra? — thashë unë. — Je bërë lodër në duar të të tjerëve. Kuptoje më në fund se ku është qëllimi i këtyre letrave.

— Ç'të bëj? — më pyeti.

— Të vesh e t'i kërkosh falje gruas. Ta lësh të qetë të punojë e ta ndihmosh. Këtë të bësh.

Ai turidi dorën i mërzhitur.

Në Gur të Zi qëndrova plot një javë. Nuk e patëm të lehtë të gjenim autorin e atyre letrave. Për më tepër kur intriga, ndonëse ordinere, ishte kurdisur me marifet. Por kjo është një histori më vetë. Interesante është se u vërtetuan dyshimet e mia. Autori ishte pikërisht Veip Skuqi, njeri i maskuar, karrierist dhe dallaveraxhi. Një varg vepërimesh të tij më krijuan në kokë ato pikëpyetje që më bënë të dyshoja. Kjo u zbulua gjatë shqyrtimit të një raporti fals, që e zëmë ato ditë të lëshuar nga mamia e fshatit, mbesë e Veipit. Sipas këtij raporti, vërtetohej se një mbesë e vogël e tij, një vajzë pesëmbëdhjetëvjeçare, ishte shtatzënë në një kohë kur ndiqte shkollën. Atë e kishin fejuar në mënyrë të paligjshme në fshatin fqinj. Që ta shkëpuste nga shkollë, në bashkëpunim me maminë, u kurdis raporti. Ndërkohë Veipi mendoi t'i dilte situatës përpara, në rast se zbulohej raporti. Në këtë mënyrë, me një gur do të vriste dy zogj, duke u përpyetur të eliminonte edhe Ruhijen nga drejtimi i kooperativës, vend të cilin mendonte ta zinte vetë, siç pohoi më vonë me gojën e tij. Ai ia diktoi ato letra mamisë, që i shkroi me dorën e saj. Kjo është arsyeja që ne s'po zbulonim dot autorin, Veip Skuqin, i cili s'kishte fjetur asnjë ditë që kur Ruhija u zgjodh kryetare. Kjo është e gjitha! Në një pikëpamje, ky, që një mësim i madh për mua. Tani po fillonte një fazë e re në punën time si in-  
strukturor partie.



## FQINJËT

Dritaret e apartamentit të tyre shikonin nga lindja. Tani çdo mëngjes, po të donin, ata mund të sodisnin edhe shfaqjen e zakonshme të diellit mbi kreshtën e Dajtit. Por as burri as gruaja nuk kishin ndonjë prirje romantike. Ata zgjoheshin herët, ndiznin sobën dhe vështronin njëri-tjetrin nëpërmjet avujve të gotave të çajit. Burri përtypej në heshtje, ndërsa gruaja e pyeste gjithmonë «a do edhe pak?».

Zakonisht burri e përcillte gruan gjer në stacionin e autobusit. Në fillim, kur morën apartamentin e ri, ai priste aty gjerësa autobusi nisej. Gruaja e përshëndeste me dorë pas xhamit të turbullt. Por s'kaluan shumë kohë dhe burrit kjo ceremoni filloi t'i dukej e tepërt. Ai nuk priste më. Largohej dhe ajo e vështronte, duke menduar se kjo ishte një gjë fare e natyrshme.

Pasdite zakonisht burri kthehej në shtëpi di-

sa orë më vonë se e shoqja. Ai ishte inxhinier në një nga uzinat mekanike më të mëdha të kryeqytetit. Kur hynte në shtëpi ai e vështronte gruan me pamje të lodhur, shpesh e puthte në ballë kur ajo i hapte derën dhe e pyeste:

— U mërzite?

— Oh, po ti qenke lodhur shumë!

— Jo, asgjë me rëndësi.

Ndërkaq gruaja e kishte ngrohur gjellën. Burri përtypej në heshtje dhe ajo përsëri e pyeste «a do edhe pak?». Ai ngrihej, shtrihej në kanape dhe lexonte gazetën.

Një vajzë në apartamentin sipër tyre, pasditeve ushtrohej në piano. Tingujt në përgjithësi vinin me një kumbim të shurdhër, jo fort të qartë. Megjithatë të dyve u pëlqente të dëgjonin sa herë që pianistja, të cilën e njihnin vetëm si fytyrë, ulej dhe ushtrohej për disa orë. Atyre as që u kishte shkuar nëpër mend të ankoheshin për prishjen e qetësisë. Aq më tepër sepse, me t'u vendosur në këtë apartament, vizitorja e tyre e parë kishte qenë pikërisht kjo pianiste, që pat ardhur t'u kërkonte të falur. Pak e druajtur e pak me turp, vajza u kënaq plotësisht kur dëgjoji se ata do të dëshironin ta dëgjonin ndonjëherë edhe në dhomën e saj tek ushtrohej. Sidoqoftë, prej disa muajsh ata nuk e kishin bërë një përçapje të tillë, me gjithë ftesat e vajzës.

Kishin vënë re gjithashtu se fqinjët përballë tyre duhej të ishin njerëz të veçantë. Këtë mendim e shprehu e para gruaja. Brenda muajit ajo konstatoi se fqinjët e kishin ndërruar tri herë ngjyrën e derës së jashtme; nga gri e kthyen në të kaltër të hapur e së fundi përdorën një krem të

ëmbël. Për dy javë me radhë nuk i la të qetë dhe zhurma e çekiçit të një marangozi. Gruaja tha se fqinjët po shtronin dhomën me parket. Ajo shtoi se ai gjithmonë kishte qenë i ngathët në këto çështje e nuk u kushtonte atyre asnjë rëndësi.

— Liza, të lutem.

— Jo, jo, përse s'të vjen mirë?

— Këtu s'ka ndonjë gjë për të më ardhur keq apo mirë.

— Megjithatë të vjen keq.

— Po këto janë vërtet meskine, Lizë!...

— Mirë, mirë — përgjigjej ajo, ndonëse në të vërtetë i pëlqente të përdorte shprehjen «ti nuk e nxjerr qimen nga qulli». Por në vend të kësaj, si mësuese, ajo ulej të përgatiste planet e nesërme, ndërsa ai, si gjithmonë, shfletonte literaturë.

\*

\* \*

Lagjja ku banonin ishte e qetë, e ndërtuar rishmë. Midis pallateve, pranë të cilave kalonte rruga automobilistike, ndodheshin akoma të shpërndara andej-këtej mbeturina, togje dheu, copëra tullash, rërë përzier me llaç të ngurtësuar, ku pasditeve luanin fëmijët. Inxhinieri, rreth të dyzetave, ndonjëherë dilte në ballkon dhe i vështronte tek bridhnin e hidheshin nëpër oborr. Kjo i ndodhte rrallë, sepse ishte tepër i zënë me punë, por atëherë zemra e tij e ndjeshme ligështohej. Ai kishte dashuri të veçantë për fëmijët, apo mbase kështu i dukej. Gjatë dhjetë vjetëve të martesës nuk po e shijonte dot gëzimin e natyrshëm e fare të zakonshëm për të

tjerët që të bëhej baba. E shoqja kishte rrezik të mos lindte kurrë. Sido që të jetë, duke vështruar tërë atë fushë të pasistemuar midis pallateve, një darkë u ngul në tryezë dhe sajoi një projekt. Të nesërmen në mbrëmje u ngul përsëri. Më në fund u bind se diçka kishte bërë. U përpoq t'ia shpjegonte së shoges, e cila i dha një këshillë të vlefshme. Projektin mund t'ua jepnin atyre të Frontit apo të lagjes e me pak punë vullnetare nga banorët do të krijohej një park i bukur për fëmijët.

E vërteta është se kjo përçapje e tij u prit mirë, bile në mbledhjen e parë të bllokut, që u bë me këtë rast (ai nuk mundi të merrte pjesë sepse ndodhej në uzinë), kryetari i Frontit u bëri thirrje të gjithë banorëve të ndiqnin shembullim e tij e të fillonin nga ndërtimi i parkut sa më shpejt. Në të vërtetë puna filloi, por me një incident fare të vogël.

Ajo që një e diel e bukur plot diell. Tutje në sheshin e gjerë e shoqja bisedonte me disa gra. Ai nxitoi të dilte dhe, tek mbyllte derën e apartamentit, u hap dera përballë. Për herë të parë ai pa fqinjin e tij, një burrë të gjatë e të bëshëm.

— Oho, gëzohem që njihemi më në fund, — thirri fqinji me gjallëri, duke i zgjatur dorën, — Kristaq Sheme.

— Lulëzim Topi, — mermëriti ai pak i hutuar nga intimiteti disi i çuditshëm me të cilin u paraqit tjetri.

Pastaj, tek zbrisnin shkallët, fqinji ndaloi për një çast, e vështroi me ngulm dhe, duke theksuar tonin konfidencial, pëshpëriti:

— Na mori në qafë një i fantaksur. Vuan si duket nga pagjumësia e na sajon ca projekte për fu-

sha basketbolli. Ec e dil tani kushedi sa të diela atje. Apo s'po mban një mot i mirë...

Inxhinieri u step. Sikur bashkëfolësi i tij të ishte pak i vëmendshëm, me siguri do të kishte vënë re pezmatimin e thellë që e pushtoi. Ai u lëndua, e ndjeu veten të fyer e deshi të thoshte diçka, por tjetri i futi krahun dhe e tërhoqi me vrull pas vetes gjersa dolën në sheshin ku qenë mbledhur banorët.



Një ditë, tek hanin drekë, gruaja vuri re se i shoqi diçka donte të thoshte. Ai përtypej me ngathësi, si të kryente një punë të detyruar. Në fytyrën e mbushur dy sytë e mëdhenj shprehnin në mënyrë të qartë një ndjenjë të lehtë hutimi. Ai u ngrit dhe nuk u shtri si gjithmonë mbi kanape për të lexuar gazetën. Me cigare në dorë u mbështet pas dritares. Një tufë laraskash të zeza fluturuan me rrëmbim mbi antenat e televizorëve dhe u zhdukën pas kodrave.

— Lizë, — tha ai.

Gruaja nuk e dëgjoi. Ajo u fut në banjë dhe doli prej andej me një grumbull rrobash.

— Lizë...

Gruaja u mundua të kuptonte mendimin e të shoqit.

— Mos ma merr për keq...

— Ti se ç'po kurdis, — tha ajo.

— Oh, jo... — foli ai me zë të mbytur. — Vetëm desha të të pyesja... Mos ma merr për keq, por as vetë s'e kuptoj sesi...

— Pse? — pyeti ajo e shqetësuar.

— Asgjë, asgjë... vetëm desha të të pyesja nëse

gjatë këtyre muajve mbase ke ndier ndonjë gjë, si të të them... kupton?

Burri i ktheu shpinën dhe kërkoi në hapësirë një objekt ku të përqëndronte vëmendjen. Në jetën e tij ai s'kishte bërë kurrë një pyetje më torturuese se kjo. Gruaja shtangu. Ajo nuk e kuptoi menjëherë pyetjen e të shoqit. Në përgjithësi ishte tepër naive për të kuptuar një domethënie të befasishme. Por papritmas ajo ndjeu një afsh të nxehtë. Intuita e femrës më në fund arriti të zbërthente rebusin e pyetjes dhe asaj i ranë rrobat nga duart. Burri përqëndroi të gjitha forcat për të përmbajtur një vërshim ndjenjash të amullta. Përplasja e mbytur e rrobave në dysheme, kërcitja e lehtë e divanit ku gruaja me sa dukej ishte ulur, shkaktuan tek ai pendimin e menjëhershëm për pyetjen që bëri.

— Jo, — tha gruaja.

Atë çast dikush trokiti në derë. Ai vrapoi, i lehtësuar që fatmirësisht u gjend një shkak për ndërprerjen e kësaj bisede. Liza, siç kishte mbetur ulur në divan, arriti të dëgjonte zërin e gëzuar të pianistes dhe të shoqin që po e falënderonte, apo diçka të tillë. Pas pak vajza iu afrua e, tek e pa të zbehur, që rrinte akoma ulur në divan, e pyeti:

— Mos jeni gjë sëmure?

— Jo, dua të të them se më dhemb pak koka. Nuk ndihem fort mirë.

— Oh, sa keq. E di? Jam fare vetëm në shtëpi. Prindërit kanë vajtur nga gjyshja. Doja të luaja diçka për ju, ta kalonim së bashku këtë mbrëmje.

Inxhinieri, pa u menduar gjatë, i tha së shoqes me zë lutës:

— Liza, vemi?

Ajo e ndjeu se i shoqi e bënte këtë që ta merrte me të mirë. Megjithatë pranoi. Vajza u ngjiti lart me vrap, e kur u futën në apartamentin e saj, atyre u ra menjëherë në sy një ambient i këndshëm, ku çdo gjë ishte e thjeshtë dhe e pastër. Vajza i priu në dhomën ku ndodhej pianoja e vogël që shkëlqente. Pastaj u zhduk në dhomën tjetër, prej nga erdhi me një tabaka në duar, ku kishte vendosur gota me konjak dhe ca pjata të vogla qelqi me reçel qershie.

— A do të provosh pak edhe një reçel molle që e kam bërë vetë? — i tha ajo Lizës.

— Jo, falemnderit, pak ujë po të doni.

Inxhinieri vështroi dhomën, një abazhur të bukur aty pranë, pastaj fushën bardhë e zi të tastierave, gjersa vajza, e cila s'dinte se si t'i kënaqte miqtë, u ul në fronin e rrumbullakët pranë pianos. Atëherë ai vuri re se ajo nuk ishte fort e bukur, por kishte një mënyrë të sjelluri që i jepte një hijeshi të veçantë. Mbi piano, në një kornizë në hollë dukej portreti i një djaloshi, që buzëqeshte.

— Vëllai? — pyeti padashur inxhinieri.

— Oh, jo, — u përgjigj vajza duke u skuqur lehtë, — është burri im.

— Burri?! — thirri me interes Liza, e cila pak nga pak po e kapërcente hutimin që e kishte pështuar. — Dhe ne s'e kemi parë asnjëherë këndeje.

— S'keni si ta shihni, ai vjen rrallë, sepse s'është në Tiranë.

— Ku është? — pyeti Liza.

— Në Fierzë.

— Aha, — tha inxhinieri. — Në Fierzë. Aty bëhet punë...

Atij i mbeti fjala në grykë. Ato nuk kuptuan asgjë dhe sigurisht nuk kishin nga ta dinin se burrin prej tri ditësh nuk e zinte gjumi as natën, vetëm kur kujtonte këtë emër. Fierza kërkonte prej tyre një detal automjeti mjaft të nevojshëm dhe ata po përpiqeshin ta prodhonin. Fillimisht duhej ta derdhnin këtë detal në fonderinë e uzinës.

— Epo, çfarë doni të luaj? — pyeti vajza duke kaluar dorën lehtë mbi tastierë.

Ai vuri gotën e konjakut mbi tabaka dhe i tha se do t'u pëlqente çdo gjë që mund të luante ajo. Më në fund vajza zuri të prekte tastierat, dhoma u mbush me tinguj, në fillim ca tinguj të ngadaltë, të butë, sikur vinin prej së langu, me një kumbim të thellë. Ai u mbështet pas shpinës së kolltukut. Për një çast vështroi Lizën, pastaj, ndërsa vajza vazhdoi të lëvizte me shpejtësi gishtërinjtë mbi tastierë, atij i mbetën sytë mbi portretin e vogël. Pak nga pak e mbërthyen tingujt e pianos, diçka hipnotizuese e gozhdoi pas kolltukut dhe e tronditi.

Vajza zuri të godiste me forcë tastierën e atij i dukej sikur ndodhej pranë një ujëvare që derdhej me vërtik që sipër një dige të lartë. Mijëra ylbere të vogla përziheshin me bardhësinë e shkumëzuar të ujëvarës. Dhe sa e bukur ishte e gjithë kjo! Papritur ai ndjeu diçka gërryese në kraharor, diçka që s'po e linte të qetë prej disa ditësh e po e mundonte. Mbase e tërë gjendja e tij shpirtërore në një farë mënyre lidhej me orët e fundit në fonderinë e uzinës, ku derdhën detalin e kërkuar për herë të parë. Furra vazhdimisht i kishte ngjallur një ndjenjë të çuditshme. Qindra orë e kishte përgjuar trupin e saj të zjarrtë, gojën



rrumbullake, që me një të goditur në çastin e duhur hapej dhe prej andej shkëputej një masë viskoze inkandeshente me nuanca jashtëzakonisht të holla. Këto nuanca për një sy të zakonshëm ishin të pakapshme, ndërsa për atë jo. Një mjeshër i vjetër, pikërisht ai që kishte derdhur dje detalin e provës, ia kishte mësuar dalngadalë gjuhën e tyre dhe inxhinieri tani, edhe pa ndihmën e aparaturave speciale, mund të përcaktonte me sy, me përpikmëri natyrën e masës viskoze, që derdhej e mund të përfytyronte plotësisht strukturën e çelikut.

Por dje ishte gabuar. Pikërisht kur nuk duhej të gabohesh, kur duhej më shumë se kurrë që prova me detalin e ri të projektuar në vend të dilte me sukses. Ndërsa ai gaboi dhe këtë e ndjeu edhe nga vështrimi i mjeshtrit, edhe në hutimin e punëtorëve, që me fytyra të habitura ndiqnin veprimet e urdhrat e tij. Masa e zjarhtë u derdh në formë por, kur e hoqën dhe e futën në provë, ajo nuk i plotësoi parametrat. Atëherë ai e ndjeu veten fajtor, ndonëse nuk ishte tërësisht faji i tij, sepse kjo gjë eksperimentohej për herë të parë dhe përbënte një proces tepër të ndërlikuar. Atëherë ai hoqi syzet e errëta, u ul pranë detalit, e mori në dorë si fëmijë dhe i erdhi të ngashërehej. Punëtorët, me fytyra të nxira e të djersitura nga vapa, i vajtën pranë. Mjeshtri i vuri dorën në sup dhe i tha:

— Mos u mërzit! Ne do të përpiqemi edhe një herë e me siguri do t'ia dalim në krye.

Ai u lehtësua, ndonëse e kuptoi që ajo mirësjellje ishte njëloj ngushëllimi për të, që nuk kishte bërë sa duhet. E ndjeu se pa ato prekje të lehta në

supe ai do ta kishte tepër të vështirë të përballonte vështrimin e tyre të çiltër, që e ftonte t'i qepej sërishmi gojës së zjarrtë të furrës, prej nga me siguri ata do të shqisnin ato që dëshironin. Këtë pa dyshim do ta bënë, sepse ky ishte shqetësimi i tyre më i madh...

Vajza, e cila ishte gjallëruar nga goditjet mbi piano, befasi ndaloi. Liza për disa çaste qëndroi e heshtur. Edhe atij nuk po i dilte asnjë fjalë. Pianistja vuri buzën në gaz nga hutimi i tyre dhe i pyeti:

— A ju pëlqeu?

— Oh, shumë, shumë, — tha Liza, — apo jo, Luli? Sa bukur që i bini! Dhe ç'gjëra të këndshme mendon njeriu kur dëgjon muzikë. E dini? Një herë dëgjova në radio një pjesë me violinë e, si t'ju them. Më pëlqeu aq shumë, sa s'kuptova ç'po ndodhte me mua....

Liza heshti. Asaj i erdhi turp që u shpreh në këtë mënyrë.

— Nuk ju shqetësojmë, — tha inxhinieri, — në qoftë se ndonjëherë vijmë te ju. Lizës i pëlqen aq tepër muzika.

— Me gjithë qejf, — tha vajza, — veçse unë s'do të jem edhe për shumë kohë këtu. Para një viti kam mbaruar Konservatorin, ndërsa ai ka dy vjet që punon në Fierzë. Ju e kuptoni vetë... Mbase mund të vendosemi hëpërhë në Tropojë... sepse edhe kaq gjatë larg njëri-tjetrit s'mund të rrimë.

— Sigurisht, — tha inxhinieri, — sigurisht.

Kur u kthyen në apartamentin e tyre, Liza ndodhej e përfshirë nga një frymëzim i përgjithshëm. Inxhinieri hapi televizorin për të parë laj-

met e mbrënjes, ndërsa ajo, e mrekulluar në mënyrë të papritur, thoshte:

— Sa mirë është kur bën diçka të vlefshme, apo jo, Luli? A nuk të kujton ajo grua e re rininë tonë? Ja, thuaj....

— Po ne s'jemi plakur, Liza, ne vetë jemi ende të rinj.

— Ah, po, po, vërtet. Dhe sa shumë mund të bëjë njeriu në jetë.



Disa ditë më vonë ai u kthye në shtëpi me dy ndjenja të trazuara. Në mëngjes, më në fund, ata kishin mundur të derdhnin detalin e kërkuar, i cili i kaloi me sukses të gjitha provat. Menjëherë njoftuan ministrinë. Pa kaluar as gjysmë ore në uzinë erdhi vetë ministri, që i përqafoi të gjithë ata që morën pjesë në projektimin dhe prodhimin e detalit. Po atë ditë ai pati një konsultë mjekësore të veçantë. E shoqja edhe një herë kishte bërë analizë. Ajo e kishte lutur të shkonte të bisedonte me mjekun. Konsulta nuk kishte zgjatur shumë. Me sa dukej nuk kishte ndonjë shpresë se mund të përmirësohej në të ardhmen, por mjeku i kishte thënë se këto raste nuk ishin kurdoherë të pashërueshme. Ai i kishte rekomanduar disa kura.

Kaloi i hutuar nëpër rrugët plot lëvizje. Ai vu-ri re se atë ditë kudo ndihej kundërmimi i luleve në ajër, gjë që lajmëronte ardhjen e pranverës, gjithashtu horizontin e përflakur që shndriste me një bukuri të jashtëzakonshme. Njerëzit për diku nxitonin me fytyra të qeshura, autobusët shkëmbë-

heshin me uturima e shoferët kujdeseshin me ankth të mos dëmtonin kalimtarët që mbushnin bulevardet. Ai do të dëshironte shumë të bridhte këtë mbrëmje të gëzuar me Lizën, prandaj u përpoq të flakte tej mendimet e mërzitshme, nxitoi hapat, ngjiti me të shpejtë shkallët e pallatit dhe trokiti në derë me nxitim, i vendosur njëherë e përgjithmonë se s'do të shqetësohej më për këtë çështje. E kuptonte se pa Lizën s'mund të jetonte, se e dashuronte më shumë se kurrë.

— Këta janë fqinjët tanë, — i tha Liza sapo hyri në dhomë.

Ai pa i habitur se në kolltuqet përballë televizorit qëndronin një burrë, një grua dhe një vajzë e vogël nja katër vjeçe.

— Gëzohem, — mërmëriti (para syve i dolën tri ngjyrat e ndryshme të derës përballë).

Burri, që menjëherë i kujtoi shprehjen «i fantaksur», u prezantua rishmë me një shtrëngim energjik të dorës. Nga tërë qenia e tij, nga trupi i bëshëm, fytyra e rrumbullakët me hundë të madhe, nga buzët e trasha buronte energji... I buzëqeshi me druajtje.

— Interessant, — tha tjetri. — Më duket se u bënë nja gjashtë muaj që erdhëm e banojmë përballë njëri-tjetrit dhe nuk njihemi. Të shkojmë njëherë te këta komshinjtë, i thashë gruas.

— Keni bërë shumë mirë, — tha Liza.

— Në vetmi nuk jetohet, — theksoi i porsaardhuri.

Gratë u ulën kokë më kokë, si mikësja të vjetra. Atij i takoi të bisedonte me burrin. Vetëm këtë natë mbase do ta kishte dashur më tepër se kurrë vetminë. Dhe kjo jo thjesht për faktin se ruante

një ndjenjë të largët antipatie për këtë njeri, që pa e njohur e kishte quajtur «i fantaksur». Të tjerët inxhinieri i falte shumë lehtë. Nga gjithë biseda mundi të kuptonte se vizitori punonte diku në një bazë grosiste, se kishte shanse për të dalë jashtë shtetit (një herë kishte qenë në Gjermani), se gruaja ishte infermiere në spital dhe vajzën e dërgonin në kopsht, por kjo punë i lodhte shumë, meqë akoma s'e kishin rregulluar në kopshtin pranë pallatit të tyre. Më në fund vajzën e vogël e zuri gjumi në kolltuk dhe ata u ngritën. Atij po i dhimbte koka.

— Njerëz të mirë, — tha Liza kur mbetën vetëm.

Ai vuri re se asaj po i dridheshin duart. Ajo e merrte me mend rezultatin e konsultës, prandaj i erdhi keq për të. Sigurisht, ai mund ta përkëdhelte pak, por diçka e rëndë iu mblodh në grykë.

— Liza, — mezi belbëzoi më në fund, — mos ndihesh e vetmuar?

Gruaja ngriti kokën.

— Luli, përse ma thua këtë?

— Nuk e di, — mërmëriti inxhinieri, — kam përshtypjen se ti ndihesh e vetmuar, pasi unë kujdesem shumë pak për ty, ngaqë jam vazhdimisht i zënë me punë...

— Jo, — tha gruaja, — unë tërë ditën jam midis fëmijëve e nuk e ndiej kurrë atë vetmi për të cilën bën fjalë ti. Veçse...

— Çfarë veçse...

— Nuk e kuptoj ç'po ndodh me ty. Shpeshherë të shikoj të mërziur e më duket sikur shkak i kësaj mërzie jam pikërisht unë. Jo, rri, mos më kundërshto... unë e di.

— Liza...

— Jo, mos u përpiq të më gënjesh.

— Po unë s'të gënjej, Liza. Ah, sikur ta kuptosh. E keqja është se unë të gjitha shqetësimet i mbaj vetë, edhe telashet e gëzimet e punës sime. Ja, për shembull, sot jam mjaft i gëzuar.

Ai i tregoi së shoqes për suksesin e punës së tyre. I tha se kishte një dëshirë të bridhnin nëpër ato vende ku kishin kaluar kushedi sa orë të këndshme, se ata duhej të mbeteshin gjithmonë të rinj, se jeta e tyre ishte e tillë, i kërkonte gjithmonë të rinj, me energji të pashtershme.

Pas dy ditësh Liza i tha se fqinjët përballë i kishin ftuar. Lizës i pëlqenin miqtë e rinj.

— Qenke familjarizuar, — i tha ai.

Këtë shprehje, që kushedi se si i erdhi ndër mend, atij u pëlqeu ta përsëriste edhe në dhomën e fqinjëve në këtë formë:

— Gruaja ime u familjarizuar shumë shpejt me ju.

Fqinji vuri buzën në gaz. E shoqja nxori mbi tryezë një takëm rakië prej kristali.

— Të pëlqejnë? — i tha fqinji. — I kam blerë kur isha në Gjermani para gjashtë vjetësh. Në Lajpcig...

— Taqi është i shkathët, — tha e shoqja. — Një javë qëndroi po solli gjithë ato plaçka.

Taqi qeshi me të madhe dhe atij iu duk se ishte nga ata tipa entuziastë që s'bëhen merak për asgjë. Kur hapte gojën i shkëlqente në cep të buzëve një dhëmb floriri. Ai vuri re gjithashtu se për çdo rast Taqi do të gjente një mënyrë për të futur turneun e tij të famshëm në Gjermani...

Që nga ajo mbrëmje fqinjët filluan t'i vizito-

nin gjithnjë e më shpesh. Liza u dha tepër pas tyre, ndërsa burri, jo pa habi, mundi të kuptonte se brenda pak javësh ajo fliste për ta me intimitetin që flitet zakonisht për njerëz të afërt. Inxhinieri mendoi se komshinjtë kishin shkaktuar një evolucion të vërtetë tek e shoqja. Ajo futej me vështirësi në shoqëri të reja dhe, pa dyshim, fqinjët duhej të kishin pasur diçka të veçantë përderisa kishin ndikuar deri në këtë masë. Arsyen ai e kuptoi fare rastësisht, ndonëse gjithçka që zhvilluar pak nga pak, pothuajse çdo ditë, para syve të tij...

Atë mbrëmje u kthye nga uzina shumë vonë. Kur hyri në shtëpi nuk gjeti njeri. Lart dëgjohehin tinguj pianoje në rrëmujë dhe ca goditje të herëpashershme mbi tavan. Më në fund ai vuri re mbi tryezë një copë pusullë, ku dalloi shkrimin e Lizës: **Jam lart, po të duash eja dhe ti. Nëse të ka marrë uria, në kuzhinë mbi sobë, të kam lënë gjellën.**

Atë çast dikush kërceu përsëri mbi dysheme, u ndien ca britma të gëzuara, pastaj pianoja. Ai qëndroi midis dhomës i pavendosur. Mëdyshjeve të tij u dha fund përplasja e një sendi me forcë në dysheme. Kur ai, si ngjiti shkallët me rrëmbim, u ndodh në dhomën e fqinjës, u befasua nga skena që pa: dhoma ishte bërë rrëmujë, një peshk prej xhami i rrëzuar përtokë që bërë copa-copa. Liza, e skuqur, me sytë që i shndrisnin nga një gaz i papërmbajtur, vështronte copat e xhamit, pianistja, gjithashtu e skuqur, duke buzëqeshur lehtë, si me druajtje, zuri të mblidhte copat, ndërsa pranë pianos, me flokë të shpupuritur e duke marrë frymë me zor qëndronte e trembur, gati për t'ia shkrepur të qarit, vajza e fqinjit.

— Na falni, — zuri të thoshte pianistja, — na falni. Ah, na gjetët në këtë rrëmujë. Dhe ta dini, të tërë fajin e ka kjo, ja kjo çamaroke që më rri si maçok i pabindur.

Vogëlushja, kur dëgjoji se po e krahasonin me një maçok të pabindur, nuk u përmbajt më. Ca ngaqë kishte kryer faj e ca ngaqë të gjithë po e vështronin, ia nisi të qarit me zë të lartë. Kjo shkaktoi një valë të qeshurash te të dyja gratë dhe inxhinieri, dashur pa dashur, vuri buzën në gaz. Liza u hodh nga kolltuku ku qe ulur, e rrëmbeu vajzën në krah, e mbuloi me të puthura mbi faqet e përlotura e, duke e kërcënuar me gisht pianisten, i tha:

— Ah, ti, teta Mira, sa e keqe që je. Na e bëre çupën të qajë. E ç'faj ka ajo nëse ky peshk buda-lla prej xhami nuk di të fluturojë? Pastaj, në qoftë se Brikena do të ishte maçok i pabindur, siç thua ti, moj teta, ajo do ta hante peshkun dhe nuk do ta hidhte në dysheme. Apo jo, moj xhan?

Vajza rrinte e tulatur, me kokën në kraharorin e Lizës, që i përkëdhelte kaçurrelat e seç i pëshpëriste me zë të butë. Inxhinieri, i hutuar nga kjo skenë, vuri re se sa të afërta ishin bërë ato me njëra-tjetrën. Ai i kreu në mënyrë krejt mekanike të gjitha veprimet e rastit, që bëhen gjatë një vizite, kur të qerasin me gotën e pijes, kafënë, kur pyesin e përgjigjesh për gjëra që detyrimisht bëhen objekt bisede. Të gjitha këto i kreu në mënyrë të pavetëdijshme, sepse mbresa që i la ai intimitet i guditshëm midis gruas së tij dhe vajzës së vogël qe aq e papritur, gati-gati si një zbulim i ri, që i ndriçoi një hapësirë të pamatë e të panjohur të jetës së tyre. Kjo mbresë nuk iu nda edhe



kur ata së bashku me vajzën e vogël u kthyen në apartamentin e tyre, kur ai pa folur ndiqte veprimet e Lizës që zuri të ushqente vajzën, t'i tregonte lloj-lloj përrallash, gjersa atë e zuri gjumi mbi divan, ku i hodhën një mbulesë. Vetëm atëherë Liza u kujtua për të shoqin e me një vështrim të përhumbur i tha:

— Luli, më fal që s'të pyeta si ia çove sot. Vajzën ma lanë ata para nja dy orësh. M'u lutën ta mbaja sepse kishin për të bërë një vizitë.

— Po mirë, moj Lizë, shumë mirë ke bërë që e mbajte, — tha ai.

— Oh, Luli! Sa fëmijë i urtë që është, sa fëmijë i mirë! Ne të dyja luajtëm aq shumë, sa vajza e shkretë u lodh dhe e zuri gjumi menjëherë.

Inxhinieri e kuptoi fare mirë gjendjen shpirtërore të së shoqes. Madje ai u tregua aq entuziast, saqë për një copë herë të dy vështruan fytyrën e ëmbël të vajzës që flinte duke buzëqeshur nëpër gjumë.

Prindërit e saj u kthyen shumë vonë. I pari u fut Taqi, i veshur me një kostum të ri që i rrinte mjaft mirë. Pas tij hyri e shoqja, me një parfum të këndshëm që mbushi tërë apartamentin.

— U vonuam ca, — tha Taqi, — por besoj se do të na falni. E vërteta është se sonte jam tepër i gëzuar, dhe, po të doni, vemi nga ne të pimë një gotë.

— Faleminderit, — tha inxhinieri, — por...

— Mos do të thoni se është vonë?

— Pikërisht!

— Dëgjo, i dashur inxhinier. Mua më pëlqejnë shumë orët e vona, e sidomos ato që quhen orë të vogla. Është koha kur njëriu mund të gëzojë

në maksimum ato kënaqësi modeste që i fal jeta...

Ai binte erë alkool dhe inxhinieri e kuptoi se tjetri ndodhej në valët e ngazëllimit alkoolik. Sytë e skuqur i qenë picëruar e i shkëlqenin me një dritë të veçantë ku ai mundi të dallonte diçka jo të mirë.

— Duhet shijuar jeta, vëlla! Kam dëgjuar se ti punon shumë, si të thuash, shuhesh në punë. Mirë e ke. Por...

Ai e la mendimin përgjysmë, diçka iu kujtua dhe zuri të qeshte. Pastaj, duke u hedhur në mënyrë të papritur në një temë tjetër, tha:

— Të jap fjalën se do të të sjell nga Izmiri një shishe me shampanjë të klasit të parë.

E shoqja, që gjer në atë çast po rrinte me Lizën pranë vajzës që flinte, ndërhyri e shqetësuar:

— Taqi, ç'janë këto që thua?

— Pse, — tha Taqi, — s'po them ndonjë gjë të keqe.

Liza kafshoi cepin e buzëve. Ajo e dinte se, në kishte biseda që e mërzitnin për vdekje të shoqin, ishin pikërisht këto që po hapte fqinji. Po inxhinieri dëgjonte i qetë. Dhe kjo qetësi po e turbullonte Lizën. Kësaj shtate i dha fund ndërhyrja e infermieres, gruas së Taqit, e cila, kur dëgjoi se i shoqi po fliste një çikë si tepër e para kohe për udhëtimin e tij të ardhshëm, u ngrit, mori vajzën në krahë e pas një këmbënguljeje energjike e tërhoqi Taqin pas vetes. Tek i përcillte, Liza nuk harroi ta porosiste:

— Dëgjo, sa herë të keni nevojë, vajzën mund ta bini këtu pa druajtje... e kam sinqerisht...

Ndërsa inxhinieri, duke dëgjuar kërcëllimën e

thatë të bravës që u mbyll, ishte krejt i qartë dhe i bindur si për sinqeritetin e së shoqes, ashtu edhe për faktin se ai do ta kishte tepër të vështirë të miqësohej me Taqin... Por ai i vuri për detyrë vetes të bëhej i durueshëm. Fundja, në një farë mënyre, njeriu edhe mund të gjejë ndonjë arsye, ndonjë argument për të justifikuar dobësitë e tjetrit. Ai u përpoq ta bënte këtë me gjithë shpirt. Por ndodhte gjithnjë e më shpesh që infermierja ulej kokë më kokë me Lizën, vajza hutohej pas televizorit, ndërsa Taqi shtrihej mbi divan si në shtëpinë e tij. Burri, me një ndjenjë apatie, vështronte ata njerëz që hynë në mënyrë të çuditshme në jetën e tyre dhe filloi të ndiente bezdi. E mërziste infermierja, që nuk linte rast pa vënë në dukje shkathtësinë e të shoqit, Taqi, që shpreonte të dilte së shpejti jashtë shtetit. Ai përpiquej ta zotëronte veten. Por gjithsesi nuk mund të duronte një farë mendjemadhësie të fqinjtit. Ndonjëherë, për orë të tëra, ishte i detyruar të dëgjonte prej tij gjithfarë marrëzish. Për shembull, një mbrëmje Taqi u mundua t'i mbushte mendjen se e kishte të domosdoshme të ndërronte shtëpinë. Ai u ankua se vajza i vuante nga astma. Dhomat nga perëndimi nuk i kapte kurrë dielli, ajri i ndenjtur ishte armiku numër një i saj. Vajza e tij vuante, këtë e dëshmonte me raportin e një komisioni mjekësh. Prandaj i duheshin patjetër dy dhoma me ajër të bollshëm (tani ai kishte vetëm një dhomë) që të shihnin nga lindja.

Inxhinieri e dëgjonte në heshtje. Ai vetëm për mirësjellje tundte kokën herë pas here. Ishte i pafuqishëm për t'i bërë ballë lumit energjik të fjalëve të fqinjtit. Reagimi i tij ishte krejt i ndry-

shëm. Në fillim provoi një ndjenjë mërie për të. Gjithë ato marrëzira, që fqinji ia ligjëronte me dëshirë të veçantë, i shkaktonte një gjendje hutimi. Burri habitej si ishte e mundur që ky njeri të fliste aq i qetë për gjëra të cilat e turbullonin vetëm kur i mendonte. Ai as që kishte nevojë të dëgjonte biseda të tilla dhe nuk i kishte rastisur të haste tipa të tillë llafazanë e mendjemëdhenj. Ai jetonte midis njerëzish punëtorë, që përpiqeshin e djersitnin, që krijonin diçka të mirë, midis njerëzish të drejtë, të ndershëm e fjalëpakë. Prandaj pallavrat nuk i pëlqenin. Për këtë arsye pak nga pak burri filloi ta shihte komshium me një sy tjetër. Ai filloi ta urrente. Nuk e duronte dot. Përpiquej ta mbledhte veten sidomos për hir të së shoqes, por shpesh zëri, mimi, qëndrimi e tradhtonin. E inatosnin mburrjet e tij, miqësitë, e inatosnin dhe imtësitë më të vogla të atij njeriu, frymëmarrja e rëndë, buzët e trasha, bile edhe kravata që lidhte në qafë...

Një pasdite ai po lexonte diçka për shkrimin e çelikut. Fqinja një kat më sipër luante «Sonatën e hënës». Liza gatuante për të mesërmën. Ai u mundua të kuptonte domethënien e asaj që lexonte, por që e pamundur. Tingujt e pianos e shqetësonin. Ai dëshironte t'i dëgjonte nga afër ata tinguj, të zhytej në kuptimin e asaj melodie të bukur që e tërhiqte, e ngrinte peshë, por që e mbushte edhe me një lloj mallëngjimi që e bënte të vuante.

U ngrit me duar në xhepa dhe nisi çapejakët nëpër dhomë.

Mbi qytet po binte muzgu. Nga dritarja ai kishte mundësi të shikonte një pjesë të madhe të qytetit. Befas u hapën njëra pas tjetrës mijëra drita

si sytë e një qenieje që rrinte e përgjonte e tular në errësirë. Ky imazh u përzie me përshkënditjet e rrëkerave të çelikut, atje thellë në fonderinë plot zhurmë, ku tani lëvrinin punëtorët me shufrat e gjata si heshta nëpër duar. Tek matej t'i propozonte Lizës të shkonin te fqinja lart, burri dëgjoi atë që hapi derën, e pastaj zërin antipatik të Taqit. Ai hyri me energjinë karakteristike, duke sjellë me vete një rrymë të ftohtë ajri.

— Ma punuan, — thirri ai pa thënë as «mirëmbrema».

Inxhinieri u habit dhe mendoi se nuk kishte asnjë lidhje midis tij dhe asaj çështjeje për të cilën Taqi ankohej se ia kishin punuar.

— Ke parë ti? — tha Taqi duke shtrënguar midis duarve tavllën e duhanit, — të ta hedhin me kaq marifet, nuk është parë.

Ai qeshi me të madhe. Në cep të buzëve u shqua dhëmbi prej ari që vezulloi. Inxhinieri u topit. E gjithë kjo nuk kishte asnjë kuptim. Ç'kërkonte prej tij?

— Mirë ma bënë, — vazhdoi Taqi pa u bërë merak për bashkëfolësin. — Për qime më iku udhëtimi në Izmir. Ta marrë djalli!

Ai u gajas përsëri. Pianistja në katin sipër vazhdonte me «Sonatën e hënës».

Burri e vështroi i hutuar. Pas këtij shpërthimi Taqi kërkoi një gotë me rakë. Ai e ktheu me një frymë. Qeshi përsëri në atë mënyrën idiote dhe burrit i erdhi t'ia shkulte atë dhëmbin prej floriri.

— Mirë ma bënë, qindin t'i punojnë kësaj koke, se më thoshte njëri: «Taqi, dua një komplet akriliku të bardhë për motrën». Peqe Taqi. Pa le

kur më vinte herë pas here «Taqi, nëm nja pesë mijë lekë borxh». Taqi drëng! Ah kokë, o kokë. Le ta provojë edhe një herë.

Ai rrahu bërrylin me paturpësi. Për inxhinierin ky qe kulmi. Ç'ishte ky njeri, që në mënyrë aq brutale vinte e futej në shtëpinë e tij? Ç'i hymin në punë atij gjithë këto dëngla?

— Më fal, — i tha i mërzhitur, — nuk ju kuptoj.

— Çfarë, — thirri Taqi, — nuk kupton? E ç'ka këtu për të kuptuar? Më iku Izmiri nga dora.

— Mua nuk më intereson asgjë nga këto bu-dallallëqe, — foli burri me inat, — as Izmiri as Honoluluja. E më vjen keq se si ju më flisni me këtë gjuhë për kolegët tuaj.

Taqi ngrysi vetullat. Ai vështroi me radhë burrin dhe Lizën, që kishte mbetur e shtangur.

— Ç'domethënë s'të intereson, — tha ai i pikëlluar. — A nuk e kupton se ç'do të thotë kjo? A nuk e kupton se mosvajtja ime këtë radhë do të thotë t'i them lamtumirë gjithë karrierës sime të ardhshme?

Burri ngriti dorën padashur. Para syve i dolën goja e zjarrtë e furrës së shkrirjes, rrëkeja inkan-deshente që lëshonte xixa, fytyrat e djersitura të punëtorëve dhe sytë e thellë të mjeshtrit. Në një çast dëshpërimi ai thirri «jashtë» me zë të lartë dhe u zhduk në dhomën tjetër. Taqi ngriti supet përpjetë, i buzëqeshi Lizës si i zënë në faj dhe u largua. Pas pak inxhinieri doli nga dhoma dhe vuri re se Liza ishte ulur mbi divan. Ai vajti pranë saj. I lëmoi flokët. I kalloi dorën mbi fytyrë dhe ndjeu t'i lagej.

— Mos u mërzhit, — i tha me butësi.

Gruaja dëneste në heshtje.

— Mos u mërzit, nuk munda ta duroj, a dëgjon? Ky dallkuk më prish nervat. Hajde shkojmë lart. Me siguri do të qetësohesh.

— Jo, unë s'kam përse të mërzitem, — tha Liza, — ti kishe të drejtë.

Të nesërmen ai e përcolli gruan përsëri gjer te stacioni i autobusit, derisa ajo u largua, duke ia bërë me dorë pas xhamit të trashë.

## FËSHFËRIMA E ERES

### 1.

Ai nuk mund të përcaktonte me siguri kohën kur, që poshtë skelave, gjer lart në muret e pasuvatuara të korpusit të koksit, nisi të ngjitej në mënyrë të rregullt, të përditshme, pikërisht në orën njëmbëdhjetë e gjysmë, një vërshëllimë e zgjatur, që i ngjante cicërimës së zogjve. Në këtë mes diçka luante. Ndryshe, si shpjegohej që ajo «kanarinë» vinte e këndonte vetëm në rrëzë të mureve të koksit?

Dyshimet e tij u vërtetuan. Një ditë, pas vërshëllimës ai ndjeu ca hapa të lehtë nëpër shkallë. Ndërsa mendoi se sa bukur ia kishin hedhur për kaq kohë, zgjati kokën mbi mur. Poshtë, në këmbët e skelës, priste dikush. Pas pak u duk koka e mbështjellë me shami e një vajze. Ajo e hoqi shaminë dhe ai vuri re flokët e verdhë të Lirikës që, nga lë-



vizja e shpejtë apo nga era, u valëvitën e i mbuluan fytyrën.

Ishte ora kur punëtorët linin punën. Ai bëri një llogari të tillë: ky birbo me siguri ka ndonjë gjysmë ore që është përgatitur të vijë këtu, ndërsa asaj që një orë më parë ka nisur t'i rrahë zemra dhe as që e ka pasur mendjen të punonte.

Rrasi kapelën dhe më, e, derisa ata të dy humbën në rrugën me pluhur në drejtim të mensës, ai qëndroi mbi mur i pushtuar nga një trishtim i lehtë. Në këtë ndjenjë mbase ndikoi edhe bardhësia e zbehtë e dëborës në majat e maleve, që prej një muaji po i rezistonte diellit të ngrohtë të marsit.

Si rregull tani duhej të zbriste poshtë. Në katin e parë, mbi mur, rrinte varur një rrjetë ku e shoqja i mbështillte drekën. Në moshën pesëdhjetekatërvjeçare, me trup ende të fortë e të drejtë, ai hante me oreks të plotë. Vitet e shkuara poshtë e përpjetë nëpër kantiere i kishin lënë vetëm disa thinja përmbi ballë.

Në të ritë e tij njerëzit i druheshin, sepse me shtat të madh, siç qe, me zërin e trashë dhe hijen e rëndë, të gjithëve u jepte përshtypjen e një njeriu të sertë. Por me kohë thinjat, që nisën të mbinin midis tufës së flokëve, e zbutën në mënyrë të ndjeshme këtë pamje. Ai nuk i trembte më të tjerët, aq më tepër Lirikën nëntëmbëdhjetëvjeçare, vajzën e një mikut të tij të vjetër nga fshatrat e Sarandës, me të cilin kishin punuar bashkë në hidrocentralin «Karl Marks». Ajo kishte ardhur në brigadën e tij para një viti me një copë letër nga i ati. Pasi i bënte shumë të fala, Jani i lutej t'ia merrte të bijën në brigadë e të kujdesej për të.

Ai vuri duart në ije. Një copë herë vështroi rrjetën e varur mbi mur. Po..., të kujdesej për të. I zënë ngushtë, në mënyrë të pavetëdijshme fërkoji kokën dhe këmbët e çuan në hyrje të mensës. Sigurisht që ai ishte kujdesur për të dhe do të kujdesej përsëri...

— Një kafe, ju lutem!

Ekspresit shfryu shtëllunga avulli. Me filxhanin në dorë i hodhi një sy sallës dhe pa asnjë druajtje, si u sorrollat nëpër tryeza, u ul përballë tyre.

Lirikës i mbeti luga në dorë. Ajo e dinte se usta Mihali vinte këtu më të rrallë, sa për ndonjë kafe. Ajo e dinte se usta Mihalit drekën ia përgatiste e shoqja e ia mbështillte me gazetë dhe se ai kurrë s'vinte këtu në këtë orë, por mbështetej në mur e mbllaçitej qetë-qetë. Kjo mjaftoi që ajo të bindej se ustai pa dyshim diçka kishte filluar të nuhaste. Ajo e donte shumë usta Mihalin. Do të ishte e pahijshme, pothuajse e pamundur t'ia kundërshtonte mendimet. E, po që se atij tashmë do t'i kishte lindur ndonjë mendim, ajo s'do të dinte si të bënte.

Pa u vënë re, Lirika i shkeli këmbën shokut pranë.

— Ç'pate, — pyeti ai pa e ngritur kokën nga pjata.

— Hiç... — tha ajo, — asgjë.

Tjetri vazhdoi të përtypej.

— Asim!

— Hë!

— Shiko përpara!

— Ç'ke kështu, — tha ai i habitur.

— Edhe ti, si bëhesh fare! Unë them shiko përpara, por me kujdes, — foli ajo me zë të ulët.

Asimi, një djalë me shtat mesatar, rreth të njëzetekatrave, ngriti pak kokën, por, si nuk zbuloi ndonjë gjë të veçantë përveç usta Mihalit që rru-fiste kafën në qejf të vet, ngriti supet.

— E çë? — tha ai.

— Ustai po na sheh.

— Le të shohë, pse, ç'po bëjmë ne?

— Jo, por...

Ajo ishte zbehur dhe ky fakt s'mund t'i shpë-tonte vëzhgimit të hollë të ustait. As biseda e tyre me zë të ulët, as ai shqetësim i turbullt që u end në tryezën përballë. Mihali e ndoqi të tërë skenën me pamjen e njeriut të shkujdesur. Megjithatë ai formoi bindjen se ky birbo, që dinte të vërshëllente si kanarinë, nuk ishte nga ata tipa që stepen...

«Bukur... bukur...», këto ishin të vetmet fjalë që Lirika dëgjoi atë pasdite nga goja e us-tait. Ai ia thoshte kur i sillte kovën me ujë, kur i afronte ndonjë tullë apo tezgën e llaçit. Dhe, meqë ustai s'e kishte pasur për zakon të mërmë-riste nëpër dhëmbë fjalë të tilla për një punë kaq të rëndomtë, ajo erdhi në përfundimin se xha Mi-hali në një farë mënyre po e qortonte. Veç kësaj, përse vendosi aq papritur ta mbante pranë si ndih-mëse?

E njëjta gjë u përsërit edhe të nesërmen. Kjo e pezmatoi së tepërmi. E hutuar ajo ndiqte lëvizjet e tij, mënyrën se si i lidhte tullat me njëra-tjetrën dhe atëherë heshtja e rëndë e vriste aq shumë, sa i mblidhej diçka në grykë.

— Xha Mihal!

— Hë, moj nuse!

— Xha Mihal!

— Urdhëro!

Ajo kafshoi çipin e buzëve.

— Unë...

— Ëh?

— U mërzita së ndenjuni, — belbëzoi Lirika e penduar që e hapi gojën.

Mihali mbajti seriozitet të plotë.

— E di çfarë? — tha ai. — Yt atë më është lutur të kujdesem për ty. Hëm... dua të them se ti do të bëhesh një muratore si unë. Kupton?

— Kuptoj.

— E pra, zanati ka shumë prandaj mos u mër-zit.

— Jo!

— Ashtu. Më sill tani një kovë me ujë.

Andej nga dreka, sidoqë Lirika u përpoq të gjente ndonjë mënyrë për t'u ndodhur larg ustait, nuk ia arriti qëllimit. Ndërsa ai vendoste tullat njërën pas tjetrës, ajo vështronte rrugën me plu-hur, majat e oxhaqeve, pastaj korpuset e çelikut, rrjedhën e lumit, gurët e bardhë të zallit gjer tutje pranë pyllit të vogël me shelgje, ku nisnin kodrat, malet, dëborat me shkëlqimin e zbehtë dhe qielli. Fshati i saj ngrihej mbi një kodër ullinjsh përballë detit, që ishte po aq i kthjellët sa ky marsi...

— Nuk do të çlodhesh pak? — pyeti ajo.

— Ja, sa të mbaroj këtë radhë.

Si dështoi edhe kjo orvatje e fundit, u dë-gjua vërshëllima e zakonshme. Mihali hodhi mistri-në mënjanë dhe filloi të dridhte një cigare. Diku, atje poshtë skelave, ai tjetri vërshëllente me shpre-së se do ta dëgjonin. Pastaj u bë heshtje. Us-tai kafshoi letrën dhe pështyu coprat e vogla që i mbetën në gojë. Fishkëllima u dëgjua përsëri,

por më e çrregullt, si të shprehte habi. Lirika dëshoi ta zgjaste kokën përtej murit, por një tundim i fortë e shtangu. Distanca gjer te muri iu duk si një humnerë dhe ajo mendoi se vërtet ishte diçka qesharake. Ajo mund ta prekte murin vetëm po të zgjaste dorën.

— Oh, nëne, — mërmëriti me zë të mekur dhe ustai ngriti kokën e vuri re tisin e purpurt që i kishte mbuluar mollëzat e faqeve.

— S'dashke të hash sot? — tha ai.

— Jo... domethënë po... Kam marrë diçka me vete.

Ai rrsi kapelën sipër syve, ndërsa ajo mbeti ende një copë herë në këmbë, fare pranë murit, përtej të cilit shtrihej një hapësirë e tejdukshme, e mbushur me ajrin e ngrohtë që lajmëronte pranverën.

## 2.

Prilli erdhi i vrenjtur. Mbi luginën e shtrënguar midis maleve grumbulloheshin re të zeza sterrë, që lëshonin me inat, si të merrnin hak për muajin e kaluar, shira të rrëmbyera, vetëtima që çanin hapësirën e kërkonin të shtypnin tërë atë masë kolosale metali e betoni anës lumit. Sapo mbaronin vetëtimat dhe era gëlltitej nga grykat, shiu vazhdonte të binte i qetë, i pandërprerë, pikëmadh. Lumi kapërceu shtratin. Pluhuri i rrugëve u kthye në baltë dhe kanalet u mbushën plot.

Me duar të futura në xhepat e mushamasë Mihali vështronte në mugëtirë. Përpiqej të merrte me mend se ku mund të ndodhej ai objekt me emrin

e çuditshëm «keson». Në përgjithësi ai nuk e kishte më qejf këtë punë, për më tepër kur i thanë se e çonin atje të vinte dorë. Pra e çonin, si të thuash, në rolin e shpëtimtarit, gjë që nuk i pëlqeu, sidomos kur mori vesh se brigadieri që do të zëvendësonte ishte një i njohur i tij. Por, meqë do të shkonte vetëm përkohësisht, ai nuk e bëri të gjatë. Si i la brigadës porositë e fundit, u largua.

Atë ditë binte një shi i imtë. Çizmet i ishin bërë tërë baltë e nga një vrimë mbi kapuçin e mushamasë uji i hynte në qafë. Mihali i erdhi rrotull kesonit dhe i vuri veshin rrymës së ujërave nëntokësore. Nga brenda vinte një jehonë e mbytur, të cilën ai e dallonte qartë, me gjithë zhurmën që bënte njëra nga pompat. Tjetra, me sa dukej, ishte prishur.

— Më thërrisni pak pompistin e turnit, — i tha një punëtori. Ai do t'ia mblidhte rripat keq këtëj njeriu. Çdo gjë mund të lejohej, por që të heshtnin pompat, kjo i kalonte të gjithë kufijtë.

Pompisti erdhi. Mihalit nuk iu desh ta vriste mendjen shumë për t'u kujtuar se ku e kishte parë atë fytyrë. Djaloshi ishte llangosur i tëri në vaj. I bërë qull nga shiu, djali qëndronte përpara tij dhe fërkonte duart me një copë ledekë.

— Sigurisht, — tha Mihali, — sigurisht...

Tjetri nuk e kuptoi nëse këto fjalë i drejtoheshin atij, apo kishin të bënin me diçka jashtë tyre, me diçka që bluante vetëm mendja e ustait. Sidoqoftë, ai s'e prishi terezinë. Përderisa s'po e begenisnin, edhe ai s'kishte përse ta hapte gojën.

— Sigurisht, do të më thuash se motori ka defekt.

— Tamam, — iu përgjigj djaloshi, — i ke rënë në të.

Fryu një erë e ftohtë që rrëmbeu pikat e shiut e ua përplasi në fytyrë.

— Patjetër. Po dëgjo këtu, djalë i mbarë! Në qoftë se për një orë pompa s'futet në punë, mos më dil përpara syve.

— Aha, aty s'më ke, — tha tjetri, — s'është puna ime kjo. Po s'erdhi mekaniku i ndërmarrjes, as nesër s'bëhet për të genë.

Secili e kuptonte se këtu kishte të bënte një shkak i ndryshëm, që s'kishte fort lidhje as me defektin e pompës, që natyrisht mund të kishte ndodhur për shumë arsye, as me mekanikun e ndërmarrjes, që mund të sillej fare lehtë. Kështu që pompa u ndreq dhe filloi të nxirrte me gurgullimë ujërat nëntokësore. Pastaj minatorët futnin minat, bënë plasjet dhe puna niste nga e para. Dalngadalë ai trup i stërmadh betonarmeje me peshën e tij shtypte tokën, i bënte vend vetes, gjersa të zhytej i tëri e të bëhej rrafsh me dheun.

Dy javë më vonë çdo gjë ishte vënë në vijë, po shirat s'kishin të pushuar. Nga mesi i prillit u ngrit një erë e marrë që ulërinte në të tërë luginën. Lumi u fry edhe më tepër, kanalet shpërthyen. Ujërat futeshin në tokë nga një mijë degëzime dhe formonin rrjedhje të forta. Megjithëse kishin më se dy javë që punonin së bashku, as Mihali, as djaloshi nuk dukej t'i jepnin njëri-tjetrit shenjë më të vogël të dobësisë. Ky fakt Mihalit shumë-shumë mund t'i shkaktonte vetëm një shqetësim të lehtë, sepse ai dëshironte të shkonte mirë me njerëzit. Ndërsa me djaloshin ndodhte e kundërta.

Ai e ndiente veten të fyer padrejtësisht, ndiente se i kishin marrë dinjitetin nëpër këmbë...

Një natë vazhdonte të binte shi me bubullima. Nga gjysmerrësira e kesonit dolën minatorët. Mihali i hodhi një vështrim orës. Ishte një e gjysmë pas mesit të natës dhe bënte ftohtë. Gjithçka kullonte ujë. Të mbuluar këmbë e kokë me mushamatë e rënda, njerëzit u shpërndanë nëpër errësirë. Nën dritat e projektorëve dukej vetëm rrjedhja pa mbarim e shiut. Dhjetë minuta më vonë u dëgjua një shpërthim i fortë. Pastaj çdo gjë u krodh në heshtje, gjersa u ndien pllaqurimat e cizmeve në pellgjet me ujë.

— Ndizni pompat, — thirri dikush.

Dalngadalë të gjithë u grumbulluan në grykën e kesonit. Njëra nga pompat filloi të gumëzhinte. Atëherë Mihali vuri re në fund vorbullën e turbullt, të ujërave që gurgullonin. Dukej sikur nën tokë ishte çarë një damar. Befas vorbulla u bë më e madhe, stërkalat kërcyen përpjetë, në faqet e trasha prej betoni u përplasën copëra gurësh e dërrasash. Niveli nisi të rritej me shpejtësi të tmerrshme.

— Oh, — thirri Mihali, — ndizni tjetrën!

Britana jehoi në hinkën e thellë, rrëshqiti anës mureve dhe humbi poshtë e përpirë nga ujërat. Në çastin e fundit, nën dritën e dobët të llambës, ai pa fytyrën e zbehtë të Asimit që ngjiti shkallët. Ai fshiu flokët e bërë qull dhe përplasi me forcë copërat e leckave me vaj.

— Është prishur, — mermëriti Asimi, — është dëmtuar nga minat.

Mihali deshi të ulërinte, por zëri i mbeti në



grykë. I hutuar, ia qepi sytë vorbullës, që u qetësua e u kthye në një masë të madhe të lëngshme. Masa ngrihej, për lau skelën prej druri e pas pak iu afrua motorit të pompës. Disa minuta më vonë edhe motori u zhduk.

— Ç'na bëre, bre djalë, ç'na bëre, — psherëtiu Mihali.

Tjetri merrte frymë me vështirësi, duke nxjerrë nga goja shtëllunga të bardha. Shiu i binte në trup, i kullonte në ballë, në hundë, poshtë gushës, mbi vetulla, por ai s'bëntë as përpjekjen më të vogël për t'iu shmangur.

— Ç'na bëre, bre djalë, ç'na bëre!

Djaloshi e vështroi me sytë e lagur, por nuk tha asnjë fjalë. U përpoq të mbante veten dhe mezi arriti të fshihte një pikëllim të thellë.

— Eh, — foli ai me gjysmë zëri, pa e kuptuar as vetë se ç'donte të shprehte me këtë «eh», që i rrëshqiti dhe ra poshtë në humbëtirë së bashku me piklat e ftohta të shiut. Pastaj u var te shkallët. Zbriti ngadalë gjer në fund e ndaloi sipër një skele, gjysmë metri mbi sipërfaqen e ujit.

— Ç'kërkon të bësh? — u dëgjua zëri i Mihalit diku lart.

Por djaloshi bëri sikur nuk e dëgjoi as atë zë, as të thirrurat e shokëve të tjerë. Ai nuk vuri re gjithashtu se si njëri u tregua më i zgjuar dhe solli në grykë të kesonit një projektor të fuqishëm. Atëherë të gjithë panë se si ai flaku tutje mushamanë e zezë, hoqi një nga një xhakëtën, trikon, bluzën e më në fund pantallonat. Duke u dridhur kërcëu në ujin e ftohtë. «Ç'na bëre, bre djalë...». Trupi iu mësua me të ftohtët dhe ai u përpoq të gjente motorin. Ata lart ndenjën një minutë me

zemër të ngrirë. Djaloshi u ngrit sipër ujit, mori frymë thellë e u zhyt përsëri. Kjo vazhdoi rreth gjysmë ore. Herën e fundit ai qëndroi në ujë gjatë, aq gjatë, sa njëri klithi e deshi të hidhej brenda. Pastaj diçka rënkoj dhe u ndie zhurma e mbytur e motorit që u ndez. Mbi ujë doli koka e Asimit, duart, i tërë trupi i zhveshur. Mihali zbriti poshtë pa parë se ku i vinte këmbët. I dha dorën djaloshtit dhe e ndihmoi të ngjitej mbi skelë. Djali dridhej i tëri. Buzët i ishin nxirë. Mihali shkopsiti mushamanë, xhupin e trashë dhe e tërhoqi pranë vetes. Një copë herë e shtrëngoi fort pas trupit të tij. Djaloshi nuk kundërshtoi, por qëndroi me këmbët e zhveshura pranë trupit të ngrohtë të ustait. Mihali hoqi xhupin dhe ia hodhi përsipër bashkë me mushamanë.

### 3.

...Shiu nuk reshti për tri javë me radhë. Javën e katërt u dha. Në fillim në qiell u formua një oaz i kaltër. Frynë ca puhiza të ngrohta dhe, pa u kuptuar, retë u fshehën pas maleve. Uturima e lumit ia la vendin një gurgullime të kënshme dhe fëshfërimës së shelgjeve.

— Usta, besoj se ai kesoni të lodhi shumë, — tha Lirika.

Mihali punon pa e ngritur kokën. Ai vendos njërën pas tjetrës tullat. Zanati i tij i pëlqen më tepër se çdo gjë tjetër në botë.

Lirika është mësuar me heshtjen e ustait. Fytyra ka nisur t'i piqet nga dielli dhe ajo e ndien pranverën në çdo qelizë të trupit. Po të ishte në

fshat, tani mund të bridhte në hijet e ullinje, të mblidhte lule e të vështronte detin nga tarracat. Por ajo e di se duhet ta ketë mendjen të duart dhe urdhrat e ustait. Ai punon shumë shpejt dhe i ka zët njerëzit e hutuar.

Afër drekës ajo vë re se duart e mëdha të ustait e humbin ritmin e tyre. Kjo do të thotë se ai ka dëshirë të dredhë një cigare. Ul kasketën sipër syve e kafshon letrën. Atëherë poshtë dëgjohet një vërshëllimë që i ngjan cicërimës së zogjve. Lirika skuqet, i vjen turp. Ustai pështyn mënjanë dhe thotë:

— Më duket se të thërresin ty.

Vajza nuk u beson veshëve. Ajo skuqet edhe më tepër. Është ustai ai që i shqipton këto fjalë, apo fëshfërima e butë e erës?

## NËNË HASIMEJA

(Tregim i jetuar)

Në mbrëmje grupi i xhirimit ndahej në dy pjesë: operatori, elektrikistët, grimierët dhe shumica e aktorëve ktheheshin me autobus në qendrën e lokalitetit, ndonja gjysmë ore larg, regjisori dhe disa të tjerë flinin në fshat.

Në fillim kjo ndarje nuk u pëlqeu banorëve të atij fshati të vogël malor. Duhet thënë se ditën që mbërritën kineastët dhe i shpjeguan kryetarit të këshillit qëllimin e punës së tyre, vendasit nuk treguan ndonjë shenjë habie, megjithëse kjo ishte diçka jo e zakonshme në jetën e tyre. Kur morën vesh se atje do të xhirohej një film për luftën, në përgjithësi ata menduan se nuk u ishte bërë ndonjë privilegj, pasi gjatë kohës së luftës jo vetëm që kishin nxjerrë partizanë, po ishin therur e djegur më tepër se çdo fshat tjetër i krahinës. Të paktën ata kështu mendonin. Edhe

sot e kësaj dite fëmijët gjenin nëpër bokërima copëra bombash<sup>o</sup> e kapsolla fishekësh, ndërsa në një brinjë kishin mbetur vetëm gërmadhat e një lagjeje të tërë të rrafshuar njësh me tokën. Përballë saj ngrihej lagjja e re, e mbase ky ishte detaji më i bukur që i pëlqeu regjisorit, të cilit aty për aty i lindi ideja për të xhiruar më vonë një film dokumentar. Por lagjja e djegur, e mbetur në një anë si dëshmi e kohës, i shërbente atij më shumë se çdo gjë tjetër si një dekor natyral, i gatshëm, që me pak punë mund të kthehej në një sfond të mrekullueshëm për disa episode të filmit. Sigurisht, banorët e fshatit nuk e kuptuan menjëherë interesimin e veçantë të regjisorit për ato gërmadha të harruara dhe u mbeti hatri që ai vendosi ta dërgonte pjesën më të madhe të grupit në qendër të lokalitetit. Kjo u tingëlloi si një lloj fyerjeje për sedrën e tyre.

Sidoqoftë, shumë shpejt filmi zuri një vend kryesor në bisedat e mbrëmjes. Ata që mërreshin si figurantë u tregonin të tjerëve hollësi dhe kjo u bë shkak që njerëzit, pas kaq kohësh, të rremonin kujtesën e të zhytëshin në historira të kaluara. E vërteta është se ai fshat i vogël, i fshehur pas dy grykash të thella, kishte një histori tragjike, mjaft të njohur. Dhe regjisori këtë e dinte. I mbështetur në parvazin e dritarës, në shtëpinë e një brigadieri të kooperativës, që u kishte li-ruar dhomën e miqve, ai vështronte gërmadhat e lagjes së rrafshuar. Episodi i fundit i filmit do të zhvillohej pikërisht aty. I duhej ta shtynte atë në kohë, ta ringjallte, të rikthente blazën e gërryer nga ujërat e viteve, të rimëkëmbte trarët e djegur, t'i jepte flakë tërë brinjës, një flakë të madhe,

si një gjuhë zjarri e kobshme, që do të lëpinte faqen e malit. Pastaj shtëllungat e zeza të tymit që do të mbulonin fshatin... Në këtë kuadër do të hynin radhët e njerëzve: në krye katër partizanë me automatikë, pas tyre komandanti gjerman i ekspeditës ndëshkimore dhe disa ushtarë të zënë rob. Pastaj përsëri partizanë dhe njerëz të armatosur...

Regjisori shtrëngoi kokën midis duarve. Dhjetëra herë e kishte menduar këtë skenë dhe çdo ditë e më tepër bindej se diçka i mungonte. Pasi lodhej më kot së vrari mendjen, ai psherëtinte dhe përgjigjja më qetësuese që i jepte vetes ishte: «E shohim konkretisht në fund».

Kështu kaloi një muaj. Fshati u mësua me kinëastët, të cilët u bënë si të shtëpisë. Zakonisht gjatë xhirimeve do të kishte një grup vendasish, sidomos fëmijë, që rrinin e sodisnin, vinin rrotull aparateve e kërkonin t'i preknin me dorë. Në këtë turmë të ngeshme, një sy i kujdesshëm do të kishte vënë re herë-herë një plakë veshur krejt në të zeza. Nënë Hasimeja zbriste rrallë nga konaku dhe gjithmonë qëndronte larg turmës së kalamajve. Ajo ishte një plakë e respektuar. Në qenien e saj nuk ishte asgjë e veçantë, përveç sharpit të zi që nuk e hiqte nga koka.

Një ditë, tek kapërcente sinorin, befas mbeti e shastisur dhe për pak iu morën mendtë. Ajo fërkoji sytë, por ata i kishte akoma shumë të fortë dhe nuk e gënjenin. Në sheshin e vogël të fshatit, në fillim dalloj një turmë të madhe. Pak më tutje, në degën e trashë të rrapit, lëkundej diçka, si njeri i varur. Turma murmurinte me një lëvizje

të çrregullt, sikur do të dyndej drejt të varurit. Së fundi, rrezet e diellit reflektuan shkëlqimin metalik të helmetave të huaja dhe në vesh i buçitën britma të pakuptueshme, në një gjuhë të rëndë, me një theks të egër, të harruar prej kohësh. Instinktivisht nënë Hasimeja ktheu kokën prapa: po ajo shtëpi me mure të bardha. Tutje, në faqe të malit uturinte një traktor. Ajo, e llahtaritur vështroi përsëri turmën në sheshin e vogël të fshatit dhe u kujtua: «Më rëntë një pikë, — tha me vete, — djemtë bëjnë sinema».

Nënë Hasimeja ndërroi mendje. Do të bënte më mirë të mbyllej në konak. Që andej mund të sodiste çfarë të donte. Duke u kapur pas parmakut të drunjtë, ajo ngjiti shkallët. «Më rëntë një pikë, — përsëriti e këputur, — djemtë bëjnë sinema».

U fut në dhomë. Mbi mur, në lartësinë e një boje njeriu, vareshin dy portrete të mëdha, të riprodhuara nga dora e një fotografi amator. Në dhomë ishte qetësi. Dëgjohej vetëm tik-taku i shurdhër i orës mbi oxhak. Tik-tak, tik-tak... Nënë Hasimeja qëndroi përpara portreteve dhe i erdhi mirë që kishte mbetur vetëm. Djali, nusët, nipërit e mbesat ishin në punë të tyre. Sytë e thellë të dy djemve të saj të mëdhenj e vështrojnë me një buzëqeshje të lehtë. Ja, nëno, ku jemi. Kemi vite që fjalosemi bashkë. Tik-tak, tik-tak, tik-tak.

Plaka mbështolli kokën me sharpin e zi. Lulet e nënës. Kisha kohë pa ju parë. Ju u dhatë në derë. Kur erdhët atë natë, vetëm yllin dhe armët ju pushë. Dhe buzët e përzhitura. Isha shtrirë, isha sëmurë. Tërë natën ndenjët sipër meje. Në të

gëdhirë u dëgjuan pushkë. Ju ikët, lulet e nënës, morët dhe Asllanin me vete. Ju ikët, por ata erdhën. U dhanë te dera e më hodhën nga shtrati poshtë. Fëmijët vunë kujën. Nuset u lebetitën... Ish-te një turmë gjermanësh e ballistësh. Ata ulërinin, ata çirreshin. I vunë flakën shtëpisë. Të tërë lagjen e dogjën, qafirët, lagjen tonë të vjetër. Gjashtë burra varën te rrapi, gjashtë pleq të mirë. Ne i pamë me sytë tanë, bijtë e nënës, i pamë tek i varën dhe dolën pranë tyre në fotografi, që i hëngërt një mortje, më keq se ç'i hëngri. Kujë, lele, kujë. Në krye kishin një oficer, një biçimsëz... Kështu do t'u varim të gjithë, tha biçimsëzi. Ja mbaj mend mirë fytyrën, surratin e qenit...

Asaj i doli sërishmi para sysh fytyra e egër e oficerit gjerman që skërmitej. Goja e tij u hap në përmasa makabre. Ndërkaq u shquan dhëmbët e mëdhenj si të një lubie që kërkonte të përpinte edhe njerëzit, edhe shtëpitë e kallura në flakë, edhe... Tik-tak, tik-tak, tik-tak... Nënë Hasimeja hapi dritaren dhe u mbush me frymë. Nga fotografitë buzëqeshnin djemtë.

Regjisori ishte i kënaqur nga puna. Para dy ditësh në Tiranë u kishin bërë një vështrim të përgjithshëm materialeve dhe mendohej se ky mund të dilte një nga filmat më të mirë të xhiruar prej tij. Ai ishte regjisor me përvojë, burrë i matur e serioz, me një sens mjaft të zhvilluar kritik. Megjithatë, mendimi i suksesit të ardhshëm e përkëdhelte lehtë diku thellë, gati fshehurazi, Këtë përdëllim tinzar të ndërjegjes ai përpiqej ta mbyste, ta konsideronte veten gjithmonë në pozitë e atij fillestari, që i besojnë për herë të parë një punë të madhe. Ky ishte parimi i tij i përhershëm.



Por kësaj radhe ai kishte një arsye të fortë, që e bënte të largonte pa mëshirë nga vetja çdo ndjenjë entuziazmi të parakohshëm. Tek kthehej në fshat me një «Karpas» të vjetër të Kinostudios, tërë rrugës u përpoq të ndërtonte imazhin e plotë të filmit, të lidhte skenat e ngjarjet, personazhet dhe detajet. Atëherë truri i tij funksiononte si një kamera e gjallë, që rrëmbente në kuadratin e saj me saktësinë e një mekanizmi të përsosur gjithçka ishte planifikuar e menduar gjatë e gjerë.

Regjisori mbase për herë të parë në këtë rast dëshironte t'i shprehte dikujt kënaqësinë për punën e mbaruar. Ai e dëshironte me të vërtetë këtë dhe do ta bënte me siguri sikur të mos dyshonte për fundin e filmit. Sepse vetëm fundi kishte mbetur. Vetëm skena në atë lagje të rrafshuar. Nuk ishte në gjendje të shpjegonte dyshimet e tij, por në mënyrë intuitive e kuptonte se aty mungonte diçka, diçka që s'po e kapte dot.

Ditën e xhirimit, pasi kaloi disa net pa gjumë, ai mori një pamje të sigurt në vetvete dhe nuk shprehu asnjë shqetësim para aktorëve, të cilët, ç'është e vërteta, këta dy muaj ishin mërzhitur larg shtëpive të tyre. Çdo gjë dukej e përgatitur më së miri. Dita ishte e ftohtë, por mjaft e kthjellët. Në një anë qëndronin figurantët: fshatarë të armatosur, partizanë, pesë ballistë, ushtarë gjermanë dhe një oficer nazist. Më tutje, turma e zaronshme e kureshtarëve. Regjisori i hodhi një vështrim pamjes që shtrihej para tij. Operatori, elektrikistët, teknikët prisnin urdhrin e fillimit të punës. Ai dha udhëzimet e fundit. Brinjën e mbuloi një qetësi e plotë. Dekori natyral befas u ringjall, vendi u

mbulua me tym, flaka përpiu trarët butaforikë. Kjo mjaftoi, që gjithçka të platitej në një heshtje të mbytur, ku ndihej vetëm zukatja e kamerës. Ndonëse ajo fiksonte në mënyrë të ftohtë, e të llogaritur, regjisorit i buçiste në vesh një orkestër e fuqishme, që ekzekutonte një simfoni heroike. Ai e kishte mësuar atë përmendsh dhe u kënaq kur mendoi se ishte i vetmi në tërë këtë zallahi që mund ta përfytyronte skenën të plotë, me të gjitha detajet dhe efektet e saj. Më në fund, në kuadratin e kamerës u shfaqën njerëzit, që dolën nga një kthesë. Mizanskena ishte e përcaktuar. Në krye do të hynte heroi i filmit. Kjo do të jepej shpejt dhe kamera do të përqëndrohej mbi oficerin gjerman. Nga turma e fshatarëve do të shkëputej një plak. Ai do të përqafohej me heroin. Pastaj do të pështynte në surrat oficerin gjerman dhe do t'i shqiste spaletat... Ky ishte detaji përfundimtar i finales, të cilit regjisor i kërkonte t'i jepte një kuptim simbolik. Por, në çastin e fundit, kur fshatari iu afrua gjermanit, mizanskena doli mjaft e zbehtë dhe regjisor i thirri me nervozizëm «stop!». Këtë herë dyshimet e tij u vërtetuan plotësisht. U hoq mënjani i lodhur, pa vënë re vështrimet kureshtarë të njerëzve dhe habinë e aktorëve. Një copë herë bisedoi me skenaristin, por ai ishte i mendimit se çdo gjë shkonte në rregull.

Atëherë xhirimet filluan nga e para. Ai i prapësoi aktorët pesë herë me radhë, duke u dhënë për çdo rast shpjegime të reja. Skena duhej të dilte e fortë, si një epilog lavdie dhe heroizmi. Ju lutem, thërriste regjisor, ju lutem!

Kamera filloi të zुकaste. Në qoshe u duk grupi i partizanëve. Pas tyre vinte oficeri gjerman

me kapotë të zbërthyer. Fytyra e tij kishte marrë një pamje indiferente të përzier me frikë. Robërit ecnin të dërrmuar mbi tokën e djegur. Në çastin e fundit, kur nga turma do të shkëputej fshatari, ndodhi diçka e pabesueshme. Operatori vuri re se si në fillim kuadratin e kamerës e mbuloi një perde e zezë. Pastaj ajo u largua dhe ai instinktivisht vazhdoi të xhironte: perdja mori trajtën e një plake të kërrusur që lëshoi një britmë të çjerrë dhe u derdh mbi aktorët. Në dorë mbante gurë. Ajo, si të mbinte nga dheu, iu hodh në fyt gjermanit, që e pa i llahtarisur dhe u rrëzua përtokë. Atë çast partizani e zuri plakën nga krahu dhe u dëgjua thirrja e fortë «stop» e regjisorit.

Turma lëshoi një klithmë habie. Nënë Hasimeja, thirri dikush. Nja dy gra vunë kujën. Por asnjeri nuk lëvizi. As regjisori, që mbeti si i shastisur, as aktorët e mbytur në djersë. Nënë Hasimeja, si të zgjohej befas, rregulloi shapin e zi në kokë. Kaloi me hapa të ngadaltë midis njerëzve që i liruan rrugën dhe u ngjiti nëpër monopatën e ngushtë të kodrës, mbi të cilën ishte varur e shkëlqente lart si llampadar gjigant një diell llamburitës.

## NJË RAST I VEÇANTË

Prej disa ditësh ai kishte vënë re një ndryshim të pakuptueshëm në sjelljet e djalit. I biri, që sapo kishte mbaruar provimet e maturës, me një natyrë të veçantë, vazhdimisht e kishte shqetësuar me karakterin e tij të mbyllur, që e largonte nga njerëzit. Diçka nervoze, të cilën mendohej ta përmbante me vështirësi, ishte shfaqur papritmas tek ai. Djali u mbyll akoma më tepër në vetvete, grindej kot së koti dhe s'i pëlqenin as ato gjëra që më parë e tërhiqnin.

Këto po mendonte Sotiri, pedagog biologjie në Fakultetin e Shkencave të Natyrës, ndërsa priste i ulur mbi një karrige në ballkonin e apartamentit të shoqen, që akoma po rregullohej në dhomë. Ajo e kishte zakon t'i linte të gjitha për në çastin e fundit, e, sido që ishte betuar disa herë se s'do të vishej përpara se të bëhej gati e shoqja, ai po

e priste, duke ndier erën e lehtë të parfumit që vinte nga dhoma.

— Mos ka rënë në dashuri, — mendoi Sotiri për të birin. Ky iu duk shkaku më i mundshëm pas gjithë arsytiveve që i erdhën në kokë, duke vështruar qytetin në muzgun e mbrëmjes.

— Marta, — thirri i mërzhitur, — edhe sa do të pres akoma?

Ai fshiu sumbullat e djersës me një shami të bardhë. Nga dhoma doli e shoqja, laborante në një institut kërkimesh.

Gruaja qëndroi te dera në mëdyshje. Fytyra e saj zakonisht e zbehtë, një zbehtësi natyrale, që u shkaktonte të tjerëve druajtje, iu duk Sotirit tamam si një copë mermeri e akullt, nën të cilën mezi dallohej një qesëndi e hollë, gati-gati me nuanca e një ironie që s'mundi të kalonte pa u vënë re prej tij. Dhe pikërisht sepse e vuri re, ai u lëndua, deshi në një farë mënyre, pas grindjes së shkurtër që patën, të shfajësohej, të përpiquej t'i mbushte mendjen se nuk mund të vepronte ndryshe. Ai e ndiente se sa qesharake ishte pozita në të cilën po e vinte veten. Por e shoqja ishte një grua me logjikë të fortë, ai s'do të mund të gjente dot ndonjë argument bindës, kështu që vetëm arriti ta pyeste:

— Viktori s'do të vijë?

— Jo.

— Vërtet e guditshme...

— Edhe unë s'e kuptoj, — tha gruaja. — Ka qysh në mëngjes që është mbyllur.

Sotiri shtrembëroi buzët. Por ai ishte njeri i prerë. Përderisa djali kërkonte vetminë, me siguri duhej të kishte diçka dhe zgjidhja më e mirë do

të qe ta linte në këtë vetmi, gjersa të kërkonte vetë të dilte prej saj.

Ata zbritën shkallët në heshtje, i hipën autobusit urban, që kalonte aty pranë dhe pas disa minutash u gjendën në qendër të qytetit.

— Larg e ka shtëpinë Bezhani, — tha gruaja.

Sotiri nuk iu përgjigj. Mbrëmja qe e zakonshme, e qetë, plot fytyra të qeshura. Por atë sikur po e mërznisnin vapa e rëndë, edhe përplasjet e njerëzve të shkujdesur në supin e tij, edhe kjo vajtje në shtëpinë e mikut. Të gjitha këto çuditërisht po i shkaktonin një ndjenjë pakënaqësie ndaj diçkaje të papërcaktuar. Ai ishte njeri i matur në veprime, të cilat kurrë nuk i kishte të tepërta, pa një qëllim në vetvete. Prandaj bisedat e kota, sorollatjet nëpër vitrinat e mëdha dhe rrugët e zhurmshme, llomotitjet që dëgjonte ndonjëherë te Bezhani, në përgjithësi çdo veprim i kotë, i krijonin te zbrazësirë. Në ndonjë rast si ky, që sigurisht në jetë është i pashmangshëm, ai betohej se s'do ta harxhonte më kohën me dërdëllisje, mbyllej në dhomën e vet, ku së fundi qetësohej. Por ndodhte përsëri që i harronte këto, sidomos kur ndeshesh me vendosmërinë e mikut të tij, i cili ç'është e drejta, e ndiente mjaft mungesën e Sotirit dhe, kur ky nuk dukej për një farë kohe, nxitonte ta merrte në telefon:

— Alo, Sotir, po si, xhanëm, s'je dukur fare? Apo mos pret, vallë, të të shlyej vizitën? Jo, i dashur, mosha në radhë të parë, mosha... Sonte të pres.

Veçse këtë mbrëmje të qetë verë nuk ishte këmbëngulja e zakonshme e Bezhanit që po e dërgonte në skajin tjetër të qytetit...

Pas kthesës së fundit, përmes muzgut, ata dalluan shtëpinë ku banonte Bezhani. Ngjitetën shkallët e jashtme. Sotiri shtypi sustën e ziles. Nga brenda u dëgjua kërcëllima e një dore që u hap.

— Sonte mund të kishe ardhur vetëm, — tha gruaja e ulur në një kolltuk.

— Marta! — i tërhoqi vërejtjen ai duke i bërë me shenjë që të mos e ngrinte zërin.

Gruaja psherëtiu e pakënaqur, pastaj zuri të vështronte sendet me shije të hollë të dhomës së pritjes, sikur të ndodhej aty për herë të parë. Sotiri po ndiente haptas një lloj mërie, gati sarkastike që shfaqej në tërë qëndrimin e ftohtë të së shoqes, me të cilën nja tri orë më parë qenë grindur. Pas një shpjegimi të mundimshëm ai i kishte hedhur poshtë përçapjet e saj për të hequr dorë nga misioni që kishte marrë përsipër, mision disi i çuditshëm për të nga çdo pikëpamje, por që duhej kryer pa tjetër, për hir të miqësisë me Bezhanin... Kur u kujtua për grindjen, padashur ai tundi kokën me ngathtësi. Nga biblioteka e murit aty pranë, ia tërhoqi vëmendjen një libër i trashë me kopertinë të lustruar. E mori në dorë dhe zuri ta shfletonte.

— Aha, — tha Bezhani, që hyri në dhomë me një tabaka në dorë, — po sheh «Larusin»?

Ai ishte një burrë i mbajtur mirë, rreth të gjashtëdhjetave.

— Po, — iu përgjigj Sotiri.

— Ma solli Ruzhdiu nga Franca. Ti e di se ai ndenji atje gjashtë muaj.

— Jo, — tha Sotiri — nuk e di.

Bezhani ia mori librin nga dora dhe lëmoi kapakun.

— Si kështu, — shtoi pas pak i habitur — ai vajti dhe erdhi, ndërsa ti s'paskë marrë vesh gjë.

— Ç'të bësh, — mëmëriti Sotiri — na mbytën punët... leksionet.

Pastaj, si të kujtohej për diçka, e pyeti:

— Për çfarë u specializua?

— Më duket për disa ligje të përgjithshme të matematikës statistikore.

Miku i tij afroi një pupe të vogël aty pranë, por befas goditi me shuplakë pjesën pa flokë të kokës, ku dalloheshin ca qime të rralla, të thinjura.

— Ah, pleqëri e mallkuar, matufepsje... Marta... po si je, xhanëm? Ky yt shoq t'i merr mendtë me...

— Me çfarë, — vuri buzën në gaz Marta.

— Ah, me çfarë... Po si është puna, xhanëm, që njerëzit plaken, ndërsa ti sikur rinohesh? Hë, mo Sotir!

Bezhani diçka deshi të shtonte, por atë çast zilja elektrike tringëlliu me forcë. Ai shtrembëroi fytyrën.

— Bah, pikërisht sonte që dua të jemi vetëm...

Pastaj u ngrit. Në dhomë u fut një çift, të cilin Sotiri e njihnte. I kishte parë shpesh aty. U përshëndetën dhe pastaj u ulën. Brenda disa minutash dhoma u mbush me tym duhani.

Sotirin e mbuluan përsëri sumbulla të mëdha djerse, të cilat i fshiu me shaminë e bardhë. Në krye të dhomës, mbi një tryezë të lustruar, qëndronte një televizor. Së largu Sotiri lexoi markën. Më në fund Bezhani, ngaqë s'dinte ç'të bënte,



shtypi sustën e televizorit, mbylli dritën dhe në dhomë ra qetësia.

— Super-ambasadorët kanë dalë mjaft të mirë, — tha dikush në errësirë.

Asnjë nuk i ktheu përgjigje. Një dritë jeshile e zbehtë i mbuloi të tërë.

— E, — i tha Bezhani mikut të tij në vesh, — ç'të reja kemi?

— Asgjë, — tha Sotiri me një pakënaqësi që po i rritej.

— Si asgjë!?

— Dëgjo, Bezhan. Unë bëra çmos, por yt bir më duket i ngathët.

Nga ekrani i vogël, ku parakalonin agregatë industriale, spikeri, me sa dukej, po fliste për prodhimet farmaceutike. Sotiri dëgjonte të flitej për aspirina. Sikur filloi t'i dhimbte koka.

— Si kështu, — pyeti Bezhani, — ai përkundrazi, ka dashur ta takonte vetë dy herë. Çupa s'ka pranuar...

Sotiri heshti. Edhe Bezhani heshti. Sotiri mendoi se djali i Bezhanit ishte pa dyshim një kungull pa fara, përderisa shpresonte që nusen t'ia gjenin të tjerët.

— E di ç'më ndodhi? — tha pas pak Sotiri.

— Çfarë?

— Ajo vajza erdhi e më takoi në fakultet.

Bezhani lëshoi një psherëtimë habie.

— Të them të drejtën s'di ç'të bëj tani...

Ata e ndërprejnë bisedën. Në ekranin e televizorit u shfaqën kuadro të një dokumentari për sipërfaqen e hënës. Të dy pedagogët ranë në hesh-tje. Ata ishin mjaft të interesuar për të dhënat biologjike që transmetonte spikeri. Pastaj spi-

keri filloi të fliste për gjëra të tjera dhe ata vazhduan bisedën e ndërprerë.

— Erdhi te ti, the? — pyeti Bezhani.

Sotiri fërkoj zverkun.

— I ati i saj është burrë i mirë, — tha, — ai më premtoi. Ti e di që unë i fola për ty, për tët bir... bile ai të njihte. Me një fjalë puna mbaroi, sepse ai kishte shumë dëshirë të bënte këtë krushqi.

— Pastaj?

— Nuk e di, mbase gjithçka e ka prishur yt bir.

— Pse?

— Mbase s'duhej t'i dilte përpara vajzës.

Sotiri e ndjeu se po fliste kuturu. Ai s'dinte ç'të fliste.

Miqtë heshtën përsëri.

— Ç'të tha vajza? — pyeti Bezhani.

— Më tha se s'duhej të fusja hundët në punët e saj.

Bezhani lëvizi në ndenjësë. Spikeri edhe një herë po fliste për sipërfaqen e hënës.

— Sigurisht, — tha Bezhani, — ajo është e re, gjimnaziste hesapi. Mbase nuk ka idenë se cili është djali im, ç'familje jemi ne.

— Nuk e di...

Sotiri vështroi përreth. Kjo bisedë po e mër-ziste. Vizioni i vajzës iu shfaq para syve dhe ai nuk mundi ta shqiste. Zëri i saj ishte i egër. Edhe pamja. Emrin e kishte të bukur, Roza. Edhe vetë që e bukur, mjaft e bukur. Ky kungulli i Bezhanit sigurisht nuk ishte pa shije. Po vizioni i vajzës nuk po i shqitej. Ai ë mundonte me atë kryeneçësi të egër.

— Ç'të bëjmë tani? — tha Bezhani.

— Nuk e di.

Bezhani nderoi një cigare.

— Si janë nga gjendja ata?

— Çka...

— Sa fëmijë ka Llikua?

— Pesë:

— E madhja është çupa?

— Jo, e dyta. Ka një djalë në Universitet. Çupa ka hyrë në punë qysh këtë verë.

— Gjynah, — tha Bezhani.

Sotiri nuk foli.

— Dëgjo, hyji edhe je herë kësaj pune, — u lut ai.

Sotiri heshti.

— Provoje edhe një herë. Mbase vajza është nxituar.

Sotiri u zhyt më thellë në kolltukun e tij.

— Thuaj Llikos se ne do ta dërgojmë në shkollë. Do t'i nxjerrim bursë.

— Çfarë?

— Do t'i nxjerrim bursë, thashë.

Sotiri tundi dorën e pakënaqur. Atij filloi t'i dhimbe koka dhe donte të dilte jashtë, në ajër të pastër. Diku, aty pranë tij, i dukej sikur dikush i rrinte mbi kokë, e qortonte në heshtje dhe kjo e mërziste më shumë se çdo gjë tjetër.

Vonë ata u ngritën. Marta mbledhi jakën e bluzës rreth qafës dhe kryqëzoi duart nën sqetulla duke u ngjethur. Mbi asfalt kërcisnin vetëm takat e sandaleve të saj dhe hapat e tij të rëndë, me një jehonë të mbytur, që mbetej prapa mbi rrugën e zbrazur, midis ndriçimit të ftohtë të neo-neve.

— Unë pothuajse i dëgjova të gjitha, — tha Marta.

— Gabim ke bërë. Vesi më i keq është të përgjosh të tjerët.

— Mbase s'kam qenë e vetmja që i dëgjova përshtëpëritjet tuaja. Ju s'dini të flisni as me zë të ulët.

— Epo mirë atëherë...

Marta u kruspullos akoma më tepër me krahet nën sjetulla dhe ai mund të dallonte shkarazi se si u shtrembëruan tiparet e saj të bukura nga një pikëllim i thellë, që s'kishte të bënte fare me krenarinë e saj të zakonshme.

— Është e padurueshme, Sotir. Nuk arrij ta marr me mend se si mund t'i lejosh vetes marrëzira të tilla.

— Marta, mjaft! Të lutem, lëre këtë histori...

Djalin e gjetën zgjuar. Sotiri e vështroi me kujdes dhe i shkoi ndër mend se mbase ai kishte rënë në dashuri. Fytyra e tij iu duk mjaft e hequr, sytë të futur thellë e të menduar.

— Përse nuk erdhe me ne? — e pyeti.

Djaloshi, me një trup të hollë e të gjatë, me një seriozitet që mbase e kapërcente moshën e tij, u ngrit. Kaloi pranë tyre me indiferencë dhe u tha «natën e mirë». Sotirit i bëri përshtypje mospërfillja e tij.

— Viktor, — thirri, — eja këtu!

Djali u bind. Ai qëndroi drejt para të atit, si një ushtar që rri gatitu.

— Ç'është kjo punë me ty? — thirri Sotiri, që e kuptoi se po nxehej, — që kur je mësuar të mos u përgjigjesh të tjerëve?

Djali e vështroi drejt në sy.

— Jam shumë i lodhur, dua të fle, — tha ai.

Sotiri e la të qetë. Marta u fut në dhomën e gjumit e filloi të zhvishej. Ai padashur kujtoi vajzën. Sotiri mendoi se të rinjtë e sotëm nuk janë aq të respektueshëm sa ç'kishte qenë, ai me shokë në një kohë. U zhvesh me ngathtësi, u fut në shtrat dhe shtypi sustën e abazhurit.

— Sidoqoftë, nesër do të bisedoj edhe një herë me Llikon, — tha me vete.

Pastaj e zuri gjumi nën krahun e butë të Martës...



Të nesërmen u zgjua më herët se zakonisht. Kishte dhimbje koke. Qysh në mëngjes dielli ishte i nxehtë, mjaft i nxehtë. Marta vuri xhezven e kafes në një plitkë. Edhe i biri ishte zgjuar herët. Ai qëndronte në ballkon. Sotiri vështroi profilin e tij përmes derës së ballkonit, duke pirë kafën. Marta këndonte me zë të ulët. Poshtë, në rrugë, lëviznin njerëzit e makinat. Dielli digjte. I biri ishte tretur shumë, kishte ndryshuar mjaft dhe atij i erdhi keq.

— Viktor, — i thirri.

Djali nuk lëvizi. Ai i thirri përsëri. Djali erdhi dhe u ul pranë tij me një pamje të huaj.

— Viktor, çfarë ke?

Djali vështroi nga e ëma.

— Asgjë.

Sotirin nuk e kënaqi përgjigjja e tij.

— Viktor, ti ke diçka, thuaja babait.

Djali mori frymë thellë.

— Më vjen turp, baba, tha ai papritur.

Viktori ishte serioz dhe Sotiri e dinte këtë. Gjithmonë kishte menduar se i biri kishte një seriozitet të çuditshëm. Ai gjithmonë kishte dashur gjithashtu të gjente ndonjë mjet për t'ia larguar ndjenjën e turpit, që e veçonte nga njerëzit. Sepse ishte i bindur që djali i tij bënte një jetë të vetmuar. Sigurisht, duhej të kishte bërë edhe një fëmijë tjetër...

— Dëgjo Viktor, — i tha me dhembshuri, — edhe nga unë ke turp?

Djali u mundua të zotëronte veten.

— Jo.

— Atëherë ç'ke, — i tha Sotiri.

— Asgjë...

Sotiri e vështroi i habitur. Ai mendoi se në fakt dashuria i bën ca budallenj njerëzit dhe i erdhi për të qeshur.

— Hajt, lëri këto tani...

Pas një ndrydhjeje të fuqishme, që mezi mundi ta mposhte, djali mërmëriti:

— Unë kam pasur një shoqe shkollë, baba, atë e quajnë Roza.

Sotirit iu drodhën buzët. Fytyra e vajzës iu shfaq si një vizion i turbullt dhe i ngjalli një ndjenjë pasigurie.

— Dhe çfarë? — tha ai.

Djali psherëtiu.

— Një ditë u takuam në bulevard...

Sotiri e humbi durimin.

— Ti, me Rozën e Llikos... — pyeti ai pa e çuar mendimin gjer në fund.

— Eh... — tha djali i pakënaqur, — Përse ma bën këtë pyetje... Unë atë e kam vetëm shoqe, asgjë më tepër...

Sotiri u përpoq të mbliidhte veçen.

— Viktor, ç'janë këto marrëzira që flet?

— S'janë marrëzira, për fat të keq, — tha djali i qetë.

Sotirin e mbërtheu dhimbja e kokës. Kjo i ndodhte nganjëherë, pasi kishte dhënë ndonjë leksion të gjatë në auditorin e madh. Vetëm pasi mbante leksionin.

— Roza më tregoi se e kishin rrahur.

Pedagogun e mbuluan sumbulla të mëdha djerse.

— Mua më erdhi turp për ty, baba, — përsëriti djali, — s'desha ta besoja se shkaktari ishte im atë.

Marta në derën e kuzhinës mbeti si e ngrirë, me një kusi në dorë.

— I di të gjitha, — tha pastaj Viktori me zë të mbytur.

— Viktor, — thirri Marta, — ç'thua kështu!

Sotiri u trëndit. Ai ia bëri me shenjë së shoqes të mës fliste. Mbase për herë të parë ndjeu t'i përmysej diçka. I hutuar, herë vështronte të birin që rrinte kokulur, me një tis të përpurt që e mbuloi të tërin, herë Martën, e çila, e shtangur te dera e kuzhinës, me kusinë akoma në dorë, sikur i thoshte me zërin e saj të butë: «Po, po, kjo s'durohet, s'durohet».

## CENTRALISTJA

Zakonisht njerëzit më drejtohen mua si të jem shpëtimtare. Disa me padurim, nganjëherë si të më luten, ndonjëri bile edhe me lëvdata, që shkojnë deri në shprehjet jo fort të këndshme: «Hë, t'u bëfsha». Mua, sidoqoftë, nuk më mbetet qejfi, bile edhe në ato raste kur njerëzit shqetësohen nga padurimi. Jam mësuar me të gjitha llojet e qëndrimeve, sepse tek unë drejtohen të gjithë tipat që mund të hasen në jetë. Dëshira ime është t'ua mbaroj punën, por jo të gjithë e kuptojnë se, në fund të fundit, unë jam vetëm centraliste kabine dhe nuk është krejt në dorën time që ata të lidhen e të flasin sa më shpejt.

Aty, pas xhamit të trashë të sportelit, në një farë mënyre jam e pranishme në gëzimet e hidhërimet e njerëzve. Duke shlyer faturën e pagesës pas bisedës, sipas rastit, marr pjesë në këto ngjar-



je sepse gjithkush e ndien të natyrshme të më bëjë pjesëtare të ndjenjës së tij, që unë vetëm e marr me mend nga mënyra me të cilën më drejtohet klienti.

Në tërë atë mori fytyrash që më shfaqen pas katrorit të vogël të sportelit, sigurisht ka edhe nga ato që mua më fiksohen dhe i mbaj mend për një kohë të gjatë. Por ka të tjerë që bëjnë përjash-tim, të cilët i njoh jo nga tiparet e tyre të veçanta, por nga fakti se janë klientë të vazhdueshëm. Disa du-ken këtu një herë në javë. Këta janë në-përgjithësi puntorë apo kuadro të Kombinatit Metalurgjik, të ardhur nga rrethet. Ka prej tyre që vijnë edhe dy herë në javë. Këta janë, si të thuash, kategoria më interesante e klientëve të mi, të fejuar apo të fejuara, që e mbushin sallën me të qeshura, në kundërshtim me rregullat e vendosura për mbajtjen e qetësisë. Unë u tërheq vërejtjen, i kërcënoj pas xhamit të trashë. Ata kujtohen se e kanë shkelur e, meqë më kanë mësuar emrin më thonë:

— Oh, Bali, na fal...

Në të hyrë të vjeshtës së vitit të kaluar më ra në sy një klient i ri. Ky qe një burrë rreth të dyzet-epesave, me flokë pak të thinjur por të dendur, me trup të drejtë, të gjatë e të bëshëm. Kur vin-te përpara sportelit përkulej në katrorin e vogël, më drejtohej me mirësjellje të veçantë, që menjë-herë linte të kuptohej se qe njeri shumë i mësuar e me edukatë.

— Ju lutem, 32-95, direkt me Tiranën.

Pastaj, me hapa të ngadaltë, të matur, shkonte në stolat pranë perdeve të bardha, ku rrinte pa u ndier, gjersa dilte thirrja. Në të shumtën e rasteve mbante me vetë një çantë të zezë, prej nga do të

nxirrte gjithmonë ndonjë libër dhe lexonte i qetë, pa u trazuar nga bisedat e të tjerëve nëpër sallë.

Zakonisht ai telefononte pas orës nëntë, kur edhe linjat tona janë më të lira. Por një ditë e prishi këtë rregull. Ai erdhi nga ora tre pasdite. Pa dyshim, këtu s'ka asgjë për t'u çuditur. Veçse më bëri përshtypje diçka: ai m'u duk i turbulluar. Si më dha numrin, që më sa dukej ishte i familjes së tij në Tiranë, nuk u ul në stol. Me çantën në dorë zuri të maste me hapa korridorin e sallës nga kreu në fund, ndezi nja dy cigare njëren pas tjetrës, të cilat sa i thithte i flakte, e më pyeste:

— Doli gjë?

E vërteta është se unë gjithmonë isha përpjekur ta lidhja sa më shpejt. Besoja se edhe atij duhej t'i kishte rënë në sy kujdesi im, prandaj m'u duk e habitshme këmbëngulja disi nervoze që po tregonte. Më në fund numri doli dhe ai u fut në kabinë.

Meqë në atë orë nuk qe paraqitur asnjë tjetër që të donte të lidhej me Tiranën, unë e lashë të fli-ste i qetë, pa e ndërprerë. Kjo zgjati rreth dhjetë mi-nuta. Kur doli nga kabina fytyra i qe zverdhur. Kaloi përpara sportelit pa e kthyer kokën, e atë-herë e kuptova se ishte aq i hutuar, sa harroi që du-hej të paguante.

— Shok! — i thirra unë.

Ai ndaloi.

— Urdhëroni?

— Më falni, por... duhet të paguani.

— Ah, sigurisht, — tha ai i turpëruar.

I plotësova fletëkuitancën. Me gishtërinjtë që i dridheshin lehtë më zgjati të hollat. Pastaj u lar-gua duke lënë prapa diçka të rëndë dhe unë s'e di se përse ndjeva keqardhje për të. Mbase ngaqë

e shihja përherë të vetmuar e kjo vetmi sikur më përfshiu edhe mua. Ai u zhduk pas xhamit të bardhë të hyrjes, ndërsa unë mbeta midis heshtjes së shurdhër që la në sallë.

Por pak më vonë gjithçka ndryshoi. Thirrjet u dendësuan, salla u mbush me njerëz. Përpara sportelit rrinin në këmbë një grup djemsh, të cilët qe e pamundur t'i largoja. Emri im popullor mësohej shpejt e shpejt, shqiptohej nga të gjithë gati në mënyrë intime, siç mund të shqiptojmë emrin e një njeriu të njohur e të afërt. Nga udhëkryqet e linjave gjer në receptorin e vogël pranë veshit tim vinin zërat e njohur të kolegeve të largëta.

— Alo, Bali, Cërrikun, moj motër!

— Lume, Peshkopia?

— Xrrr...

— Çfarë Peshkopia! Dukati.

— Alo Vlora, më lidh me Dukatin. Ah!...

— Bali, të keqen, a doli Tirana?

Nga ora nëntë e gjithë kjo zallahi u fashit. Linjat u qetësuan. Ndonjë thirrje e vonë vraponte përmes telave që zgjateshin maleve e përfundonte në sinjalin e verdhë të centralit.

Unë mbështeta kokën mbi të dyja duart. Më buçisnin veshët. Dikush u var mbi xhamin e lartë të sportelit. Nga poshtë u shtri një dorë e madhe, që më vuri përpara syve një rrip të hollë letre, ku munda të dalloja shifrën 21 e 20.

— Largohu, — thashë unë, — do të thyesh xhamin.

— Mos ki merak, — u përgjigj tjetri, — as që e kam prekur.

Ai ishte një djalë rreth të njëzetepesave, të cilin e njihja prej dy vjetësh. Instinktivisht thirra Shkodrën.

— Përsëri me të fejuarën? — e pyeta.

Ai vuri buzën në gaz.

— Ti je e mrekullueshme, Bali!

— Oh, lëri komplimentet për nusen.

— Jo, ti meriton më tepër!

— Shiko, shiko dreqi. Qenke me humor.

— Ha-ha! Do të të ftoj në dasmë.

Ai u shkeli syrin dy shokëve të tij, të gjatë si zdapa, që rrimin aty pranë. M'u dukën tamam si im bir. Edhe ai ka diçka të tillë, si këta djem, diçka prej abdalli, që të bën të qeshësh kot së koti.

— Për kur e keni lënë dasmën? — e pyeta.

— Dasmën? Ç'dasmë, moj Bali!

— Shejtan, do t'i them së fejuarës.

— Xrr...

— Alo, Shkodra?

— Vali me Samiun, thirrja jote.

— Hajt, — i thashë atij, — vrap, kabina katër.

Tri minuta më vonë ai doli duke u zgërdhirë vesh më vesh. Kruajti xhepat i kënaqur, nxori ca monedha metalike, të cilat i tundi në dorë si guriçka e i hodhi mbi tryezë.

— Pas dy muajsh, — tha.

— Çfarë?

— Atëherë mbaroj afatin e qëndrimit këtu dhe drejt e në dasmë.

— Si kështu, vërtet?

— Po pse xhanëm? A nuk të janë mërzitur edhe ty fytyrat tona antipatike?

Ata u larguan, humbën pas xhamit të bardhë

të hyrjes e lanë prapa një dalldisje të çartur, prej montatorësh në kohën e lirë.

Nga fundi i atij muaji moti u prish. Disa ditë me radhë ranë shira të forta. Përtej dritareve të mëdha të postës rruga e zbrazur lahej nga rrëkerat e ujërave që rridhnin në të dyja anët e trotuarëve. Era, e zënë si në kafaz midis ndërtesave të qytetit, grindej e çirrej, ndërsa receptor i vogël më sillte me ca zhurma të çuditshme jehonën e ulërimave të stuhisë andej nga malet.

— Bali, të lutem, Tiranën!

— Mirë, moj xhan, por nuk del. Prit sa të ndreqet! Ja, shiko atë burrin atje matanë. Edhe ai ka gjysmë ore që pret për Tiranën.

— Cilin?

— Ja, atë që na ka kthyer shpinën e vështrotrugën.

Fqinja ime, një grua e bëshme, e trashë si vozë, ktheu kokën.

— Ua, moj Bali, po ai është mësuesi i sime bije.

— Vërtet?

— Pa, pa, pa. S'kam parë njeri më të sertë.

— Ç'thua, moj? Unë e kam klient të rregullt dhe është shumë i sjellshëm!

— Kush, ai? Bah!

Fqinja nduku faqen e shtrembëroi buzët. Ajo ishte një grua energjike. Në të vërtetë njihej ca për llafazane, kështu që edhe kur kishte të drejtë e humbiste, ngaqë nuk dinte ta përmbante veten.

— Sepse e ka marrë me gazep time bijë, drejtë e merr vesh. Ti e njeh vetë gocën. As zogjtë e pulës nuk tremben prej saj.

Kjo ishte e vërtetë. Fqinja kishte një vajzë të urtë e të rregullt, që binte në sy në tërë pallatin tonë.

More shoku mësues, i thashë një ditë kur vajta në shkollë, që më thirre bëre mirë, po shiko mos ma ngatërron vajzën me ndonjë tjetër. Jo, më përgjigjet, ajo është e pavëmendshme, është kështu e ashtu. Un e dëgjoj e diçka më gërryen. I them: Po si, o shoku mësues, ka dymbëdhjetë vjet që e dërgoj në shkollë e s'më është ankuar njeri për këtë fëmijë, ndërsa ju po më batërdisni? Meazallah! Një orë konferencë më bëri, sa më ënjti kokën. Ika, ç'të bëja? Desha t'i thosha njëherë: More shok, në goftë se mërzitësh këtu vetëm, pa njeri e pa familje, ne s'ta kemi borxh. Gjene thashë me vete: Ik, Esma, ik e shtrëngo vajzën, më mirë ta ulë ajo kokën. Po ç'ti shtrëngoj asaj, aman, më thuaj, jo se e kam timen!

Fqinja rregulloi kapësen e flokëve dhe pshe-rëtiu. Jashtë vazhdonte të binte shi. Ai rrinte me fytyrë pas xhamit, si të numëronte pikat e ujit që pluskonin mbi asfalt.

— Eh, moj xhane, sot s'qenka gjë më duket.

— Ç'të të them? — iu përgjigja.

Esmaja tundi çadrën në ajër, u mbështoll mirë, hodhi vjedhurazi një vështrim në qoshen ku po rrinte ai dhe u largua. Qe një nga ato pasditet e rralla, kur posta mbetej bosh. Ndodheshim vetëm ne të dy, unë pas sportelit, në pritje të vendosjes së linjës, dhe ai në qoshen e stolit, si i përhumbur. Prisnim të njëjtën gjë, linjën. Unë me ndjenjën e zakonshme të detyrës, ndërsa ai... Vërtet, çfarë priste ai? Ç'ishin tërë ato biseda të pafundme që e turbullonin gjith-

monë? Ah, mendova, tek shihja fytyrën e tij të mër-  
zitur, sa të liga bëhemi ndonjëherë ne, gratë. E si  
mund të lihet burri vetëm, në një qytet larg shtë-  
pisë. Për veten time s'do ta bëja kurrë...

— Xrrr...

— Xrrr...

Rrëmbeva receptorin.

— Alo, Tirana?

— Bali, ç'kemi andej, — dëgjova zërin e njohur  
të centralistes së Tiranës.

— Po he, moj motër, ç'qe kjo pikë e zezë sot! Na,  
dëgjo! Më jep një numër 32-95, shpejt!

— Xrrr...

Ai u ngrit. Me hapa të mëdhenj përshekoi distan-  
cën nga qoshja e stolit deri te sporteli.

— Doli? — më pyeti.

— Kabina dhjetë! — i thashë.

Ai u mbyll në vetminë e kabinës. Vazhdonte të  
binte shi, një shi i qetë, i shtruar, strehët pikonin.  
Drurët e lagur anës trotuarit sikur kishin varur kra-  
hët e flisnin me njëri-tjetrin me gjuhën monotone të  
shushurimës së shiut. Për pak do të dremisja nga kjo  
heshtje e plogët. Befas dera e kabinës u shty me for-  
cë. Unë ktheva kokën e trembur.

— Ç'është? — thashë.

Ai kishte nxjerrë gjysmën e trupit matanë de-  
rës. Ishte skuqur. Sytë i shkrepnin nga një inat i  
pakuftueshëm.

— Ç'bëhet kështu, xhanëm? Ç'është ky shërbim?  
Një herë m'u desh të prisja një orë gjersa u lidha,  
ndërsa tani s'të lënë të flasësh!

— Si është puna, more shok, — thashë unë, e  
fyer nga shpërthimi i tij.

— Po ja, s'dëgjohej gjë!

Unë hyra në linjën që lidhej paralel me atë të kabinës. Vinte një zhurmë e çrregullt, e fortë, sikur nëpër fillin telefonik rrokullisej një ujëvarë gurësh. Pas pak zhurmat u shuan dhe dëgjova zërin e largët të një gruaje:

— Alo, Miltiadh...

— Hë, — u përgjigj burri, — a dëgjon?

— Po, tani të dëgjoj më mirë, — tha gruaja me një zë të butë e të ëmbël.

— Pra, më the se paske vajtur te shoku Qenan, — foli burri.

— Po, — u përgjigj gruaja. — Nuk e merr me mend se sa të rëndë e pata.

— Vefi, lëri sentimentalizmat tani. Nuk është koha. Dje unë refuzova përsëri të marr shtëpi.

Përsëri zhurmë. Burri doli i shqetësuar nga kabina. Vura receptorin tim përsëri në vesh dhe u përpoqa të bëja diçka.

— Më mirë dëgjohej, — thirri ai.

— Oh, — tha gruaja, — Miltiadh, është e dyta herë dhe më duket se s'ke për të nxjerrë gjë në dritë.

— Vefi, mos më mbush me miza tani. Ç'të tha Qenani?

— E ç'do të më thoshte? Unë nuk kisha asnjë argument të fortë, asnjë arsye serioze që të mbështesja kërkesën time.

Pa dashur të dëgjoja këtë bisedë intime, u bëra dëshmitare e saj.

— Të pyeta ç'të tha Qenani, — foli burri me ton të rreptë.

Gruaja nuk iu përgjigj menjëherë. Tërë hapësira prej dhjetëra kilometrash, që i ndante, sikur u ten-



dos në trajtën e një teli të ftohtë, memec, që s'donte të fliste. U përpoqa ta përfytyroja atë grua të panjohur, diku në apartamentin e saj, mbështetur pas murit, tek kafshonte buzën, shtrydhte kokën e shtrëngonte tëmthata, që me siguri tani po i dhimbnin.

— Qenani, — u dëgjua zëri i saj i largët, — më porositi të të transmetoj një këshillë të tijën, asgjë tjetër.

— Çfarë? — tha burri, — nuk dëgjohet mirë.

— Thuaj Miltiadh, më tha, se është kuadër. Ka rënë në sy për keq me bishtat që po nxjerr.

— Si? Vërtet kështu të tha? — thirri burri. — Ah! E unë kam kujtuar gjithmonë se e kam pasur mik.

— Miltiadh...

— Hë, çfarë, mos duhet të dëgjoj dënglat e Qenanit, apo do të më tregojë vijën ai.

— Mos kështu, Miltiadh, nuk bën kështu...

Përsëri gjëmimi i ujëvarës, nervozimi i burrit dhe ndërhyrja ime e menjëhershme.

— Nejse, — vazhdoi burri duke psherëtirë. Ai s'po e zotëronte dot veten, — nesër do të vesh te shoku Jorgji. T'ia thuash atij të gjitha ato që kemi biseduar. Ndërkaq edhe unë këtu, nesër kam një takim me rëndësi. Pasnesër do të të marr në telefon, nga ora nëntë. Pastaj shohim e bëjmë, kur të vij në Tiranë.

— Ç'ne te shoku Jorgji, — tha gruaja, — po kjo s'ka asnjë kuptim.

— Vefi!

— Jo, s'mund të vete. Më vjen zor. Më kanë ardhur në majë të hundës këto gjëra.

— Vefi, të lutem, lëri budallallëqet. Flet sikur nuk e di gjendjen time. Për këtë u përpoqa gjithë jetën! Gjepura.

— Linda është sëmure, — tha befas gruaja.  
Unë vendosa receptorin në vend. Pa ditur asgjë,  
kisha përbuzur atë grua, ndërsa tani po më vinte  
keq për të. Edhe mua po më dhimbte koka, po më  
buçisnin tëmthat. Nuk më kujtohet se sa folën më  
pas. Më kujtohet vetëm se, kur doli nga kabina, ai  
ishte i qetë, me pamjen e tij prej njeriu të sjellshëm.  
Pagoi të hollat, humbi në mugëtirën gri të asaj pas-  
diteje të lagësht, por unë e dija se të pasnesërmen  
ai do të vinte përsëri. Dhe vërtet ashtu ndodhi...

Ajo që një mbrëmje e jashtëzakonshme. Thirr-  
jet nuk kishin të mbaruar. Njerëzit dyndeshin në  
pöstë valë-valë. Nëpër qoshe disa pinin duhan e kjo  
më nervozonte më tepër se të gjitha. Fjollat e tymit  
vareshin në sallë bashkë me murmurimën e mbytur  
të bisedave nën zë. Dikush më vuri përpara një copë  
pusullë. E mora dhe e vendosa në vandakun e thirr-  
jeve.

— Bobo, qenke me nerva sonte.

Unë ngrita kokën.

— Ashtu është, prandaj mos më rri këtu si ka-  
rafil.

Djaloshi lëshoi një vërshëllimë të gjatë.

— Kam një hall sonte, — tha pas pak.

— E di, të pret nusja... Alo, Tropoja?

— Jo, — tha ai, — kam me të vërtetë një hall. Të  
lutem, më ndihmo.

E vështrova me vërejtje.

— Tropoja? Fierzën, thirrja jote.

— Sontë dua të flas me Tiranën, — tha ai.

— Pse kështu... Alo, Fierza?

— Vali është në Tiranë, — tha ai, — te xhaxhai.  
Javën tjetër më presin të kthehem në Shkodër, ndër-  
sa unë s'do të kthehem dot.

— Fierza? Na, fol këtu me Qemalin.

Atë çast në katrorin e sportelit u duk fytyra e shqetësuar, por e mbushur e klient Miltiadhit.

— Të lutem, Tiranën, — më tha, — e dua me urgjencë!

Nuk vajti të ulej në qoshen e tij. I hodhi një vështrim orës e u mbështet në mur, përballë meje. Ishte i ngrysur. Me siguri këto mendime të ngrysurra pas pak do t'i zbrazte në vrimat e vogla të receptorit. Ato do të rrëshqisnin nëpër tela, do të përshkonin si vetëtimë, me shpejtësi të llahtarshme hapësirat e maleve e do të derdheshin diku, në skajin e një apartamenti, ku tani një grua, së cilës i kisha dëgjuar vetëm zërin e butë, priste me ankth tringëllimën e trazuar të ziles.

— Kam frikë se s'do ta gjej te xhaxhai. Sonte ajo mund të jetë në Shkodër.

— Çfarë?

— Oh, Bali, ti s'po më dëgjon fare.

Djaloshi, i pezmatuar trokiti gishtin në xhamin e trashë.

— Më fal, — i thashë, — s'e kisha mendjen. Po ç'është ky hall që të paska zënë?

— Jo, — tha ai, — asgjë. Veçse ata më presin, ndërsa unë s'do të kthehem.

— Si kështu?!

— Dola vullnetar, kupton? Do të qëndroj këtu edhe një vit.

— Shoqe, të lutem, Tiranën! E kam me urgjencë, — ndërhyri Miltiadhi.

Unë tunda kokën.

— Po dasmën? — pyeta.

— Ç'hyn këtu dasma, — u habit ai.

— Po ja, ç'ka për të thënë Vali...

— Vali? Çudi. Kjo s'më kishte vajtur nëpër mend. Ta zëmë se do të mërzhitet ca.

— Shoqe, të lutem, Tiranën, ju thashë. E kam me shumë urgjencë...

— Pastaj kjo është një gjë fare e zakonshme për ne montatorët.

— Xrrr...

— Alo, Tirana?

Miltiadhi nderi trupin përpara si pendul. Për një çast vështrimet tona u kryqëzuan. Diçka jo e mirë u ndez në sytë e tij të fjetur. E unë pashë aty një pikëllim, pikëllimin e së shoqes. Nuk munda ta duroja.

— Ç'numër do, — i thashë djaloshit shpejt e shpejt.

— 57-20

— 57-20, — përsërita unë.

Ai vajti me vrap e u mbyll në kabinë. Miltiadhi futi kokën në sportel. Buzët i dridheshin. E kishte humbur atë qetësinë e jashtme, e me sytë e shqyer dukej tamam si ata njerëzit që kërkojnë sherr.

— Ju po veproni me padrejtësi, — më tha, — unë duhej të flisja përpara atij djaloshit.

— Jo, — thashë unë, duke u përpjekur të zotëroja veten, — atij i takonte përpara jush.

— Ah, jo, unë jua tregova se e kisha me urgjencë. E kam tepër urgjente punën, moj shoqe, merr vesh apo jo?

Mua më hipën nervat. Desha t'ia përplasja tërë mllefin që më ishte mbledhur kundër tij, por u përmbajta. E thonë pastaj se ne, centralistet, bëhemi nervrike. A nuk të mërzhisin këta njerëz?

## NË AGIMIN E NJË DITE

### I

Atëherë punoja në brigadën e frontojës të fabrikës së çimentos në kombinatin e materialeve të ndërtimit të kryeqytetit. Shahin Alushi, brigadieri ynë, qe një burrë me trup mesatar, ndonja pesëdhjetë e dy vjeç. Ai kishte një hundë të madhe me xhungë në majë, sy të zgjuar, por gjithmonë të qetë.

Në cep të fabrikës, ngjitur pas faqes së murit të trashë, ne kishim dhomën tonë, një kthinë me deriçkë të vogël prej druri, ku zhvisheshim ose pushonim. Herë pas here te ne vinte, ose ngaqë i binte rruga rastësisht, ose për kontroll, Sali Molla, njëri nga të katër teknikët e fabrikës. Ky qe një burrë i gjatë, i thatë, me sy të kaltër, si të përgjumur. Vuante prej kohësh nga stomaku dhe, megjithëse mbante dietë, e prishte herë-herë duke hedhur ndonjë gotë me punëtorët.

Sali Molla ecte duke u tundur, mbante një kaske të të çuditshme prej doku, me cepa e me strehë të gjerë, që i jepte një pamje disi komike. Kur vinte në dhomën tonë, ngaqë ishte tepër i gjatë, ndërsa dera e ulët, përkulej e atëherë dukej sikur trupi i tij i hollë palosej e thyhej më dysh.

— E, more pëllumba, — thërriste — prapë ulur ju?

Si nuk mernte përgjigje futej brenda, ulej në stol, ku ne i bënim vend shpejt e shpejt. Shahini vinte këmbën mbi këmbë.

— Bëni qejf ju, bëni, — thoshte pastaj, — por dije, o Shahin Alushi, se je personi më liberal që kam njohur.

Shahini fillimisht turbullohej. Teknikut të vjetër i pëlqenin romuzet, hidhte thumba në mënyrë të hollë, kështu që të tjerët e kishin të vështirë ta kuptonin nëse bënte shaka apo godiste me një ironi të lehtë. Por Shahin Alushi, komunist i vjetër, ish-partizan, ish-oficer i forcave të ndjekjes, nuk i përtypte kollaj këto gjëra. Nga vitet e vështira që kishte kaluar në shërbimin ushtarak, ai e ruante të paprekur ndjenjën e rregullit. Nuk i pëlqenin brigadier Shahinut vicklat dhe kur takohej me teknikun mobilizohesh që ky të mos ia hidhte.

— E, or, e, grij ti, — thoshte duke kruajtur xhungën e madhe në majë të hundës. — Pa shihni një herë punët tuaja andej. Apo shyqyr na ke mësuar të dredhësh zinxhirin e të tallesh tërë ditën. Mblidh, or, mendjen, se, për nder, të bëj hatanë.

Dhoma e vogël gjëmonte nga zëri i tij. Ai e nisi replikën i qetë, por fytyra i skuqej, një damar i kërcente mbi ballë, elektrizohej, e ngrinte zërin, për-

plaste grushtin te gjunjët me inat aq, sa Saliu, të cilin i thahej pështyma të buzët, e ndërpriste i mërzi-tur:

— Mjaft, se na ënjte kokën. S'flet dot njeriu me ty.

Flora, mbesa e Saliut, e vetmja vajzë që punonte në brigadën tonë, kur shihte këto skena të stuhishme midis xhaxhait të saj dhe Shahinit, strukej në qoshen më të largët të dhomës. Lidhte shallin e bardhë pas flokëve, picërronte sytë e bukur, si e nemi-tur.

Atëherë edhe unë e humbja pusullën. Përpiqesha të takoja vështrimin e syve të Florës, më turbullonte tisi i purpurt që i mbulonte fytyrën, bëhesha pjesëtar i një faji imagjinar, të cilin hëpërhë e dinim vetëm ne të dy. Ajo ngrihej në këmbë, gjente ndonjë shkak për t'u larguar, ndërsa unë rrija i pezmatuar nga hidhërimi i saj pa kuptim.

— Hajde djema, — ndërhynte Shahini për t'u dhënë fund bisedave, — makinat mbërritën...

Pasditeve, si bëja një dush të nxehtë në banjat e fabrikës, më pëlqente të shtrihesha në një pyllë të vogël shelgjesh, buzë lumit. Ua vija veshin gurgullimës së ujërave, fëshfërimës së gjetheve të plepave, prisja Florën dhe, kur ajo nuk vinte, mërziutesha.

Por ndodhte që Flora vinte, disi e hutuar, disi e trembur nga syri zhbirues i xhaxhait. Ne rrëshqisnim në rrugën me pluhur, ndonjëherë ktheheshim gjer në qytet në këmbë. Më të shumtën e rasteve ajo fliste, kurse unë heshtja. Flora vazhdimisht gjente ndonjë temë për të biseduar, i bënin përshtypje edhe gjërat më të vogla, kishte një tip ëndërrimtar, në kontrast me pamjen e saj kryeneçe.

Përballë frontojës, në krahun e djathtë të fabrikës, ndodhej ofiçina. Mbi derën prej llamarine mekanikët kishin shkruar me bojë zmallt të kuqe «Ndalohet hyrja». Ata që nuk e dinin se si qëndronte puna stepeshin, rrinin në hyrje e nuk guxonin të futeshin brenda. Këtë ndjenjë ngurrimi të huajve ua përforconte sidomos një tabelë e sigurimit teknik me simbolin e njohur, ku qe shkruar me shkronja të zeza e të forta «Rrezik vdekje». Por ne, të brendshmit, e dinim se këto lloj tabelash i kishte vënë Zihni Nurja, një mekanik me trup të shkurtër, që kur i kishin humbur, s'dihet se si, nja dy çelësa papagallë. Përveç rrjetit elektrik mjaft të sigurt, në ofiçinë s'kishte asgjë të rrezikshme. Megjithatë mekanikët, me sa dukej, qenë të një mendjeje me Zihniun dhe i kishin zët njerëzit që shkonin në ofiçinë pa ndonjë punë. Ndërsa unë bëja përjashtim. Kjo ndodhi që kur u ndihmova për vendosjen e një rrufepritëseje në majën e oxhakut të fabrikës. Atëherë dikush prej tyre propozoi të më merrnin si ndihmës në repartin e remontit. Por këtë e kundërshtuan edhe tekniku Sali Molla, edhe brigadieri i remontit, i cili tha se ata nuk kishin nevojë për njerëz që dinin të mbanin vetëm hekura në krahë, pasi ishin të fortë vetë për këtë punë.

Mua më mbeti qejfi. Një vlerësim të tillë për veten time po e dëgjoja për herë të parë e sidoqoftë kjo nuk qe diçka e këndshme. S'do të kisha shkelur kurrë më në ofiçinë, sikur aty të mos ndodhej Xhabir Defi.

Ai qe një burrë ndonja dzyzetvjeçar. Dikur ki-



shte shërbyer në flotën tonë tregtare si marinar, thuhej se ishte polumbar i shkëlqyer dhe kishte bredhur me anije në të katër anët e botës.

Ne e montuam së bashku rrufepritësen. Kur më kujtohet ajo që pata bërë më ngrihen qimet e kokës përtpjetë. Unë e ndieja se, i lidhur me litar pas grykës së pjerrët të oxhakut metalik, isha zverdhur, nuk guxoja të vështroja poshtë nga ajo lartësi e lllah-tarshme ku nuk isha ngjitur kurrë. Mua bile nuk më kujtohet as se si i kryeja mekanikisht ato veprime, që më udhëzonte Xhabiri me zë të ulët. E dija se diku atje poshtë po e ndiqnin me ankth këtë montim e midis tyre ishte Flora. Lëkundjet gati të pandjeshme të oxhakut rreth vetes më dukeshin si dallgë të mëdha në hapësirë, trupi i vogël si një grimcë dhe vetëm kur zbritëm poshtë kuptova se në një farë mënyre kisha fituar shumë në sy të të tjerëve.

— Pate frikë? — më tha Xhabiri.

— Kush, unë?

— Mos gënje. Megjithatë je djalë i guximshëm.

Që nga ajo ditë unë shkoja shpesh te Xhabiri. Gjatë pushimeve ai më tregonte historira udhëtimesh, më fliste për lundrimet e gjata nëpër dete dhe unë e dëgjoja i mahnitur duke përfytyruar tallazet me shkumbë, pulëbardhat, delfinët e peshkaqenët, botën e pafundme të detit. Atëherë Xhabiri më dukej njeri i madh, i paarritshëm.

— Xhabir, përse ike nga flota, — e pyeta një herë.

— Si përse ika?

— Po ja, nuk ishe më mirë atje në flotë sesa këtu?

Xhabiri vuri buzën në gaz.

— Qenke një çikë i lehtë, — më tha, — pse, ç'kujton ti, bëjnë pallë detarët?

Nuk e prisja që Xhabiri të më quante të tillë. Ai kapi me mashë një pinjon të vogël, e futi në prushin e forxhës dhe i lëshoi ajrin. Nga forxha u ngritën xixat përpjetë, midis kokrrizave të qymyrit dolën ca gjuhëza flake.

— Ti, nuk e merr me mend, mor djalosh, se ç'do të thotë të jetosh në dete, të bredhësh në vende të huaja. Në ato vise njeriu e ndien më shumë se kudo krenarinë për vendin e vet, por s'ka gjë që të ta shuajë mallin për këto që ty të duken kaq të zakonshme.

• Çastet më interesante, më të këndshme për mua qenë ato kur në dhomën tonë të vogël qëllonte që mblidheshim të tre, Shahini, Saliu dhe Xhabiri. Djemtë dëgjonin rrëfimet e Shahinit për përleshjet me bandat e diversantëve apo ngjarje nga Lufta Partizane. Shahini nuk mburrej por Saliu, me dinakërinë e tij, gjente gjithmonë ndonjë rast për ta ngacmuar. Sido që në dukje ata kapeshin shpesh me njëri-tjetrin, ne e dinim se qenë miq të ngushtë. Në këto raste Xhabiri, si më i ri, bëhej arbitër e mua më vinte keq që ai mbante anën e Saliut. Por kjo nuk e merakoste fare Shahinin. Ne të gjithë e kuptonim se Shahini nuk gënjente, se historirat e tij ishin të vërteta dhe e kishim për mburrje që brigadierit ynë që një njeri i rrahur, që e kishte parë vdekjen me sy.

Kur ata mblidheshin në dhomë më të rrallë, unë dëshiroja të rrinin sa më shumë. Më krijohej një ndjenjë intime si ajo që të shkaktojnë kujtimet e vagëlluara të fëmijërisë, me një mister të ëmbël e nanurisë. Kur shpërndaheshim mua më pushtonte gjithmonë një trishtim i lehtë. Ata kishin shumë për

të rrëfyer për jetën e tyre, kishin diçka të veçantë që i zmadhonte në sytë e mi. Po unë, çfarë mund të rrëfeja për jetën time?

Në fëmijëri kam pasur karakter të vështirë. Babai, trenist, pjesën më të madhe të kohës e kalonte larg shtëpisë. Nëna, e dhemshur nga natyra, më përkëdhelte. Tërë ditën luanim me top, bridhnim kodrave ku ngrinim kurthe për zogj, ndërsa verës laheshim në lumë, futeshim në arën me bostan të ndonjë fshatari, gjersa ia mbathnim me të katra nga të lehurat e qenve...

Atëherë motra ime Marta, që tani studion në vitin e dytë të Fakultetit të Inxhinierisë, ishte fare e vogël, ndërsa vëllai, Fredi, që është frezator në uzinën «Dinamo» e që tani pret nga dita në ditë flutëthirrijen për të kryer shërbimin ushtarak, nuk mund të më ndiqte në çapkëllëqet e mia. E, meqë isha disi i prapë, gjë për të cilën kisha dhënë prova të sigurt, dhe meqë nëna punonte me turne, gjatë pushimeve të verës babai më merrte shpesh me vete. Ai nuk e dinte se këto qenë ditët e mia më të lumtura, kur mezi prisja të gdhihej. Dorë për dorë ne kalonim nëpër rrugët ende të përgjumura të qytetit. Babai më blinte ndonjë pite të ngrohtë me qofte. Arrinim të parët në stacionin e qetë, që shumë shpejt gjallërohej, mbushej me udhëtarë, gëlonte nga zhurmat e thirrjet poshtë e përpjetë. Kur treni nisej dhe babai drejtonte lokomotivën, mua më pëlqente të rrija në vagon, në dritaren e kabinës së faturinave, prej nga vështroja fushat e mbjella që më kalonin para syve e mbeteshin prapa porsia ca qilima me qëndishtë të blerta e kafe.

Kjo vazhdonte deri në të hyrë të Durrësit. Unë përgjoja me një përqëndrim plot tension horizontin e gjelbër të drurëve pas të cilëve befas shfaqej një fjongo e shndritshme e kaltër me një rrezatim verbues. Kjo do të thoshte se diku atje tutje shtrihej deti, i cili dalngadalë pushtonte tërë hapësirën midis qiellit dhe brigjeve të gjelbra. Pas kësaj vinte çasti më triumfal: në kuadratin e dritares fiksoheshin krahët e gjatë të vinçave, si krahët e ca shpendëve të llahtarshëm që zhvendoseshin e rrotulloheshin me lëvizje të shpejta mbi hambarët e vaporëve. Zhurma e tyre përzihet me zhaurimën e detit, me klithmat e pulëbardhave e zogjve të tjerë që vërvireshin sipër direkëve të anijeve të vogla të peshkimit e mbi oxhaqet e trasha të vaporëve që lëshonin tym. Më pas këto mbeteshin prapa, edhe stacioni, edhe porti, edhe vaporët, edhe vinçat e mëdhenj me njerëzit. Deti fshihej pas kodrës si të përpihej papritur, treni futej përsëri midis fushave të gjera dhe mua dalngadalë fillonte të më binte interesi. Atëherë ia vija veshin zhurmës monotone të rrotave mbi shinat e hekurta. Dalngadalë kjo zhurmë më nanuriste, për pak më zinte gjumi. Por unë nuk doja të flija, sepse të gjithë faturinat do të më tallnin. Prandaj bridhja nëpër vagona, shpesh gjeja ndonjë djallë, me të cilin ia filloja muhabetit. Por ndodhte që më tërhiqnin bisedat e ndryshme të udhëtarëve, ku shihja lloj-lloj fytyrash e dëgjoja lloj-lloj historirash. Bota hapej para meje e madhe, e madhe, e lëvizte pa pushim me një trok të hekurit, si troku i lokomotivës mbi shina.

Shumë shpejt vura re se Flora kërkonte të ushtronte një lloj ndikimi mbi mua. Në fillim më vinte për të qeshur. Këtë mundohej ta bënte pa rënë në sy, në mënyrë të natyrshme, gjersa dashur pa dashur më detyroi të regjistrohesha në shkollën pa shkëputje nga puna. Por, kur unë kërkjoja të kaloja atë cakun e një miqësie të thjeshtë, Flora hutohej, mbyllej në vetvete e për disa ditë me radhë nuk më fliste me gojë. Atëherë edhe unë nuk i flisja. Për të më shqetësuar, ajo bënte shoqëri me Todin, një shofer që sillte gurë për ne nga gurorja e Qafë-Priskës.

— Ti je i vrazhdë, — më tha një ditë Flora.

— Unë i vrazhdë? Çudi!

— Po, po, ashtu! Bile je edhe një njeri pa perspektivë.

Këtë herë u zemërova. Në fakt rrallë më kishte qëlluar të mendoja seriozisht për jetën. Isha endur për disa vjet në dy-tri ndërmarrje, pa u ngulur dot në një vend. Kështu që mbeta, si të thuash, pa zanat. Por kjo nuk më shqetësonte shumë. Kudo mund të gjeja sa të duash punë që u përshtateshin krahëve të mi.

— E, kështu jam unë, — thashë me mospërfillje, ndonëse fjalët e saj më mbetën gozhdë.

U dëgjua uturima e makinës së Todit, që ndaloi pranë grykës së frontojës. Shahini, me zërin si bubullimë, ngriti në këmbë djemtë që prisnin makinën mbi pirqjet e mëdha të gurëve. Elevatorët u vunë në lëvizje, çekiçët e mulinellës kërcëllinë me gjëmim. Flora u fut në dhomë e pas saj vajti Todi. Djemtë s'e vunë re, sepse filluan të shkarkonin makinën.

As Shahini. Po t'ia tregoja, Shahini do të nxehej, do të shkonte në dhomë, ndërsa ajo do të vinte të shkarkonte makinën së bashku me ne. «Budallaqe, thashë me vete, kujton se do të bëhem karagjoz».

Kur mbaruam punë, djemtë u futën në dhomë. Unë nuk desha të shkoja. Por m'u duk vetja qesharak. Përse? U futa pas tyre si kapadai.

Todi, një djalë moshatar me mua, kishte hapur në stol një copë letër ambalazhi, ku vura re mbeturina mollësh, që ata i kishin ngrënë së bashku.

— Shiko, shiko, — tha Shahini i habitur, — ia paskeni shtruar ju këtu.

Ngrysi vetullat e trasha dhe fërkoi xhungën në majë të hundës.

— Moj, po ty s'të pashë në makinë, — tha pas pak.

Flora heshti. Todi u mundua të vinte buzën në gaz.

— Hë mo, po ti, ç'më hap dhëmbët? Tuaf!

Flora doli jashtë pa ma varur, ndërsa Todi lëshoi një vërshëllimë të gjatë, e para se të largohej më vështroi me mospërfillje.

— Hë, mor Bushi, — tha Shahini i mërziur, — shikon ç'bëhet? Ajo shejtane ma ka marrë anën, e di që jam i butë. Po pse, o burrë i dheut, vetëm unë duhet t'i them asaj të punojë?

— Po ajo punon, xha Shahin, — thashë unë, — s'është dembele.

Shahini tundi supet i habitur. Florën ai do ta duronte më pak se çdo njeri tjetër, sikur të mos qe mbesa e Saliut.

— E di ç'ke ti? — tha pas pak, — hidhu një vrap gjer nga zyrat. Se ç'ka ai shefi i planit.

— Shefi i planit?! .

— Po, dora vetë.

— Ç'ne shefi i planit me mua?

— Bëj si të thonë, o Bushi, aman. . .

Shefi i planit qe një burrë me trup të gjatë, me një fytyrë të ëmbël. Unë takohesha mjaft rrallë me të, sepse puna s'më lidhte fare. Herë pas here ai kalonte nëpër të gjitha nyjet e fabrikës dhe më kishte rënë në sy kujdesi i tij i veçantë për t'u ruajtur nga pluhurat. Por te ne kjo qe diçka e pamundur, prandaj në këto lloj inspektimesh atë e shoqëronte vazhdimisht një ndjenjë bezdie. Ai raste gjer te veshët një skufje të bardhë nga ato që përdorin te ne punëtorët e mullinjve të çimentos apo të gurit, kalonte shpejt e shpejt për të verifikuar gjendjen, por pjesën më të madhe të kohës mbyllej në zyrën e tij, ku do ta gjeje kurdoherë mbi letrat e bardha apo me kalkulatrice në dorë. Thoshin se qe njeri shpirtmirë e i butë. Megjithatë ne druheshim para tij po aq, sa druhej ai para nesh.

— Urdhëroni, — thashë tek mbyllja derën pas vetes, — më keni kërkuar?

Ai ngriti sytë e buzëqeshi lehtë. Për herë të parë po bisëdoja vetëm për vetëm me shefin e planit dhe s'kisha si të mos e ndieja veten disi të turbulluar.

— Ti je Bushi? — më pyeti.

— Po, — iu përgjigja.

— Kam një porosi nga drejtori për ty, — vazhdoi ai. — Në fakt, duhej të ta kisha thënë para tri ditësh, kur drejtori ma la këtë porosi tek nisej me

shërbim për në Shkodër... Megjithatë s'prish punë...

— Urdhëroni, — thashë unë përsëri, më tepër i nxitur nga kureshtja që për mua paskej lënë porosi vetë drejtori.

— Jo, — foli ai, — s'është ndonjë gjë e madhe. Çështja varet prej teje, nëse do të jesh i gatshëm.

— Me gjithë qejf, — nxitova të thosha pa u menduar fare.

— Mirë pra, çështja është kështu: në kavon e argjilës tani ne kemi nevojë. Drejtori ka mendimin të shkosh ti atje... Dale, mos u nxito. Ne kemi përshtypjet më të mira për ty si punëtor...

Ai vazhdoi të fliste duke rrotulluar nëpër gishtërinj një stilograf. Unë ndjeva të skuqesha, më doli para syve kavoja e argjilës, rrzëzë një kodre disa kilometra jashtë qytetit. Atje ishte larg, mjaft larg dhe veç kësaj... Në këtë mënyrë unë mund të vija fare rrallë në fabrikë, pothuajse s'do të kisha lidhje me fabrikën, bile edhe rrogën s'do të vija ta merrja këtu, por do të ma sillnin atje... Kjo që rrethana më e rëndësishme, që më vuri para një dileme të madhe. Unë do të largohesha nga të gjithë, nga Shahini, nga Xhabiri, nga ëndrra për të punuar me mekanikët, edhe nga Flora... Por kjo që diçka e pamundur, unë s'mund ta bëja një gjë të tillë, unë s'mund të pranoja...

Shefi i planit vuri buzën në gaz e me një zë të butë më tha:

— Sidoqoftë mos u trondit. Asnjëri nuk të detyron për këtë. Gjithçka është në dorën tënde.

Toni i tij i shkujdesur shkakttoi tek unë efektin e kundërt. Sikur ai të kishte ngulur këmbë dhe ca, me siguri që do të kisha pranuar. Por... Ai qeshi



lehtë, duke më thënë vetëm se drejtorit mbase do t'i vinte keq për këtë. Unë isha i lirë të vendosja ç'të doja. Dhe unë e vendosa aty për aty...

Dola jashtë pa thënë as po, as jo. Dëgjova zërin e tij që më thirri nga pas, por nuk ndalova. Vajta i hutuar në buzë të lumit, zura të hidhja me inat në rrjedhën e shkumbëzuar gurë zalli dhe më erdhi të ulërija nga marazi. Kisha treguar një dobësi të madhe, të cilën e kuptoja, e ndieja, por s'kisha forca për ta kapërcyer.

#### IV.

Po atë ditë ndodhi diçka që më shqetësoi. Kur lashë punën as që më shkoi ndër mend të shtrihesha në pyllin me shelgje. I hipa autobusit, zbrita në qendër, piva një gotë birrë e, para se të kthehesha në shtëpi, u enda një copë herë nëpër vitrinat e dyqaneve. U enda kot së koti, pa ndonjë qëllim. Njerëzit lëviznin në të dyja anët e trotuareve. Disa nxitonin, të tjerë ecnin me nge. Më kishte pushtuar një lloj përbuzjeje për veten. Të gjithë këta njerëz diku shkonin, nxitoheshin për diçka të filluar e të paçuar deri në fund, shqetësoheshin, diçka do të bënin të nesërmen, mbase interesante e të panjohur. Ndërsa unë dija vetëm të hidhja gurë në grykën e frontojës.

Tek endesha si i përhumbur, dikush u përplas pas meje. Ktheva kokën i mërëzitur. Atëherë vura re diçka të çuditshme. Një djalë kishte zënë nga dora një vajzë dhe s'po e lëshonte. Djali ishte i gjatë, me ca kaçurrela që i binin mbi ballë. Vajza, e trembur,

përpiqej të shkëputej prej tij. Ajo vështronte për-  
rreth e turpëruar, si të kërkonte ndihmë.

— Ju lutem, lërmëni, — tha vajza. Ajo u ngul  
në një vend e mua më erdhi keq për të. Djali i pa-  
njohur seç i tha me zë të ulët. Vajza qe gati t'ia shkrep-  
pte të qarit. Një burrë me kapelë kashte kaloi aty  
pranë, e vuri re ç'po ndodhte e iu hakërrua djalit:

— Ç'ke me të, more? Nuk të vjen turp se je go-  
xha burrë?

Tjetri nuk u përgjigj.

— Ty; or, të them, — thirri burri që e zuri dja-  
lin nga dora, por ky i dha një të shtyrë e për pak e  
rrëzoi përtokë.

— Maskara, — tha burri, të cilit i ra kapela.

— Ik, or, mbushu, — shfryu tjetri.

Mua nuk m'u durua.

— E teprove, — i thashë atij.

Pa e lëshuar vajzën, që rrinte e shushatur, ai  
më vështroi nga këmbët te koka e më tha me zë an-  
tipatik:

— E di ç'ke ti? Rrugën e kë të hapur.

Iu afrova e ia shkëputa dorën e vajzës me for-  
cë, aq sa ajo klithi nga dhimbja. Befas ndjeva një  
të goditur në nofull. M'u errën sytë. Mbaj mend se  
munda t'i shmangesha goditjes së dytë. Në çast m'u  
tendosën të tërë muskujt e trupit. Harrova ku ndo-  
dhësja, në tru m'u fiksua vetëm ajo fytyrë e ngër-  
dheshur, ku lëshova me tërbim, pa gabuar, grush-  
tet e mia. Tjetri nuk më përballoi dot. Vuri duart në  
fytyrë që të mbrohej, por unë vazhdova ta godisja,  
gjersa ndjeva se më mbërthyen ca krahë të fuqi-  
shëm.

Rreth nesh u grumbullua një turmë e madhe

njerëzish. Ai po pështynte pranë një qytetari, i cili e kishte zënë mirë e seç bisedonte me burrin me kapelë kashte. Vajza, e zbehtë rrinte mënjanë... Unë rregullova bluzën. Një polic trupmadh na tha se duhej të venim në rajon.

Eca kokukur nëpër rrugën plot me njerëz, që m'u duk rruga më e mundimshme dhe më e gjatë në jetën time. Nuk vija re asgjë, as kalimtarët, as makinat e shpejta që kalonin njëra pas tjetrës, as burrin me kapelë kashte që më rrinte në krah. Vështroja poshtë në këmbët e mia trotuarin, pastaj asfaltin, pastaj përsëri vijat katrore të pllakave të trotuarit. Në rajon mezi arrita të shpjegohesha dhe u lashë i lirë me ndërhyrjen energjike të burrit e të vajzës.

Në shtëpi u ktheva vonë, aq vonë, sa të gjithë i gjeta në gjumë. Këtë e bëra qëllimisht që të mos takoja njeri. Rashë pa ngrënë, me gjithë rroba mbi minderin e kuzhinës. Më dhimbte koka. Nëpër errësirë, diku si në një ekran imagjinar herë-herë më shfaqeshin buzëqeshja e lehtë e shefit të planit, zëri i tij i shkujdesur, pastaj ai birboja, të cilit ia bëra turinjtë përshesh. M'u duk sikur midis këtyre dy ngjarjeve kishte një lidhje të padukshme. Mbase ngaqë ndodhën njëra pas tjetrës e unë isha nën pushtetin e ngacmimit të tyre torturues. Për atë birbon isha i qetë, s'më vriste fare ndërgjegjja. Mendova se ai e meritonte e megjithatë... megjithatë... Përse më vinin punët kaq ters? Ç'do të mendonin për mua Flora, Shahini, Xhabiri? Të gjitha këto po ma brenin shpirtin në përfundim të asaj dite të ngarkuar...

## V.

Të nesërmen vajta në punë si zakonisht. Dola pas fabrikës pa rënë në sy dhe qëndrova pranë një bunkeri të madh në breg të lumit. Prapa dhomës sonë nuk lëvizte njeri. Ajri dridhej nga gjëmimi i rëndë i mullinjve të gurit. Nga oxhaku i lartë i fabrikës varej poshtë një tym i bardhë që ulej mbi çatitë, mbi degët e pemëve, gjer tutje në pyllin e shelgjeve.

Një ndjenjë e çuditshme dhe e paspjegueshme më bënte të kujtoja se të gjithë e kishin mendjen tek unë, se, me të vajtur, Shahini do të më hakërruhej, Flora kushedi se ç'do të bënte, ndërsa Saliu do të më hidhte ndonjë thumb. Por nuk ndodhi asgjë e tillë. Bile hyrja ime në dhomë nuk bëri asnjë përshtypje. Shahini, me sytë pak të buhavitur, rrinte i menduar. Flora më buzëqeshi, sikur një ditë më parë midis nesh të mos kishte ndodhur asgjë. Djemtë kishin shpëstjellë mbi gjunjë sillën e po përtypeshin.

U ula në stol pa përshëndetur. Pas pak erdhi Saliu.

— Ore pëllumba, tani e keni gjetur të hani? Ç'bëhet kështu, o Shahin Alushi?

Shahini nuk luajti nga vendi. Saliu u ul, nxori nga xhepi një qese të vogël najloni e filloi të dridhte një cigare.

— Ç'qe ajo proçkë që bënë dje ata, — tha Shahini.

Saliu nuk u ndie.

— Për nder, këta njerëz nuk janë në vete. Po si, ore, të vendosë tjetri si t'i teket? Ç'i thua kësaj

ti, Sali Molla? Se na vërtitesh këndeje e na shet dëngla. Për këto të ka vënë qeveria, ta hapje gojën dje, të më dilje krah, jo të më rrije si mumje!

Saliu nxori nga vrimat e hundëve një shtëllungë të madhe tymi, që mbushi tërë dhomën. Me buzët e përthara ai vazhdonte të përtypte copërat e letrës që i kishin mbetur në gojë.

— Lëre këtë muhabet, — tha, — kjo punë mbaroi. Mos i fut aty ku s'duhet.

— Ah, kështu thua ti, — briti Shahini dhe dhoma gjëmoi, — por ka edhe më lart se ata.

Shahini nuk e zgjati. Saliu u ngrit, me çehren e tij të zakonshme të verdhë.

— Shih mos bësh ndonjë gomarllëk, — tha tek dilte nga dera.

— Atë e di vetë, — u përgjigj Shahini.

Saliu mbeti në këmbë me sy të shqyer.

— Dëgjo, s'bën kështu, — belbëzoi me buzët e përthara.

— Po si, o Sali, aman? Më vjen inat me ty, o burrë i dheut. Bën proçka shefi i planit e duhet t'i paguajë fabrika. E pse planifikon ai me rezervë? S'i pëlqejnë propozimet tona? Jo, or, jo. Do të shkoj ku të jetë e mundur më lart po s'e zgjidhët ju. Na i ka hapur dyert Partia, të gjitha.

— Dale, bre, dale, — tha Saliu me një shqetësim që nuk mundi ta fshihte dhe që të dy dolën jashtë.

Flora ngriti supet. Unë heshta e në një farë mënyre kërkova të shpaguaja qëndrimin e djeshëm. Më mundonte kujtimi i vagëlluar i asaj që më kishte ndodhur. Doja t'ia thosha dikujt. I hetova me radhë shokët, por s'ma mbushi mendjen asnjëri. As

Flora. Dhe nuk e di përse ndjeva nevojë t'ia rrëfeja Shahinit. Ndjeva një dëshirë të marrë të më qortonte, të derdhte mbi mua atë inatin e tmerrshëm që i hipte. Mbase ishte i vetmi person të cilit do t'ia pranaja pa asnjë kundërshtim çfarëdo që të më thoshte.

Pastaj erdhën makinat. Nofullat e çelikta të frontojës filluan të bluanin me grykësi shkëmbinjtë. Iu solla rrotull brigadierit, por ai ishte i zemëruar.

Së fundi e mblodha. Si shkarkuam makinat, të gjithë ia mbathën me vrap për nga çesma. Shahini u fut në dhomë. Unë e ndoqa nga pas, me zemrën që më rrihte fort. Por, sakohë që haja veten në dilemë, para deriçkës së drunjtë qëndroi një djalë me kokën të qethur. Ai vështroi përreth, pastaj u fut brenda duke lënë derën nga prapa gjysmë të hapur. Unë u afrova.

— Hë, erdhe? — dëgjova zërin e Shahinit.

Tjetri nuk u përgjigj.

— A mbarove punë?

— Më bënë një propozim, — tha djali.

— A, pra s'ke filluar akoma.

— Jo, akoma, sepse më bënë një propozim.

— Çfarë? — tha Shahini.

Djali nuk foli.

— Më propozuan të vete në minierë, — tha pas pak.

Përsëri u bë heshtje.

— Po ti, çfarë u the? — pyeti Shahini?

— Nuk pranova. Unë kam zanatin tim.

Një copë herë asnjëri prej tyre nuk u ndie.

— Si, ore, kështu? Domethënë s'paske pranuar,  
— tha Shahini me zë të mbytur,

— Ta merr mendja, — foli djali me gjallëri.  
— Ata më bënë edhe një lloj agjitacioni, që, si djallë komunisti që jam, duhet të jap shembullin i pari për të vajtur në minierën e re. Mirëpo përse të vete unë, kur kam zanat shumë të mirë. Pastaj, a nuk është rregull, kur njeriu kthehet nga ushtria, vendi që ka pasur i ruhet? Pse të mos veprohet edhe me mua kështu?

Shahini po e dëgjonte pa e ndërprerë dhe unë u mundova të përfytyroja pamjen e tij në ato çaste.

— Pra, paske kërkuar të drejtën tënde.

— Pse, çfarë të bëja?

— Po si, mor kopuk, ç'të bëje, — shpërtheu Shahini ngadalë, fare ngadalë, me një dhimbje të thellë, si të donte të mos e dëgjonte njeri, — a nuk e merr vesh se ç'ke bërë?

— Baba!

— Ç'baba, more? Po të kanë zgjedhur për burrë të mirë, mor tuaf!

— Pse të vete unë, xhanëm, unë jam elektrikist, — tha djali, që e humbi torruan.

— Po kush të vejë, bre? Gjermani do të punojë në minierat tona? Tuaf!..

Unë u largova me jehonën e dridhshme të zërave të tyre në vesh. Vetja m'u duk i vogël, shumë i vogël në atë shqetësimin tim banal. Ç'do të bënte për mua më tepër Shahin Alushi, ai burrë babaxhan, që nuk fliste kurrë për hallet e veta?!

Dielli që ngritur mbi oxhakun e fabrikës. Herë-herë ai humbiste pas tymit të dendur, mbi sheshin me pluhur binte hija, që befas trembej sapo frynte ndonjë puhizë e lehtë që davariste tymin. Djemtë

u kthyen nga çezma me kokë të lagura. Flora më derdhi nga prapa në zverk një kavanoz me ujë.

— Budallaqe, — i thashë.

Ajo qeshi me të madhe. Atë çast pranë nesh kaloi Xhabiri, duke tërhequr një karrocë të sajuar me ca rrota të trasha prej gome. Vendi që i mbushur me guriçka, copa dërrasash e tullash, të cilat mbeteshin nën rrota e ai mezi e tërhiqte.

— Shtyje pak, — më tha.

Unë i vura shpatullat karrocës, i kënaqur që po ndahesha nga Flora pa u grindur. Para derës së oficinës Xhabiri ndaloi.

— S'paskeni makina? — më tha.

— Tani i shkarkuam, — thashë unë.

Xhabiri fshiu duart me një copë leckë. Papritur më pyeti:

— More, ku të punon babai?

— Është trenist, — iu përgjigja.

Ai flaku leckën tutje e, duke u futur në oficinë, shtoi:

— Kisha ndër mend të propozoja diçka për ty, e di? Po më qenke një çikë shejtan ti. Të njihja për djalë të mirë.

— Pse? — thashë unë duke u skuqur.

— Jo, jo. S'them se je djalë i keq. Por, sidoqoftë, të dija për më të mirë.

Unë s'e mora vesh kurrë se çfarë propozimi kishte bërë Xhabiri. Tani, që kanë kaluar disa vjet, vetëm arrij të marr me mend diçka. Ai ishte komunist dhe... Por sigurisht, atëherë unë isha shumë larg atij përfytyrimi që kishte krijuar Xhabiri për mua. Në fakt atë ditë unë u turbullova më tepër



nga lidhja që bëja në kokën time midis fjalëve të Xhabirit dhe asaj që më brente shpirtin.

— Na, — tha ai i merakosur, — nuk t'i thashë këto fjalë të të zemëroja. Ti je punëtor i mirë, këtë unë e di. Por mund të bëhesh edhe më i mirë, si të thuash, të bëhesh më i vlefshëm për shoqërinë.

Këto ishin një lëvdatë e madhe për mua. Sado ta kisha shtrydhur trurin, s'do të kisha arritur të formuloja diçka të tillë. Por e vërteta s'ishte kështu, unë po tregohesha i pasinqertë, i pandershëm ndaj atij njeriu të cilin e adhuroja.

— Jo, — thashë i mërzitur. — Ti ke të drejtë. Unë kam shumë të meta.

— Oh, sa për të meta, nuk themi se s'kemi, — tha Xhabiri. Ai hapi dollapin e tij e nxori prej andej një copë letër të bardhë, të palosur. E shtriu me kujdes mbi një bankë.

— E merr vesh se çfarë është kjo? — më pyeti.

Unë zgjata kokën. E tërë faqja e letrës që mbushur plot me vija të zeza. Ishte diçka si projekt.

— Nuk e kuptoj, — thashë.

— Ky është projekti i thithësit të pluhurave. Ti e ke vënë re se fabrika jonë ka shumë pluhura.

— Po.

— E pra, me anë të këtij mekanizmi, që po e prodhojmë këtu, një pjesë e madhe e pluhurave do të thithen, do të nxirren jashtë, kështu që ajri do të jetë më i pastër, ne do të punojmë më lehtë dhe më mirë.

Unë rrija si guak, duke vështruar mbi letrën e bardhë. Xhabiri zuri të më shpjegonte pjesët e atij mekanizmi. Ai fliste me një zë të shtruar, sytë i ki-

shte të thellë, me një shkëlqim të butë e të kthjellët.

— Fjala vjen, tani ti punon te frontoja, — vazhdoi Xhabiri, — unë e di për shembull se ti atë punë e bën mirë, kam dëgjuar se je i vetmi që mund të bësh dy norma. Ama, ajo është një punë tepër e vështirë.

Unë tunda kokën. Kjo ishte e vërtetë.

— Përse të mos e mekanizojmë atë proces? Këtë fabrikë ne e kemi ngritur me forcat tona, besoj e ke dëgjuar, e ngritëm për të thyer bllokadën, për të shuar urinë që kishte për çimento vendi ynë. Po tani? Tani ne kemi disa fabrika të mëdha e moderne. Prandaj edhe këtë duhet ta modernizojmë.

Në oficinë ndodheshim vetëm ne të dy. Herë të tjera, kur më fliste për detin, për zhytjet me polumbar e botën e nënujshme, unë nuk ngopesha së dëgjuari. Ndërsa tani po rrija si në gjemba. Më dukej vetja tamam si ai polumbari që më pat treguar dikur Xhabiri, të cilit i qe bllokuar tubi i ajrit...

Tërë atë ditë e kalova me një ndjenjë të rëndë në shpirt. Nga fundi Flora më kujtoi se në orën dy duhej të shkonim në shkollë.

## VI

I ishim afruar stacionit të autobusit. Përreth fëshferinim gjethet e pemëve në kopshtet e mëdha të fermës. Qe një pasdite e bukur, qielli ishte i kaltër e vetëm tek-tuk motonin ca re të holla.

— Nuk e di, — mermëriti Flora, — nganjëherë, të them të drejtën, më dukesh një njeri, si të them... sa e qortoj veten rëndë që...

— Oh, — thashë unë i fyer, — nuk të mban njeri me zor.

— Ja, — tha ajo me rrëmbim, — përsëri po flet tamam si... E di që ke filluar të më trembësh? Për kokën e nënës! Si flet kështu?

— Po ti a i kontrollon fjalët? — i thashë dhe vendosa përfundimisht të mos i tregoja asgjë nga ato që më kishin ndodhur.

Pranë nesh kaloi me uturimë autobusi urban. Vende bosh kishte sa të doje, sepse në atë orë udhëtonin pak njerëz për në qytet. Por unë qëndrova në këmbë dhe Flora më zuri dorën. Atëherë ndjeva frymëmarrjen e saj, gudulisjen e lehtë të flokëve që më fshikën faqen. Autobusi çau në rrugën e ngushtë midis kopshteve. Zogjtë e pemëve u trembën e fluturuan lart, një qen na ndoqi për një farë kohe nga pas duke lehur, gjersa u futëm në rrugën kryesore, duke lënë prapa me shpejtësi arat e mbjella të periferisë, fushën e aviacionit, plepat e lartë anës rrugës e pastaj pallatet, ku njerëzit mbanin saksit me lule nëpër dritare.

Në fakt ne nuk ishim marrë vesh se ku do të shkonim. Këmbët na çuan vetvetiu në qendër dhe ndenjëm pak në sheshin «Skënderbej», ku banda e qytetit po luante ca marshe të gëzuara. Një copë herë u kënaqëm me lëvizjet e dirigjentit, një burrë trashalug që drejtonte me fodullëk, por befas merрте ca poza të çuditshme, si të ngërdheshej. Mua më lindi mendimi t'ia mbathnim nga kodra, të pinim nga një birrë në klubin pranë liqenit e të shikonim kafshët e parkut zoologjik. Pastaj mund të shëtisnim në pyll, në rrugicat e bukura që futeshin midis akaceve, busheve dhe qiparisave, të bënim një rrotu-

• Ilim të plotë e të dilnim në anën tjetër, te Qyteti i Studentëve. Por Flora e kundërshtoi me vendosmëri këtë mendim. Ajo dëshironte të shkonim në kinema, gjë të cilën e hodha poshtë unë, meqë i kisha parë të gjithë filmat e ditës. Së fundi vendosëm të futeshim në Pallatin e Kulturës. Unë piva fërneta, ndërsa Flora mori akullore.

Tek zbritnim shkallët e mermerta të pallatit, ajo ndaloi. Nuk kisha vënë re se tashmë ndodhesha ballë për ballë me një djalë, sytë dhe tërë fizionomia e të cilit më kujtuan tiparet e njohura të Saliut.

— Oh, — thirri Flora, — po ti, nga mbive këtu?

Djali vuri buzën në gaz.

— Ju pashë nga biblioteka tek zbritnit shkallët.

— Njihuni, — tha Flora, — vëllai im.

Thashë emrin. Tjetri më dha dorën e u skuq. Ishte një djalë i turpshëm.

— E ç'bëje në bibliotekë? — e pyeti Flora, e cila, me sa dukej, s'ndjeu asnjë lloj druajtjeje që takohej me të vëllanë në praninë time.

— Kemi një konkurs në ndërmarrje, — u përgjigj ai duke u skuqur edhe më tepër. — Mua më caktuan shokët në grupin e konkurimit të repartit. Pas një jave kemi takimin e parë me repartin instrumental.

— Bravo, — tha Flora. — A nuk është interesante? — m'u drejtua mua me gjallëri.

Unë tunda kokën.

— Po të duash eja më prit, — i tha ai së motrës, — pastaj kthehemi bashkë në shtëpi. Si thua?

Flora më vështroi me keqardhje, me një ironi të lehtë, të cilën e ndjeva kur më tha si të shfajësohej «natën e mirë» e humbi pas të vëllait në dyert me grila plastmasi të gjelbër.

Unë mbeta si skërfyell në shkallët e bardha prej mermeri. «Në bibliotekë», thashë me vete dhe u ktheva drejt e në shtëpi.

## VII.

Kur u futa në dhomë ishte ngrysur. Atëherë ka qenë fund prilli, por në mbrëmje netët ftoheshin jashtëzakonisht. Megjithatë nëna nuk bindej ta ndizte sobën. Mendonte se është e panatyrshme dhe e pazakontë të ndizen sobat në prag të majit. Unë kisha filluar të mbaja një veshje gjysëmverore, ndërsa Fredi, vëllai im i vogël, në mëngjesin e asaj dite kishte veshur një pulovër të trashë ngjyrë portokalli. Ai dukej shumë qesharak me atë pulovër dhe unë me siguri do të bëja qyfyre. Por nuk isha në qejf. Provoja diçka zvaranike në shpirt, që më mundonte e më topiste.

Babai ishte në kuzhinë. Ai sapo kishte ardhur dhe po lexonte gazetën. Nëna lante pjatat. Fredi rrinte në këmbë me duar në xhepa, duke dëgjuar muzikë në radio.

— Mbylle atë radio, — tha babai dhe unë kuptova se me dikë që zemëruar.

Fredi bëri sikur nuk e dëgjoi. Unë rrija në tryezë përballë tij, pa folur. Vetëm pllaquritja e ujit mbi enët luante me muzikën e Fredit.

— Ore, merr vesh ti? — tha babai.

Fredi mërmëriti nëpër dhëmbë dhe mbylli radion. Tani dëgjohej vetëm pllaquritja e ujit të ftohtë.

— Pse nuk vete të flesh, — i tha babai Fredit.

— S'më flihet, — u përgjigj ai.  
— Hajt, — tha babai, — nesër do të zgjohesh herët.

Fredi u bind. Unë i hodha një vështrim orës, të cilën nëna e mbante mbi dollapin e ushqimeve. Po shkonte nëntë përmes tiktakeve të thata. Nëna mbaroi pjatat dhe fshiu duart. Pastaj mori në dollap një shishe me raki dhe e vuri në tryezë. Më të rrallë babai pinte ndonjë gotë.

— Do edhe ti një? — më pyeti.

Unë pranova. Nëna u ul me ne, por nuk deshi të hidhte asnjë gllënjë. M'u duk sikur bëra një zbulim. Vura re për herë të parë në jetën time se nëna dhe babai ishin tipa të kundërt. Bile tepër i habitur për këtë zbulim e, nga një dëshirë e pazakonshme për të filozofuar, m'u duk e çuditshme se si ishin marrë vesh aq mirë me njëri-tjetrin për një jetë të tërë. Unë s'i kisha parë kurrë të grindeshin. Vërtet. Nëna është e butë. Ajo tërë jetën ka punuar dhe vazhdon të punojë në NLRG. Nëna ka qenë e bukur, vajzë shumë e bukur. Këtë e kam parë në fotografitë e pakta të rinisë së saj. Ndërsa babai është një tip i vrazhdë. Ai qesh shumë rrallë. Por unë e di se ai ka një shpirt shumë të dhemshur e një dobësi të veçantë për Martën.

— Hë pra, — tha ai, si piu gotën e dytë, — ç'dre-qin ndodh në këtë shtëpi? Ku e ke çupën, moj grua?

Marta, motra ime, akoma nuk qe këthyer në shtëpi, megjithëse kaloi ora nëntë.

— Të thashë një herë, — foli nëna, e bezdisur nga shqetësimi i babait, — është në mbrëmje.

— Në mbrëmje! Ç'domethënë kjo? A ka rregull shtëpia?

Nëna psherëtiu e mërzitur.

— Nuk të marr vesh, — tha pas pak, — po ta kishim vënë Martën në punë, ajo do të punonte me tri turne, si gjithë bota. Pse bën llafe kot? Edhe në turnin e tretë do ta ndiqje nga pas?

Babai heshti. Nëna kurdoherë kishte pasur një gjykim të qartë. Mbase nga gotat që hodha, paku ptuar ndjenja e trishtimit m'u davarit, gjoksi më gufoi, tiparet e babait m'u zbutën, m'u bënë të dashura si të gjitha sendet e dhomës, si mbrëmja e bukur dhe e qetë. Më hipi të ngrihesha, të derdhesha nëpër rrugë, të bridhja nëpër natë, të vështroja qie llin me yje, të përqafoja këdo që më dilte përpara, të këndoja me zë të lartë, të vërshëlleja me ngazëllim e t'i tregoja dikujt gjithçka. Por në vend të këtyre mbusha një gotë dhe e rrëkëlleva me fund. Babai u zgurdullua:

— Ç'bën ore, — më tha.

Unë buzëqesha.

— Pykë mbete.

Unë vazhdova të buzëqeshja.

— Ç'më zgërdhiesh? U bëre njëzet e dy vjeç e mbete pa zanat. Edhe Fredi ta hodhi.

— S'ka gjë, — thashë unë, — njësoj është.

Atë çast trokiti dera. Nëna u ngrit. Babai u bë i heshtur. Marta hyri në kuzhinë tërë qejf. Si pa të keq i dha babait një të puthur në ballë, më nxori mua gjuhën fshehurazi dhe u ul në karrige. Asaj i shkëlqenin sytë.

— Inxhiniere, — thashë unë duke u përpjekur të formuloja ndonjë shaka. Por zëri më mbeti në grykë. Babai mbushi gotën dhe psherëtiu në mënyrën e tij.

— Babush, ç'ke që psherëtin? — tha Marta.

Ai u ngrit rëndë-rëndë. Marta kishte një aftësi të veçantë për t'i çarmatosur të tjerët. Babai iu afrua e i shkoi dorën në flokët e verdhë. M'u duk si një maunë e madhe, e rrahur nga erërat.

— Unë po iki, — tha, — ju po të doni rrini akoma.

Marta më shkeli syrin. Unë e kërcënova me gisht.

— Ai është zemëruar me ty, — i thashë.

— Vërtet?

Ajo u ngrit e hapi dritaren. Në dhomë u fut ajri i ftohtë i natës. Marta ishte e gjallë, e zgjuar. Tërë qenia e saj, fytyra, buzët, trupi i hedhur, komunikonin diçka të freskët. E pata zili. Ajo dinte shumë gjëra, ajo merrte vesh nga bota, lexonte libra, shumë libra. Kur futesha në dhomën e saj më zinte frika nga librat e trashë, shpesh të pakuptueshëm për mua që në kopertinë, sepse ishin në gjuhë të huaj.

— Ti je me perspektivë, Marta, — i thashë.

Ajo hapi sytë e më vështroi e habitur.

— Bushi, ç'thua kështu?

— Vërtet, ndërsa unë jam njeri i trashë.

Marta rrëmbeu shishen e rakisë dhe e mbylli në dollap.

— Nuk jam dehur, — i thashë me një ndjenjë të turbullt në kokë. — Më trego tani se si e kalove në mbrëmje.

— Bushi, ti se ç'páske sónte, — më tha ajo dhe u ul pranë meje.

— Hë pra, si e kalove?

— Po mirë. Na kishte ftuar një organizatë rinie nga uzina «Traktori».



— Me industrinë ju puqet juve, — thashë, — me ne të ndërtimit. . .

Ajo kërceu përpjetë e ia shkrepri gazit.

— Eja nesër tek unë e, po të duash, të prezantoj me të gjitha shoqet e mia.

— Gjepura!

U ngrita me vrull e vajta në dritare. Qyteti, në gjumin e parë, dremiste nën qiellin e ftohtë, plot me yje. Por unë e dija se mijëra njerëz, të rinj, gra, burra, diku nëpër periferi, ku qenë përqëndruar uzinat e mëdha, rrinin mbi torno, freza, mbi makineri të panjohura për mua, lodheshin, i këpuste gjumi, por e bënë diçka të vlefshme, diçka që kërkonte mend, mprehtësi, vullnet.

— Unë jam i paaftë, jam i dobët, — thashë me gjysëm zëri, më tepër për veten time. — Marta më dëgjo!

— Ç'janë këto marrëzira, Bushi?

Atëherë i tregova gjithçka më kishte ndodhur, sigurisht, pa e përmendur Florën. Marta u trondit.

— E shikon pra? — i thashë. — E përse mund të vlej unë?

— Ti po flet marrëzira, — më tha Marta e shashtisur. — Pa tjetër, nuk ke bërë mirë. Mund ta kishe ndihmuar ndryshe atë vajzën. Ja, zëre se isha unë në vend të saj. Po se si më duket e gjithë kjo. Fundja njeriu duhet të ketë kurajë edhe të përleshet me vagabondë të tillë kur është e nevojshme. Veç kësaj, ke bërë gabim dhe unë s'arrij të kuptoj përse ke kundërshtuar të vesh në kavon e argjilës. Kjo s'të nderon.

Marta e ndërpreu mendimin e saj për një çast.

— Po ti e ke vetë në dorë, gjithçka, — tha pas pak.

— Ti s'kupton asgjë, — ndërhyra unë i përfshirë nga një dëshirë e madhe për të folur, ndonëse nuk isha në gjendje t'i lidhja mendimet, — po më pyet mua? Ja, ka disa kohë që më mundon diçka e unë nuk e di se çfarë. Veçse një gjë e di mirë; unë ndryshoj nga ti, bile edhe nga Fredi, edhe nga babai, edhe nga nëna...

— Bushi!

— Lermë të flas. Të kujtohet ajo ditë kur jemi takuar bashkë në park? Ti ishe me shokët e fakultetit.

— Po, më kujtohet, — tha Marta. — Pedagogu i matematikës që sëmurë dhe ne kishim dy orë bosh.

— Ndërsa unë isha turni i dytë, — thashë. — Atë ditë unë po bridhja kot, siç kam bredhur shpesh. Ti iu krenove me mua shokëve të tu, ndërsa mua më vajti mendja te babai, te miqtë e mi të cilët ti nuk i njeh dhe as që i ke parë kurrë. E pra, këtyre njerëzve unë nuk e di përse nuk mund t'u dal para syve. Sikur i kam fyer e kjo më mundon. Oh, kur s'di të them tamam atë që ndiej, Marta. Dëgjon? Sa gjëra duhej të kisha bërë në jetë e nuk i kam bërë. Pse? Ja, më thuaj përse? Përse, fjala vjen, ti ndoqe shkollën ndërsa unë jo? Pra a nuk ndryshojmë ne? Ja këtë më thuaj...

— Mjaft, Bushi. Më duket se qenke bërë egoist.

— Kush, unë egoist?

— Jo në kuptimin që e merr ti. Të vjen keq që nuk ke ndjekur shkollën?

— Hiç, aspak.

— Gënjen, — tha Marta, — kjo shihet. Po kush

ta ka fajin? Sigurisht, fajin e ke vetë, sepse i ke pasur të gjitha mundësitë por s'ke dashur.

E pashë se asaj nuk do t'ia dilja dot. Unë po flisja kuturu.

— Jo, për kokën e nënës, — i thashë.

— Atëherë çfarë ke, Bushi, — më tha Marta e më përkëdheli kokën. — Jeta është kaq e bukur, kaq interesante! Veçse duhet të dish ta jetosh. Ja, shih nënën, apo babanë. A mund të thuash se u vjen turp për jetën e tyre? Kurrë. Mbase ata mund të anko-heshin për shumë gjëra, për rininë e vështirë, gjersa na rritën. Ata s'kanë pasur mundësira, ndërsa ne... Oh, Bushi, si nuk i kupton këto... Dhe si tërhiqesh para gjërash kaq të vogla!

— Ç'bëni ju atje, — u dëgjua zëri i fortë i babait nga dhoma. — Lërimi llafet për nesër! Do të zgjohe-mi herët.

Marta vuri gishtin te buzët, me hapa të lehtë doli nga kuzhina, ndërsa unë u shtriva mbi minder plot mendime të trazuara.

## VIII.

Gjumi më doli herët. Babai kishte ikur me kohë. Kuzhina mbante erë kafeje të djegur, që i qe derdhur atij në plitkë. Më dhimbte koka. U vështoi shpejt dhe përgjova në dhomën ku flinte Marta me nënën. Pastaj u largova pa zhurmë nëpër shkallët e heshtura të pallatit.

Rrugët, të pastruara, nuk qenë shkundur akoma nga plogështia. Herë-herë kërcëllinte ndonjë dritare ndërsa më tutje, tringëllima e fortë e ziles së një sa-

hati dhome u dëgjua gjer në rrugë. Agimi i ftohtë pastronte tani mushkëritë e pallateve nga ajri i ndenjur i natës. Pa kuptuar muzgu i kaltër u zhduk, dielli nxori syrin pas kreshtës së Dajtit, një tufë rrezesh llamburitëse çanë përpjetë. Trotualet u mbushën. Udhëkryqet gumëzhinë nga autobusët.

Gjithçka qe si zakonisht, një mëngjes i zhurmshëm, plot lëvizje, që të detyronin të shpejtoje. Unë ecja ngadalë, si përherë, pa u trazuar, i sigurt se gjithsesi do të arrija në kohë. Më rastiste shpesh që ta bëja me vrap dyqindmetërshin që mbetej nga stacioni i autobusit gjer në derën e ndërmarrjes, që ta gjeja të hapur. Hyja i fundit, i mbytur në djersë, me frymëmarrje të prishur, ndërsa portieri, i mësuar me mua, më thoshte:

— Ore, përse kështu ti, gjithmonë në fund?!

Vërtet. Gjithmonë në fund. Tërë jetën kështu. Njerëzit nxitonin, shpejtonin, ndërsa unë s'kisha shpejtuar kurrë. Përse nuk ecja edhe unë me ritmin e të gjithëve në këtë mëngjes të zakonshëm të qytetit tim?

Sahati mbi kullën e gurtë përballë arkitekturës klasike-moderne të pallatit të kulturës, me një kumbim të fortë sikur zgjati dorën përmbi kubënë e xhamisë e më goditi në tëmtha: «Nxito!»

Kur mbërrita në fabrikë në dhomën tonë nuk kishte ardhur njeri. U zhvesha. Mullinjtë e rëndë të çimentos gumëzhinin. Punëtorët e turnit të tretë, me fytyra pak të zbehta nga nata pa gjumë, po shkonin njëri pas tjetrit në drejtim të banjave. Lumi gurgullonte i qetë. Toka, me ftomën e natës në gji, thithte si e pangopur rrezet e diellit të mëngjesit, gjer sa të nxehej e të digjte si saç. Pas pak filluan të vi-

nin turma-turma punëtorët. Ata të turnit të tretë, si u lanë, me flokë të krehur e të gjallëruar nga dushi, me pamje të ndryshuar nga rrobat e tyre të zakonshme e të pastra, filluan të grumbulloheshin përpara oficinës. U mbledhën edhe punëtorët e turnit të parë, por këta me rroba pune.

Do të ketë ndonjë mbledhje, mendova. Në të vërtetë ne kishim një sallë të madhe mbledhjesh, por ato të mëngjesit i bënim në oficinë.

Isha ulur në një parg të madh gurësh e po ngroheshja në diell. Në daljen që komunikonte me sallën e mullinjve vura re Shahinin, Saliun dhe Xhabirin. Ata diçka bisedonin, ndërsa prapa tyre, shumë pranë, rrinte e dëgjonte Flora. Shahini ktheu kokën. Se ç'i tha, ndërsa ajo vrapoi në dhomën e zhveshjes.

Unë nuk lëviza nga vendi. Kalimthi Saliu më pa mbi pargun e gurëve, por nuk më bëri zë. Flora doli me nxitim nga dhoma e zhveshjes, u fut në oficinë, prej nga doli përsëri.

— Flora, — i thirra.

Ajo qëndroi në vend. Unë kërceva nga pargu i gurëve e u mbështeta pas nofullës së ftohtë të frontojës.

— Ty po të kërkoja, — më tha.

— Pse?

— Në fakt nuk të kërkoja unë, por më porositi Shahini.

Ajo ishte prishur në fytyrë. Uli kokën. Sytë i kishte të vrarë, me rrathë të zinj, si të kishte kaluar një natë pa gjumë. «Dreq o punë, thashë me vete, mbrëmë të gjithë e paskan kaluar pa gjumë».

— Ç'ke? — e pyeta.

— Hiç, — u përgjigj ajo, — kemi një mbledhje.

— Epo mirë.

— Shahini më tha të vesh të lajmërosh përgjegjës in e transportit.

— Mirë, vete unë, po ti çfarë ke?

Ajo kafshoi cepin e buzëve dhe goditi guriçkat pranë këmbëve me majën e këpucëve.

— Më vjen turp nga ti, — tha, — më vjen turp.

— Flora, — i thirra dhe e zura nga dora.

Ajo u tërhoq me forcë. U largua nja dy hapa, një pikë lot i rrëshqiti në cep të syrit.

— Përse mban të fshehta nga unë, — foli gati me dënësë.

— Flora, ku e ke fjalën, — belbëzova i mekur, pa ditur ç'të thosha, duke e kuptuar se qe e vetmja pyetje që s'duhej ta bëja.

Ajo heshti, fshiu sytë e drejtoi trupin.

— Mbrëmë xha Saliu qe nga ne në shtëpi. Por ti je i lig, të kam thënë. Vëllai e pyeti për ty, ndërsa xha Saliu të bëri një portret me të vërtetë interesant. Po ta kishe dëgjuar besoj se do të kënaqeshe nga historirat e tua, që përfundonin me rrahje... Ndërsa unë s'di asgjë. Ah, sa turp, çfarë tmerri! Ti je i lig, i lig...

— Flora... po unë...

Ajo u largua ndërsa unë mbeta i ngrirë pranë grykës së frontojës, që vithisej thellë në humbëtitirë. Nofullat e çeliktat dërgjeshin të mbështjella me një pluhur të bardhë guri, me një pamje paqësore, sikur s'ishin ato që bënin batërdinë me shkëmbinjtë gëlqerorë. Rrëmbeva një gur dhe e përplasa në lëfytin e lagësht të frontojës. Guri kërciti e u thye me zhurmë. «Ta marrë djalli, thashë, ajo ka të drejtë».

Vajta të kërkoja përgjegjës in e transportit. Laj-

mërova dikë. Tek kthehesha, një zëtor më kaloi pranë duke gulçuar, la prapa një re të dendur pluhuri, që më pudrosi gjer në majën e kokës.

Në oficinë mbledhja kishte filluar. Ishte qetësi. Vetëm mullinj të gjëmonin pa pushuar, por gjëmimi i tyre që aq i zakonshëm për veshin tim, sa dukej sikur nuk pipëtinte asgjë. Përmes xhamave të dritares dallova se dikush po fliste. Ishte drejtori. Pranë tij rrinte i ngrysur shefi i planit. Pastaj folën Shahini, Saliu, Xhabiri, disa punëtorë, ndërsa shefi i planit i turbulluar mbante shënime në një bllok të vogël. Ndonëse ishte akoma mëngjes dhe vapa s'kishte filluar, ai fshinte me shami djersët që i kullonin në gushë e herë-herë buzëqeshte me vete.

Mbledhja mbaroi shpejt. Punëtorët dolën turma-turma.

— E mo, se s'i bën keq kritika as shefit të planit, — tha njëri tek dilte, — le të mësohet të punojë mirë e të planifikojë drejt.

— Sikur e goditëm si rëndë, — tha një tjetër.

— S'ka gjë, asnjë e keqe s'i vjen prej kësaj.

Në derën e oficinës u duk drejtori. Shefi i planit, i mbuluar me blana të kuqërremta, bisedonte me Shahinin. Xhabiri vështronte përreth si të kërkonte dikë. Me siguri më kërkon mua, mendova. Më kulan mornica në trup. U struka akoma më tepër pas transportierëve. Nuk guxoja të dilja në shesh. Kisha jetuar aq larg shqetësimeve të shokëve të mi...

— Ore, mos e keni parë gjëkund Bushin, — thirrri Xhabiri.

— Aha, vështirë të duket sot këndeje, — tha njëri.

Zgjata kokën. Këto fjalë i kishte shqiptuar Todi.

Flora, që vinte pas tij, u zbeh. Lidhi shaminë e bardhë e u largua me vrap.

Atëherë s'di sepse m'u kujtua një ngjarje e fëmijërisë. Kam qenë në klasën e katërt apo të pestë, diçka e tillë. S'di se ç'faj kisha bërë, më duket se kisha derdhur një shishe boje në fletoren e detyrave të shokut të bankës. Mësuesja më nxori jashtë e më tha se s'do të më pranonte më në shkollë po të mos thërrisja babanë. Mirëpo kjo gjë më trembte. S'guxoja t'ia thosha babait prapësinë time. Ai do të më qortonte rëndë, e mbase s'do të më merrte kurrë me vete në lokomotivë. Kështu vazhdoi për një ditë një gjendje ankthi të vërtetë. Në shkollë nuk shkova, ndërsa në shtëpi ndenja si në gjemba. Por kjo s'mund të vazhdomte gjatë dhe unë ia thashë babait. I thashë se kisha bërë gabim. E kur njeriu e pranon gabimin, ndihet fare i lehtësuar. Një gjë e tillë po ndodhte me mua edhe në ato çaste. Jeta ime do të merrte një drejtim të ri. Për këtë isha jo vetëm i vendosur, por dhe i paduruar...



## MURE TË RRËZUARA

Ai u shtri pranë dritares, fare pranë, aq sa mund të shikonte bisqet e pemëve dhe barin që papritur e pakujtuar kishte mbirë. Pas një jave pagjumësie dhe kujë grash, atij iu duk pothuajse i befasishëm ky shpërthim i natyrës. Gjithçka i kujtonte diçka të njohur, diçka si era e plorit, e lëmishteve të kalburra, e luleve të bajames. Burri fërkoj mjekrën e parruar prej disa ditësh. Tani ai ndiente një qetësi të brendshme, të plotë, ndonëse diku thellë i fërgëllonte një trishtim i lehtë... Kur kishte vajtur në spital për herë të fundit, mjeku i kishte thënë se nëna e tij pat vdekur nga një sëmundje e rëndë. Ai e dëgjoi i hutuar dhe mendoi se nuk kishte asnjë kuptim të pyeste për hollësitat. Sikur për mjekun këto komunikime aspak të këndshme të mos përbënin veçse një detyrë të cilën i takonte ta kryente shpesh, ai mbase do të qëndronte me këtë të afërm të pa-

cientes së vdekur e do të thoshte diçka më tepër se një frazë të zakonshme ngushëllimi. Por ai u largua dhe nuk arriti të vështronte se si tjetri u mundua të fshihte një pikë loti. . .

Dikush ngjiti shkallët e drunjta të çardhakut. Burri u shkund. I porsaardhuri, një njeri i shkurtër, vuri dorën në zemër. Mërmëriti nëpër dhëmbë ca fjalë të pakuptueshme dhe u ul në qoshen tjetër të oxhakut. Një copë herë qëndruan pa folur. Gjatë kësaj kohe burri vështroi fytyrën e hequr të mysafirrit dhe u habit kur mendoi se si kishte mundësi që ai trup, dikur i ngjallur, të tretej e të bëhej si purtekë.

— Gjynah mos paça! — tha vizitori, — sot e mora vesh.

Xhemali u detyrua të ripërsëriste të njëjtën histori, që e kishte treguar kushedi sa herë. Ditët e para ai e tregonte me gjithë shpirt, prekej nga fjalët e veta dhe mallëngjehej. Por pastaj kjo gjë iu bë e mërzitshme dhe torturuese.

Vizitori mori në vatër një thëngjill të madh dhe e afroi pranë fytyrës. Xhemali vuri në sytë e tij të skuqur, që nuk të vështronin kurrë. Një hije e rëndë mërzie varej në atë fytyrë të hequr, mërzitë cilën mundahej ta fshihte, por që shfaqej gjithnjë e më tepër e zyrtë dhe e egër. Dikur ai kishte qenë hoxhë, një hoxhë që kryente shërbesat fetare në tri lagjet më të mëdha të fshatit. Ndërsa tani, me atë kasketë kadifeje të rrasur shtrembër pas kokës, mund ta merrje për çfarë të doje. . .

— S'ke ç'bën, — tha vizitori i pikëlluar. — Kështu qe shkruar. . .

Xhemali e dëgjoi në heshtje. Në të vërtetë tani

ai e kishte kaluar atë dhembje të madhe të papërmbytur të fillimit dhe donte të mendonte vetëm për gjëra të mira. Bota në sytë e tij kishte ndryshuar, ishte bërë më e dashur dhe e butë. Ishte si një lloj fisnikërimi që ndien njeriu, fisnikërim që e afron më tepër me jetën dhe njerëzit. Tani ai ishte gati të dilte arave, të bridhte pas tufës së viçave, të përkëdhelte krifat e mëzave që kullotnin luadheve.

— Më vjen keq që nuk u ndodha, — pëshpëriti përsëri mysafiri. — Njëzet e ca vjet kam qenë kudo në raste të tilla. Ti e di. Më dhemb mua, më dhemb shpirti. . . — Zëri i tij i ngjante një rënkimi të mbytur. Pastaj u ngrit. Hodhi një vështrim të hutuar nëpër dhomë e se ç'deshi të thoshte. Tek zbrisnin shkallët e drunjta, mori frymë thellë.

— Kishte qenë Nexhipi!? — tha prerë.

— Po, — iu përgjigj Xhemali i habitur. — Ti nuk ishe këtu.

Që tutje u dëgjua angullima e një qeni. Pas pak para tyre kaluan duke lehur të trembur dy qen, të cilët dikush i ndiqte me gurë.

— Lanet, — bërtiti mysafiri, — ç'ke me ta. . . Megjithatë mund të më kishe gjetur, — iu drejtua Xhemalit duke e ulur zërin.

Ai kapërceu ledhin përpara shtëpisë dhe u zhduk në korijen e gështenjave. Xhemali mbeti një copë herë në këmbë, duke vështruar andej nga humbi njeriu i shkurtër, që dikur kishte qenë hoxhë.

Një tufë mëllenja fluturuan sipër tij. Dita po thyhej. Nga korija dolën dy mushka dhe ai e mori më mend se pas tyre duhej të vinte i vëllai. Rrapi, një burrë ndonja tridhjetë e pesë vjeç, me një fytyrë të ashpër prej natyre, ku binin në sy musta-

qet e trasha dhe një e çarë e vjetër mbi ballë, vajti drejt e në katua. Lidhi mushkat, u vari hejbet e tagjisë në qafë dhe u ul në çardhakun e drunjtë. Ky ishte një zakon i vjetër. Sa herë që ktheheshin nga ara, ata do të uleshin në çardhak, ku qëndronin gjersa errej duke pirë duhan.

— Këtu ishte Lush efendia? — tha Rrapi me një mëri të hapur.

Xhemali e vështroi si i zënë në faj. Prej njëzet vjetësh, pas vdekjes së plakut, si më i madhi i djemve, Xhemali kishte në dorë frenat e shtëpisë. Por, më i vogli, Rrapi, me karakterin e tij të papërmbajtur, nuk pyeste për parësi.

— Erdhi tek unë, — tha Xhemali, — unë s'ua mbyll derën njerëzve.

Tjetri tundi dorën.

— Shtëpia është e të gjithëve, — tha i mërëzitur.

— Vërtet, por unë jam i parë. Prandaj mos tërhiq muhabet.

Rrapi heshti. Me një zë të mbytur, që sikur i dilte diku thellë, mermëriti:

— Ashtu është... na ke rritur. Të kemi pasur në vend të babait. Por ta dish, unë s'mund të bëhem shok i qenit...

Xhemalit i mbeti pështyma në grykë. Vite më parë, për këto fjalë do ta zhdepte në dru. Do t'ia bënte shpinën më të butë se barkun. Iu errën sytë dhe mezi foli:

— Pse bie në gjynah e shan njerëzit?

Rrapi hodhi krahëve xhaketën. I fyer në sedër, ngjiti shkallët e drunjtja. Pastaj, si të kujtohej për diçka, iu këthe të vëllait:

— S'e marr vesh! Ti e njeh më mirë se unë atë dallkauk.

Xhemali mbeti vetëm përpara ledhit të shtëpisë. Po binte nata. Në fshat u ndezën dritat e, bashkë me të lehurat e qenve, ai dëgjoji tingujt e një kënge të njohur. Shtëpia e tij ngrihej aty pranë, me ato mure të vjetra, e shurdhër, e mbështjellë nga nata. Prej një jave e shurdhër, fare bosh. Vetëm Rrapi, me të çarën e thellë mbi ballë, sorollatej në dhomën e burrave e herë-herë pështynte nga dritarja. Atë e pushtoi një trishtim i pakuptueshëm.

Të nesërmen kaptoi ledhin, korijen e gështenjave dhe u ngjiti nga dyqanet. Njerëzit kishin nxjerrë plehun nga plevicat. Kundërmimi i athët i plehut i çau hundën. Atëherë i hipi dëshira të mbrehte qetë, të ecte pas ugarit gjersa dielli t'i binte në kokë. Xhemali në tërë qenien e tij ndjeu ardhjen e pranverës, kundërmimin e saj dehës e plot ngasje të çuditshme.

— Ajs. . .

Ai ktheu kokën, po nuk pa njeri. E kishte marrë malli për të lëruar tokën.

Në dyqan ishte rrëmujë. Befas iu duk se nga qoshja po e vështronin me ngulm dy sy të shqetësuar.

— Merhaba.

— Merhaba, — u përgjigj ai.

Dikush në gjysmerrësirën e dyqanit i futi kra-hun dhe dolën jashtë. Zbritën tatëpjetë kodrës dhe qëndruan nën drurin e një molle.

— Ai po na bën hatanë, — tha më në fund tjetri.

Xhemali nuk e kuptoi. Vështroi fytyrën e tij të

trembur dhe nuk arriti ta merrte me mend nga se po trembej ky njeri.

— Ç'është kjo hata, o Nexhip? — e pyeti.

Nexhipi, një burrë i shëndoshë, rreth të gjashtëdhjetave, nxori kutinë e duhanit dhe filloi të dridhte një cigare.

— Dëgjomë mua ti, do të na bëjë hatanë!

Nga respekti për të, Xhemali gëlltiti me pahir një sharje.

— Rri, o Nexhip, — iu përgjigj. — S'më bën dot njeri hatanë mua.

Bashkëfolësi u mbështet pas trungut të mollës.

— Ai erdhi në shtëpinë time, — foli në mënyrë tinzare.

Xhemalit diçka i fërgëlloi, po nuk e bëri veten. Nuk i lëvizi asnjë muskul i fytyrës.

— Erdhi në shtëpinë time ai, — vazhdoi tjetri me një shqetësim të hapur, — më kërcënoi.

— Kush pra? — e humbi durimin Xhemali.

— Lushi, — tha me rrëmbim Nexhipi, — më kërkoi paratë.

Xhemali buzëqeshi hidhur. Për këtë nuk do t'i kishte vajtur mendja kurrë. Nxori biçakun nga brezi dhe filloi të mprhihte një purtekë. Ashklat kërcënin me nervozizëm dhe herë-herë përplaseshin në fytyrën e rrudhur të Nexhipit kokëthinjur, që qëndronte si i shastisur, i përfshirë nga paniku.

— Po ti çfarë i the, — e pyeti Xhemali me një qetësi të akullt.

Nexhipi e vështroi i habitur.

— I thashë, s'kam para.

— Pastaj?

— Më kërcënoi. Po të mos ia jap, do të na tregojë te kryetari.

— Ah... — thirri Xhemali me një dhembje të brendshme, të çuditshme, që e bëri tjetrin të zgurdullohet i tmerruar.

— Për pejgamber, i rashë në gjunjë. Derman i thashë, se na bën hatanë!

Xhemali u ngrit. Ndjeu se nuk po mbushej dot me frymë. Këmbët mezi e mbanin. Bëri një përpjekje të dëshpëruar të thithte me gjithë shpirt ajrin e ngrohtë, që iu fut në mushkëri, i ndezi gjakun në trup, në kokë, në zemër, në të gjithë gjymtyrët e ngrira nga një tërbim i heshtur.

— Aferim të qoftë, o hoxhë Nexhipi! — belbëzoi dhe para syve i doli e çara e thellë në ballin e Rrapit.

Në mbrëmje ai mbështeti kokën në gurin e latuar të vatrës, një gur i vjetër, i skalitur nga mjeshhtër gollobordas. Njerëzit e shtëpisë ishin në punë pothuajse të gjithë.

Në anën tjetër të vatrës qëndronte Rrapi. Që nga vdekja e nënës ai ishte bërë i ngrysur. Xhemali e dinte se kjo nuk do të vazhdonte gjatë, se një ditë ata do të lëshonin qetë e do të pinin ujë në një bucelë. Ky mendim i shkaktoi një tronditje prej fajtoni. Por kjo që vetëm një shkëndijë e vakët pendimi, sepse qëndrimin kryeneç të të vëllait ai nuk mund ta përfillte. Po t'ia tregonte bisedën me Nexhipin, ishte i bindur se Rrapi do të turfullonte, do të shante si t'i vinte për mbarë e me siguri do t'i thoshte: «S'më dëgjove mua. Pse e thirre atë qen në vdekjen e nënës?»

Xhemali lëshoi një ofshamë të gjatë. Diçka ishte

krisur brenda tij, diçka e pandreqshme, që kishte të bënte me nderin, shtëpinë, kujtimin e gjyshërve. Tërë atë ditë ishte sorollatur arave, kodrave, si të kërkonte një mendim të pathënë, të fshehur diku në mendjen e njerëzve, një mendim që do t'i zbulonte të vërtetën e jetës. Kishte rendur i pushtuar nga një turbullim ndjenjash që i gërryente shpirtin, që i fliste për diçka të cilën ai nuk do të guxonte kurrë t'ia pohonte vetes, sepse kishte të bënte me një besim të lashtë, të futur në trupin e tij. Këtë besim ia mbanin muret e xhamisë së rrëzuar, ku shëtitnin zhapinjte, gurët e vjetër të varreve të gjyshërve të radhitur njëri pas tjetrit, guri i latuar i varrit të nënës. Këtë besim ia mbanin gjallë zërat stërgjyshorë që vinin nga thellësitë e kohërave e i kujtonin se ai ishte pasardhës i një oxhaku njerëzish të mirë e besimtarë. Por, ngado që shkonte, atë e turbullonin fytyra e hequr, tinzare e Lushit, trupi i ngjallur i Nexhipit, e çara e thellë në ballin e vrenjtur të Rrapit... Dhe paratë...

Me këto mendime në kokë ai nuk vuri gjumë në sy gjithë natën. Qëndroi i mbështetur pas gurit të vatrës, duke dremitur copa-copa, gjersa u gdhi, kur e ftohta i kishte hyrë në palcë. U hodhi një grusht ujë syve dhe u shtriq. Fshati i mbuluar nga vesa po zgjohej. Ai eci mbi barin e lagur si i përgjumur. Këndesat kishin pushuar së kënduari. Vetëm lart, nga stanet, dëgjoheshin ca tingëllima të shurdhura këmborësh.

Papritur u ndodh ballë për ballë me Lushin.

— Merhaba, — tha Lushi me dorë në zemër.

— Merhaba, — iu përgjigj ai me një fije zëri



Xhemali vështroi fytyrën e tij të hequr, ku shquhej një hundë e madhe e kthyer.

— Për ku qenke nisur kaq herët? — e pyeti.

Lushi, me një lëvizje të kotë fërkoj mjekrën e hollë.

— Te ti, — iu përgjigj me butësi, — thashë me vete se duhet të mërzhitesh...

Në shkallët e çardhakut u duk Rrapi. Ai hodhi xhaketën krahëve dhe kaloi pranë tyre.

— Merhaba, — përshëndeti Lushi.

Rrapi ktheu kokën. Xhemali, për herë të parë nuk i rezistoi dot vështrimit të tij.

— Mirëmëngjes, — tha Rrapi prerë dhe u zhduk në korijen e gështenjave.

Ata mbetën vetëm. Xhemali nuk kishte dëshirë të ngjiteshin lart. Zjarri në vatër ishte shuar dhe atij tani i dukej shumë e mundimshme të merrte një kërcu të vjetër e ta ndizte nga e para. U ulën në çardhak. Xhemali nxori kutinë e duhanit dhe ia zgjati.

— Më vjen keq që nuk u ndodha ditën e varrimit, — tha ai, — tek lagte me pështymë cigaren.

Xhemali ndiqte lëvizjen e gishtërinjve të Lushit, ca gishtërinj të hollë e të gjatë, që dalloheshin menjëherë se nuk e kishin kapur kurrë dheun e tokës.

— Ishte plakë e mirë, — vazhdoi tjetri i pikëlluar, — më dhemb shpirti kur mendoj se nuk isha.

— S'ka gjë, — iu përgjigj Xhemali duke u përpjekur të përmbante një ngasje kryeneçe, — thirra hoxhë Nexhipin...

Lushi buzëqeshi me ligësi. Kafshoi tabakun dhe pështyu me neveri.

— Tobe stafurillah. . . Nexhipi është gomar.

Xhemalit iu mbështoll një lëmsh në grykë. Die-lli kishte dalë mbi mal dhe ajri ishte ngrohur.

— Mos i shaj njerëzit, hoxhë Lushi, — tha ai.

— Ç'njerëz, — thirri Lushi, që gjer atë çast kishte folur me zë të butë. — Ai është hajdut. . .

Xhemali shtrëngoi parmakun e shkallëve, sa i dhembën gishtërinjtë. Deshi të ulërinte, por çuditërisht e përmbajti veten dhe fare i qetë e pyeti:

— Po pse është hajdut, o Lush?

— Ai ka marrë paratë e mia. . .

— Në shtëpinë tënde i ka vjedhur?

Lushit i kërcyen nervat. Ai lëvizi nga vendi dhe flaku cigaren.

— Më duket i paske harruar zakonet, Xhemal, — tha ai. — Prej njëzet vjetësh kjo lagje ka qenë imja. Kush vdiste, unë e varrosja. Paratë që i ke dhënë Nexhipit më takojnë mua. S'ka të drejtë ai të fusë hundët në zonën time.

Xhemalit i doli para syve e ëma. Pranë tyre përsëri kaluan duke lehur të trembur dy qen, të cilët dikush i ndiqte me gurë.

— Lanet, — thirri Lushi, — ç'ke me ta. . .

— Dhembja e njeriut nuk blihet me para, hoxhë Lushi, — tha Xhemali.

Tjetri e vështroi i zgurdulluar.

— Çfarë?! — belbëzoi ai. — Ti mendon të mos m'i japësh ato para?

Pastaj, duke u ngritur në këmbë, me një zë kërcënues shfryu:

— Po qe kështu, unë do t'ju denoncoj. Do t'i them kryetarit se në varrim ke thirrur një hoxhë dhe i ke dhënë para.

Për Xhemalin ky qe kulmi. Zemërimi që i qe mbledhur gjatë dy ditëve shpërtheu të gjithë kufijtë dhe ai ulëriu si i tërbuar:

— Qen, bir qeni! Shko ku të duash!

Lushi mbeti si i ngrirë nga ky shpërthim i pabesueshëm.

— Mos, o Xhemal, se të vret buka që ha...

— Shporru që këtej dallkaur, në xhehenem të vesh! — thirri ai, ndërsa tjetri, i tmerruar, u largua duke sharë nëpër dhëmbë.

Xhemali thithi ajrin e mëngjesit me tërë mushkëritë.

## SESION I VËSHTIRË

Në plogështinë e vapës zilja e telefonit shqetësoi tërë apartamentin. Ai sapo kishte filluar të dremiste mbi divan. U ngrit me ngadalë dhe pa qejf mori receptorin.

— Alo, — tha duke iu hapur goja.

— Alo, — u përgjigj një zë i njohur në anën tjetër. — Maqo, ti je?

Pastaj bashkëfolësi, me gjallëri të veçantë, e detyroi t'u përgjigjej një vargu të tërë pyetjesh nga më të zakonshmet: «Si je me shëndet? Po Eftimia si është? A ke menduar për pushimet e verës? Interestant! Gjithmonë duhet të mendojnë të tjerët për ty... Ha, ha, ha...»

Maqoja, një burrë rreth të dyzetave, pedagog matematike, u përpoq të merrte me mend arsyen për të cilën i kunati në mënyrë të papritur e kërkonte në telefon pikërisht në piskun e vapës.

— More, po nuk dukesh fare, — tha tjetri, — u myke mbi libra.

— Ç'të bësh, — tha Maqoja duke kruajtur veshin. Atë çast nuk gjeti ndonjë përgjigje më të saktë.

Kunati, veteriner në një nga fermat e mëdha të kryeqytetit, nguli këmbë të takoheshin patjetër pasdite. «Kam një punë urgjente tha ai, të lutem».

Maqoja, njeri shumë serioz, por edhe mjaft i sjellshëm e i butë nga natyra, ishte i pafuqishëm t'u kundërshtonte të tjerëve. Veç kësaj atë pasdite ishte i lirë.

Katër orë më vonë ata qëndronin përballë njëri-tjetrit, me nga një kafe përpara, në një lokal afër qendrës. Kunati pinte duhan, ndërsa Maqoja përpiqej të sillte ndër mend studenten, për të cilën bënte fjalë ai.

— Interesant, si s'të kujtohet, — tha kunati. — Drita, një vajzë e gjatë, flokëverdhe...

— Ah, po, po, — u kujtua Maqoja, — në kursin e parë.

— Hë, bravo...

Pastaj kunati, duke u munduar të fshihte një emocion të brendshëm, nisi një ligjëratë të gjatë, të cilën ai e dëgjoji copa-copa. Kërkesa e tij ishte e qartë. Por, i prirur për t'i tragjedizuar gjërat, të kunnatit iu desh më tepër se gjysmë ore për t'i shpjeguar se si ajo studente duhej të kalonte patjetër, si vajza e njërit prej shefave të tij.

— Të lutem shumë, të ma bësh këtë nder, — përfundoi ai. — Është hera e parë që të kërkoj një favor, i cili për mua ka shumë rëndësi.

Për Maqon kjo kërkesë ishte krejt e papritur. Si

njeri me bindje të formuara, ai nuk mund të shpërdoronte në ato gjëra, të cilat i quante të paprekshme. I kapur në befasi, në fillim provoi një ndjenjë papastërtie në trup. E mbuluan djersët dhe këmi-sha iu ngjiti në shpinë.

— Si të thuash, — nisi të fliste pa e vështruar tjetrin në sy, — kjo është një çështje që s'varet vetëm nga unë. . .

Kunati nuk e humbi torruan. Shuajti cigaren në filxhanin e kafesë, dhe me një zë energjik e ndërpreu:

— Ama zyrtarisht po na flet tani?

— Jo, por. . .

— Lëre, lëre, çfarë por. . .!

Maqoja u skuq. Megjithatë, pas një bisede të mërzitshme, ku u përmend edhe shëndeti i fëmijëve dhe i Eftimisë, astma e vjetër e babait dhe reumatizmi i nënëmadhes, Maqoja u thye. «Fundja, studentja do të vijë e përgatitur, arsyetoi, mbase nuk është fare tapë».

Ditën e provimit vajti në fakultet më herët se zakonisht. Një tufë studentë qëndronin të mbështetur në kangjellat e hekurta, ndërsa disa të shpërndarë nëpër qoshe vazhdonin të shfletonin leksionet. Në të vërtetë edhe ai e ndiente veten të emocionuar. Ishte përpjekur të shpjegonte disa herë se si ishte e mundur që gjatë tërë sezionit të provimeve të ndiente një shqetësim të çuditshëm, që i kujtonte netët pa gjumë të viteve studenteske. Kjo e bënte të dhembshur, për pak dhe sentimental. Por ai e mblidhte veten menjëherë dhe çdo gjë kryhej normalisht; ai dëgjonte, studentët përgjigjeshin. . .

Në sallën e pedagogëve bisedohej me zë të ulët.

Maqoja vështroi fytyrat e kolegëve, ku vihej re një hije jo e zakonshme serioziteti. Përshëndeti dhe i hodhi një sy listës së provimit.

— Kjo nuk është normale, — dëgjoi njërin nga pedagogët e fizikës që po bisedonte aty pranë me shefin e katedrës, — njeriu s'di si të veprojë.

Tjetri nuk u përgjigj. Maqoja, duke u munduar të merrte me mend se çfarë mund të mos ishte normale, palosi fletët e provimit dhe u fut në auditor. Pastaj, njëri pas tjetrit, katër studentët e parë tërhoqën biletat. Në këto raste ai ishte mësuar të shihte pamje të ndryshme. Disa dridheshin nga emocioni dhe nuk ishin në gjendje të lexonin tezën. Atëherë ai u lexonte me zë të lartë, u jepte shpjegime dhe bënte ndonjë shaka të vogël. Ndonjëri, sapo hapte biletën, kërkonte të përgjigjej aty për aty. Kishte pastaj edhe nga ata që, me fytyrë të zverdhur nga studimi i sforcuar, uleshin në një qoshe të auditorit dhe për një kohë të gjatë qëndronin mbi fletët e bardha.

Dita ishte e nxehtë. Me katër të parët mbaroi punë shpejt e shpejt. Tri orë më vonë filloi t'i dhimbte koka, gjersa pranë katedrës qëndroi e heshtur dhe e druajtur studentja Drita Mersini.

Gjatë kësaj kohe Maqoja ishte përpjekur të mendonte sa më pak për të. Takimi me të kunatin po tulatej diku në një qoshe të kujtesës së tij, gati po i mbushej mendja se ishte i lirë nga çdo detyrim. Por, fytyra e prerë e vajzës, dridhja nervoze e duarve të saj, i kujtuan se në të vërtetë kishte dhënë një premtim.

Vajza shpalosi biletën dhe me një zë të mbytur tha:

— Teza katëmbëdhjetë.

Maqoja i dorëzoi tezën dhe e pyeti nëse kërkonte ndonjë sqarim. Në këtë ceremoni të shkurtër deshi të tregojë i përzemërt, por, jashtë vullnetit të tij, frazat iu ngatërruan. As vetë nuk e kuptoi nëse ajo që tha ishte inkurajuese apo një lloj qortimi...

Studentja u ul në bankën e parë, ku ndenji gati një orë me kokë të mbështetur në pëllëmbët e duarve. Ajo nuk po shkruante asgjë. Herë-herë psherëtinte thellë, shtrëngonte kokën si të donte ta shtrydhte, pastaj linte stilografin mbi bankë dhe vështronte nga dritarja.

Maqoja u ngrit nga katedra dhe vajti pranë saj. Vajza ngriti kokën. Atëherë ai pa dy sy të kthjellët, të butë.

— Unë kam studiuar, shoku pedagog, — tha ajo.

— Nuk të kujtohen? — e pyeti Maqoja.

Skena të tilla për të ishin të zakonshme. Ai mund të mos i jepte asnjë rëndësi. Por iu duk se vajza kishte një tronditje të veçantë dhe atij i erdhi keq.

— Hëm... — mërmëriti, — Teorema e Lagranzhit. Po kjo është elementare. — Pastaj i dha disa shpjegime dhe u kthye në katedër. Një orë më vonë studentja, e ulur përballë tij, filloi të përgjigjej. Maqoja e dëgjonte në heshtje tek fliste me një zë të butë, të pasigurtë. Pasi formuloi teoremën, vajza bëri një sërë gabimesh logjike. Maqoja nuk e ngacmoi, por e la të vazhdonte më tutje. Dikush nga studentët e vështroi i habitur.

— Kalo në pyetjen e dytë, — tha ai papritur.

Vajza heshti. Në auditor nuk pipëtinte njeri.



Kjo gjendje e nderë vazhdoi për disa minuta, që atij iu dukën orët më të gjata të jetës. Ai nuk mund t'i qëndronte vështrimit pyetës të studentëve. I zënë ngushtë, u pushtua nga një mërzi, shkakun e së cilës nuk mund ta kërkonte gjëkund tjetër veç te vetja e tij. Për të ishte tepër e vështirë edhe të mendonte se njeriu ka raste kur duhet t'i bëjë lëshime ndërgjegjes, asaj ç'ka më të shtrenjtë dhe të paprekshme, ndershmërisë... Krejt i hutuar zgjati dorën, mori librezën e notave, shkroi një pesë fare të vogël dhe hodhi një firmë. Ai kujtonte se në atë çast me siguri duhej të ndodhte diçka. Por çdo gjë u zhvillua në mënyrë të zakonshme. Vajza u ngrit, përshëndeti dhe doli jashtë. Studentët ulën koka: mbi fletët e bardha. Vetëm kaq...

Vonë, kur po ngrysej, ai doli nga auditori. Dërgoi shkresat në sekretari dhe, tek mbyllte pas tij derën e fakultetit, vuri re se dikush po e priste.

— Më falni, — tha vajza, — më falni, por...

— S'ka gjë, s'ka gjë, — tha Maqoja shpejt e shpejt, duke u drejtuar me hapa të mëdhenj në trotuar, — natën e mirë.

Studentja e ndoqi nga pas. I doli përpara dhe Maqoja u detyrua të qëndronte.

— Ç'doni tani, — tha ai me një mërzi që mezi e përmbajti.

Vajza heshti. Ajo rrotullonte nëpër duar me nervozizëm një stilograf.

— Hë pra, — foli ai me padurim, — shko në shtëpi, provimin e more, apo jo?

Atëherë studentja e vështroi si e zënë në faj. Një pikë e vogël loti i kishte qëndruar në cep të sy-

ve dhe diçka deshi të thoshte, por ajo fshiu me rrethim lotin dhe me një zë të mbytur psherëtiu:

— Oh, sa keq...

Pastaj u largua me vrap. Maqoja mbeti si i ngrirë në asfaltin e rrugës.

Kur u kthye në shtëpi i dhimbte koka. Gruaja s'kishte ardhur ende. Ai nuk e ndezi dritën. U zhyt në kolltukun e korridorit dhe para syve i doli fytyra e studentes. Kishte diçka të çuditshme në qëndrimin e saj, diçka si një dhimbje të pakuptueshme. Kurirë nuk i kishte qëlluar një rast i tillë. Por ç'mund të bënte më tepër?

Ndërkaq ra zilja e telefonit. Ai u ngrit dhe mori receptorin.

— Alo, — u dëgjua një zë i gëzuar në anën tjetër. — Maqoja?

— Po.

— Faleminderit, i dashur, — tha tjetri, — s'do të ta harroj kurrë.

Ndërsa kunati dërdëliste në telefon, Maqos iu shfaq përsëri fytyra e vajzës. Sa më i gëzuar që vinte zëri, aq më tepër po e pushtonte dalngadalë një zemërim i brendshëm.

— Nuk e merr me mend se çfarë nderi më ke bërë, — thoshte tjetri. — Për më tepër Elhamit. Besoj se e njeh, apo jo?

Maqoja tha se nuk e njihte.

— Oh, — thirri i kunati, — është burrë i shkëlqyer! Po e 'ka zënë halli me të bijën. Ka një vit që po i çan kokën se nuk dëshiron të vazhdojë inxhinierinë. I kishte hipur të bëhej aktore. Ke parë tjetër?

— Çfarë, çfarë? — foli Maqoja i hutuar.

— E pra, apo nuk të thashë, që asaj i ka shkru-

pur të bëhet aktore. I varfri Elham! Punë kalamajš. . .

Maqoja u pre. E gjithë kjo lojë ishte një spektakël fyes. Befas fjala fyes mori një kuptim të jashtëzakonshëm. Si një fjalë e magjishme, ajo ndriçoi diçka të turbullt, që po i mbliidhej në grykë, në trup, në tërë qenien e tij.

— Sigurisht, pas një jave ajo ka provimin e fizikës, por besoj se ti. . .

Ai nuk mundi ta duronte më tutje. Ndonëse njeri i sjellshëm, përplasi dorezën e telefonit dhe u mbështet në kolltuk i mbytur në djersë.

## «KUSHËRIRI»

Ato kishin mbetur vetëm, plaka dhe nusja. Në kushte të zakonshme dy njerëz, për më tepër dy gra, do ta ndienin veten shumë të qeta në tërë atë shtëpi, por tani zbrazësia e saj u sillte shqetësim, veçanërisht nuses, që prej disa kohësh ndiente ca si turbullime. Kjo kishte mbetur shtatzënë përpara se burri i saj, djali i madh i plakës, së bashku me të dy vëllezërit të merrnin malin e të dilnin partizanë.

Plaka mbahej e fortë. Largimi i djemve nuk e kishte penguar të vazhdonte të njomte rregullisht saksitë e luleve në hajat, trëndafilat e oborrit, lulenishtet dhe karafilat e kuq. Nusja, pjesën më të madhe të kohës e kalonte duke bërë punëdore. Ajo dinte të qëndriste bukur. Por tashmë qëndisimat s'hynin në punë. Në vend të tyre ajo thurte çorape leshi, triko apo qepte yje. Një herë në dy javë, një

njeri i veshur si fshatar, të cilin e quanin Gani, u sillte një gomar me dru. Drutë i shkarkonte në oborr, i bënte stivë dhe, kur largohej, merrte me vetë çorapet dhe trikot.

Një ditë në derën e madhe në fund të oborrit trokitën fort. Plaka rregulloi napën. Ajo ishte një trokitje e panjohur. Duke tërhequr mallanet mbi kalldrëm, arriti deri te porta. Në fillim sytë e saj ndeshën shkëlqimin e fortë të çizmeve të të panjohurit. Pastaj ajo vuri re qillotat e ngrira nga hekurri, xhakëtën e puthitur pas trupit e një kapë me strehë të gjerë. Nën strehë dalloj një fytyrë të lëmuar, nga e vështronin me qesëndi dy sy të zinj, ndërsa mbi buzë një palë mustaqe të prera sipas modës së oficerëve italianë.

Plaka mbeti e hutuar.

— Mos u shqetëso, — tha tjetri, — e di që s'më prisje.

Njeriu me uniformën e oficerit, me një lëvizje të lehtë të bërrylit, e shtyu plakën dhe u fut në oborr... Pastaj këputi tre karafila. I afroi te hunda, e, ndërsa plaka e ndiqte nga pas duke fshirë duart në futën e zezë, u shkreh në një të qeshur pa kuptim.

— Mos u zemëro, tre karafila janë!

— Këputi, — tha plaka, — kam plot.

— Oh, bukur, na sill një karrige tani.

— Ç'karrige!?

— E pra, një karrige. Sot paskam dëshirë të qëndroj këtu, t'u marr erë karafilave të tu të kuq.

Plaka e vështoi me dyshim. Në rrethana të tjera ajo do të ishte tallur ca me këtë njeri, që mundohet të imitonte në hollësiat më të vogla sjelljen

e oficerëve italianë. Por sot, në kohën kur Ganiu pas pak do të sillte gomarin me dru, ajo nuk mund të ishte e qetë. Me një kërshtëri të veçantë ajo vuri re buzët e tij të trasha, fytyrën e ngërdheshur, që fshihnte diçka tinzare.

— Ke ardhur jangëllësh, — belbëzoi plaka.

— Pse, nuk banon më këtu kushërira ime?

— Ç'kushërirë...

— Si kështu, kaq shpejt e paska harruar nusja e tët biri se halla e saj është gruaja e djalit të xhaxhait tim?

Plakës i erdhi në majë të hundës. Ajo nuk e duronte dot tek fliste në këtë mënyrë, duke i ngjallur vazhdimisht një ndjenjë pështirosjeje.

— E, a derëzi, — i tha, — ç'më mollois mua? Në je burrë, çap e merru me punë burrash.

Tjetri goditi dheun me majën e çizmes, flaku karafilat dhe fishkëlleu. Në oborr u futën dy milicë.

— Fshihuni! — tha ai. — Do të presim pak.

Milicët me armë në krah u drejtuan në dhomë, prej nga doli nusja dyllë e verdhë.

— Ç'pate që dole? — thirri plaka. — Shko nga dhoma tjetër!

E reja, e rënduar nga barra, qëndroi në këmbë pa ditur ç'të bënte. Papritur e ndjeu veten të këputur. Oficeri i vajti pranë. E vështroi nga këmbët te koka dhe me një zë të butë i tha:

— Jot vjehrrë më shau. Për nder, erdha të të bëj një vizitë.

— S'ke turp! — mermëriti gruaja.

Tjetri bëri sikur nuk e dëgjo.

— Ja, thuaj, a s'jemi kushërinj bashkë?

Plaka deshi t'i thoshte një fjalë të rëndë, por e mbajti veten.

— Ec, të keqen, çap në dhomë, — tha ajo.

Nusja u bind. Me hapa të ngadaltë u fut në dhomën e errët dhe zuri vend pranë dritares. Prej andej mund të vështronte gjithçka; fytyrën e njohur të atij njeriu që e quante kushërirë, të vjehrrën, derën e drunjtë në fund të oborrit, që së shpejti dikush do ta hapte. Atëherë milicët do të sulleshin mbi të, do ta lidhnin e do ta vinin përpara. Një vallë e nxehtë i pushtoi trupin dhe e dërrmuar mbështeti kokën pas xhamit. Sigurisht, ajo nuk mund të ishte fajtore që këtu e dhjetë vjet të shkuar, rasti e solli që halla e saj e bukur të martohej me djalin e xhaxhait të tij, një tregtar me trup të shkurtër, të cilin e njihte tërë qyteti. Iu kujtua se si ditën e martesës tregtari shkurtabiq i hallës e kishte zënë këtë njeri, që po e thërriste kushërirë, me presh në dorë, tek vidhte një varëse floriri në pajën e nuses. Pastaj e kishte zhdëpur atë keq në dru, saqë për pesë vjet nuk hynë e dolën me të vëllanë dhe dasma për pak u prish... Ajo lëvizi kanatin e dritares. Befas, në qetësinë e shurdhër oficeri nxori revolverin. Ia drejtoi plakës në gjoks dhe me hapa të ngadaltë u tërhoq drejt murit. Dera e oborrit kërciti. Ajo deshi të ulërinte por nuk mundi. Dera u hap. U duk turiri i butë i gomarit që qetë-qetë, me ngarkesën e druve u ndal në mes të oborrit. Pas tij, me qeleshe të rrasur mbi kokë, vinte Ganiu.

Gjithçka ndodhi në mënyrë të rrufeshme. I porsaardhuri u gjend midis njerëzve të armatosur, që i drejtuan grykat e armëve. Në fillim ai bëri një lëvizje instinktive prapa, zuri gomarin për kapistre,

por ky qe vetëm një çast, sepse ai e mblodhi veten, vështroi plakën i hutuar, bëri një kundërshtim të vogël dhe pyeti i habitur:

— Ore, ç'dreqin keni me mua?

— Vërinë hekurat! — urdhëroi oficeri.

Milicët i shtrënguan duart. Pas një farë përleshjeje të shkurtër ai nuk lëvizi më.

— Ç'keni me të, — tha plaka.

Oficeri vuri buzën në gaz. E zuri Ganiu nga jaka e xhaketës dhe e afroi pranë vetes.

— Ti, qelbësirë, mos u shit i padjallëzuar. Ndryshe do të t'i thyej dhëmbët.

Ganiu u përpoq të çlirohej nga shtrëngimi i tij i fortë dhe i ra qelshja te këmbët e gomarit. Një milic e goditi me shqelm dhe qelshja fluturoi tutje në rrëzë të murit.

— Ç'pate me qelshen, mor edepsëz, — shau Ganiu i tërbuar.

Ndërkaq milicët i kontrolluan të gjithë xhepat, një hejbe të vogël në vithet e gomarit, ku nuk gjetën asgjë të dyshimtë. Në fund, në xhepin e brendshëm të xhaketës, mundën të gjenin një letër. Ajo ishte për plakën dhe për nusen. Oficeri e mbajti një copë herë në dorë, ia tundi plakës para syve, por pastaj e futi në xhep.

— E pat dhe ndërlidhësi juaj, — tha ai.

Njëri milic vuri Ganiu përpara, tjetri zuri gomarin për kapistre e, ndërsa përgatitej të dilte pas tyre, oficeri u kthye papritur te dera.

— Për pak harrova. Po të doni, letrën e djemve mund të vini ta lexoni në kuesturë. I thuaj edhe kushërirës...



Dy ditë me radhë gratë nuk dolën nga shtëpia. Ditën e tretë plakën e zunë ca ethe. E reja, që nuk dinte ç'të bënte, thirri fqinjët. Si e panë, njëra prej tyre, një grua e shëndoshë, tha se plaka nuk vuante nga ethet. Në të vërtetë ajo ishte zbehur dhe i merrreshin mendtë, por, po t'i vinin disa shushunja, çdo gjë do të kalonte shumë shpejt. Si ikën gratë, plaka e thirri nusen pranë.

— Dëgjo, shpërto, mos u bëj merak. Tani do të vesh te Liçi, kallajxhiu, do t'i thuash për Ganiun. T'i thuash se me siguri na kanë spiunuar. Ai do të të japë edhe shushunja për mua. Nusia nuk tha asnjë fjalë. Në përgjithësi prej disa kohësh ajo nuk para dilte.

Dyqani i Liçit ndodhej larg, tutje pazarit, atje ku radhiteshin njëri pas tjetrit samarxhinjtë, qeleshepunuesit e lloj-lloj bakërxhinjsh. Ajo nuk po e ndiente veten mirë. Vapa e menjëhershme, që kishte rënë mbi hatullat e qytetit të vogël, ia rëndonte trupin, ia mbushte me një lloj plogështie të padurueshme, e cila përzihej me shqetësimin që i shkaktohej nga shtatzënia.

Kështu u gjend në xhadenë e vetme të qytetit, ku kaloi me rropamë një karvan makinash me ushtarë italianë. Ajo priti me zymbyle në dorë midis pluhurit dhe tymit të makinave, duke vështruar e humbur fytyrat e nxira, nën helmata, të ushtarëve të huaj. Pastaj kaloi ngadalë përpara reklamave të kinemasë, përballë hotelit «Ekselsior». Një fëmijë vrapoi në rrugën e zbrazët, ndërsa më tutje, një qen

i madh, në hyrje të hotel-restorantit, brente një kockë. Sa kohë kishte pa parë film?

U mundua të shkundte plogështinë, e, tek kalonte para hotelit, dera e tij u hap me vull. Në fillim doli një kamerier. Qeni rrëmbeu kockën midis dhëmbëve dhe zuri vend nën reklama. Pastaj u shfaq kushëriri me uniformë. Asaj iu drodh trupit. Ktheu kokën mënjanë, deshi të largohej, por oficeri me një lëvizje të shpejtë i doli përpara dhe i zuri rrugën.

— Kushëriri, për nder të kam pritur!

— Lërmë, — tha ajo, — të lutem hiqmu!

— Ah, pse kështu, — qeshi ai, — ç'është kjo frikë? Të gjithë e dinë se ne jemi tanët.

— Largohu, — thirri ajo e zemëruar.

Oficeri e zuri nga krahu. Atë çast ajo ndjeu t'i përplasej në fytyrë afshi i nxehtë i frymës së tij përzier me alkool. Asaj i erdhi për të vjellë.

— Ti më ngjall krupën, — belbëzoi gruaja, — ti... ti je një i poshtër!

— Oho, — thirri oficeri dhe ia lëshoi dorën, — shko, edhe ti një qelbësirë si yt shoq je. Ama, ta dish se kurrë s'ke për ta parë më me sy. Edhe po s'i la kockat andej gërxheve, me dorën time do ta var. Ja këtu, në këtë shtyllë telefoni.

Atë çast dera e restorantit u hap dhe prej andej doli një oficer italian i bërë tapë.

— Zenel, ç'djall bën aty me atë femër?

— Erdha, — thirri Zeneli.

— Për besë, na e le lojën përgjysmë.

— Erdha, pra, erdha!

Dhe duke iu drejtuar gruas shtoi:

— Mbaje mend, në shtyllë të telefonit do ta var...

Ai u fut me vrull në restorant, ndërsa ajo vazhdoi rrugën e zbehur. Gruaja, atë ditë nuk e gjeti Liçin në dyqan. Mbi derë ishte varur një tabelë ku thuhej se myshterinjtë mund të vinin të nesërmen. Gruaja psherëtiu e lodhur. Një copë herë qëndroi ulur mbi një gur, që ishte vendosur aty posaçërisht për këtë punë. E keqja ishte se tashmë ajo nuk mund të përqëndronte mendimet, nuk mund të largonte dot atë dyshimin e tmerrshëm që i lindi për herë të parë, se i shoqi mund të vritej. Ajo kishte parë partizanë të vrarë. Dy prej tyre i kishin shëtitur dikur nëpër qytet, por ajo s'kishte ndier frikë. Ndërsa tani diçka e çuditshme po ndodhte me të, diçka që i ngjante lodhjes, stërmundimit nga pritja e gjatë në netët plot ankth, plot vuajtje dhe shpresë.

Kur u kthye në shtëpi i tha plakës vetëm se Liçi nuk ishte ndodhur në dyqan dhe se do të shkonte të nesërmen...

### 3.

Liçi ishte një burrë i shkurtër, me flokë krejt të rënë.

— Ganiun e zunë! — tha ajo sapo mbetën vetëm.

— E morëm vesh! — tha Liçi.

— Nëna më tha se duhet të kenë spiunuar.

— Ku ta dish. Ai horri, Zeneli, e mbushi kupën me poshtërsitë që po bën.

Ajo u skuq.

— Edhe ju duhet të keni kujdes, mërmëriti pas pak.

Liçi, njeri gazmor e qejfli, goditi me çekiq bankën prej çeliku para këmbëve.

— A do të na bësh një djalë, apo jo, — thirri ai.

Ajo pënsëri u skuq. Në dyqan hyri një djalë i vogël, të cilin e kishin dërguar të silltë shushunjat. Nusja mbështolli shishem me letër dhe u ngrit.

— Të fala Nurijes, — tha Liçi, — mos u mërzi-tni! I thuaj të dalë ndonjëherë këndeje.

Gruaja e ndjeu veten të lehtësuar. I ra mes për mes pazarit të fshatarëve, ku bleu dy tufa lakra dhe i lindi dëshira të dilte nëpër qytet. Ajo kishte kaq kohë pa dalë. Qyteti i saj ishte i bukur, i këndshëm, plot me oborre lulësh, plot me shtëpi të qeta, që gu-mëzhinin çdo mëngjes nga kënga dehëse e kumuri-ve dhe guitjet e pëllumbave.

Vendosi t'i binte sa më gjatë rrugës për në shtë-pi. Iu shmang rrugës kryesore që kalonte përpara hotel-restorantit «Ekselsior» dhe mori në të djath-të, një rrugicë me kalldrëm, ku ndodheshin furr-xhinjtë e disa mejhane.

Rrugica ishte e shkretë. Në të dyja anët rridh-nin vija uji. Më tutje kaloi një fshatar, që mbante mbi krahë një kosh. Fshatari u ul në pragun e mej-hanes dhe futi këmbët në vijën e ujit. Ajo vuri bu-zën në gaz. Përfytyroi se si ai tani do të porosiste raki e do të pinte me këmbët e z bathura në ujë.

— Ç'ke në kosh? — e pyeti ajo.

— Ëh! — tha i hutuar fshatari, — jo, s'kam gjë, nuk shes gjë.

Papritmas, nëpërmjet xhamit të dritares, përmes errësirës së mejhanes, iu bë sikur po e shihnin. Gruaja ngriu. Dikush nga brenda lëvizi dhe ajo deshi t'ia jepte vrapit. Mbi kalldrëm ndjeu hapa të çrregullt e kërcitje çizmësh të rënda. Forcat po e llinin, e megjithatë ajo nuk ndaloi. Vazhdoi të ecte pa e kthyer kokën, vetja iu duk krejt e pafuqishme e nga çasti në çast qe gati t'ia shkreppte të qarit.

— Na, moj, kushërirë, ndalo pak se kam një fjalë.

Gruaja, e alarmuar, nuk ndaloi. Tjetri e ndoqi duke kërcyer mbi kalldrëm, duke folur e duke u zgërdhirë, gjersa më në fund e zuri.

— Na, pra, të thonë, ndalo! Ha-ha... Ç'trembesh kaq shumë?

Ai ishte gjysmë i dehur, mbi ballë i kishte kërcyer një damar dhe, ca nga pija e ca nga vapa, fytyra i ishte mbuluar nga djersët.

— Ik, të lutem, lërmë të qetë! — tha gruaja.

— Të qetë? Ha-ha... Kur të var tët shoq.

Gruaja mblodhi të gjitha forcat, vështroi rreth e rrotull për të kërkuar ndihmë, e, si nuk pa njeri, e shtyu. Por ai nuk iu shqit. Një lumë fjalësh të ndyra u derdh nga goja e tij, përzier me avujt e alkoolit, gjersa befas dikush doli nga prapa dhe i dha një të shtyrë të fortë.

— Largohu ti! — i thirri ai gruas me një zë të tmerrshëm.

Ajo instinktivisht u hoq mënjanë. Fshatari, që pak kohë më parë kishte futur këmbët në vijën e ujit, nxori me shpejtësi një revolver dhe, pa i lënë kohë tjetrit të merrte veten, thirri:

— Spiun i fashizmit Zenel Zoga! Në emër të popullit je i dënuar me vdekje!

Kushëriri deshi të nxirrte armën e tij nga këllëfi, por në atë çast revolveri i tjetrit shkrepiti tri herë me radhë. Ai u rrëzua mbi kalldrëm, me kokën në vijën e ujit. Dy vetë vrapuan në krye të rrugicës. Fshatari vrapoi pas tyre dhe të tre u zhdukën.

Asaj i ra shishja nga duart. Shishja u thye dhe shushunjat u derdhën në vijën e ujit, u përzier me vorbullën e gjakut e qëndruan në çipin e mustaqeve të të vrrarit.

## SHOKË TË NJË KLASE

Kamerierja vuri përpara tij akulloren dhe e vështroi me sytë e kaltër. Ai ndoqi lëvizjet e saj midis tryezave, derisa u fsheh pas banakut të stolisur me mozaik. Ishte i vetmi në sallë që porositi akullore, ndërsa të tjerët pinin me nxitim kafën e mëngjesit. Por kjo nuk e shqetësonte. Prej dy ditësh ndodhej në Tiranë dhe gjatë kësaj kohe e kishte ndër veten të vetmuar. Në të vërtetë ata erdhën tre përfaqësues. Por me të zbritur nga treni kolegët i uruan «natën e mirë», sepse kishin njerëzit e tyre në Tiranë. Kështu që atij s'i mbeti tjetër, seçse të zinte një dhomë teke në hotel «Peza», meqë, kur flinte, gërhiste jashtëzakonisht.

Para tre muajsh e njoftuan se duhej të përgatiste një kumtesë. Në Tiranë do të mbahej një konsultë për çështjet e shkollës. Tre muajt kaluan dhe tani, me kumtesën prej dhjetë faqesh të daktilogra-

fuara në xhepin e pasëm të pantallonave, ai gëllti-  
ste akulloren e ngrirë, duke vështruar nga lartësia  
e lokalit të bukur të Pallatit të Kulturës autobusët  
e kuq, që çanin turmën në sheshin «Skënderbej».

Dhjetë minuta më vonë, nga kolltuku prej lë-  
kure, diku në mes të sallës së konferencave, ai vuri  
re një grup njerëzish. Ata dolën prapa skenës, mbi  
të cilën qenë vendosur tryezat e presidiumit dhe zu-  
në vendet nëpër karrige. Në qendër ndodhej zëven-  
dësministri. Dikush njoftoi të pranishmit për qëlli-  
min e konsultës. Pastaj, midis solemnitetit të mble-  
dhjes, në podiumin e lartë u ngjit një mësuese, që  
filloi të lexonte kumtesën e parë.

Atëherë ai mori frymë lehtësisht. Vështroi për-  
reth për kolegët e tij, që këto dy ditë sikur i kishte  
përrpirë dheu. Befas, në radhën e parë të karrigeve  
të krahut tjetër, iu duk sikur pa një profil të njo-  
hur. Njeriu, të cilin iu duk se e njohu, qëndronte i  
përkulur anash. Ai u mundua të dallonte tiparet e  
tij dhe u bind se s'mund të ishte tjetërkush veç Fo-  
tit, shokut të tij të vjetër të fakultetit.

Në kokë i lindën lloj-lloj mendimesh. Po të  
ngrinte dorën e t'ia bënte me shenjë, Foti mbase do  
ta shikonte. Por prania e njerëzve që zunë vend në  
presidium ia hodhi poshtë këtë mendim. I vajti në  
mendje t'i shkruante një pusullë të vogël, e dorë më  
dorë t'ia dërgonte. Por edhe nga kjo u tërhoq, sepse  
mund të shkaktonte zhurmë në sallën e heshtur.  
Meqë të gjitha variantet që mendoi iu dukën të pa-  
përshtatshme, vendosi të priste pushimin.

Ai qortoi veten që s'ishte kujtuar më parë për  
mikun e tij. Prej dy ditësh sorollatej i vetmuar në-  
për rrugët e Tiranës dhe as që i kishte rënë ndër



mend se këtu, fare pranë tij, në një apartament, adresën e të cilit e dinte, banonte Foti. Mendoi se si puna në të vërtetë i ndan njerëzit. Sepse, të rrish tre vjet pa u parë, nuk është një gjë e vogël. Tre vjet janë një jetë e tërë! Njeriu jepet pas punës, pas telasheve e kokëçarjeve të jetës dhe nganjëherë pothuajse harron se në botë ka miq e të dashur, ka gjëra të cilat janë aq të afërta, por që pakuptuar bëhen aq të largëta e të ftohta.

Ndërkohë kumtesa e parë mbaroi. Ai që drejtonte seancën, u ngrit, afroi mikrofonin pranë vetes dhe foli me një zë basi:

— Efekti psiko-pedagogjik i përdorimit të mjeteve didaktike, nga Foti Meçe, punonjës në Institutin e Studimeve Pedagogjike.

Salla ra përsëri në qetësi. U dëgjuan vetëm hapat e Fotit, që u ngrit nga karrigia, kaloi me trupin drejt shkallët e vogla pranë tryezave të presidiumit dhe u mbështet në podiumin e lartë. Nga xhepi i xhakëtës nxori faqet e daktilografuara. I shpalosi pranë mikrofonit, duke shkaktuar një zhurmë të thatë. Pastaj filloi të lexonte me zë të rrjedhshëm. Herë-herë hidhte vështrimin nga dëgjuesit. Të gjitha këto i kryente me lehtësi, si një njeri mjaft i stërvitur me të tilla gjëra.

Tani ai kishte mundësi ta shihte më mirë Fotin, të dallonte fytyrën e tij të mbushur, trupin e bëshëm dhe kravatën e madhe të lidhur pas këmi-shës së bardhë.

Ai mendoi se vitet rrjedhin shpejt, se njerëzit lëvizin e ndryshojnë në mënyrë të papërfytyrueshme. Që kur mbaruan studimet nuk ishin parë me njëri-tjetrin. Në fillim shkëmbyen ndonjë letër. Po

kjo me sa dukej e mërziste Fotin. Në letrën e fundit ai i tregonte se që fejuar, se ishte vendosur në një apartament më vete dhe së shpejti do të martohesh. Vetëm kaq. Atë e habitën toni lakonik dhe fraza e thëhtë. I shkroi dy herë me radhë, por nuk mori përgjigje. Pastaj nuk i shkroi më.

Në sallë bënte vapë. Të pranishmit shkopsitën xhaketat. Disa filluan të flisnin me zë të ulët. Foti me të vërtetë po fliste në mënyrë të mërzitshme. Dikujt në presidium iu hap goja. Foti i dha fund leximit të kumtesës me një frazë bombastike. Më vonë, kur burri me zë të trashë deklaroi pesëmbëdhjetë minuta pushim, të gjithë psherëtinë të lehtësuar.

Zëvendësministri, i rrethuar nga një grup njerëzish zbriti në sallë. Foti ecte pas tyre. Ata i kaluan fare pranë, aq sa, po të zgjaste pak dorën, mund të prekte kravatën e Fotit. Ai deshi t'i fliste, por grumbulli i njerëzve u drejtua nga lokali. Kamerierja e bukur fluturoi pranë tyre. Vuri re se Foti qëndronte në këmbë, megjithëse në tryezën e zëvendësministrit një karrige ishte bosh. Deshi ta thërriste përsëri, por diçka e mbajti. Fytyra e Fotit kishte marrë një shprehje të çuditshme. Ai vinte rrotull afër zëvendësministrit, bisedonte me kamerieren, pastaj kalonte pranë karriges së lirë, por nuk ulej. I mbuluar nga djersët, Foti, me sa dukej, priste më kot që ta ftonin të ulej. Pas pak u afrua kamerierja me një tabaka, ku kishte vendosur kafe dhe shurupë. Por përsëri nuk e vunë re. Atëherë Foti buzëqeshi i hutuar, fshiu sumbullat e djersës dhe u ul në tryezën pas tyre.

— Foti, lapangjuz, — mërmëriti ai.

Ktheu shpejt e shpejt filxhanin e kafes dhe u drejtua nga hyrja e lokalit. Ndjeu një dhimbje koke. Nga vapa, me siguri, mendoi. U ul në kolltuk dhe u mundua ta shqiste nga mendja atë skenë të habitshme.

Seancën e dytë e ndoqi me vështirësi. Pas dy orë kumesash kokën e ndiente të rëndë. Me të mbaruar seanca nuk priti ta takonte Fotin, sepse ai përsëri u largua pas një grumbulli njerëzish. Nuk u mundua të kërkonte as kolegët e tij. Hëngri drekë në restorant dhe i dërrmuar nga vapa u shtri në krevatin e hotelit. Nxori bllokun e vogël të shënimeve, ku mbante numrat e telefonave dhe adresat e shokëve. Pastaj e zuri gjumi...

U zgjua i mbytur nga djersët. Dielli i pasdites hynte pas perdeve të holla në dhomën e vogël, që qe nxehur si furrë. Futi kokën në çesmë dhe hapi rubinetin. Në pasqyrë fytyra i doli e fryrë.

«Paskam fjetur si kalë,» — mendoi.

Iu kujtua Foti.

— Kastravec, — tha me vete.

Pastaj filloi të qeshte. Ai mendoi mos kishte ndier një fije zilie për Fotin, tek rrinte në shoqëri me gjithë ata burra seriozë. Atij iu kujtuan disa persona që, nuk e humbisnin kurrë rastin, kur vinte puna për të qëndruar sado pak në një tryezë me njerëz me përgjegjësi.

Zbriti shkallët e hotelit dhe u ndodh midis turmës që shëtiste në bulevard. Fundja Foti s'kishte bërë ndonjë mëkat... Këmbët e çuan padashur në rrugën e Durrësit. Qëndroi përpara një pallati. E dinte se në hyrjen e parë, në katin e tretë banonte Foti. Ai nuk mendoi më gjatë. Ngjiti shkallët derisa u

ndesh përballë me etiketën «Familja Foti Meçe». Shtypi sustën e ziles dhe priti.

— Kush është? — u dëgjua një zë gruaje nga brenda.

Ai mbeti.

— Aty është Foti?

— Një minutë, ju lutem.

Dera u hap. Para tij qëndronte Foti, i veshur me një kostum gri.

— Foti, — thirri ai dhe deshi t'i hidhej në qafë.

Tjetri vuri buzën në gaz me druajtje, i zgjati dorën dhe foli i hutuar:

— Oh, Mali...

Pas supeve të Fotit sytë i zunë kalimthi një sikhade të varur në mur, në fund të korridorit të ngushtë.

— Si s'më ke shkruar, — tha Mali tek futeshin në dhomë.

— Lëre — tha Foti me pamje të lodhur — na mbyten punët.

Ata u ulën përballë njëri-tjetrit dhe për një çast u vështruan sy në sy. Ai e ndjeu se diçka kish-te ndryshuar te Foti. Edhe frazën e famshme «na mbyten punët» e shqiptoi me seriozitet, me seriozitetin e mjeriut që e di kuptimin e sendeve. Ai mendoi se tre vjet janë një kohë ë gjatë dhe s'kishte përse të habitej që miku i tij qe bërë aq serioz.

Foti i zgjati një cigare. Puliti sytë e kaltër, të butë dhe u zhyt në kolltuk.

— S'më the përse ke ardhur, — i tha pas pak.

— Për konsultën.

— Ëhë.

Foti buzëqeshi i kënaqur.

— Më dëgjove?

— Po.

Ai nuk e pyeti se si iu duk kumtesa e tij.

— Zëvendësministri më tha fjalë të mira.

Mali padashur mendoj se Foti po e gënjente.

— Unë e kam radhën nesër.

— Pse, edhe ti ke përgatitur kumtesë? — pyeti Foti me një kureshtje të dukshme.

Mali nuk foli. Mënyra se si Foti shprehu habinë e tij e lëndoi. Dikur kishin qenë shokë shkolle, si të thuash, e njihnin njëri-tjetrin me dhëmbë e dhëmballë. Megjithatë ai nuk deshi t'i jepte rëndësi. Nuk donte as të bisedonte për gjëra të tilla. Kishin aq tepër për t'i thënë njëri-tjetrit.

— Që kur ke filluar në institut?

— Po mbushet viti, — tha Foti me mospërfillje.

Mali heshti. Edhe Foti heshti. Bënte vapë. Në korridor dëgjoheshin trokitjet e takave të gruas së Fotit. Në xhamin e dritares përpëlitej një mizë e mbetur pezull.

— Vapë, — tha Foti.

Mali pohoi me kokë. Iu kujtua ajo shprehje klasike se gjëja më e mërzitshme është kur bisedon për motin. Mori në dorë një zbukurim prej kristali që ndodhej mbi tryezën e rrumbullakët e filloi ta lëmonte.

— Qenke rregulluar mirë...

Tjetri nuk u përgjigj. Ai thithte duhanin, puliste sytë e butë dhe heshte. Mali vështroi fytyrën e tij të mbushur. Jaka e fortë i shtrëngonte qafën e trashë, mbi të cilën dukej një vijë e bardhë. Kravata me kokë të madhe po i zinte frymën. Ia tërhoqën vëmendjen pikturat e bukura të varura në mure, li-

brat e trashë të bibliotekës në disa gjuhë (Foti kurrë s'kishte qenë në gjendje të lidhte dy fjalë në ndonjë gjuhë të huaj), e gjithë ato sende e kinkalerira të imta të vendosura kudo. Mbi të gjitha shquhej një kornizë e madhe me një riprodhim të Mona Lizës.

— Me sa shoh ke filluar të merresh me shkencë të madhe.

Foti preku i menduar librat e trashë të bibliotekës.

— Ti e di profesionin tonë, — i tha me seriozitet. — Të them të drejtën, kur hap ndonjëherë ato leksionet që morëm në fakultet, më rrëmben gazi.

— Pse?! — e pyeti Mali i habitur.

— Disa profesorë kanë qenë me të vërtetë pa fantazi.

Mali deshi të thoshte se edhe ato leksione pa fantazi shpesh ai mezi i merrte në sesionin e vjeshtës.

— Sidoqoftë të ka ecur mbarë, — i tha.

— Epo...

Foti u skuq. U kollit me zor dhe mori një pozë të vrazhdë. Atë çast në dhomë u fut gruaja e Fotit me një tabaka në dorë. Mali vështroi tiparet e saj nazike.

Gruaja i zgjati tabakanë. Mali mori një gotë kornjak.

— Atëherë, — tha duke e ngritur përpjete, por nuk arriti të uronte ndonjë gjë. E piu me fund. Foti sa e çiku te buzët. Pastaj gruaja doli dhe s'u kthye më në dhomë. Në korridorin e ngushtë dëgjoheshin takat e këpucëve të saj.

— Si të duket jeta familjare?

— Çka...

Mali e ndjeu se Fotit nuk i pëlqeu të bisedonin për këtë temë. Por ai kishte dëshirë të fliste, të qëndronte atë natë aty, të pinin e të këndonin si dikur.

Miza që kishte mbetur në xhamin e dritares zukaiste në mënyrë të bezdisshme. Ajo lëvizte me nervozizëm nga njëra qoshe në tjetrën. Foti kërciti të gjitha gishtat e dorës me radhë, pastaj tha:

— Vapë... na mbyti vapa.

Mali vështroi kravatën me kokë të madhe.

— Vërtet, bën shumë vapë.

Ata po mërzhiteshin, Malit iu shfaq përsëri skena e lokalit dhe u pendua që erdhi ta takonte.

— Foti, — u dëgjua zëri i gruas pas derës.

Foti fshiu sumbullat e djersës dhe u ngrit. Mali psherëtiu. Mendoj se do të kishte bërë më mirë të shëtiste. Në korridor ata të dy pëshpërisnin me zë të ulët. Gruaja ndonjëherë e ngrinte zërin më tepër... Pastaj për disa minuta u bë heshtje, gjersa në dhomë u fut Foti me fytyrë të skuqur.

— Do të shkoni gjëkund? — e pyeti.

— Jo, jo, — tha Foti, — hiç, në të vërtetë përgatiteshim të dilnim.

Pastaj pa fjalë e përcolli gjer në krye të shkallëve.

Të nesërmen në mëngjes, me gjithë habinë e kamerieres sykaltër, ai porositi përsëri akullore. Në sheshin «Skënderbej», si zakonisht, çanin autobusët e kuq midis turmës. Kafeneja murmurinte. Salla e konferencave murmurinte. Grilat prej plastmase ishin të pazonjat të ndalnin vapën kapitëse që futej përmes tyre. Por ndryshe nga dita e djeshme, njerëzit sot ishin pak më me humor. Dikush nga kreu i presidiumit, para se të fillonte seanca, bëri një shaka

të cilën ai s'e dëgjoi, por salla gumëzhiu nga të qeshurat. Burri me zë basi që drejtonte konsultën u ngrit në këmbë e pastaj u lexuan dy kumtesa me radhë. Ai vështronte Fotin përsëri në vendin e djeshëm, që qëndronte i qetë, puliste sytë e butë dhe kushedi se çfarë mendonte. E ndiente se Foti ishte i kënaqur, gati-gati notonte i zhytur brenda një lumturie të papritur dhe shikonte herë-herë me indiferencë tërë atë sallë që shtrihej rreth tij. Megjithëse tërë natën pothuajse s'kishte vënë gjumë në sy nga mërzia, atij i vinin nëpër mend, si kujtime të harruara, vitet studenteske. Dhe vështirë të shkëputej nga ato vite, sikur zëri i trashë i burrit që drejtonte seancën të mos kishte shqiptuar emrin e tij.

Ai u ngrit disi i turbulluar. Kaloi para presidiumit dhe pati frikë se njerëzit s'do ta dëgjonin. Prandaj filloi të lexonte shpejt, nganjëherë dhe pa e marrë vesh as vetë se çfarë lexonte.

— Më ngadalë, — tha njëri nga presidiumi.

Ai vuri buzën në gaz me druajtje, fshiu djersët, po përsëri vazhdoi të lexonte shpejt. Në fund, tek paloste letrat, vuri re se salla kishte rënë në qetësi. U dëgjuan vetëm hapat e tij, që zbriti shkallët e podiumit. Ata të rreshtave të parë në sallë i buzëqeshën me dashamirësi.

— Si të quajnë, — dëgjoi ai zëvendësministrin që e pyeti. I tregoi emrin. Pastaj u ul në vendin e tij pa e kuptuar akoma se të gjithëve që ndodheshin në konsultë u kishte bërë përshtypje kumtesa e tij. Në mbarim të seancës zëvendësministri, i pasuar nga disa njerëz, i kaloi pranë dhe i buzëqeshi.

— Kështu, — i tha me afërsi, — të quajnë Mali.



Ai nuk dinte ç'të fliste. E gjithë kjo qe krejt e papritur për të. Zëvendësministri i kaloi dorën mbi supe dhe e mori me vete. Tek futeshin në lokal, vështroi kalimthi Fotin, që ecte pas tyre dhe i bënte disa shenja të çuditshme. Po ai nuk u vuri rëndësi. U ulën në një tryezë. Kamerierja erdhi pranë tyre. Zëvendësministri e pyeti ç'dëshironte. Ai ngriti supet i druajtur. Më në fund porositen të gjithë nga një kafe.

Ai vuri re se Foti vazhdonte të vinte rrotull pranë tyre. Për herë të parë ulej në një tryezë me zëvendësministrin dhe sigurisht kjo qe diçka e jashtëzakonshme për të. Ai as që e kishte përfytyruar se studimi i tij do të ngjallte kaq tepër kureshtje.

Dy orë më vonë, tek zbriste shkallët prej mermeri të bardhë të pallatit, dikush e zuri për krahu. Ishte Foti.

Në fytyrën e tij shquhej një buzëqeshje e shtirë. Atë e tronditi buzëqeshja e Fotit. Zbritën në he-shtje shkallët e dolën në asfaltin e nxehtë.

— Interesant, — tha Foti, — a e di se në shumicën e mendimeve ne përputhemi bashkë? Tamam si ta kishim bërë me fjalë.

Ai heshti. Ecën mes për mes sheshit që avullo-nte nga nxehtësia. Ndaluan para ndërtesës së Komitetit Ekzekutiv. Mali mezi po duronte dhe donte të ndahej sa më parë prej tij.

— Dëgjo Mali, — tha Foti, — ne s'ndenjmë fare bashkë. Dje, ti e kupton, isha i zënë.

— Jo mo, — tha Mali kot së koti.

— S'mund t'ia prishja gruas, e kupton? Dje na priste daja i saj. Njerëzit e saj kanë bërë shumë për mua, kështu që...

— Aha...  
— E kupton, apo jo...  
— Po, po, — tha Mali, të cilit në të vërtetë po i dhimbte koka nga dielli i nxehtë.  
— E di çfarë? — tha Foti, — sot pasdite të pres në shtëpi.

Pastaj ata u ndanë.  
Tek udhëtonte me tren midis muzgut, ai u shtriq i kënaqur në ndenjese. Ditët e kaluara në Tiranë mbetën prapa bashkë me fishkëllimat e gjata të lokomotivës që çante përpara. Ndërsa vagoni tundej, atij i dolën para syve Foti dhe gruaja e tij. Ndonëse e kishte pushtuar një nostalgji e lehtë, mendoi se bëri mirë që nuk vajti t'i takonte.

## LINDA

Ulur mbi një sop dheu të butë ata sodisnin luginën e ngushtë që shtrëngohej midis maleve. Përrroi me gurët e bardhë të zallit vithisej thellë, humbiste midis shkëmbinjve, tretej nën gjelbërimin e dendur të pemëve dhe dilte diku larg, si një fashë gri që rrëzëllente me një shkëlqim të vakët. Në hapësirë vërtitej një shpend. Vajza ndiqte fluturimin e shpendit, që herë-herë lëshohej në pikiadë dhe gati çikte me krahët e tij majat e drurëve të arrave. Më këndej, në qoshe të arave të pjerrëta, duke-shin çatitë e shtëpive me rrasa të hirta. Në oborret e rrethuara me mure guri luanin fëmijë, më tutje shquhej kurrizi i kuq i një lope që kulloste, ndërsa në një brinjë dikush po kosiste jonxhë.

— Përse nuk vjen, — tha vajza, — sonte të gjithë do të mblidhen, edhe ata të Qerretit, ndërsa ti...

Djali u zu ngushtë. Sa herë që ndodhej pranë

saj, ai tronditej, i çrregullohej frymëmarrja. Mëdmet i mjegulloheshin, nuk gjente dot fjalët e duhura e i dukej se do të shprehej përçart. Prandaj përpiquej të fliste sa më pak, mendohej ta përmbante veten, ndonëse kjo qe fare e kotë. Prej më se një viti ai e provonte këtë ndjenjë të çuditshme. Shpesh i dilte gjumi në mes të natës, i dhimbte kraharori, diçka i ziente aty brenda, diçka si rënkim, si deheje, si një gërryerje e mundimshme. Këtë ai e ruante me fshehtësi të rreptë. I prirur për të gjykuar me gjakftohtësi, mendonte se nuk duhej të jepej qorrazi pas asaj ndjenje e, aq më tepër, të ushqente veten me iluzione të kota. Pikërisht, ai nuk dëshironte të shikonte ëndrra me sy hapur, pasi edhe rrethanat i dukeshin të tilla. Bir fshatari, nga një kooperativë fushore mjaft larg prej këtej, ai ishte emëruar mësues dy vjet më parë në këtë malësi të thellë, sapo kishte mbaruar studimet në degën e matematikës. Ndërsa Linda ishte nga qyteti, e veçkësaj (rrethanë që atë e turbullonte shumë), ishte një vajzë e bukur. Pra qe fare e logjikshme që një vajzë si Linda, së cilës, pa dyshim, nuk i mungonin propozimet, as të mos i shkonte nëpër mend ta lidhte jetën e saj me një njeri që do të jetonte përgjithmonë në fshat, në mos këtu, në rastin më të mirë, pranë familjes së tij në kooperativën fushore.

— Jo, — tha ai i turbulluar nga kjo ftesë e papritur, — nuk mundem! Sonte i zoti i shtëpisë ka ditëlindjen e djalit. Dëshiron të më bëjë kumbarë.

— Kumbarë?! — u habit vajza.

Ajo u ngrit në këmbë. Mblodhi një tufë lule të bardha dhe sajoi një buqetë të vogël. Ai, i penduar

- që ia zuri me gojë punën e kumbarit, vrau mendjen të gjente ndonjë temë bisede, me qëllim që ajo të rrinte edhe ca. Por nuk iu kujtua asgjë interesante.

— A të të përcjell? — i shpëtoi padashur.

— Jo, — tha ajo, — s'është nevoja.

— Do të vish përsëri? — guxoi ta pyeste.

— Kush, unë?

Një tufë zogj fluturuan të trembur përmbi zabela dhe ajri fërgëlloi nga përpjekjet e krahëve. Tatëpjetë kodrës u lëshuan ca dele që përhapën një erë të athët vathe. Delet u futën me blegërime në korije dhe ai do të kishte dashur të vraponte pas tyre, për t'iu shmangur këtij çasti të vështirë që u krijua nga pyetja e Lindës. Vërtet, përse duhej të vinte ajo? Gjepura...

— Linda, unë sonte do të vija me gjithë qejf, por...

— Mirë, mirë, — tha vajza. — Kur ke diçka më interesante, sidoqoftë...

— Oh, jo, — ndërhyri ai, — për mua njësoj është, bile as njësoj nuk është, dua të them se...

Vetëtimthi, fare papritur djaloshi mendoi se s'kishte asnjë kuptim të mendohej në këtë mënyrë.

— Linda, të lutem, ti duhet ta kuptosh. Do të isha shumë i lumtur të rrija sonte pranë teje, sepse... Këtu s'ka asgjë të keqe. Unë të dua, Linda!

Vajza shtangu. Ajo u kap në befasi, nuk arriti të lëvizte, as nuk mundi ta kundërshtonte djaloshin, që bëri një hap përpara, e afroi lehtë pas vetes dhe e puthi. «Oh, ç'është kështu, mendoi, ç'po bëj»? Pa vështirësi u shkëput prej tij, e vështroi si me frikë dhe ia krisi vrapit tatëpjetë kodrës. Vetëm kur arriti në skaj të pyllit, ajo qëndroi. Duke iu marrë fry-

ma preku me gishtërinj buzët, shtrëngoi faqet e përflakura midis pëllëmbëve, si të donte të verifikonte gjithçka kishte ndodhur.

— Ua, ua, — tha me vete. Pastaj zuri të qeshte, këputi ca lule batre me petale të bardha si borë, u fut në pyll e hutuar, e magjepsur e njëkohësisht e trishtuar. «Ua, ua, sa shpejt, sa çudi!»

Po të mos ishte traga, mbuluar me gjethe lisi, ajo do të rrotullohej nëpër pyll pa qenë në gjendje të dilte në anën tjetër, ku ndodhej shkolla. Por traga ishte e sigurtë, futej në përrua, pastaj dilte midis myshkut të gjelbër, duke lënë prapa gurgullimën e ujërave, kalonte pranë lisave të lartë me zgavra, gjer poshtë, në shkallët e një mulliri të vjetër e të braktisur prej kohësh. Aty Linda ndaloi përsëri. Ujërat rridhnin nën mulli, shkumbëzonin me zhurmë, hidheshin në një vijë të thellë midis barit të dendur, që i shpinte drejt e në zallin e madh plot pellgje. Ajo u përkul mbi muçilen e mullirit. Nga sipërfaqja e ujit silueta e saj e zbehtë e vështroi me pikëllim. Mori një plis të vogël dhe e qëlloi. Atëherë silueta u përkund mbi valët e lehta dhe ajo ndjeu një marramendje.

— Oj, oj, pa shih! Linda, moj shpirte, po ti ç'bën kështu?

Ajo u hodh në këmbë.

— Ha, ha, Linda, po vështroheshe në muçile!

Tjetra, një vajzë me flokë të lëshuar rreth fytyrës së imtë, e kishte kaluar atë moshë kur mund të thuhej se i lejoheshin shkujdesje të tilla. Ajo ishte afër të tridhjetave. Për këtë arsye mësueset e reja ia dëgjonin fjalën, bile qëllonte që i besonin edhe ndonjë «të fshehtë». Prandaj, e sigurtë për autoritetin e

saj, iu afrua, i shkoi dorën nën flokë dhe e përkëdhe-  
li.

— S'më duket shenjë e mirë kjo. Po e bën si vaj-  
za e asaj përrallës.

— Neta, të lutem, mos u tall me mua.

— Të tallm?! Jo, moj shpirtë. Pastaj ti dukesh  
që një kilometër larg.

— Neta...

— Mirë pra, më thuaj, ku ishe gjer tani? Ke tri  
orë që je zhdukur.

Linda u skuq. Megjithatë ajo nuk kishte ndër  
mend të shpjegohej, as ishte në gjendje ta bënte  
këtë.

2.

— Emër quhet ajo pjesë e ligjëratës që tregon...

Nxënësi, një djalë i shkurtër, me kokë të qe-  
thur, mbeti i hutuar.

— Çfarë tregon?

— Emër quhet ajo pjesë e fjalisë që...

— E fjalisë, apo e ligjëratës?

Nxënësi ktheu sytë e zbërdhulët nga klasa. U  
ngrit një murmurimë e mbytur dhe Linda u mun-  
dua të përqëndrohej në kuptimin e pyetjes që bëri.  
Pastaj trokiti dera. Ajo u hap përgjysmë dhe u duk  
koka e vogël me flokë të dendur e Netës, që ia bëri  
me shenjë të afrohej.

— Do të dalësh sonte? — e pyeti.

— Aman, Neta, nuk gjete kohë më të përshtat-  
shme për këtë?

— Si?

— Mirë, mirë, do të shihemi.

Dera u mbyll.

— Emër quhet ajo pjesë...

— Mjaft, — e ndërpreu Linda nxënësin. — ul!

Klasa u krodh në një qetësi të shurdhër. Ajo iu afrua dritares, ku vareshin degët e gjata të shëlgjeve. Me siguri, diku në skajin tjetër të kodrës edhe ai po rrinte tani në dritare, si i përhumbur. Ajo sikur i shikonte sytë e tij të menduar atje, të tretur në hapësirën e kaltër. Befas iu bë se dikush po dëneste. U kthye nga klasa. Në bankën e fundit, nxënësi, me fytyrë të përmbysur mbi pëllëmbët e duarve, po qante. I tërë trupi i dridhej. Atëherë, shoqja e tij e bankës, një vajzë flokëverdhe, me baluke, u ngrit e iu afrua Lindës. Qëndroi përpara saj gatitu, e druajtur dhe e turpëruar i zgjati një kokërr mollë.

— Ç'është kjo, — tha Linda e habitur.

— Mësuese, ne të kemi mërzitur sot.

— Ç'thua kështu, moj Fize?

— Mësuese, merre, — tha vajza me këmbëngulje, — merre!

Lindës i erdhi për të qeshur. Nxënësit kishin ngrirë. Ata po prisnin me ankth veprimin e saj, sikur po i luteshin që ajo ta merrte atë mollë. Atëherë Linda, e përfshirë nga një vërshim i brendshëm, e rrëmbeu vajzën e vogël në kraharor, e shtrëngoi fort, u bëri me shenjë fëmijëve që ta ndiqnin dhe u derdhën me zhurmë në oborr, vrapuan gjer në hijen e një arre të madhe, prej nga dukej e tërë luginë me gjelbërimin e thellë të livadheve. Djemtë ia mbathën nga zalli, andej nga vinte zhaurima e ujërave të mullirit, ndërsa vajzat qëndruan pranë saj,



të urta, pa fjalë, të kënaqura më tepër ndoshta se mësuesja po e mbante mollën e tyre në dorë. S'dihej përse ajo heshte, heshte, ndërsa ato s'ngopeshin duke e parë.

Dy orë më vonë shkolla u boshatis. Mësuesit, të mërzhitur nga vonesa e zakonshme e kolegëve të tyre që përsëritej, si për inat, gjithnjë kur ata vendosnin të shkonin në qytet ndonjë të shtunë, po prisnin në oborr duke pirë duhan. Më në fund mësuesët u bënë gati dhe, tek i ngjiteshin malit për të dalë në rrugën e makinës, Linda ktheu kokën prapa... Ai nuk ishte dukur fare dhe ajo që përpjekur me të gjitha forcat ta largonte nga mendja. Sa herë që dikush i trokiste në derën e klasës, ajo turbullohej, i trembej një takimi të ri, që mund t'i jepte fund gjithçkaje. Por ajo nuk dëshironte që ky fund të vinte kaq shpejt, nuk ishte e sigurtë në vetvete dhe nuk mund të përcaktonte nëse ajo që ndiente ishte diçka reale, e qëndrueshme, apo një trill, një maramendje me të cilën shtynte ditët prej një viti, pa i pohuar vetes asgjë. Në fakt diku thellë ajo e kuptonte shkaku e këtij ngurrimi, të cilin nuk guxonte ta shprehte e ta shih-te në sy...

— Ja, presim këtu, — tha një mësues, duke treguar hijen e një lisi buzë rrugës së qetë.

Ata u ulën me shpresë se do të shpëtonin nga mundimi rraskapitës i vapës. Dikush ndezi një radiotransistor. Neta, së cilës i pëlqenin pjesët sentimentale, iu lut atij ta mbyllte radion. Atëherë Dimitri, një mësues fizkulture, që s'dihet përse e kishte marrë me vete atë ditë kitarën, e kuptoi se duhej të luante diçka për Netën. Ai filloi t'i prekte te-  
lat pa qejf.

— O bubrec, o bubrec, të gjithë ditën rri tuj ec, — këndoi Dhimitri, i bezdisur, ndërsa Neta shtrembëroi fytyrën.

— Uh, sa i keq që je ti, sa i keq!

Pastaj u dëgjua uturima e mbytur e një makinë. Ata morën çantat e dolën në rrugë. Shoferi frenoi, kërceu poshtë dhe zuri t'i hidhte ujë radiatorit. Karrocëria që ngarkuar me trupa.

— Vetëm dy vende kam, — tha ai.

Një fshatar në ndenjësën e pasme nxori kokën dhe shkundi llullën pas paretit prej llamarine. Ata po rrinin të pavendosur.

— Neta, ngjitu ti me Lindën, — tha dikush.

Shoferi, i ngrysur, futi kovën në kabinë dhe u ul pranë timonit. Neta u tërhoq prapa e zbehur.

— Po pres makinë tjetër, — tha ajo.

— A vendosët? — thirri shoferi, që e humbi durimin.

Atëherë Dhimitri me kitarën në qafë e tërhoqi Lindën pas vetes, e cila pa kuptuar asgjë u ul në sedilien e parë, ktheu kokën nga Neta, që kishte mbetur si e shushatur në anë të rrugës, gjersa shoferi i futi marshin makinës. Makina u drodh, kërceu përpara dhe, pa këmbyer asnjë fjalë, kapërcyen tërë hapësirën e maleve.

Në hyrje të qytetit, pranë parkut automobilitik, ata zbritën. Dhimitri qëndroi pak me shoferin. Linda u tërhoq mënjanë. Ata qeshën me zë të lartë dhe ajo e ndjeu veten si në gjemba. Tek futeshin në rrugën kryesore, ku ngriheshin pallatet e periferisë, Dhimitri u shfajësua:

— E pashë që u shqetësove, po s'qeshëm me ty. Në fakt ai është djalë i mrekullueshëm dhe Neta bë-

ri gabimin më të madh që nuk pranoi të martohej me të.

— Ç'thua kështu, Dhimitër?

— Pse, s'di gjë ti?

Dhimitri zuri t'i tregonte një histori të dy vjetëve më parë, ndërsa ajo e tronditur mendonte se sa e mbyllur ishte Neta, së cilës ato i besonin gjithçka.

### 3.

Në oborr, midis rrugicës së shtruar me çimento, ndodhej një karrige. Linda u ul dhe vuri çantën me rroba pranë këmbëve. I shungullonte koka. Me sa dukej të gjithë njerëzit e shtëpisë kishin rënë të pushonin. Portokallet, me gjelbërimin e jashtëzakonshëm të atij viti, mezi e mbanin diellin, që gjente të çara midis gjetheve dhe binte pa mëshirë mbi lulet anës bordurave, të cilat i ati i ujiste rregullisht. Pastaj në majë të gishtërinjve u fut në dhomën e saj. E dërrmuar u hodh mbi krevat, por nuk qëndroi shumë. Zuri të nxirrte rrobat nga çanta. Në fund preku diçka të fortë. Ajo u kujtua. Ishte molla që i kishin falur nxënësit atë mëngjes. «Oh, sa larg janë ata, mendoi, sa larg». E mori mollën dhe e vendosi në komodinë. Ajo ishte e kuqe. Përse e kishte marrë me vete atë mollë? As vetë nuk e dinte...

— Këtë herë më dukesh si e dobësuar, — vuri në dukje e ëma tek rrinin në oborr e pinin nga një kafe në hijen e portokalleve. Nëna, nëpunëse llogarie në një ndërmarrje të madhe të qytetit, ishte një grua e kolme, e zgjuar e me sens shumë praktik. Në

këtë pikëpamje Linda ndryshonte disi prej saj dhe ngjante më shumë me të atin, mjek veteriner në një fermë aty pranë, burrë i shtruar e i qetë, me pasion të veçantë për lulet.

— Ashtu të duket, — tha Linda, — kemi dy javë pa u parë.

— Jo, jo, — ndërhyri e ëma duke vendosur filxhanin mbi pjatën e vogël. — Ti je dobësuar, kjo duket.

Ajo priti gjersa Linda mbaroi kafënë e saj dhe me filxhanin në duar, me gjithë kundërshtimin e vajzës, vajti t'i lante vetë.

— Mirjana u fejua, — tha duke e këmbyer bisedën.

— Ah, vërtet?

— Ka ca ditë. Goxha djalë mori, inxhinier në kombinatin e drurit. Bën llogari bota, Linda. Tani, pa dyshim, doradorës do të rregullohet në qytet.

Linda, e turbulluar nga kjo goditje e tërthortë, bëri sikur nuk e kuptoi thelbin e atij njoftimi të papritur. E ëma u fut në dhomë duke ecur ngadalë. Linda, me ndjenjën e një zilie të lehtë për shoqen e saj të klasës, mbeti në karrige e topitur. Pastaj pada-shur preku buzët me gishtërinj. Atë çast dera e jashtme u hap me vrull. Një grua e re, me trup të gjatë, e veshur me një fustan të ndezur që i rrinte mjaft bukur, përplasi takat e sandaleve mbi çimento.

— Linda, — thirri ajo me gjallëri, — ç'bën këtu, moj xhan?

— Pse, moj teze, ç'të bëj? — tha Linda, që ndjeu një erë të këndshme parfumi.

Ato u përqaftuan. Gruaja e re fshiu të kuqin e buzëve që mbeti në faqet e mbesës.

— Si ç'të bësh! Një herë në kaç kohë zbret nga fshati dhe vjen e më mbyllesh në shtëpi.

Pastaj tezja, e cila ishte mjaft e re për t'u quajtur kështu nga një vajzë e rritur si Linda, e njonu me gjithçka kishte ndodhur në mungesë të saj.

I tha se edhe ajo e kishte ndier veten të vetmuar gjatë kësaj kohe për arsye të largimit të të shoqit, që kishte vajtur me shërbim në zonat e veriut e së fundi e urdhëroi:

— Tani vishu! Do të dalim të bëjmë një shëtitje bashkë.

Linda deshi të kundërshtonte, por kjo që diçka e pamundur. Kur ngulte këmbë tezja e vogël, s'mund t'i bënte ballë njeri.

Një orë më vonë ato sorollateshin midis turmës që endej në bulevard. Rrëzë mureve të kalasë së vjetër të qytetit, në bufetë e vogla me fasada plastmasi, njerëzit kënaqeshin me birrën e ftohtë e sodisnin të shkujdesur ata që endeshin. Ndërsa tezja po i fliste për një model fustani veror, fluturimthi Lindës i kapën sytë një imazh të njohur. U mundua të përqëndrohej dhe vuri re se ajo ishte Neta. Po, sa çudi, Neta, me tiparet e imta, me tiparet e bukura, sa çudi! Ajo mundi të dallonte tualetin e hollë që kishte bërë shoqja, tualet që i jepte asaj pamjen e një gruaje dhe vështrimin e mekur, që dukej sikur kërkonte diçka midis turmës, diçka të papërcaktuar, por në mënyrë ngulmuese e të hapur.

— Uh, — psherëtiu Linda, që me një lëvizje të shpejtë iu shmang takimit me të.

— Ç'pate? — e pyeti tezja.

— E di çfarë! S'jam fort mirë, kthehem në shtëpi!

— Linda, dhe një herë që dolëm bashkë kërkon të ma prishësh? Mirë atëherë, por më parë futemi gjëkund. Më ka hipur për akullore. Pastaj çlodhu sa të duash.

Linda u bind. Po errej. Nëpër rrugë u ndezën dritat. Ato ndaluan në hyrjen e një lokali, që të shtunave rezervohej vetëm për çifte, ku, për çudinë e beqarëve, pranoheshin edhe çifte grash, por jo burrash. Vendet ishin të gjitha të zëna. Qëndruan një copë herë në këmbë dhe befas tezja e tërhoqi Lindën nga pas.

— Vemi në atë tryezën atje, — tha ajo, — është një shoqja ime me të vëllanë.

Shoqja ishte një 'grua e re, me flokë të verdhë e të lëshuar mbi supe. Djali, jo më tepër se njëzet e tetë vjeç, ngjante shumë me të motrën. Kishte veshur një bluzë sportive ngjyrë vishnje, rrinte si i druajtur në shoqërinë e tri femrave dhe fliste rrallë. Lindës iu duk se diku e kishte parë atë djalë. Tezja zuri të bisedonte me gjallëri, tjetra herë-herë qeshte me zë të lartë, djali, me pirunin e vogël thërmonte copa-copa pjesën e tortës që kishte mbetur në pjatë, ndërsa Linda, disi e bezdisur nga kjo shoqëri e re, automatikisht ndiqte lëvizjet e pirunit që kërciste «çik-çik». Më në fund copa e tortës u thërmua plotësisht dhe ajo nuk pati ndonjë objekt tjetër interesant ku të përqëndronte vëmendjen. Pastaj ata biseduan për gjëra fare të zakonshme. Linda mori vesh se shoqja e tezes punonte në një dyqan permanenti, se vëllai i saj, që kushedi përse nuk e lëshonte pirunin nga dora, ishte inxhinier në kombinatin ushqimor, se kjo verë, sipas parashikimeve,

duhej të ishte tepër e nxehtë dhe se që tani ishin mbyllur përfundimisht prenotimet e plazhit.

— Bah, — tha tezja, — këtë verë unë do të vete patjetër.

— Edhe ne do të vemë, — shtoi mikja e saj.

Kur u nisën për në shtëpi, tezja nguli këmbë ta përcillte. Lindës, së cilës iu duk krejt i tepërt ky kujdes, u habit më shumë kur vuri re se në shtëpi po e prisnin me padurim ardhjen e tyre. E ëma, me filxhan në dorë, sikur vazhdonte të pinte po atë kafe të hidhur. I ati, meqë nuk ishin takuar, e përshëndeti dhe menjëherë gjeti një shkak të largohej nga dhoma. Tezja u ul në karrige me një buzëqeshje të lehtë. E ëma mërmëriti nëpër dhëmbë, vuri filxhanin mbi tryezë dhe nuk ia shqiti sytë.

— Hë, — pyeti ajo me një lloj padurimi.

Tezja u gajas përsëri nën hundë me një si gujtje pëllumbi.

— Nuk ia kam thënë ende.

Linda u step. Një tis i purpurt i mbuloi fytyrën, gjymtyrët iu prenë, në mënyrë të turbullt arriti të kuptonte diçka dhe, ndërsa tezja zuri të fliste për vëllanë e mikeshës, ajo u zhyt në fantazinë e ngjyrave të ndezura të fustanit të saj, që i kujtuan pyllin, gjethet e kuqërreme në të verdhë të lisave, prarimin e arave të pjerrëta me grurë dhe...

— Oh, — klithi ajo me dhimbje, — po kjo s'është e mundur.

— Linda, — ndërhyri e ëma e shqetësuar, — ti gjyko njëherë! Fundja këtu s'ka asgjë të keqe!

— S'është e mundur, s'është e mundur, — tha Linda që, pa e kontrolluar dot veten, i la të dyja gratë në habi, doli me vrull nga dhoma dhe u përplas

përmbys mbi krevat. Në përfundim të asaj dite të gjatë, ajo s'qe më në gjendje të përmbahej, diçka e rëndë e përfshiu dhe i rrodhën lotë të nxehtë. Vonë, shumë vonë, ajo ngriti kokën. Mbi komodinë ndodhej molla e kuqe.

— Unë e dua, vërtet e dua, — tha me vete. E mori mollën, e mbajti midis duarve dhe me të në dorë e zuri gjumi.



## TROKITJE

Ai rrotulloi çelësin dhe dera u hap me zhurmë. Ajri i paradhomës që i lagësht, i përzier me tym duhani.

— Qenka errësirë, — tha gruaja.

Burri ndezi dritën. Ajo vuri re se dyshemeja ende ruante gjurmët e një të lare të nxituar. Një grumbull sendesh qenë hedhur pa kujdes në një qoshe. Edhe në dhomë i njëjti ajër i ndenjtur, i njëjti çrregullim, që i ngjallën mëzri.

— Më thua se jeton mirë, — foli ajo me qortim.

Burri u përkul dhe ngriti nja dy libra që kishin rënë mbi dysheme. Pastaj i hodhi asaj duart në bel.

— Bëre mirë që erdhe.

— Mirë, mirë, — iu përgjigj ajo duke u shkëputur prej tij, — lërmë të fshij njëherë këto pluhura.

Gruaja e re hoqi pallton, e vuri në një karrige, afër derës dhe hapì dritaret. Mbi qytetin e vogël varej një qiell i lagësht. Ngjyra gri futej e shkrihej në tërë peisazhin e atij qyteti. Kjo që përshtypja e saj e parë. Por, në vend që të fliste për natyrën, ajo pyeti:

— Vaso, përse më shikonin njerëzit ashtu...

— Si ashtu?!

— S'di si të them!

— Ndoshta u ke bërë përshtypje si fytyrë e panjohur. Njerëzit këtu njihen të gjithë.

Ajo u rrëqeth nga të ftohtët që u derdh në dhomë përmes dritares. Si ndenjën një copë herë të hutuar, burri u kujtua:

— Vera, tani duhet të shkoj.

— Kaq shpejt?

— Të thashë, sot është prova e parë. Dola vetëm të të pres, sepse sot...

— Ç'provë, — e ndërpreu gruaja, — akoma më atë projektin?

Ai u bind se gruaja s'do ta kuptonte dot rëndësinë e kësaj dite. Ajo as që e merrte me mend se ç'do të thoshte projekt i rekonstruksionit të furrës së një fabrike, për të cilin ai kishte dy vjet që punonte, prandaj e zuri nga krahët dhe u mundua të buzëqeshte.

— Duhet të shkoj tani.

Gruaja ktheu kokën mënjanë, ashtu siç bënte sa herë që donte të shprehte pakënaqësi për veprimet e të shoqit. Atëherë fytyra e saj e bukur, tiparet e imta fitonin një nuancë fëmijërore, kryeneçësie. Kjo e lëndonte gjithmonë burrin, që habitej se si ajo qenie e imtë të kishte një pushtet aq të fuqishëm ndaj tij.

— Vera, — foli me butësi, — s'besoj të vonohem shumë.

— Xhaxhai më porositi të të qortoj rëndë.

— Aha.

— Ai më tha se ti po i vë shkelmin së ardhmes sate.

— Vera...

— Më mori malli për ty, po s'do të kisha ardhur gjer këtu sikur...

Gruaja nuk e gjeti dot fjalën e përshtatshme

për ta çuar mendimin gjer në fund. Burri vuri buzën në gaz. Ai mendoi se xhaxhai i gruas së tij ishte njeriu më ngatërrestar në botë.

— Vera, u bëra vonë.

— Shko, shko, — tha gruaja e mërzitur. — Po ta dish, nuk më shpëton kollaj.

Ajo i tundi gishtin tregues përpara syve në mënyrë kërcënuese.

Burri veshi një xhup të vjetër, të ndotur me vaj, puthi gruan në buzë dhe doli. I erdhi keq që ajo nuk i uroi të paktën sukses. Tundi dorën në ajër i lënduar dhe fluturoi nëpër shkallë.

Kur mbeti vetëm në atë dhomë krejt të huaj për të, gruaja ndjeu zbrazësirë. Diçka të tillë ajo e kishte ndier sapo pat zbritur nga autobusi në këtë qytet të largët, që mbante erë tymi dhe vaji. Qëndroi në këmbë midis dhomës me përshtypjen e ftohtë të puthjes së burrit, që akoma s'i qe shqitur nga buzët. Në përgjithësi çdo gjë po i dukej e ftohtë këtu, dhe ai krevat portativ i mbuluar me batanije, edhe librat e mbytur nga pluhurat, si të gjitha sendet e hedhura në rrëmujë në atë dhomë.

Mbi komodinën e vogël në krye të krevatit ia tërhoqi vëmendjen një fotografi. E mori në dorë. Ai kishte dalë duke qeshur. Ajo me një seriozitet që nuk i shkonte karakterit të saj. U kujtua se qe fotografia e ditës së martesës. Diçka iu mblodh si lëmsh, duke parë ato figura të fiksuara, që e vështronin me një shikim të largët.

— Uh, — psherëtiu dhe e la fotografinë mbi komodinë. Mori një kovë që e gjeti në një qoshe dhe e mbushi me ujë. Pastaj i ktheu mbrapsht të gjitha sendet, i shkundi dhe i rregulloi. U mor kështu ndo-

një orë me këtë punë. Pasi i sistemonte të gjitha, i vështronte nga qoshja e dhomës. Përsëri ndërronte mendje. Diçka sikur nuk shkonte. I hynte punës nga fillimi: lëvizte krevatin, tryezën, raftin e librave, sobën. Më në fund iu mbush mendja se dhoma kishte marrë një pamje për të qenë. Megjithatë nuk u qetësua. Ata po grindeshin gjithmonë e më shpesh. Dhe herën e fundit që u takuan, ajo e kuptoi se diçka serioze nuk shkonte midis tyre. Kjo iu duk e tmerrshme. Pushtohet prej pasigurisë ndaj vetes, prej asaj pasigurie që e ndien kushdo që ndodhet para diçkaje të panjohur. Nuk ia merrte mendja se mund të vinte një ditë, që do t'i druheshin njëri-tjetrit.

Zhurma e fortë e ziles e shkundi nga mendimet. Ajo kujtoi se që i shoqi. Vrapoi të hapte derën. Në krye të shkallëve qëndronte një burrë.

— Ç'dëshironi? — e pyeti.

— Më falni, — tha burri me druajtje, — desha Vason.

— Nuk është këtu.

Ai po e vështronte me një kureshtje të veçantë, që e bëri të skuqej.

— Mos jeni Vera? — pyeti.

— Po, — iu përgjigj, e habitur që i panjohuri i dinte edhe emrin.

— E mora me mend, — tha ai. — Mua më quajnë Llazi. Jemi fqinjë.

Burri, që i krijoi përshtypjen e një abdalli, qëndronte në këmbë, duke rrotulluar nëpër duar kasketën. Flokët e zinj, të dendur, që i binin mbi ballin e pjerrët, i kishte krehur me kujdes.

— Sonte, si të thuash, kam festë, — kuptoni?

— foli ai përsëri. — Më ka lindur gruaja. Vajzë, është e katërta vajzë. Ju keni ardhur në kohën e duhur. Sonte, si të thuash, ju ftoj edhe ju.

— Faleminderit, — iu përgjigj pa e pasur mendjen, — do të vijmë me gjithë qejf.

Burri e përshëndeti, i shtrëngoi dorën midis gishtërinjve të ashpër dhe u largua nëpër shkallë.

Ajo mbylli derën. Përsëri mbeti vetëm. Filloi të zhgarraviste në një copë letër gjëra pa kuptim. Shkroi emrin e saj, të Vasos, vizatoi një njeri me çadër e pastaj diçka pa formë. Si u mërzi me këto, shkroi pesë herë radhazi fjalën «Vera». Në fund e mblodhi letrën shuk dhe e hodhi në sobë.

«Jam bërë si fëmijë,» — mendoi. I erdhi keq për veten. Iu duk i pamëshirshëm vendimi i të shoqit për të qëndruar s'dihej se për sa kohë ende në këtë qytet shoferësh (këtu vetëm shoferë kishte parë.) Dhe ajo marrëzisht kujtonte se çdo gjë do të ishte aq e lehtë, aq e bukur. Transferimi i Vasos në D. pothuajse u vendos. Por ai s'e kishte çarë kokën, ishte sjellë me një mendjelehtësi të pafalshme, gjer në idiotizëm. E vuri në pozitë të vështirë para njerëzve të saj, që bënë ç'ishte e mundur...

Qysh atëherë pasi ishin grindur, ata s'qenë takuar më. Ajo shpresonte se Vasoja do t'i kërkonte falje. Kishte pritur javën e parë, të dytën, kur ai kthehej zakonisht prej atij qyteti verior, por i shoqi nuk dukej. Ajo vështronte rrugën e zbratur, ku era luante me gjethet e fundit, me spiralet e shqetësuar të pluhurave që vërtiteshin nëpër trotuare dhe pushtohej nga ankthi. Por gjithashtu e dinte se Vasoja, me atë naivitetin e tij të natyrshëm, ndonjëherë ishte kokëfortë, se të gjitha këto i bënte nga

kryeneçësia. Atëherë edhe ajo bëhej kryeneçe. I vinte inat që ai mund të qëndronte një kohë kaq të gjatë pa e parë, zemërohej, qante fshehurazi, gjer-sa më në fund e humbi durimin. I dërgoi një telegram dhe u nis për herë të parë për në atë qytet të panjohur...

Mbi pullazet e çatave retë e errëta u shpërndanë si njolla të murme. E mërziti vetmia. E lodhën mendimet. Ajo hodhi pallton krahëve dhe doli. Një rrugë e gjerë e përshkonte atë qendër të vogël nga kreu në fund. Herë-herë kamionë të ngarkuar kalonin me uturimë. Tutje male të ashpra, të larta e të ftohta.

— Paskeni dalë të shëtisni, — dëgjoi një zë prapa krahëve.

Ishte Llazi. Por ajo s'kishte dëshirë të bisedonte. Donte të sorollatej e vetmuar. Dhe sa i çuditshëm ky Llazi, që po i shfaqej kudo...

— Më falni, — i tha, — nuk ju vura re.

Ai mbante në dorë një trastë.

— Është hera e parë që vini te ne? — e pyeti.

— Po.

— A ju pëlqen?

Gruaja e re u ndodh ngushtë.

— Si t'ju them, s'e kam parë akoma qytetin.

I erdhi ligsht që po gënjente.

— Ka njerëz që mërziten te ne, — tha burri pa të keq. — Një herë këtu erdhi një mjek, që dëndeji tërë ditën me fërnet. Më vonë morëm vesh se që ndarë me të fejuarën, ndaj pinte aq tepër.

Ajo e vështroi me dyshim. Një lëvizje nervoze ia përshkoi trupin.

— Ndodh ndonjëherë kështu, — shtoi ai me një afërsi të tillë, sikur njiheshin prej kohësh.

— Ndodh edhe kështu, — përsëriti ajo në mënyrë të pavetëdijshme me vete. Ky mendim iu duk qesharak. Edhe Llazi me ata flokë të krehur me aq kujdes iu duk qesharak. Edhe shëtitja me këtë njeri të panjohur, në këtë vend të panjohur, iu duk e çuditshme.

Vera s'e ç'deshi të thoshte, por befas, nga kreu i rrugës së gjerë u dëgjua një bori makine. Njerëzit kthyen kokën. Makina e bardhë me dritën blu, që lëshonte reflekse të trembura në tisin e mbrëmjes, kaloi me shpejtësi pranë tyre, duke lënë prapa pis-kamat e alarmit. Pastaj u humbi nga sytë në një kthesë.

Njerëzit u shpërndanë dhe në trotuarin e zbrazur mbeti vetëm ajo me Llazin, që vështronte akoma në kthesën nga u zhduk makina. Përballë tyre, pas vitrinave të ndritshme qëndronte një kasap faqekuq me duar të mbështetura mbi banak. Pastaj edhe Llazi iku. Asaj iu duk se vuri re një shqetësim të turbullt në fytyrën e tij. Sigurisht, makinat e ambulancës kishin punën e tyre dhe ajo mendoi se s'kishte përse të shqetësohej. Ngjiti me përtim shkallët e larta të pallatit. Rrotulloi çelësin me duart e ngri-rra. Nga apartamenti përballë ndiheshin të qarat e një fëmije. U shtri mbi krevat dhe ndenji ashtu gjersa i hynë të dridhurat. Pastaj dikush trokiti. Ajo kërceu fluturimthi nga shtrati dhe hapi derën.

— Shyqyr që erdhe, — tha e përgjumur.

Burri nuk foli. Ai dukej i lodhur. Vetëm kur u fut brenda, Vera vuri re sytë e tij të vrarë, fytyrën

e mavijosur nga të ftohtët dhe të mbuluar me blana të errëta vaji.

— Kujtoja se flije, — tha ai.

Zëri i tij qe i ftohtë.

— Vaso, ç'ke kështu?

Burri mori frymë thellë.

— Për pak na u vra një shok, — tha me zë të mbytur.

Gruas iu kujtuan piskamat e makinës së urgjencave, pastaj fytyra e turbullt e Llazit.

— E parandjeva, — tha ajo.

— Çfarë?

— Unë pashë një makinë, isha me Llazin.

— E paske njohur Llazin?

— Na ka ftuar sonte për darkë.

Burri psherëtiu.

— Llazi është në spital, dhuroi gjak.

Pastaj ata heshtën. Vera vështroi tiparet e tij të hequra, xhupin e ndotur dhe vuri re se gjatë kësaj kohe ai sikur qe bërë njeri tjetër, sikur nuk ishte më ai Vasoja i saj i butë, i sjellshëm. I erdhi keq për të. I lëmoi flokët. Ai i zuri dorën dhe ia largoi.

— Më lër — i tha.

— Vaso!

Era u përplas me forcë në qelqet e dritareve.

— Atë e dërguan në spital.

Vera u ngjeth. Vasoja u ngrit nga karrigia dhe qëndroi pranë dritares. Matanë nata kishte mbështjellë qytetin. Një hije e gjatë projektohej në muret e dhomës. Ai e ndiente me tërë peshën zbrazësinë e kësaj nate të ftohtë, që përzihej me vuajtjen e një dështimi të papritur. Asgjë nuk i hynte në sy, as grujaja, as dhoma e rregulluar, asgjë që ndodhej pranë tij. Donte të ngashërehej, por instinkti i vjetër prej



fshatari i thoshte se lotët s'janë për burrat. Donte të zbrazej, t'i hapej dikujt dhe më mirë se gruas së tij mbase nuk do t'i qajej asnjë njeriu tjetër. Por ai ndiente diçka që e largonte prej saj, diçka të egër, që i vërshonte përbrenda, sepse i dukej sikur në gjendjen e tij, edhe ajo, me ato qarjet e pafund, me ato ankesat që ia kishin sjellë shpirtin në majë të hundës, kishte një pjesë të madhe. Bile tani nuk ndiente atë dhemshurinë karakteristike për të, as atë ndjenjë të çuditshme inferioriteti.

Gruaja vajti ngadalë dhe u mbështet pas tij. Burri nuk lëvizi. Gruaja ndjeu frymëmarrjen e tij të rëndë.

— Vaso, përse më flet kështu?

Burri heshti. Ai vështronte tej dritares.

— Të gjithë janë në spital, — tha me zë të ulët.

Vera i shtrëngoi supet.

— Ata po japin gjak, ai kishte humbur shumë gjak.

— Ti je lodhur shumë, — tha gruaja, — ke nevojë të pushosh.

— S'kam nevojë për asgjë tani.

— Unë të kisha thënë, kot i hyre kësaj pune, edhe xhaxhai...

Befas burri u kthye nga ajo dhe e zuri fort nga supet.

— Vera, s'të kam pyetur, përse erdhe gjer këtu?

Gruaja e ndjeu veten ngushtë.

— Më mori malli...

Ai vuri buzën në gaz. Qe një e qeshur e hidhur.

— Pse më gënjen, Vera?

Gruaja u struk pas shpatullave të tij.

— Vaso, pse më flet kështu?

— Unë e di. Ke ardhur të më qortosh, ke ardhur të më thuash se të kam turpëruar me njerëzit e tu, që po bëjnë aq tepër për mua.

— Vaso!

Ai e shkundi përsëri nga supet. Për herë të parë po e ndiente veten të fortë, të lirë dhe kjo e lehtësoi.

— Dëgjo Vera. Sot për pak na u vra një shok. E di? Një shok... Një punëtor që vlen një mijë herë më tepër se gjithë xhaxhallarët e tu së bashku...

— Vaso, — thirri Vera përmes lotëve, që iu derdhën me dënësë. — Ç'ke me mua?

Ai e lëshoi, u ul në karrige i lodhur. Pastaj u ngrit dhe mbërtheu xhupin.

— Unë po shkoj, — i tha me butësi, — më fal, s'desha të të fyeja, por dotë bëjmë rojë pranë tij gjer në mëngjes. Ti fli në krevat. Po të kesh ftohtë hidh sipër pallton time. Është në dollap.

Vera mbeti si e ngrirë në dhomën e zbratur. As vetë nuk e kuptoi se sa kohë qëndroi ashtu. Diçka e rëndë i mblodh në shpirt. Ajo nuk vuri re as flokët e butë të borës që filluan të zbardhnin pullazet e strukura, as arabeskat në xhamin e dritares. Vonë, shumë vonë, dëgjoi vetëm të qarat e një fëmije dhe mendoi se edhe gruaja e Llazit duhej të ishte vetëm. Edhe ajo kishte nevojë për një njeri. Fshiu sytë, që të mos dukeshin gjurmët e lotëve dhe trokiti në apartamentin përballë.

— Kush është? — u dëgjua nga brenda një zë gruaje e pastaj përsëri të qarat e fëmijës.

— Jam unë, fqinja e re, — foli gruaja me zë të butë.

## NË VERË BUZË DETIT

Atë pasdite qëndrova në çadër dhe nuk dola të shëtisja bregut të detit si zakonisht. Nga pjesa e saj e hapur dallohej transparenca e kaltër e qielit, që pasqyrohej mbi ujin e detit me një ngjyrë çuditërisht të gjelbër. Dukej sikur në atë gji përzihej e tretej butësia e tërë ngjyrave të natyrës, që të ngjallte në shpirt diçka të ëmbël.

Befas vura re siluetën e gjatë të një njeriu, që zuri hyrjen e çadrës me trupin e tij të madh. Ai qëndroi ashtu disa sekonda dhe u fut brenda me shtatin gjysmë të përkulur. Ishte nëndrejtori.

U ngrita ndenjtur dhe lashë mënjanë një libër, të cilin po e mbaja në dorë thujse kot prej më se një ore.

— Ç'po bën? — më pyeti.

— Hiç, — i thashë, — desha të lexoja.

Nëndrejtori im, një mesoburrë, tepër i rregullt

në detyrë, i përpiktë deri në përsosmëri, gëzonte respektin e tërë personelit pedagogjik. Ndjenjën e rregullit ai e manifestonte gjer në hollësitat më të vogla, pa bërë fjalë për paraqitjen e tij personale, që mund të të ngjallte vetëm admirim. Fliste me zë të butë e të shtruar. Gjatë dimrit, meqë flokët i qenë rralluar, mbante një borsalinë që u shkonte ti-  
pareve të tij të buta, ndërsa në verë kishte qejf të vishte këmishë me ngjyrë të bardhë. Kur vinte për kontroll nuk merrej me cikërrima, dëgjonte me vëmendje, herë pas here mbante shënime në bllokun e tij dhe, kur mbetej i kënaqur, tundte kokën.

— Hëm, — ia bëri nëndrejtori, — ju siguroj se këtu ka njëqind mënyra për të kaluar kohën.

Unë e vështrova i habitur nga theksi i veçantë me të cilin i shqiptoi këto fjalë. Atëherë munda të vija re se ai ishte i turbulluar. Balli i qe mbushur me djersë, fytyra i qe zbehur, sytë fshihnin një alarm të pazakontë.

— Ç'kemi, nëndrejtor, — i thashë, — si është puna?

Ai uli kokën. Fërkoj duart me njëra-tjetrën, psherëtiu, pastaj u dha prapa flokëve të rrallë.

— Asgjë... Po desha t'ju kujtoja se këtu, as mua e as ju nuk na kanë sjellë për konvaleshencë.

Valët e detit u përplasën pas bregut qetësisht. Prej ishullit të Sazanit, si gunga e një gamileje të zhytur në ujërat e kripura, gjer në hundën e Karaburunit varej një re e kuqërremtë.

— S'po ju kuptoj, — i thashë.

— Hëm... Sigurisht! Unë dhe ju rrimë shtrirë tërë ditën, si të ishim me pushime, por s'dimë ç'ndodh rreth nesh.

Padashur më hipi t'ia shkrepja gazit. Nëndrejtori gjithmonë u jepte ngjarjeve një ngjyrë kurioze, si ata njerëzit që e kanë të zhvilluar jashtë mase ndjenjën e fshehtësisë së vogëlimave dhe i veshin sendet me mjegulla enigmatike. Kjo i ndodhte sidomos kur merrte vesh ndonjë kontroll nga seksioni i arsimit. Në këto raste nëndrejtori, ndonëse njeri i arsyeshëm, për t'i dhënë gështjes seriozitet, bëhej me të vërtetë i padepërtueshëm. Nganjëherë mbyllej disa orë në zyrën e tij dhe së fundi, atë gështje që qe e zakonshme dhe e thjeshtë, ua shtronte mësuësve në mënyrë tepër të ndërlikuar. Por seksionit të arsimit as që i shkonte ndër mend të bënte kontrole këtu, në kodrat e Jonufrit, ku nxënësit tanë po hapnin tarraca agrumesh.

— Më falni, — i thashë, — sot nuk më dukeni në rregull.

Ai më vështroi me ngulm. Punonim së bashku prej tre vjetësh dhe kishim një ndryshim të madh në moshë. Megjithëse kolegë, me të sillesha si nxënësi para mësuesit. Largësia ime i pëlqente, këtë e kisha vënë re, por kjo shkaktonte tek ai të kundërtën. Sa më me respekt i sillesha, aq më tepër më afronte, shpesh harronte që isha në një farë mënyre vartësi i tij dhe më trajtonte si shok.

— Vërtet, mbase ke të drejtë, — tha dhe u ul në cep të krevatit. Pastaj më kërkoi një cigare.

Kapanonet e nxënësve ndodheshin fare pranë bregut të detit. Tani ata çlodheshin, dikush lexonte ndonjë libër, ndërsa një grup vajza qenë ulur në gurët e rrumbullakët e të limuar. Herë pas here ato hidhnin guriçka mbi kreshtat e valëve. Pulëbardhat klithnin. Lart, mbi horizont, dielli varej mbi ujërat

e gjiut, sipër resë së përflakur, që dukej si një vello e kuqe.

— Mbase ke të drejtë, — përsëriti nëndrejtori.  
— Por unë nuk e di, s'më ka qëlluar kurrë një rast i tillë.

— Si është puna, — i thashë unë, — s'po marr vesh asgjë.

— Sigurisht! Dhe vërtet një rast që s'më ka qëlluar kurrë!

Piro Lakoja, ai maturanti, së bashku me një nxënëse të vitit të tretë, me Veronika Ninin, pasi hëngrën drekë, s'kanë rënë të shtrihen e të pushojnë me shokët. Bexheti më tha se i kishte parë të shkonin bregut të detit.

Nëndrejtori thithi fort cigaren, por, meqë zakonisht nuk e pinte, e zuri një kollë e fortë.

— Për këtë jeni shqetësuar? — e pyeta.

Ai u vrenjt. Mbështeti kokën në pëllëmbën e dorës, ndërsa njëren këmbë filloi ta përplaste përtokë ritmikisht, me nervozizëm. Picërroi sytë i mërzitur dhe, papritur, me një zë shumë energjik, më tha:

— E dini, Fuat? Këtë pyetje ia bëra unë i pari Bexhetit, e pas tij ia bëra vetes. Përse të shqetësohemi? Ç'ka këtu për t'u shqetësuar? Asgjë. Por ama, sapo ai mësues m'i tha këto fjalë, më bëri një përshtypje të keqe. Ç'domethënë kjo?

Unë desha të thosha diçka në formë aprovimi të mendimit të tij, diçka të tillë si «sigurisht» apo «domemos». E vërteta është se e tërë kjo skenë m'u duk komike. Për më tepër më bënte përshtypje se si nëndrejtori im, burrë i mençur e i shtruar, njeri me arsye të fortë, të tundohet nga ngasje të tilla fëmijërore. Por ai nuk më la të flisja dhe vazhdoi:

— Ama ne, ose, më saktë të them, unë, se ti je akoma i ri, nuk jam vetëm mësues apo nëndrejtor, por edhe prind. E, si prind, edhe unë kam ndjenja prindërore. Na i kanë besuar, Fuat, këta fëmijë. Por ata nuk janë fëmijë. . .

Ai heshti. Nga turpi që ndjeu kur tha këto fjalë, ktheu kokën mënjanë. Nëndrejtori, pa dyshim, e kuptoi flagrancën e arsytimit të tij, që ia shfaqte një tjetri aq hapur, për më tepër një kolegu të punës, një mësuesi fillestar.

Unë u trondita. Ngaqë s'dija ç'të bëja, u ngrita në këmbë e veshi një bluzë të hollë pambuku, me mëngë të shkurtra. Ajri i rëndë i çadrës po më zinte frymën. M'u duk sikur diçka më kapi prej fyti. Fjalët më mbetën të mbytura në grykë, siç ndodh ndonjëherë në ëndrrat e këqija të gjumit, kur përpiqesh të thërrasësh e s'thërret dot, kur përpiqesh të vraposh e s'mundesh dot, rrëzohesh rakapjekthi, trupi të rëndohet si plumb, gjersa të del gjumi, psherëtin i lehtësuar, i mbytur në djersë, e kupton se gjithçka ishte një ankth i kotë.

— Nëndrejtor, unë e di, por... Kjo në fakt s'ka asnjë lidhje.

— Ç'farë? — tha nëndrejtori duke fshirë sumbullat e djersës.

— Nuk ka asnjë lidhje, më falni. Ju përmendët ndjenjat prindërore e mbase unë s'i kuptoj. Ç'hyjnë këtu ndjenjat prindërore, kur ne kemi parimet tona? Kjo është kontradiktore, nëndrejtor, ju vetë e thatë se ne s'kemi të bëjmë me fëmijë. Vërtet ne i mësojmë, por këto mësimet e këtë edukatë nuk ua japim ashtu, kuturu, si të më teket mua. Ne kemi normat tona. Pra ne i mësojmë nxënësit, por mos

harroni, edhe ata na gjykojnë për veprimet që mund të bëjmë.

Ai mbeti si i përhumbur. U përpoq të mposhte tronditjen e brendshme, t'i jepte zërit një ton të sigurtë, atë sigurinë karakteristike që kishte kur jepte konkluzionet e kontrolleve.

— Unë s'ju zura në gojë asgjë nga këto. Nuk është nevoja të më flisni për normat... Çështja është se ne ndodhemi para një problemi.

— Oh, nëndrejtor, për çfarë problemi e keni fjalën? Kjo gjë mua më duket fare e thjeshtë. Për më tepër ju flisni sikur ata nxënës të ishin larguar fshehurazi e tinëzisht, si ca hajdutë, që kanë frikë nga njerëzit. Përse i gjithë ky dyshim, kur vetë Bexheti i paska parë tek shkonin bregut të detit? Ç'të keqe shihni në këtë mes?... Jo, jo, mos më ndërprisni. Ky është thjesht një mosbesim fiktiv...

— Fuat, s'lejoj të më flisni me këtë gjuhë...

— Epo mirë, nëndrejtor. Edhe unë kam të drejtë të them mendimin tim. Aq më tepër që për nxënësit në fjalë kam mendimin më të shkëlqyer. E pse, nëndrejtor, a nuk janë ndër nxënësit më të mirë që kemi në shkollë? A nuk po punojnë këtu për mreku-lli? A nuk është i padrejtë bile dyshimi që hidhni mbi ta, ja kështu, ditën me diell?

— Fuat!

Atë çast ngriti fletën e çadrës dhe hyri mësuesi i kimisë, Bexheti. Hyrja mbeti e hapur e prej andej dukej gjiri i thellë, i qetë, me një shkëlqim verbues. Pulëbardhat silleshin rrotull, fluturonin mbi sipërfaqe me britma, fshiknin me krahë ujërat e kaltra, pastaj ngriheshin vërtikalisht përpjetë me një gëzim të çartur.



— Puna është se çdo gjë ta zgjidhim pa bujë. S'ka nevojë të bëjmë zhurmë të kotë. Ç'mendon ti, Bexhet? Pavarësisht se si qëndrojnë gjërat, s'ka asnjë të keqe që ne të bëjmë punën tonë...

Mësuesi i kimisë përpara disa vjetëve kishte mbaruar fakultetin. Studimet i patëm kryer njëkohësisht e, pas një shërbimi trevjeçar në fshat, filluam menjëherë të jepnim mësim në të njëjtën shkollë të mesme të qytetit. Ai kishte një trup të lidhur prej atleti, fytyrë të bukur, serioze, një seriozitet të sforcuar, që s'para i shkonte temperamentit të tij të gjallë. I pëlqente shoqëria e gjerë, e zhurmshme, i binte kitarës, këndonte, luante basketboll me skuadrën e dytë të qytetit. Ai zinte shumë shpejt miqësi me njerëzit, të cilët e pëlqenin menjëherë e u hynte në zemër.

Mbase për arsye të karakterit tim disi flegmatik, që kur ishim në fakultet (për këtë ndikoi edhe fakti që ndiqnim degë të ndryshme) e më vonë në fshat, në mënyrë të heshtur kuptuam, secili në vetvete, se s'mund të bëheshim miq të ngushtë. Prej vitesh nisi një tërheqje e ngadalshme, e dyanshme, pa ndonjë shkak, gjersa marrëdhëniet tona u ftohën, u reduktuan në ndjenjën e respektit reciprok.

Bexheti ngrysi vetullat.

— Unë jua thashë, nëndrejtor. Është mirë t'i kërkojmë, ndërsa nesër t'i nxjerrim para nxënësve. Le t'u bëhet mësim të gjithëve kjo.

— Çfarë? — thashë unë dhe ndjeva se po skuqesha.

Bexheti bëri sikur nuk e vuri re shqetësimin tim. Nëndrejtori u ngrit në këmbë e doli jashtë. Ne

e ndoqëm nga pas. Kumi i imtë ishte ende i ngrohtë. Tek-tuk xixëllonin kokrrizat e kuarcit. Një grup djem po luanin futboll. Vajzat qenë shpërndarë anës bregut e me këmbët në ujë sodisnin detin. Tutje, si në një mjegull të hollë, dukej maja e direktut të një anijeje të mbytur.

— Mirë, — tha nëndrejtori duke mermëritur, — edhe unë ashtu mendoj. T'i gjejmë njëherë, pastaj shohim e bëjmë.

— Cilin të kërkojmë, çfarë të gjejmë, — thashë unë, — ç'domethënë kjo?

Nëndrejtori tundi dorën i mërzitur, me padurim.

— Mjaft, — thirri ai. — Përse shtireni kaq naiv? Ne s'po bëjmë asgjë të keqe. Fundja kjo do të mbetet midis nesh.

Bexheti nuk foli. Ndjeva se po më hipte gjaku në kokë; desha të kundërshtoja, t'i thosha nëndrejtorit se s'më pëlqenin punëra të tilla, se s'kisha ardhur këtu të bëhesha qesharak me nxënësit, por ai më vuri dorën në sup e me tonin e tij të zakonshëm e të butë më tha:

— Ju lutem. Të paktën bëjeni këtë për mua.

Pastaj u largua me çape të ngadalta, ndërsa unë mbeta në këmbë si i ngrirë, i mposhtur nga lutja e tij intime, pranë Bexhetit, që fishkëllinte nëpër dhëmbë.

— Nisemi? — tha Bexheti, — unë e marr me mend se ku janë.

E vështrova i pezmatuar, tek lëshonte mbi rërë një hije të gjatë si pikëçuditëse. U binda plotësisht se ishte ky njeri që kishte ndikuar me hamendjet e tij te nëndrejtori gjër në këtë masë.

— S'ma merrte mendja që të ishe për forma të tilla. Për të gjithë do ta besoja, por vetëm për ty jo.

Ai e ndjeu ironinë time.

— Ti nuk i njeh njerëzit, Fuat, — tha pas pak i qetë, me një lloj mospërfilljeje. — Ke mbetur një çikë, si të thuash, një çikë tip libresk. Ndërsa unë i shoh gjërat me një sy më praktik. Këtu është ndryshimi ynë. Për shembull, atë djaln e njoh mirë dhe s'më ka pëlqyer kurrë...

— Kurse mua jo, — thashë, — nuk e di për se mund të shahet ai djalë.

E lashë fjalën përgjysmë. Diskutime të tilla të kota më mërznisin.

— Dëgjo, — më tha Bexheti, — puna është të çojmë në vend porosinë e nëndrejtorit. Unë do të shkoj bregut të detit, ndërsa ti do të ngjitesh në kodër. Takohemi atje, te kepi.

Kep ne quanim një grumbull shkëmbinjsh mbi ujë, që futeshin thellë në det si pykë. Mendimi se po vihesh në ndjekje të nxënësve m'u duk qesharak. Edhe vetja m'u duk qesharake. Në veprimin tim kishte diçka anormale.

Kur u takuam, desha t'i thosha se nuk kisha dëshirë ta vazhdoja më tutje këtë lodër, por ai erdhi drejt meje me vrap, vuri gishtin në buzë e më pëshpëriti në vesh:

— Mos fol, se na dëgjojnë. Ja tek janë!

Vështrova andej nga më tregoi Bexheti. Në fillim nuk dallova asgjë. Një grumbull shkëmbinjsh të zinj, tërë vrime e guva të vogla, çanin ujërat, futeshin si pykë në det e ngjanin si një gjemi e mby-

tur, e përplasur në breg. Ai më tërhoqi nga mënga dhe u futëm pas një shkëmbi.

— Kjo është marrëzi, — murmurita.

Ne kishim qëndruar përballë njëri-tjetrit, të ulur mbi rërë. Mbase kurrë nuk kishim qëndruar kaq pranë dhe kjo na shqetësonte të dy.

— Të lutem, zgjat pak kokën të vështrosh, nuk janë larg, as njëzet metra, — tha Bexheti, si duke u tallur me mua.

M'u tha pështyma në grykë. Shkopsita bluzën që më shtrëngonte qafën dhe qëndrova më dysh.

Ai më shtyu lehtë, duke vënë buzën në gaz.

— Shiko, shiko, — më tha, — pse trembesh?

Zgjata kokën si hajdut e tutje, mbi një shkëmb gri, ku ujërat lëviznin e dyndeshin me zhurmë, vura re dy trupa të vegjël. Djali, që mbante në dorë fillin e një grepi, herë pas here e tërhiqte dhe e flakte përsëri në ujë, duke u tundur. Vajza, me një shall të zakonshëm aksioni që ia rrëmbente era, qëndronte pa lëvizur. Ata diçka i thoshin njëri-tjetrit me zë të lartë, por fjalët nuk i dëgjonim nga zhurma e valëve.

— E, — më tha Bexheti, — romantike, ë? Ka gjetur çupën më të mirë, rrufjani.

— Kjo është e turpshme, — thashë mbyturazi.

Ai buzëqeshi. U ngjit mbi shkëmbinjtë, u hodh me kërcime të vogla si njeri i stërvitur dhe vajti te nxënësit. Ata kthyen kokën të hutuar. Vajza u ngrit në këmbë e mbante me dorë fustanin që ia rrëmbente era. Djali qëndoi i ulur gjersa tërhoqi fildispanjën. Pastaj u ngrit me një lëvizje të ngathët. Një copë herë qëndruan që të tre mbi shkëmb, pranë dallgë-

ve që thyheshin me stërkala, si të donin të shkallmonin atë grumbull gurësh që u dilte përpara me kryeneçësi. Me sa dukej Bexheti u kërkonte shpjegime, i qortonte apo diçka të tillë. Vetëm ai fliste, duke tundur duart në ajër. Nxënësit heshtnin. Kur erdhën pranë meje, fytyrat i kishin të skuqura.

— Shumë keq, shumë keq, — po thoshte Bexheti, të cilit, për çudi, nuk po i kujtohej ndonjë frazë tjetër më e përshtatshme.

Djali futi duart në xhepa. Mbase në këtë mënyrë ai shprehte mospërfilljen për ne, për mua e për Bexhetin.

— Ti, vajzë, do të vish me mua, — i tha ai nxënëses, — do të nisemi përpara. Ju qëndroni pak dhe ecni pas nesh.

E dëgjova pa qenë në gjendje të thosha asnjë fjalë. Ata u larguan anës bregut. Unë mbeta vetëm me djalin. Ai kopsiti bluzën sportive, mori frymë thellë dhe psherëtiu. Qëndronte para meje si i shushatur. Edhe unë isha si i shushatur.

— Sot është ditë e bukur, — desha të hapja bisedë, por zëri m'u duk i akullt, i huaj, tmerrësisht i huaj.

Ai heshti. Unë bëra disa hapa në kumin e imtë dhe vura re tutje në det një grup delfinësh që u shfaqën papritur. Fillova të shikoja delfinët. Ata dilnin mbi ujë e përsëri zhyteshin me kërcime të gjata. Edhe djali filloi të shihte delfinët. Mbase që e vetmja gjë që mund të bënim në ato çaste. Ai s'kishite dëshirë të më dëgjonte, por edhe unë s'kisha dëshirë të flisja. Më në fund edhe delfinët u zhdukën diku, në thellësi të gjirit.

— Ikim, — i thashë.

Ai përsëri nuk foli. Më vështroi me një mënyrë që s'kam për ta harruar gjithë jetën.

— Më vjen keq për ju, mësues, — më tha, — nuk e besoja që...

Por ai nuk e mbaroi frazën gjer në fund dhe iku me vrap. M'u duk sikur dikush më goditi me shuplakë në fytyrë.

## PASQYRA E LËNDËS

— Kur hyja në jetë .....	3
— Dhurata e ditëlindjes .....	14
— Dy letra .....	22
— Fqinjët .....	65
— Fëshfërima e erës .....	88
— Nënë Hasimeja .....	100
— Një rast i veçantë .....	108
— Centralistja .....	120
— Në agimin e një dite .....	133
— Mure të rrëzuara .....	169
— Sesion i vështirë .....	174
— Kushëriri .....	188
— Shokë të një klase .....	199
— Linda .....	211
— Trokitje .....	225
— Në verë, buzë detit .....	235